



KODI I PROCEDURËS PENALE

I

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë, 2018

ISBN: 978-9928-01-081-0

Shtypur në shtypshkronjën e Qendrës së Botimeve Zyrtare

Adresa:

Rruga “Nikolla Jorga”

Tel/fax: +355 42 427005, 04 2427006

E-mail: info@qbz.gov.al,

Web: www.botimezyrtare.gov.al

PËRMBAJTJA E LËNDËS

	Neni	Faqe
PARIMET KRYESORE TË PROCEDIMIT PENAL	1-10	7
I. SUBJEKTET E PROCEDIMIT PENAL		
1. Gjykata	11-23	11
a) <i>Funksionet dhe përbërja e gjykatave</i>	11-14/a	11
b) <i>Rastet e papajtueshmërisë me funksionet e gjyqtarit në gjykim</i>	15-23	14
2. Prokurori	24-29	18
3. Policia gjyqësore	30-33	22
4. I pandehuri	34-47	24
5. Mbrojtësi i të pandehurit	48-57	34
6. Viktima, viktima akuzuese, paditësi dhe i padituri civil	58-68	39
II. JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCAT		
1. Juridiksioni	69-73	46
2. Kompetenca	74-97	48
a) <i>Kompetenca lëndore</i>	74-75/b	48
b) <i>Kompetenca tokësore</i>	76-78	49
c) <i>Kompetenca për shkak bashkimi të procedimeve</i>	79-82	51
ç) <i>Disponimet për shkak të moskompetencës</i>	83-88	53
d) <i>Mosmarrëveshjet për kompetencat</i>	89-91	55
dh) <i>Bashkimi dhe ndarja e çështjeve</i>	92-93	56
e) <i>Transferimi i çështjes</i>	94-97	57
III. AKTET, NJOFTIMET DHE AFATET		
1. Aktet	98-131	59
a) <i>Rregulla të përgjithshme</i>	98-111	59
b) <i>Aktet e gjykatës</i>	112-114	64
c) <i>Dokumentimi i veprimeve</i>	115-122	65
ç) <i>Përkthimi i akteve</i>	123-127	69
d) <i>Pavlefishmëria e akteve</i>	128-131	71

	Neni	Faqe
2. Njohjet	132-143	73
3. Afatet	144-148	80
IV. PROVAT		
1. Rregulla të përgjithshme	149-152	82
2. Llojet e provave	153-197	84
a) Dëshmia	153-165/a	84
b) Pyetja e të pandehurit dhe e palëve private	166-168	92
c) Ballafaqimet	169-170	94
ç) Njohjet	171-175	94
d) Eksperimenti	176-177	97
dh) Ekspertimi	178-186	98
e) Provat materiale	187-190	102
f) Dokumentet	191-197	103
3. Mjetet e kërimit të provës	198-226	106
a) Këqyrjet	198-201/b	106
b) Kontrollat	202-207	111
c) Sekuestrimet	208-220	115
ç) Përgjimet	221-226	122
V. MASAT E SIGURIMIT		
1. Masat e sigurimit personal	227-259	128
a) Rregulla të përgjithshme	227-231	128
b) Masat shtrënguese	232-239	130
c) Masat ndaluese	240-243	134
2. Caktimi dhe zbatimi i masave të sigurimit	244-250	135
3. Arrestimi në flagrancë dhe ndalimi	251-259	140
4. Revokimi, zëvendësimi dhe shuarja e masave të sigurimit	260-267	145
5. Kompensimi për burgim të padrejtë	268-269	151
6. Masat e sigurimit pasuror	270-276	152
a) Sekuestroja konservative	270-273	152
b) Sekuestroja preventive	274-276	153
VI. HETIMET PARAPRAKE		
1. Dispozita të përgjithshme	277-279/a	154

	Neni	Faqe
2. Marrja dijani për veprën penale	280-287	157
3. Kushtet e procedimit	288-292	161
4. Veprimtaria me iniciativë e policisë gjyqësore	293-303	163
5. Veprimtaria e prokurorit	304-315	173
6. Sigurimi i provës	316-322	178
7. Afatet e përfundimit të hetimeve	323-326	183
8. Përfundimi i hetimeve	327-331	185
9. Seanca paraprake	332-332/gj	192
VII. GJYKIMI		
1. Veprimet përgatitore	333-338	199
2. Shqyrtimi gjyqësor	339-378	201
<i>a) Rregulla të përgjithshme</i>	339-347	201
<i>b) Veprimet paraprake</i>	348-358	205
<i>c) Marrja e provave</i>	359-371	210
<i>ç) Akuzat e reja</i>	372-377	218
<i>d) Diskutimi përfundimtar</i>	378-378/a	221
3. Vendimi	379-399	222
<i>a) Marrja e vendimit</i>	379-386	222
<i>b) Vendimi i pushimit të çështjes dhe i pafajësisë</i>	387- 389	225
<i>c) Vendimi i dënimit</i>	390-399	227
4. Gjykimet e posaçme	400-406	230
<i>a) Gjykimi i drejtpërdrejtë</i>	400-402	230
<i>b) Gjykimi i shkurtuar</i>	403-406/ç	233
<i>c) Gjykimi me marrëveshje</i>	406/d-406/f	238
VIII. ANKIMET		
1. Rregulla të përgjithshme	407-421	242
2. Apeli (gjykimi në shkallë të dytë)	422-430/1	248
3. Rekursi në Gjykatën e Lartë	431-448/1	254
<i>a) Rregulla të përgjithshme</i>	431-435	254
<i>b) Shqyrtimi në Gjykatën e Lartë</i>	436-438	256
<i>c) Vendimi</i>	439-448/1	257
4. Rishikimi	449-461	261

	Neni	Faqe
IX. EKZEKUTIMI I VENDIMEVE		
1. Vënia në ekzekutim e vendimeve	462-469	266
2. Shqyrtimi nga gjykata i çështjeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve	470-480	270
3. Gjendja gjyqësore	481-484	274
4. Shpenzimet procedurale	485-487	276
X. MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA		
1. Ekstradimi	488-505	277
<i>a) Ekstradimi për jashtë shtetit</i>	488-503	277
<i>b) Ekstradimi nga jashtë shtetit</i>	504	286
2. Letërporositë ndërkombëtare	505-511	287
a) Letërporositë nga jashtë shtetit	505-508	287
b) Letërporositë për jashtë shtetit	509-511	289
3. Ekzekutimi i vendimeve penale	512-523	290
<i>a) Ekzekutimi i vendimeve penale të huaja në Shqipëri</i>	512-518	290
<i>b) Ekzekutimi jashtë shtetit i vendimeve penale shqiptare</i>	519-523	294
Dispozita të fundit	524-525	296
Treguesi alfabetik		299

LIGJ
Nr.7905, datë 21.3.1995

KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

(ndryshuar me ligjet: nr. 7977, datë 26.7.1995, 8027, datë 15.11.1995, nr. 8180, datë 23.12.1996, nr. 8460, datë 11.2.1999, nr. 8570, datë 20.1.2000, nr.8602, datë 10.4.2000, nr. 8813, datë 13.6.2002, nr.9085, datë 19.6.2003, nr. 9187, datë 12.2.2004, nr. 9276, datë 16.9.2004, nr. 9911, datë 5.5.2008, nr. 10 054, datë 29.12.2008, nr. 145/2013, datë 2.5.2013, nr. 21/2014, datë 10.3.2014, nr.99/2014, datë 31.7.2014, nr. 35/2017, datë 30.3.2017; vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 55, datë 21.11.1997, nr. 15, datë 17.4.2003 dhe nr. 31, datë 17.5.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Detyrat e legjislacionit procedural penal

1. Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit.

Neni 2

Respektimi i normave procedurale

(Shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.

2. Dispozitat procedurale penale janë të zbatueshme edhe për të pandehurit e mitur për aq sa nuk parashikohet ndryshe në ligjin e posaçëm në fuqi.

Neni 3

Pavarësia e gjykatës

1. Gjykata është e pavarur dhe vendos në bazë të ligjit.

2. Gjykata jep vendim në bazë të provave që shqyrtohen e verifikohen në seancë gjyqësore.

Neni 4

Prezumimi i pafajësisë

(Shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.

2. Gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Neni 5

Kufizimet e lirisë së personit

1. Liria e personit mund të kufizohet me masa sigurimi vetëm në rastet dhe mënyrat e përcaktuara me ligj.

2. Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit poshtërues.

3. Të dënuarve me burgim u sigurohet trajtimi njerëzor dhe rehabilitimi moral.

Neni 6

Sigurimi i mbrojtjes

(Shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat në rastet e parashikuara nga ky Kod.

2. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t'i garantohen të drejtat procedurale dhe t'i ruhen interesat e tij ligjore.

Neni 7

Ndalimi i gjykimit dy herë për të njëjtin fakt

(Ndryshuar fjalë në titull dhe në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Askush nuk mund të gjykohet rishtas për të njëjtin fakt penal, për të cilin është gjykuar me vendim të formë së prerë, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga gjykata kompetente.

Neni 8

Përdorimi i gjuhës shqipe

(Shtuar fjalë në pikën 2 dhe shtuar pika 3, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Në të gjithë fazat e procedimit përdoret gjuha shqipe.

2. Personat që nuk dinë shqip përdorin gjuhën e tyre dhe, me anën e përkthyesit, kanë të drejtë të flasin e të marrin dijeni për provat e aktet, si dhe për zhvillimin e procedimit. Personat që nuk dëgjojnë

dhe nuk flasin kanë të drejtë të përdorin gjuhën e shenjave.

3. Shpenzimet e përkthimit dhe interpretimit paguhen nga shteti.

Neni 8/a

Provat

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Faktet në procesin penal provohen me çdo provë, me kusht që ato të mos cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

2. Organi procedues duhet të mbledhë dhe të shqyrtojë si provat që fajësojnë të pandehurin, ashtu edhe ato që janë në favor të tij.

Neni 9

Rivendosja e të drejtave

1. Personave që procedohen në kundërshtim me ligjin ose dënohen pa të drejtë u kthehen të drejtat dhe shpërblehen për dëmin e pësuar.

Neni 9/a

Të drejtat e viktimës nga vepra penale

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjatë procedimit penal, viktimat kanë të drejtat e parashikuara nga ky Kod.

2. Organet publike duhet të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohen nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara nga ky Kod.

Neni 10

Zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare, të pranuar nga shteti

shqiptar, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, si dhe dispozitat e këtij Kodi.

PJESA E PARË

TITULLI I SUBJEKTET

KREU I GJYKATA

SEKSIONI I FUNKSIONET DHE PËRBËRJA E GJYKATAVE

Neni 11

Funksionet e gjykatës

1. Gjykata është organi që realizon dhënien e drejtësisë.
2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor dhe të dënohet për kryerjen e një vepre penale pa vendim të gjykatës.

Neni 12

Gjykatat penale

Drejtësia penale jepet nga:

- a) gjykatat penale të shkallës së parë;
- b) gjykatat e apelit;
- c) Gjykata e Lartë.

Neni 13

Gjykatat penale të shkallës së parë dhe përbërja e tyre

(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002, nr.9276, datë 16.9.2004, nr.9911, datë 5.5.2008 dhe nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Veprat penale gjykohen në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas rregullave dhe përgjegjësi të caktuara në këtë Kod.

2. Gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykojnë me një gjyqtar:

a) kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake;

b) ankimi ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e ndjekjes penale apo pushimin e çështjes për kundërvajtjet penale;

c) kërkesa e prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes për krimet;

ç) kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq;

d) kërkesën e prokurorit për miratimin e urdhrit penal;

dh) kërkesat që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale;

e) kërkesat për rivendosje në afat;

ë) kërkesat që lidhen me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, sipas titullit X të këtij Kodi;

f) çdo kërkesë tjetër të parashikuar në këtë Kod apo në ligje të veçanta.

3. Gjykatat e rretheve gjyqësore gjykojnë me një gjyqtar veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 10 vjet. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

3/1. Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe. Kjo gjykatë gjykon me një gjyqtar akuzat penale kundër funksionarëve, sipas nenit 75/a, të këtij Kodi, për vepra penale të ndryshme nga korrupsioni dhe krimi i organizuar, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 10 vjet.

4. Gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse të krijuara sipas ligjit. Këto seksione gjykojnë edhe të pandehurit e rritur që akuzohen për kryerjen e veprave penale në dëm të të miturve.

5. Parashikimet e pikës 4, të këtij neni, nuk zbatohen në rastet e përcaktuara në paragrafin 1, të nenit 80, të këtij Kodi.

Neni 14

Gjykatat e apelit dhe përbërja e tyre

(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar pika 3 me ligjin nr.9085, datë 19.6.2003 dhe me ligjin nr.9276, datë 16.9.2004; shfuqizuar pika 2 me ligjin nr.9911, datë 5.5.2008; ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykatat e apelit shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykatat e rretheve gjyqësore.

2. Shfuqizuar.

3. Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shqyrton në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

4. Gjykimet për kërkesat e parashikuara në pikën 2, të nenit 13, shqyrtohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

Neni 14/a

Gjykata e Lartë dhe përbërja

(Shtuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 dhe ndryshuar me ligjin nr. 35/ 2017, datë 30.3.2017)

Gjykata e Lartë shqyrton rekursat në dhomë këshillimi me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në kolegje me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore në kolegje të bashkuara.

SEKSIONI II
RASTET E PAPAJTUESHMËRISË ME FUNKSIONIN
E GJYQTARIT NË GJYKIM

Neni 15

Papajtueshmëria për shkak të pjesëmarrjes në procedim

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjyqtari që ka dhënë ose që ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë të procedimit nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit në shkallët e tjera, as të marrë pjesë në rigjykim apo rishikim pas prishjes së vendimit.

2. Nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake ose në seancë paraprake për të njëjtin procedim. Gjyqtari që shqyrton kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit të seancës paraprake në të njëjtin procedim.

3. Nuk mund të ushtrojë në të njëjtin procedim detyrën e gjyqtarit ai që ka qenë prokuror ose që ka kryer veprime të policisë gjyqësore ose që ka qenë mbrojtës, përfaqësues i një pale ose dëshmitar, ekspert viktimë ose person që ka paraqitur një kallëzim ose ankimin e procedimit.

Neni 16

**Papajtueshmëria për arsye lidhjeje familjare, gjinie ose
krushqie**

(Shtuar fjalë me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Në të njëjtin procedim nuk mund të marrin pjesë si gjyqtarë personat që janë ndërmjet tyre ose me pjesëmarrësit në gjykim, bashkëshortë, bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave) ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kumatë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka).

Neni 17

Heqja dorë

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete:

a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit, bashkëjetuesit ose i fëmijëve të tij;

b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njëjës nga palët private ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njëjës prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij;

c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit;

ç) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njëjën prej palëve private;

d) kur ndonjë prej të afërmeve të tij ose të bashkëshortit është cenuar ose dëmtuar nga vepra penale;

dh) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin procedim;

e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16;

ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.

2. Deklarimi i heqjes dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse, i cili e miraton ose e refuzon atë me vendim të arsyetuar.

3. Mbi deklarin e heqjes dorë të kryetarëve të gjykatave vendosin kryetarët e gjykatave të një shkalle më lart. Mbi deklarin e heqjes dorë të kryetarit të Gjykatës së Lartë vendos një trup gjykues i Gjykatës së Lartë i përbërë nga tre gjyqtarë.

Neni 18
Përfshirja e gjyqtarit

1. Palët mund të kërkojnë përfshirjen e gjyqtarit:
 - a) në rastet e parashikuara nga nenet 15, 16 dhe 17;
 - b) kur gjatë ushtrimit të funksioneve dhe para se të jetë dhënë vendimi ai ka shfaqur mendimin e tij mbi faktet ose rrethanat objekt procedimi.
2. Gjyqtari nuk mund të japë ose të marrë pjesë në dhënien e vendimit derisa të jepet vendimi që e deklaron të papranueshme ose që e rrëzon kërkesën e përfshirjes.

Neni 19
Afartet dhe format e kërimit të përfshirjes

1. Kërkesa për përfshirjen e gjyqtarit bëhet në seancë menjëherë pas legjitimitit të palëve.
2. Kur shkak i përfshirjes lind ose zbulohet pas mbarimit të momentit të legjitimitit të palëve, kërkesa duhet të bëhet brenda tri ditëve nga konstatimi. Kur shkak ka lindur ose është zbuluar gjatë seancës kërkesa e përfshirjes duhet të bëhet para mbarimit të seancës.
3. Kërkesa përmban shkaqet e provat dhe parashtrohet me akt të shkruar. Ajo paraqitet, bashkë me dokumentet, në sekretarinë e gjykatës kompetente. Një kopje e kërkesës i jepet gjyqtarit për të cilin kërkohet përfshirja.
4. Kur nuk bëhet personalisht nga palët, kërkesa mund të paraqitet me anën e mbrojtësit ose të një përfaqësuesi të posaçëm. Në prokurë duhet të tregohen shkaqet për të cilat kërkohet përfshirja, ndryshe ajo nuk pranohet.

Neni 20
Konkurrimi i heqjes dorë dhe i përfshirjes

1. Kërkesa e përfshirjes konsiderohet se nuk është bërë, kur gjyqtari edhe pas bërjes së saj, deklaron se heq dorë dhe ajo është pranuar.

Neni 21

Kompetencat për të vendosur përjashtimin

(Ndryshuar paragrafi 1 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar fjalë në pikën 1, ndryshuar paragrafi 1.1 dhe shtuar fjalë në pikën 3, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve shqyrtohet në dhomë këshillimi nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë.

1/1. Gjyqtari për të cilin është kërkuar përjashtimi paraqet me shkrim mendimin e tij mbi kërkesën për përjashtim.

2. Për kërkesën e përjashtimit të një gjyqtari të Gjykatës së Lartë vendos një kolegji i kësaj gjykate, i ndryshëm nga ai të cilit i përket gjyqtari që kërkohet të përjashtohet. Vendimi është i formës së prerë.

3. Nuk pranohet kërkesa për përjashtimin dhe as ripërsëritja e kërkesës për të njëjtat shkaqe e gjyqtarëve të caktuar për të vendosur mbi përjashtimin.

Neni 22

Vendimi mbi kërkesën e përjashtimit

(Shtuar fjalë në pikën 1 dhe 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur kërkesa e përjashtimit është bërë nga ai që nuk e ka patur këtë të drejtë ose duke mos respektuar afatet ose format e parashikuara nga neni 19 kur kërkesa për heqje dorë nga gjykimi i çështjes është miratuar nga kryetari, ose kur shkaqet e paraqitura janë të bazuara në ligj, gjykata që shqyrton ankimin e shpall atë të papranueshëm me vendim.

2. Gjykata mund të pezullojë përkohësisht çdo veprimtari procedurale ose ta kufizojë atë në kryerjen e veprimeve të ngutshme.

3. Gjykata, pasi merr të dhënat e nevojshme, vendos për kërkesën e përjashtimit brenda 48 orëve nga paraqitja e kërkesës.

4. Vendimi i dhënë në bazë të paragrafëve të sipërm i njoftohet gjyqtarit, për të cilin është kërkuar përjashtimi, prokurorit, të pandehurit dhe palëve private. Kundër tij mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë.

Neni 23

Disponimet kur pranohet deklarimi i heqjes dorë dhe kërkesa e përjashtimit

1. Kur deklarimi i heqjes dorë ose kërkesa e përjashtimit pranohen, gjyqtari nuk mund të kryejë asnjë veprim procedimi.
2. Akti që pranon deklarimin e heqjes dorë ose kërkesën e përjashtimit cakton nëse dhe në ç'pjesë kanë vlerë veprimet e kryera më parë nga gjyqtari që ka hequr dorë ose që është kërkuar të përjashtohet.
3. Dispozitat për heqjen dorë dhe përjashtimin e gjyqtarit zbatohen edhe për sekretarin e seancës dhe personat e ngarkuar për të bërë transkriptime ose riprodhim fonografik apo audioviziv. Për heqjen dorë ose përjashtimin e tyre vendos gjykata që shqyrton çështjen.

KREU II PROKURORI

Neni 24

Funksionet e prokurorit

*(Shtuar pika 5 me ligjin nr.8460, datë 11.2.1999
dhe ndryshuar me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002 dhe nr. 35/2017,
datë 30.3.2017)*

1. Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.
2. Prokurori ka të drejtë të mos fillojë procedimin, të pushojë akuzën ose çështjen, t'i kërkojë gjykatës pushimin e akuzës ose

çështjes, si dhe të kërkojë dërgimin e çështjes në gjyq, sipas rasteve të parashikuara nga ky Kod.

3. Prokurori ka të drejtë të lidhë marrëveshje bashkëpunimi, të hartuara në zbatim të nenit 37/a, të këtij Kodi, dhe të dispozitave ligjore të veçanta për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

4. Prokurori mund të arrijë një marrëveshje mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit, në përputhje me nenin 406/d e vijues të këtij Kodi.

5. Prokurori mund të paraqesë në gjykatë kërkesë për miratimin e urdhrit penal sipas parashikimeve të këtij Kodi.

6. Kur nuk është i nevojshëm ankimi i viktimës, ndjekja penale ushtrohet kryesisht.

Neni 25

Ushtrimi i funksioneve të prokurorit

(Ndryshuar pika 2 dhe 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Funksionet e prokurorit ushtrohen:

a) në hetimet paraprake dhe në gjykimet e shkallës së parë, nga prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë;

b) në gjykimet e çështjeve të ankimuar, nga prokurorët pranë gjykatave të apelit dhe pranë Gjykatës së Lartë.

2. Në ushtrimin e funksioneve të tij prokurori është i pavarur. Rregullat për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga prokurori parashikohen në ligj.

3. Për veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, i këtij Kodi, funksionet, sipas nenit 24, të tij, ushtrohen në të gjitha shkallët e gjykimit nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme.

Neni 26

Heqja dorë e prokurorit

(Shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie për rastet e parashikuara nga neni 17.
2. Mbi deklarinimin e heqjes dorë vendosin, sipas detyrave përkatëse, drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë, i prokurorisë pranë gjykatës së apelit dhe Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Për drejtuesit e prokurorive vendosin titullarët e prokurorive të një shkalle më lart.
3. Me vendimin që pranon deklarinimin e heqjes dorë, prokurori që ka hequr dorë zëvendësohet me një prokuror tjetër.

Neni 27

Rastet e zëvendësimit të prokurorit

(Ndryshuar paragrafi 1 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; shtuar fjalë në pikën 1 dhe shfuqizuar pika 2, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Drejtuesi i prokurorisë vendos zëvendësimin e prokurorit kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit, si dhe në rastet e parashikuara në nenet 16 dhe 17 paragrafi i parë shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”. Në rastet e tjera prokurori zëvendësohet vetëm me pëlqimin e tij.
2. Shfuqizuar.
3. Rregullat e caktuara për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit zbatohen edhe për oficerin e policisë gjyqësore.

Neni 28

Kalimi i akteve një prokurorie tjetër

(Shtuar pika 3 dhe ndryshuar numërtimi me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur gjatë hetimeve paraprake prokurori çmon se vepra penale është në kompetencën e një gjykate të ndryshme nga ajo pranë së

cilës ushtron funksionet e tij, ia kalon menjëherë aktet prokurorisë pranë gjykatës kompetente.

2. Prokurori që ka marrë aktet, në qoftë se çmon se duhet të procedojë prokuroria që ia ka dërguar aktet, njofton Prokurorin e Përgjithshëm, i cili, pasi shqyrton aktet, cakton se cila prokurori duhet të procedojë dhe njofton prokuroritë e interesuara.

3. Nëse prokurori çmon se vepra penale është në kompetencën e Prokurorisë së Posaçme ose merr dijeni se pranë kësaj prokurorie po zhvillohen hetime për të njëjtin fakt dhe në ngarkim të të njëjtit person, ia kalon aktet Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i cili, pasi i shqyrton ato, vendos pranimin e akteve ose i ridërgon ato në prokurorinë e mëparshme. Kjo e fundit ka detyrimin të pranojë aktet.

4. Veprimet hetimore të kryera para kalimit ose caktimit të bërë sipas paragrafit 1 dhe 2, janë të vlefshme dhe mund të përdoren në rastet dhe në mënyrat e parashikuara nga ligji.

Neni 29

Kërkimi i akteve nga një prokurori tjetër

*(Shtuar pika 3 dhe ndryshuar numërtimi me ligjin nr. 35/2017,
datë 30.3.2017)*

1. Kur prokurori merr dijeni se pranë një prokurorie tjetër janë duke u zhvilluar hetime paraprake në ngarkim të të njëjtit person dhe për të njëjtin fakt, në lidhje me të cilin ai procedon, njofton pa vonesë atë prokurori, duke i kërkuar dërgimin e akteve.

2. Prokurori që ka marrë kërkesën, kur nuk është dakord me të, informon Prokurorin e Përgjithshëm, i cili pasi të ketë marrë të dhënat e nevojshme, vendos, sipas rregullave, mbi kompetencën e gjykatës se cila prokurori duhet të procedojë dhe njofton prokuroritë e interesuara. Prokurorisë së caktuar i dërgohen menjëherë aktet nga prokuroria tjetër.

3. Nëse prokurori i Prokurorisë së Posaçme merr dijeni se pranë një prokurorie janë duke u zhvilluar hetime paraprake në ngarkim të të njëjtit person dhe për të njëjtin fakt, në lidhje me të cilin ai procedon,

njofton pa vonesë drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, i cili vendos, sipas rregullave mbi kompetencën, se cila prokurori duhet të procedojë. Në rast se ai vendos që kompetenca i takon Prokurorisë së Posaçme, njofton prokurorinë e caktuar, e cila duhet t'i dërgojë aktet.

4. Aktet e hetimit paraprak të kryera nga prokurori të ndryshme janë të përdorshme në rastet dhe në mënyrat e parashikuara nga ligji.

KREU III POLICIA GJYQËSORE

Neni 30

Funksionet e policisë gjyqësore

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Policia gjyqësore, edhe me iniciativën e vet, duhet të marrë dijeni për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal.

2. Policia gjyqësore kryen çdo veprim hetimor që i është urdhëruar ose deleguar nga prokurori.

3. Funksionet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2, të këtij neni, kryhen nga oficerët e policisë gjyqësore. Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit kanë statusin e oficerit të policisë gjyqësore.

Neni 31

Shërbimet dhe seksionet e policisë gjyqësore

(Hequr fjalë në shkronjën "a", shkronja "c" bëhet "ç" dhe shtuar shkronja "c" në pikën 1, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Funksionet e policisë gjyqësore kryhen:

a) nga oficerët e policisë gjyqësore që u përkasin organeve, të cilëve ligji u ngarkon detyrën për të kryer hetime që nga çasti që marrin dijeni për veprën penale;

- b) nga seksionet e policisë gjyqësore të krijuara pranë çdo prokurorie rrethi dhe të përbëra nga një personel i policisë gjyqësore;
- c) nga Byroja Kombëtare e Hetimit pranë Prokurorisë së Posaçme;
- ç) nga shërbimet e policisë gjyqësore të parashikuara me ligj.

Neni 32

Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore

- 1. Janë oficerë të policisë gjyqësore:
 - a) drejtuesit, inspektorët dhe pjesëtarë të tjerë të policisë së Ministrisë së Rendit Publik, të cilëve me ligj të veçantë u njihet një cilësi e tillë;
 - b) oficerët e policisë ushtarake, të policisë financiare, pyjore dhe të çdo policie tjetër, të cilëve me ligj të veçantë u njihet një cilësi e tillë.
- 2. Janë agjentë të policisë gjyqësore:
 - a) personeli i policisë së rendit, të cilit me ligj të veçantë i njihet një cilësi e tillë;
 - b) personeli i policisë ushtarake, i policisë financiare dhe i çdo policie tjetër të njohur me ligj, kur janë në shërbim.
- 3. Janë gjithashtu oficerë dhe agjentë të policisë gjyqësore, në caqet e shërbimit që u është besuar dhe sipas attributeve përkatëse, personat, të cilëve me ligj u njihen funksionet e parashikuara nga neni 30.

Neni 33

Varësia funksionale e policisë gjyqësore

*(Ndryshuar titulli dhe pikat 1, 2, 3 me ligjin nr. 35/2017,
datë 30.3.2017)*

- 1. Policia gjyqësore përgjigjet përpara prokurorit për veprimtarinë e kryer prej saj gjatë procedimit penal.
- 2. Policia gjyqësore kryen detyrat që i janë caktuar nga prokurori dhe e njofton atë menjëherë mbi rezultatet e tyre.

3. Oficerët e seksioneve dhe shërbimeve nuk hiqen nga veprimtaria e policisë gjyqësore, përveç rasteve të parashikuara në ligj.

4. Gjykatat dhe prokuroritë disponojnë drejtpërsëdrejti personelin e seksioneve dhe mund të shfrytëzojnë çdo shërbim të policisë gjyqësore.

KREU IV I PANDEHURI

Neni 34

Marrja e cilësisë së të pandehurit

(Shtuar një paragraf në pikën 1 me ligjin nr. 8460, datë 11.2.1999; shtuar pika 4 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

Kur pas marrjes së një personi si të pandehur dalin të dhëna të reja që ndryshojnë akuzën e paraqitur ose e plotësojnë atë, prokurori merr vendim, të cilin ia njofton të pandehurit.

2. Cilësia e të pandehurit ruhet në çdo gjendje dhe shkallë të procesit derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose i dënimit.

3. Cilësia e të pandehurit rimerret kur prishet vendimi i pushimit ose kur vendoset rishqyrtimi i procesit.

4. Shfuqizuar.

Neni 34/a

Të drejtat e të pandehurit

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Personi nën hetim ose i pandehuri ka të drejtë:

a) të njoftohet në një kohë sa më të shkurtër, në gjuhën që kupton, për veprën penale për të cilën hetohet, si edhe për shkaqet e akuzave;

b) të përdorë gjuhën që flet ose kupton ose të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një përkthyes dhe interpretues nëse ka paaftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;

c) të heshtë, të paraqesë lirisht mbrojtjen e tij, si dhe të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara;

ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij;

d) të ketë një mbrojtës të siguruar nga shteti, nëse mbrojtja është e detyrueshme ose nuk ka mundësi financiare për të pasur një mbrojtës, sipas parashikimeve të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi për ndihmë juridike;

dh) të takohet privatisht dhe të komunikojë me mbrojtësin që e përfaqëson;

e) të ketë kohë të mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen;

ë) të njihet me materialet e çështjes, sipas parashikimeve të këtij Kodi;

f) të paraqesë prova që i shërbejnë mbrojtjes së tij;

g) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve, ekspertëve dhe të pandehurve të tjerë gjatë gjykimit;

gj) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

2. Përpara marrjes në pyetje për herë të parë ose përpara kryerjes së akteve ku prania e tij është e detyrueshme, sipas ligjit, organi procedues e njofton të pandehurin për të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar.

3. Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe.

Neni 34/b

Të drejtat e personit të arrestuar ose të ndaluar

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Përveç të drejtave të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të paragrafit 1, të nenit 34/a, të këtij Kodi, i arrestuari ose i ndaluari ka të drejtë:

a) të takojë vetëm për vetëm mbrojtësin e tij përpara marrjes në pyetje për herë të parë;

b) të njihet me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e arrestimit ose ndalimit të tij;

c) të kërkojë që një anëtar i familjes ose një person tjetër i afërt të njoftohet menjëherë për arrestimin e tij. Në rast se i arrestuari ose i ndaluari është shtetas i huaj, ai ka të drejtë të kërkojë të njoftohet përfaqësia konsullore ose diplomatike e vendit të tij dhe në rast se është person pa shtetësi apo refugjat, ai ka të drejtë të kërkojë të njoftohet një organizatë ndërkombëtare;

ç) të marrë menjëherë përkujdesjen e nevojshme mjekësore.

2. Organi procedues e njofton menjëherë personin e arrestuar ose të ndaluar për të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të paragrafit 1, të nenit 34/a, të këtij Kodi, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar. Personi ka të drejtë ta mbajë letrën e të drejtave.

Neni 35

Ndihma që i jepet të pandehurit të mitur

(Shtuar shenja e pikësimit dhe fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e

prindit, kujdestarit ligjor ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon.

2. Organi procedues mund të kryejë veprime dhe të përpilojë akte, për të cilat kërkohet pjesëmarrja e të miturit, pa praninë e personave të treguar në paragrafin 1, vetëm kur një gjë e tillë është në interes të të miturit ose kur vonesa mund të dëmtojë rëndë procedimin, por gjithmonë në praninë e mbrojtësit.

Neni 36

Ndalimi i përdorimit si dëshmi i deklarimeve të të pandehurit *(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

1. Deklarimet e bëra gjatë procedimit nga i pandehuri nuk mund te përbëjnë objekt dëshmie.

Neni 36/a

Deklarimet e bashkëpunëtorit të drejtësisë *(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

1. Bashkëpunëtori i drejtësisë pyetet në cilësinë e dëshmitarit. Në rast se bën deklarime ose dëshmi të rreme, ai mban përgjegjësi penale sipas ligjit.

2. Thëniet e bashkëpunëtorit të drejtësisë vlerësohen sipas kriterëve që përcakton paragrafi 3, i nenit 152, të këtij Kodi.

Neni 37

Deklarimet që tregojnë vetëpërgjegjësi

1. Kur para autoritetit procedues një person, që nuk është marrë si i pandehur, bën deklarime, nga të cilat dalin të dhëna për inkriminim në ngarkim të tij, autoriteti procedues ndërpret pyetjen, duke e paralajmëruar se pas këtyre deklarimeve mund të zhvillohen hetime ndaj tij dhe e fton të caktojë një mbrojtës. Deklarimet e mëparshme nuk mund të shfrytëzohen kundër personit që i ka bërë.

Neni 37/a

Bashkëpunimi me drejtësinë

(Shtuar me ligjin nr.9276, datë 16.9.2004 dhe ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. I pandehuri që akuzohet për një krim që dënohet në maksimum jo më pak se 7 vjet burgim, të kryer në bashkëpunim ose për një nga veprat penale të parashikuara nga shkronja “a”, e paragrafit 1, të nenit 75/a, të këtij Kodi, mund të fitojë statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë, duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me prokurorin. Marrëveshja që përmban kushtet e bashkëpunimit mund të lidhet në çdo gjendje dhe fazë të procedimit, edhe pasi vendimi penal ka marrë formë të prerë dhe është vënë në ekzekutim.

2. Marrëveshja nënshkruhet kur i pandehuri dëshmon pa asnjë rezervë apo kusht për të gjitha faktet dhe rrethanat që ka dijeni për shkak të pjesëmarrjes së tij në veprimtarinë kriminale. Dëshmia e tij duhet të jetë provë vendimtare fajësie, në drejtim të provueshmërisë së fakteve dhe të autorësisë së tyre, si dhe për parandalimin e krimeve të rënda dhe riparimin e dëmeve të shkaktuara prej tyre. I pandehuri, në dëshminë e tij, duhet të identifikojë të gjitha pasuritë me origjinë kriminale në posedim të tij dhe të bashkëpunëtorëve. Të dhënat e mësipërme duhet të jepen brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes.

3. Bashkëpunëtori i drejtësisë ka të drejtë të kërkojë mbrojtje të posaçme për vete dhe për familjen e tij, sipas legjislacionit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

4. Në rastet e bashkëpunimit me drejtësinë, prokurori i kërkon gjykatës uljen e masës së dënimit ose përjashtimin e bashkëpunëtorit të drejtësisë nga dënimi. Kur marrëveshja lidhet në fazën e ekzekutimit të vendimit, kompetenca për të shqyrtuar kërkesën e prokurorit i përket gjykatës që ka dhënë vendimin. Ulja e masës së dënimit ose përjashtimi prej tij çmohen në përpjesëtim me kontributin e dhënë nga bashkëpunëtori i drejtësisë për faktet dhe rrethanat që tregohen në paragrafin 2 të këtij neni. Zbatohen rregullimet e paragrafit 7, të

nenit 28, të Kodit Penal, si dhe rregullat e paragrafit 1, të nenit 480, të këtij Kodi.

5. Marrëveshja e bashkëpunimit revokohet kur bashkëpunëtori i drejtësisë shkel kushtet e marrëveshjes së bashkëpunimit, fsheh të dhëna pasurore ose fakte me interes për drejtësinë, ose bën deklaramë apo dëshmi të rreme. Zbatohen për aq sa janë të pajtueshme rregullat e paragrafit 1, të nenit 480, të këtij Kodi.

Neni 37/b

Përmbajtja e marrëveshjes

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Marrëveshja me bashkëpunëtorin e drejtësisë përmban:

a) identitetin e prokurorit dhe gjenealogjin e bashkëpunëtorit të drejtësisë;

b) faktin se bashkëpunëtori i drejtësisë detyrohet të dëshmojë në cilësinë e dëshmitarit;

c) detyrimin e tij për të dhënë informacion të plotë pa asnjë rezervë ose kusht, për të gjitha faktet e rrethanat e parashikuara në paragrafin 2, të nenit 37/a, të këtij Kodi, jo më vonë se tridhjetë ditë nga data e nënshkrimit të marrëveshjes;

ç) paralajmërimin për revokimin e marrëveshjes dhe për përgjegjësinë penale në rastet e parashikuara nga paragrafi 5, i nenit 37/a, të këtij Kodi;

d) të drejtën e bashkëpunëtorit për të kërkuar lidhjen e një marrëveshjeje me prokurorin për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit, sipas neneve 406/d e vijues të këtij Kodi;

dh) detyrimin e prokurorit që t'i kërkojë gjykatës uljen e masës së dënimit ose përjashtimin e tij nga dënimi, në përpjesëtim të drejtë me shkallën e kontributit të tij në bashkëpunimin me drejtësinë;

e) të drejtën e bashkëpunëtorit për të kërkuar mbrojtje të posaçme, sipas paragrafit 3, të nenit 37/a, të këtij Kodi;

ë) nënshkrimin e prokurorit, të bashkëpunëtorit të drejtësisë dhe të mbrojtësit, kur ai është i pranishëm.

2. Deklarimet e bashkëpunëtorit të drejtësisë së bashku me marrëveshjen e bashkëpunimit bëhen pjesë e fashikullit të hetimeve paraprake.

Neni 38

Rregulla të përgjithshme për marrjen në pyetje

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. I pandehuri, edhe kur është me masë sigurimi izoluese ose kur i është hequr liria për çdo lloj shkaku tjetër, merret në pyetje i lirë, përveç rasteve kur duhen marrë masa për të parandaluar rrezikun e ikjes ose të dhunës.

2. Nuk mund të përdoren, as me pëlqimin e të pandehurit, metoda ose teknika për të ndikuar mbi lirinë e vullnetit ose për të ndryshuar aftësinë e kujtesës e të vlerësimit të fakteve.

3. Përpara marrjes në pyetje, i pandehuri pyetet shprehimisht nëse i ka kuptuar të drejtat e tij, të dhëna me shkrim sipas neneve 34/a dhe 34/b, të këtij Kodi. Në rast se i pandehuri nuk është njohur paraprakisht me këto të drejta, sipas dispozitave të këtij Kodi, deklaratimet e tij nuk mund të përdoren.

Neni 39

Pyetja në themel

1. Organi procedues i shpjegon të pandehurit, në formë të qartë dhe të përpiktë, faktin që i atribuohet, e njeh me provat që ekzistojnë kundër tij dhe, kur hetimet nuk dëmtohen, i tregon burimet e tyre.

2. Organi procedues e fton atë të shpjegojë gjithçka që çmon të dobishme për mbrojtjen e tij dhe i bën drejtpërsëdrejti pyetje.

3. Kur i pandehuri nuk pranon të përgjigjet kjo shënohet në procesverbal. Në procesverbal shënohen, kur është e nevojshme, edhe tiparet fizike dhe shenjat e veçanta eventuale të të pandehurit.

Neni 40

Verifikimi i identitetit personal të të pandehurit

1. Me paraqitjen e të pandehurit organi që procedon e fton atë të deklarojë gjeneralitetet dhe gjithçka tjetër që mund të vlejë për identifikimin e tij, duke e paralajmëruar për pasojat që ka ai që refuzon të japë gjeneralitetet e tij ose kur i jep ato të rreme, me përjashtim të rasteve kur ky deklaram nënkupton vetëfajësi.

2. Pamundësia për t'i atribuar të pandehurit gjeneralitetet e tij të sakta nuk pengon kryerjen e veprimeve nga ana e organit procedues, kur është i sigurt identiteti fizik i personit.

3. Gjeneralitetet e gabuara që i janë atribuar të pandehurit ndreqen me vendim të organit që procedon.

Neni 41

Verifikimi i moshës së të pandehurit

1. Në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, kur ka arsye për të besuar se i pandehuri është i mitur, organi procedues bën verifikimet e nevojshme dhe kur është rasti urdhëron ekspertimin.

2. Kur, edhe pas verifikimeve dhe ekspertimit, mbeten dyshime për moshën e të pandehurit, prezumohet se ai është i mitur.

Neni 42

Verifikime për personalitetin e të pandehurit të mitur

1. Organi procedues merr të dhëna për kushtet e jetesës personale, familjare dhe shoqërore të të pandehurit të mitur me qëllim që të sqarojë përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë, të vlerësojë rëndësinë shoqërore të faktit si dhe të caktojë masa të përshtatshme penale.

2. Organi procedues mbledh informacione nga personat që kanë patur marrëdhënie me të miturin dhe dëgjon mendimin e ekspertëve.

Neni 43

Verifikimet për përgjegjshmërinë e të pandehurit

1. Kur ka arsye të çmohet se për shkak të sëmundjes mendore të shkaktuar pas ngjarjes i pandehuri nuk është në gjendje të marrë pjesë me vetëdije në procedim, gjykata vendos, edhe kryesisht, ekspertimin.

2. Gjatë kohës që vazhdon ekspertimi, gjykata, me kërkesën e mbrojtësit, merr provat që mund të çojnë në pafajësinë e të pandehurit, dhe kur vonesa paraqet rrezik, çdo provë tjetër të kërkuar nga palët.

3. Kur nevoja e përcaktimit të përgjegjshmërisë del gjatë hetimeve paraprake, ekspertimi urdhërohet nga prokurori kryesisht ose me kërkesën e të pandehurit apo të mbrojtësit të tij. Ndërkohë prokurori kryen vetëm veprimet që nuk kërkojnë pjesëmarrjen e vetëdijshme të të pandehurit. Kur vonesa paraqet rrezik, mund të merren prova vetëm në rastet e parashikuara për sigurimin e provës.

Neni 44

Pezullimi i procedimit për shkak të papërgjegjshmërisë së të pandehurit

(Shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur del se gjendja mendore e të pandehurit është e tillë që pengon pjesëmarrjen e vetëdijshme në procedim, organi që procedon merr vendim për pezullimin e procedimit, por gjithnjë kur nuk duhet të merret vendim pafajësie ose pushimi. Me vendimin e pezullimit organi që procedon i cakton të pandehurit një kujdestar të posaçëm, të cilit i jepen të drejtat e përfaqësuesit ligjor.

2. Shfuqizuar.

3. Pezullimi nuk pengon organin procedues që të marrë prova që mund të çojnë në pafajësinë e të pandehurit dhe kur vonesa paraqet rrezik, çdo provë tjetër të kërkuar nga palët. Në veprimet që duhet të kryhen rreth personit të të pandehurit, si dhe në ato ku i pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm merr pjesë kujdestari i posaçëm i tij.

Neni 45

Revokimi i vendimit të pezullimit

1. Vendimi i pezullimit revokohet kur del se gjendja mendore e të pandehurit lejon pjesëmarrjen e vetëdijshme në procedim ose kur i pandehuri duhet të deklarohet i pafajshëm apo çështja të pushohet.

Neni 46

Masat mjekësore të detyrueshme

1. Në çdo rast kur gjendja mendore e të pandehurit tregon se ai duhet të kurohet, gjykata, vendos, edhe kryesisht shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik.

2. Kur është vendosur ose duhet vendosur masa mjekësore e detyrueshme për të pandehurin, gjykata urdhëron që i pandehuri të ruhet në një institucion psikiatrik.

3. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori i kërkon gjykatës të vendosë për shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik dhe kur vonesa paraqet rrezik, urdhëron shtrimin e përkohshëm deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

Neni 47

Vdekja e të pandehurit

1. Kur rezulton vdekja e të pandehurit, organi procedues, në çdo gjendje e shkallë të procedimit, pasi dëgjon mbrojtësin, vendos pushimin e çështjes.

2. Vendimi nuk pengon ushtrimin e ndjekjes penale për të njëjtin fakt dhe kundër të njëjtut person, kur më pas vërtetohet se ai nuk ka vdekur.

KREU V
MBROJTËSI I TË PANDEHURIT

Neni 48

Mbrojtësi i zgjedhur nga i pandehuri

1. I pandehuri ka të drejtë të zgjedhë jo më shumë se dy mbrojtës.
2. Zgjedhja bëhet me deklaram të bërë para organit procedues ose me akt të dhënë mbrojtësit ose të dërguar atij rekomande.
3. Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij, në format e parashikuara nga paragrafi 2.

Neni 49

Mbrojtja e detyrueshme

*(Ndryshuar titulli dhe pikat 1, 2, 3, 5, 7 me ligjin nr. 35/2017,
datë 30.3.2017)*

1. Organi procedues i siguron menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti të pandehurit që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të kur:
 - a) është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç;
 - b) nuk dëgjon dhe nuk flet;
 - c) është me aftësi të kufizuara, që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes;
 - ç) është akuzuar për një vepër penale, për të cilën ligji parashikon dënim në maksimum jo më pak se 15 vjet me burgim;
 - d) akuzohet për një vepër penale, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 75/a, të këtij Kodi;
 - dh) është deklaruar i ikur ose në mungesë, me vendim gjykate;
 - e) merret në pyetje personi i arrestuar ose i ndaluar;
 - ë) në rastet e parashikuara nga paragrafi 5, i nenit 205, ose paragrafi 1, i nenit 296, të këtij Kodi;

f) në çdo rast tjetër të parashikuar nga ligji.

2. Nëse ekzistojnë arsyet për mbrojtje të detyrueshme, sipas këtij neni, organi procedues i cakton menjëherë një mbrojtës të pandehurit. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin në të gjitha fazat e procedimit, për aq kohë sa ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Mbrojtësi i caktuar, sipas këtij neni, zgjidhet nga organi procedues nga lista e vënë në dispozicion nga Dhoma e Avokatisë.

4. Gjykata, prokurori dhe policia gjyqësore, kur duhet të kryejnë një veprim për të cilin parashikohet ndihma e mbrojtësit dhe kur i pandehuri është pa mbrojtës, njoftojnë për këtë veprim mbrojtësin e caktuar.

5. Kur kërkohet prania e mbrojtësit dhe mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar nuk është siguruar, nuk është paraqitur ose e ka lënë mbrojtjen, gjykata ose prokurori zbaton paragrafin 4, të nenit 350, të këtij Kodi. Nëse mungesa e tij është e përligjur, gjykata ose prokurori mund të caktojnë si zëvendësues një mbrojtës tjetër, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit.

6. Mbrojtësi i caktuar mund të zëvendësohet vetëm për shkaqe të përligjura. Ai i pushon funksionet kur i pandehuri zgjedh mbrojtësin e tij.

7. Kur mbrojtja nuk mund të sigurohet sipas kësaj dispozite dhe pikës 3, të nenit 49, mbrojtja garantohet nga institucionet që administrojnë ndihmën juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 49/a

I pandehuri pa mjete të mjaftueshme financiare

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Kur nuk janë rastet e mbrojtjes së detyrueshme dhe i pandehuri që nuk ka mjete financiare të mjaftueshme kërkon mbrojtës, organi procedues cakton mbrojtësin nga lista e vënë në dispozicion nga institucionet e ndihmës juridike falas. Shpenzimet e mbrojtjes mbulohen nga shteti.

Neni 49/b

Papajtueshmëria për të vepruar si mbrojtës

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Nuk mund të jenë mbrojtës:

- a) viktimë ose të afërmit e saj, sipas nenit 16 të këtij Kodi;
- b) personi i thirrur si dëshmitar në të njëjtën çështje;
- c) personi i cili në të njëjtën çështje është ose ka qenë bashkëipandehur, gjyqtar ose prokuror.

Neni 50

Shtirirja e të drejtave të të pandehurit të mbrojtësi

1. Mbrojtësi ka të drejtat që ligji i njej të pandehurit, përveç atyre që i rezervohen personalisht këtij të fundit.

2. Mbrojtësi ka të drejtë të komunikojë lirisht dhe vetëm për vetëm me të ndaluarin, të arrestuarin apo të dënuarin, të njoftohet paraprakisht për kryerjen e veprimeve hetimore ku është i pranishëm i pandehuri dhe të marrë pjesë në to, t'u drejtojë pyetje të pandehurit, dëshmitarëve dhe ekspertëve, të njihet me të gjithë materialin e çështjes në përfundim të hetimeve.

3. I pandehuri mund të zhvleftësojë, me deklaram të shprehur, veprimin e kryer nga mbrojtësi para se të jetë marrë një vendim nga gjykata lidhur me këtë veprim.

Neni 51

Zëvendësuesi i mbrojtësit

1. Mbrojtësi, në rastin e pengesës dhe për aq kohë sa zgjat ajo, me pëlqimin e të pandehurit, mund të caktojë një zëvendësues.

2. Zëvendësuesi ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit.

Neni 52

Garancitë për mbrojtësin

(Shtuar shkronja “c” në pikën 1, fjalia e dytë në pikën 2, shenja e pikësimit dhe fjalë në pikën 3 dhe bequr fjalë në pikën 6, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Këqyrjet dhe kontrollimet në zyrën e mbrojtësit lejohen vetëm:

a) kur ai ose persona të tjerë që zhvillojnë vazhdimisht veprimtari në të njëjtën zyrë janë të pandehur dhe vetëm brenda qëllimeve për të provuar veprën penale që u atribuohet;

b) për të zbuluar gjurmët ose provat materiale të veprës penale ose për të kërkuar sende a persona të përcaktuar në mënyrë të posaçme.

c) në rastet kur mbrojtësi ndodhet në kushtet e flagrancës ose ndjekjes, sipas paragrafit 1, të nenit 298, të këtij Kodi.

2. Para se të bëjë këqyrjen, kontrollimin ose sekuestrimin në zyrën e një mbrojtësi, organi procedues njofton këshillin drejtues të dhomës së avokatëve me qëllim që një anëtar i tij të ketë mundësinë që të jetë i pranishëm në veprimet. Përveç rasteve të flagrancës, organi procedues shtyn këqyrjen, kontrollimin ose sekuestrimin deri në mbërritjen e anëtarit të caktuar, por jo më shumë se 2 orë pasi është informuar Dhoma e Avokatisë. Në çdo rast një kopje e aktit i dërgohet këshillit drejtues të dhomës së avokatëve.

3. Këqyrjet, kontrollimet dhe sekuestrimet në zyrat e mbrojtësve, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të paragrafit 1, të këtij neni, i bën gjyqtari personalisht, kurse gjatë hetimeve paraprake ato i bën prokurori në bazë të një vendimi autorizues të gjykatës.

4. Nuk lejohet përgjimi i bisedimeve ose i komunikimit të mbrojtësve dhe të asistentëve të tyre, as ndërmjet njëri-tjetrit dhe as me personat që ata mbrojnë.

5. Ndalohet çdo formë kontrolli e korrespondencës ndërmjet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

6. Rezultatet e këqyrjeve, të kontrollimeve, të sekuestrimeve, të përgjimeve të bisedave ose të komunikimit, të kryera në shkelje të dispozitave të mësipërme, nuk mund të përdoren.

Neni 53

Biseda e mbrojtësit me të pandehurin e paraburgosur

1. Personi i arrestuar në flagrancë ose i ndaluar ka të drejtë të flasë me mbrojtësin menjëherë pas arrestimit ose ndalimit.
2. I pandehuri i paraburgosur ka të drejtë të flasë me mbrojtësin e tij që në momentin e ekzekutimit të masës së sigurimit.

Neni 54

Mbrojtja e disa të pandehurve nga një mbrojtës

1. Mbrojtja e disa të pandehurve mund të merret përsipër nga një mbrojtës i përbashkët, me kusht që midis të pandehurve të mos ketë papajtueshmëri interesash.
2. Organi procedues kur konstaton papajtueshmërinë e interesave të të pandehurve e deklaron atë me vendim dhe bën zëvendësimet e nevojshme.

Neni 55

Mospranimi, dorëheqja ose revokimi i mbrojtësit

1. Mbrojtësi që nuk pranon detyrën që i është besuar ose që heq dorë prej saj njofton menjëherë organin procedues dhe atë që e ka caktuar.
2. Mospranimi ka efekt që nga çasti kur i komunikohet organit procedues.
3. Dorëheqja nuk ka efekt derisa pala të ndihmohet me një mbrojtës të besuar të ri ose me një mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të ketë mbaruar afati që mund t'i jetë dhënë mbrojtësit zëvendësues për t'u njohur me aktet dhe provat.
4. Dispozita e paragrafit 3 zbatohet edhe në rastin e revokimit.
5. Heqja dorë e përfaqësuesit të paditësit dhe të të paditurit civil nuk pengon në asnjë rast vazhdimin e procedimit.

Neni 56

Përgjegjësia për lënien ose refuzimin e mbrojtjes

1. Organi procedues i referon këshillit drejtues të dhomës së avokatëve rastet e lënies së mbrojtjes, të refuzimit të mbrojtjes dhe të shkeljes nga ana e mbrojtësve të detyrave të besnikërisë dhe ndershmërisë.

2. Këshilli drejtues i dhomës së avokatëve ka të drejtë të marrë masa disiplinore në rastin e lënies së mbrojtjes ose të refuzimit të mbrojtjes të caktuar kryesisht.

3. Kur këshilli drejtues i quan të përligjura lënien ose refuzimin, për shkak të shkeljes së të drejtave të mbrojtjes, masa disiplinore nuk jepet edhe në qoftë se shkelja e të drejtave të mbrojtjes nuk është njohur nga gjykata.

Neni 57

Afati për mbrojtësin zëvendësues

1. Në rastet e dorëheqjes, të revokimit dhe të papajtueshmërisë së interesave të të pandehurve, mbrojtësit të ri të të pandehurit ose atij që është caktuar si zëvendësues, u jepet një afat i përshtatshëm për t'u njohur me aktet dhe provat.

KREU VI

VIKTIMA, VIKTIMA AKUZUESE, PADITËSI DHE I PADITURI CIVIL

(Ndryshuar titulli i kreut me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Neni 58

Të drejtat e viktimës së veprës penale

(Shtuar pika 3 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 dhe ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Viktima e veprës penale ka të drejtë:

- a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;
 - b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;
 - c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar;
 - ç) të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;
 - d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;
 - dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrijë kërkesa të tjera përpara organit procedues;
 - e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;
 - ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;
 - f) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
 - g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;
 - gj) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;
 - h) të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
 - i) të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;
 - j) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.
2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre.

3. Viktima që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat e saj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit të tij, përveçse kur kjo nuk është në interesin e viktimës. Kur vëren papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, gjykata cakton një kujdestar të posaçëm, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.

4. Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “j”, të paragrafit 1, të këtij neni. Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor.

Neni 58/a

Të drejtat e viktimës së mitur

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Përveç të drejtave të parashikuara në nenin 58 dhe parashikimeve të tjera të këtij Kodi, si dhe legjislacionin e posaçëm për të miturit, viktima e mitur ka të drejtë: (

- a) të shoqërohet nga një person i besuar prej tij;
- b) të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale;
- c) të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.

2. Organi procedues duhet të trajtojë viktimën e mitur të veprës penale duke mbajtur parasysh moshën, personalitetin dhe rrethana të tjera, me qëllim shmangien e pasojave të dëmshme për zhvillimin dhe edukimin e saj të ardhshëm.

3. Nëse ekziston mundësia që viktima është e mitur dhe mosha e viktimës nuk dihet, prezumohet se ajo është e mitur.

4. Viktima e mitur pyetet pa vonesë nga persona të specializuar për këtë qëllim. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, biseda regjistrohet me mjete audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Ky regjistrim mund të përdoret si provë në procedimin penal dhe vlerësohet së bashku me provat e tjera, sipas kritereve që parashikohen nga paragrafi 4, i nenit 361/a, të këtij Kodi. Kur viktima e mitur është nën 14 vjeç, biseda zhvillohet në mjedis të përshtatura për të.

Neni 58/b

Të drejtat e viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore
(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Veç të drejtave të parashikuara në nenet 58 dhe 58/a, të këtij Kodi, viktimat e abuzuar seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë gjithashtu të drejtë:

- a) të pyeten pa vonesë nga një oficer i policisë gjyqësore ose prokuror i të njëjtës gjini;
- b) të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me jetën private, e cila qartësisht nuk ka lidhje me veprën penale;
- c) të kërkojnë të dëgjohen nëpërmjet mjeteve audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

Neni 59

Viktima akuzuese

(Shtuar pika 3 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr.10 054, datë 29.12.2008; ndryshuar titulli, bequr referenca në pikën 1, shtuar pika 4 dhe 5, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119,119/b, 120, 121, 122, 125, 127, dhe 254 të Kodit Penal ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

2. Prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij.

3. Nëse viktimat akuzuese ose mbrojtësi i caktuar prej tij nuk paraqitet në seancë pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos pushimin e gjykimit.

4. Viktimat akuzuese që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat që i janë njohur me ligj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor.

5. Kur disa viktimë të së njëjtës çështje paraqesin kërkesë në gjykatë, sipas nenit 59, të këtij Kodi, kërkesat e tyre bashkohen në një gjykim të vetëm.

Neni 60

Kërkesa e viktimës akuzuese

(Ndryshuar titulli, shkronja "a" në pikën 1 dhe pika 2, shtuar fjalë në shkronjën "b" dhe "ç" në pikën 1, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kërkesa për gjykim e viktimës akuzuese depozitohet në sekretarinë e gjykatës. Ajo është e pavlefshme në qoftë se nuk përmban:
 - a) gjenealogjet e viktimës akuzuese dhe adresën e saktë të saj;
 - b) gjeneralitetet e personit që akuzohet dhe adresën e tij;
 - c) emrin dhe mbiemrin e përfaqësuesit dhe prokurën;
 - ç) parashtrimin e arsyeve që përlligjin kërkesën si dhe provat në të cilat ajo mbështetet;
 - d) nënshkrimin e viktimës akuzuese ose të përfaqësuesit të tij.
2. Kërkesa duhet t'i njoftohet personit që akuzohet dhe prokurorit.

Neni 61

Padia civile në procesin penal

(Hequr fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Ai që ka pësuar dëm nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrejë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit.

Neni 62

Afati për legjitimimin e paditësit civil *(Shtuar pika 3 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)*

1. Legjitimimi i paditësit civil mund të bëhet nga organi procedues, derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor.
2. Afati i parashikuar nga paragrafi 1 nuk mund të zgjatet.
3. Me kërkesën e palëve ose kryesisht, gjykata mund të vendosë veçimin e padisë civile dhe dërgimin e saj në gjykatën civile nëse gjykimi i saj vështirëson ose zvarrit procesin penal.

Neni 63

Sigurimi i padisë civile

1. Për të siguruar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit, me kërkesën e paditësit civil, organi procedues mund të vendosë sekuestrimin e pasurisë së të pandehurit ose të të paditurit civil. Kjo masë qëndron deri në përfundimin e çështjes.

Neni 64

Heqja dorë nga gjykimi i padisë civile

1. Heqja dorë nga gjykimi i padisë civile mund të bëhet në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit me një deklaratë të bërë personalisht nga paditësi ose nga përfaqësuesi i tij në seancë ose me akt të shkruar e të depozituar në sekretarinë e gjykatës dhe të njoftuar palëve të tjera.
2. Në qoftë se paditësi civil nuk paraqet konkluzionet në diskutimin përfundimtar ose kur ngre padi përpara gjykatës civile, quhet se ka hequr dorë nga gjykimi i padisë civile.
3. Kur hiqet dorë nga gjykimi i padisë sipas paragrafëve 1 dhe 2, gjykata penale nuk mund të njohë shpenzimet dhe dëmet e shkaktuara të pandehurit dhe të paditurit nga ndërhyrja e paditësit civil. Padia për kërkimin e tyre mund të ngrihet para gjykatës civile.
4. Heqja dorë nuk pengon ngritjen e padisë në gjykatën civile.

Neni 65

Thirrja e të paditurit civil

1. Ai që përgjigjet civilisht për veprën e kryer nga i pandehuri mund të thirret në procesin penal me kërkesën e paditësit civil. I pandehuri që ka marrë pafajësinë ose ndaj të cilit është pushuar çështja, mund të thirret si i paditur civil për veprat e bashkëtëpandehurve të tjerë.

2. Kërkesa për thirrjen e të paditurit civil duhet të bëhet para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

3. Thirrja urdhërohet me vendim të gjykatës.

Neni 66

Ndërhyrja e të paditurit civil me vullnetin e tij

1. Kur bëhet legjitimimi i paditësit civil, i padituri civil mund të ndërhyjë me vullnetin e tij në procedim derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor, duke bërë kërkesë me shkrim. Gjykata vendos për kërkesën pasi dëgjon palët.

2. Afati i parashikuar nga paragrafi i parë nuk mund të zgjatet.

3. Ndërhyrja e të paditurit civil i humbet efektet kur hiqet dorë nga gjykimi i padisë civile.

Neni 67

Përfaqësuesi i palëve private

1. Viktima akuzuese, paditësi civil dhe i padituri civil kanë të drejtë të përfaqësohen në procedim nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose një përfaqësuesi të pajisur me prokurë.

2. Adresa e viktimës akuzuese, paditësit dhe të paditurit civil nënkuptohet, për çdo efekt procedural, pranë atij që e përfaqëson.

3. Përfaqësuesi, në rastin e pengesës dhe për aq kohë sa zgjat ajo, me pëlqimin e të përfaqësuarit, mund të caktojë një zëvendësues.

Neni 68

Disponimet për padinë civile

1. Gjykata, sipas rastit, pranon tërësisht ose pjesërisht padinë civile ose e rrëzon atë.
2. Kur jepet vendim pafajësie, për shkak se fakti nuk parashikohet si vepër penale ose kur vendoset pushimi i çështjes penale, padia civile lihet e pashqyrtuar.
3. Kur rrëzohet padia civile në procesin penal, nuk lejohet ngritja e saj përsëri në gjykatën civile.

TITULLI II

JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCAT

KREU I

JURIDIKSIONI

Neni 69

Juridiksioni penal

1. Juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.
2. Gjykata penale shqyrton gjithçka që është e nevojshme për marrjen e vendimit dhe vendos sipas rregullave të caktuara me ligj.

Neni 70

Efektet e vendimit penal për gjykimin civil dhe administrativ

1. Vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës vetëm përsa i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari.
2. Vendimi penal që zgjidh rastësisht një fakt që lidhet me një çështje civile, administrative ose penale nuk ka efekt detyrues në asnjë proces tjetër.

Neni 71

Pasojat e procedimit civil dhe administrativ për atë penal

1. Vendimi civil i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që gjykon çështjen penale vetëm përse i përket faktit nëse vepra ka ndodhur ose jo, por jo për fajësinë e të pandehurit.

2. Kur vendimi penal varet nga zgjidhja e një mosmarrëveshje mbi gjendjen familjare ose mbi shtetësinë, për të cilën ka filluar një procedim pranë gjykatës kompetente, gjykata penale mund të vendosë, edhe kryesisht, pezullimin e shqyrtimit gjyqësor derisa mosmarrëveshja të zgjidhet me vendim të formës së prerë. Pezullimi nuk pengon kryerjen e veprimeve të ngutshme.

Neni 72

Mungesa e juridiksionit

1. Mungesa e juridiksionit ngrihet, edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të gjykimit. Gjykata jep vendim dhe urdhëron, kur është rasti, dërgimin e akteve organit kompetent.

2. Kur mungesa e juridiksionit ngrihet gjatë hetimeve paraprake prokurori që procedon vendos dërgimin e akteve gjykatës kompetente për të vendosur.

Neni 73

Mosmarrëveshjet për juridiksionin

(Shtuar fjalia e dytë në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur ka mosmarrëveshje për juridiksionin, gjykata që e ngre atë merr vendim, të cilin bashkë me kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj ia dërgon Gjykatës së Lartë, duke treguar palët dhe mbrojtësit.

2. Zbatohen dispozitat e seksionit IV të kreut II të këtij titulli. Gjykata e Lartë vendos brenda 30 ditëve nga marrja e akteve.

KREU II
KOMPETENCAT

SEKSIONI I
KOMPETENCA LËNDORE

Neni 74

*(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002, nr.9911, datë 5.5.2008
dhe nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

1. Gjykata e rrethit gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Neni 75

Kompetencat e gjykatës ushtarake

*(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 dhe shfuqizuar me ligjin
nr.9911, datë 5.5.2008)*

Neni 75/a

**Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të
Organizuar**

*(Shtuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 dhe ndryshuar me ligjet
nr.9276, datë 16.9.2004, nr.9911, datë 5.5.2008, nr.145, datë
2.5.2013, nr. 21, datë 10.3.2014, nr. 99, datë 31.7.2014 dhe
nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon:

a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e;

b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 75/b

(Shtuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar pika 1 dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata e Lartë shqyrton rekursat për shkelje të ligjit, për të siguruar njësimin, zhvillimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore, si dhe ushtron kompetenca të tjera, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

2. Shfuqizuar.

SEKSIONI II KOMPETENCA TOKËSORE

Neni 76

Rregulla të përgjithshme

1. Kompetenca tokësore përcaktohet, me radhë, nga vendi ku është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja.

2. Në qoftë se vendi i treguar në paragrafin 1 nuk dihet, kompetenca i përket, me radhë, gjykatës së vendqëndrimit ose të vendbanimit të të pandehurit.

3. Në qoftë se as kështu nuk mund të përcaktohet kompetenca, kjo i përket gjykatës së vendit ku ndodhet prokuroria që ka regjistruar e para veprën penale.

4. Rregullat e caktuara në paragrafët e mësipërm zbatohen edhe gjatë hetimit paraprak.

Neni 77

Kompetencat për veprat penale të kryera jashtë shtetit

1. Në qoftë se vepra është kryer tërësisht jashtë shtetit, kompetenca përcaktohet, me radhë, nga vendi i qëndrimit, i banimit, i arrestimit ose i dorëzimit të të pandehurit. Kur ka shumë të pandehur, procedon gjykata që është kompetente për numrin më të madh të tyre.

2. Në qoftë se nuk mund të përcaktohet në mënyrat e treguara në paragrafin 1 kompetenca i përket gjykatës së vendit ku ndodhet prokuroria që ka regjistruar e para veprën penale.

3. Në qoftë se vepra penale është kryer pjesërisht jashtë shtetit, kompetenca përcaktohet në bazë të rregullave të përgjithshme të kompetencës tokësore.

Neni 78

Kompetenca për procedimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve

1. Procedimet, në të cilat një gjyqtar ose prokuror merr cilësinë e të pandehurit ose të personit të dëmtuar nga vepra penale, që sipas normave të këtij kreu do të ishin në kompetencën e një gjykate të rrethit, ku gjyqtari ose prokurori ushtron funksionet e tij ose i ushtronte në momentin e ngjarjes, janë në kompetencën e gjykatës që ka kompetencën lëndore dhe ndodhet në qendrën e një rrethi tjetër më të afërt, me përjashtim të rasteve kur në këtë rreth gjyqtari ose prokurori ka ardhur më pas për të ushtruar funksionet e tij. Në rastin e fundit është kompetente gjykata e një rrethi tjetër më të afërt me atë, në të cilën gjyqtari ose prokurori ushtronte funksionet e tij në momentin e kryerjes së veprës penale.

SEKSIONI III
KOMPETENCA PËR SHKAK TË BASHKIMIT TË
PROCEDIMEVE TË LIDHURA

Neni 79

Rastet e bashkimit të procedimeve

(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

1. Organi procedues mund të vendosë bashkimin e procedimeve:
- a) kur vepra penale për të cilën zhvillohet procedimi është kryer nga disa persona në bashkëpunim ndërmjet tyre ose kur disa persona në mënyrë të pavarur kanë shkaktuar veprën;
 - b) kur një person akuzohet për disa vepra penale;
 - c) kur një person akuzohet për disa vepra, nga të cilat një pjesë janë kryer për të realizuar ose për të mbuluar të tjerat ose për t'i siguruar fajtorit apo të tjerëve përfitime të paligjshme ose mosdënimin.

Neni 80

Bashkimi i procedimeve që janë në kompetencë të gjykatave të ndryshme

(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar pika 1 dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Në rastet e procedimeve të lidhura ndërmjet tyre dhe që nuk mund të ndahen, nga të cilat një ose disa janë kompetencë e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe procedimet e tjera në kompetencë të gjykatave të tjera të shkallës së parë, kompetente është Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Ky rregull zbatohet edhe në rastin e të pandehurve të mitur. Në këtë rast, gjykata zbaton rregullat e gjykimit për të miturit.
2. Shfuqizuar.

Neni 81

Kufijtë e bashkimit në rastin e veprave penale të kryera nga të miturit

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur disa nga procedimet e lidhura ndërmjet tyre i përkasin kompetencës së gjykatës së zakonshme dhe të tjerat seksioneve perkatese që shqyrton çështjet me të mitur, kompetente për të gjitha procedimet është kjo e fundit, përveç rasteve kur gjykata çmon se ato duhen veçuar.

2. Kur i pandehuri në kohën e gjykimit është madhor, por një ose disa vepra i ka kryer kur ka qenë i mitur, çështja gjykohet nga seksioni perkates që shqyrton çështjet me të mitur.

Neni 82

Kompetenca tokësore e përcaktuar nga lidhja e procedimeve

1. Kompetenca tokësore për procedimet e lidhura, për të cilat disa gjykata kanë të njëjtën kompetencë lëndore, i përket gjykatës kompetente për veprën penale më të rëndë dhe në rast se veprat janë njëlloj të rënda, gjykatës kompetente për veprën që është regjistruar e para.

2. Krimet konsiderohen më të rënda se kundërvajtjet. Ndërmjet krimeve ose ndërmjet kundërvajtjeve konsiderohet më e rëndë vepra penale për të cilën parashikohet dënim maksimal më i lartë ose, kur maksimumet janë të barabarta, dënimi minimal më i lartë. Në qoftë se parashikohen dënime me burgim dhe me gjobë, dënimi me gjobë merret parasysh vetëm atëherë kur dënimet me burgim janë të barabarta.

SEKSIONI IV
DISPONIMET PËR SHKAK TË MOSKOMPETENCËS

Neni 83

Moskompetenca

1. Moskompetenca lëndore ngrihet, edhe kryesisht, në çdo gjendje e shkallë të procesit.

2. Moskompetenca tokësore dhe ajo që rrjedh nga bashkimi i procedimeve për shkak lidhje, mund të ngrihet ose të kundërshtohet, vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor.

Neni 84

Moskompetenca e shpallur gjatë hetimeve paraprake

(Shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur gjatë hetimeve paraprake ose në përfundim të tyre prokurori konstaton moskompetencën e vet për çdo lloj shkak vëndos dërgimin e akteve prokurorit pranë gjykatës kompetente.

2. Kur prokurori shpall moskompetencën, ai njofton menjëherë të dyja gjykatat. Gjykata, brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit të prokurorit, i përcjell gjykatës kompetente aktet e hetimeve paraprake të kryera deri në atë moment përpara asaj gjykate.

Neni 85

Moskompetenca e shpallur në gjykimin e shkallës së parë

1. Në qoftë se në gjykimin e shkallës së parë gjykata çmon se procedimi është në kompetencën e një gjykate tjetër, shpall me vendim moskompetencën e vet për çdo lloj shkak dhe urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente.

Neni 86

Vendimi i gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë mbi kompetencën

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata e apelit, kur konstaton se gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur kompetencë lëndore, prish vendimin e apeluar dhe e dërgon çështjen në gjykatën kompetente.

2. Vendimi i Gjykatës së Lartë mbi kompetencën është i detyrueshëm, përveç rasteve kur dalin fakte të reja që çojnë në një përcaktim të ndryshëm juridik, nga i cili bëhet kompetente një gjykatë më e lartë.

Neni 87

Provat e marra nga gjykata jokompetente

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Mosrespektimi i dispozitave mbi kompetencën nuk sjell papërdorshmërinë e provave të marra.

2. Deklarimet e bëra para gjykatës që nuk ka pasur kompetencë lëndore, në qoftë se përsëriten, mund të përdoren vetëm për kundërshtim të përmbajtjes së deponimit.

Neni 88

Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata jokompetente

1. Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata, e cila në të njëjtën kohë ose më vonë shpallet jokompetente për çdo lloj shkak, i humbasin efektet, në qoftë se brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, gjykata kompetente nuk vendos për masën e sigurimit.

SEKSIONI V MOSMARRËVESHJET PËR KOMPETENCAT

Neni 89

Rastet e mosmarrëveshjeve

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Ka mosmarrëveshje, në çdo gjendje a shkallë të procedimit, kur dy a më shumë gjykata në të njëjtën kohë marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën akuzë, që i atribuohet të njëjtit person.

2. Mosmarrëveshjet në fazën e hetimit paraprak mes prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, zgjidhen nga prokurori më i lartë. Në rast konflikti gjatë hetimeve paraprake ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe një prokurorie tjetër, ka përparësi kompetenca dhe juridiksioni i së parës. Zbatohen parashikimet e neneve 28 dhe 29 të këtij Kodi.

3. Gjatë hetimeve paraprake nuk mund të parashtrohet mosmarrëveshja e bazuar në arsytet e kompetencës territoriale për shkak lidhjeje të procedimeve.

Neni 90

Parashtrimi i mosmarrëveshjes

1. Mosmarrëveshja mund të parashtrohet nga prokurori pranë njëres prej gjykatave në mosmarrëveshje ose nga i pandehuri dhe palët private. Parashtrimi paraqitet në sekretarinë e njëres prej gjykatave në mosmarrëveshje, me kërkesë të shkruar e të motivuar, të cilës i bashkohet dokumentacioni i nevojshëm.

2. Gjykata që ngre çështjen e mosmarrëveshjes merr vendim, me të cilin i paraqet Gjykatës së Lartë kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj, duke treguar palët dhe mbrojtësit.

3. Gjykata që ka dhënë vendimin, njofton menjëherë gjykatën në mosmarrëveshje.

Neni 91

Zgjidhja e mosmarrëveshjes

1. Mosmarrëveshjet zgjidhen nga Gjykata e Lartë me vendim. Gjykata merr të dhënat, aktet dhe dokumentet që i çmon të nevojshme.

2. Vendimi u komunikohet menjëherë gjykatave në mosmarrëveshje, prokurorive përkatëse, të pandehurit dhe palëve private.

SEKSIONI VI

BASHKIMI DHE NDARJA E ÇËSHTJEVE

Neni 92

Bashkimi i çështjeve

1. Bashkimi i çështjeve që qëndrojnë në të njëjtën gjendje dhe shkallë para të njëjtës gjykatë mund të vendoset, kur nuk dëmtohet shpejtësia e zgjidhjes së tyre:

- a) në rastet e parashikuara nga neni 79;
- b) në rastet e veprave penale të kryera nga disa persona në dëm të njëri-tjetrit;
- c) në rastet, kur prova e një veprë penale ose e një rrethane të saj ndikon mbi provën e një veprë penale tjetër ose të një rrethane të saj.

Neni 93

Ndarja e çështjeve

(Shfuqizuar shkronja "c" dhe vendosur shenja e pikësimit e shtuar fjalë në shkronjën "ç" të pikës 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Ndarja e çështjeve vendoset, edhe kryesisht, vetëm kur nuk dëmtohet vërtetimi i fakteve, në këto raste:

- a) kur për një a më shumë të pandehur ose për një a më shumë akuza është vendosur pezullimi i procedimit;

b) kur një a më shumë të pandehur nuk janë paraqitur në gjyq për shkak të pavlefshmërisë së aktit të thirrjes, të padijenisë pa faj për aktin e thirrjes ose për shkak të pengesave të ligjshme;

c) Shfuqizuar.

ç) kur për një a më shumë të pandehur ose për një a më shumë akuza hetimi gjyqësor është i plotë, kurse për të pandehurit e tjerë ose për akuzat e tjera është e nevojshme të kryhen veprime të tjera, me përjashtim të rastit kur akuza është ngritur për kryerjen e veprës penale në bashkëpunim.

2. Përveç rasteve të parashikuara nga paragrafi 1 ndarja mund të vendoset edhe me marrëveshje të palëve, kur gjykata e çmon të dobishme për qëllimet e shpejtësisë së gjykimit.

SEKSIONI VII TRANSFERIMI I ÇËSHTJES

Neni 94

Shkaqet e transferimit

(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

1. Në çdo gjendje dhe shkallë të gjykimit, kur siguria publike ose liria e vullnetit të personave që marrin pjesë në proces cenohen nga situata të rënda lokale, të cilat mund të dëmtojnë zhvillimin e gjykimit dhe që nuk mund të mënjahen në mënyra të tjera, Gjykata e Lartë, mbi kërkesën e motivuar të prokurorit pranë gjykatës që procedon ose të të pandehurit, ia transferon çështjen një gjykate tjetër.

Neni 95

Kërkesa e transferimit

1. Kërkesa e transferimit depozitohet, bashkë me dokumentet që lidhen me të, në sekretarinë e gjykatës kompetente dhe u njoftohet brenda shtatë ditëve palëve të tjera.

2. Kërkesa e të pandehurit nënshkruhet personalisht ose nga një përfaqësues i tij i posaçëm.

3. Gjykata ia dërgon menjëherë Gjykatës së Lartë kërkesën bashkë me dokumentet dhe vërejtjet eventuale.

4. Mosrespektimi i formave dhe i afateve të parashikuara nga paragrafët 1 dhe 2 është shkak për mospranimin e kërkesës.

Neni 96

Pasojat e kërkesës

1. Paraqitja e kërkesës së transferimit nuk pezullon gjykimin, por gjykata nuk mund të përfundojë çështjen derisa të mos jetë vendosur për pranimin ose rrëzimin e kërkesës.

2. Gjykata e Lartë mund të vendosë pezullimin e gjykimit. Pezullimi nuk pengon kryerjen e veprimeve të ngutshme.

Neni 97

Vendimi mbi kërkesën e transferimit

1. Gjykata e Lartë, pasi merr të dhënat e nevojshme, vendos në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve.

2. Vendimi që pranon kërkesën i njoftohet gjykatës që procedonte dhe asaj që i është caktuar për ta gjykuar. Gjykata që procedonte ia kalon menjëherë aktet gjykatës që është caktuar dhe urdhëron që vendimi i Gjykatës së Lartë t'u njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe palëve private.

3. Gjykata e caktuar nga Gjykata e Lartë deklaron me vendim nëse dhe në ç'pjesë veprimet e kryera i ruajnë efektet.

TTULLI III
AKTET, NJOFTIMET DHE AFATET

KREU I
AKTET

SEKSIONI I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 98

Gjuha e akteve

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Aktet procedurale penale bëhen në gjuhën shqipe.
2. Personi që nuk flet gjuhën shqipe pyetet në gjuhën amtare ose në një gjuhë tjetër që kupton, të zgjedhur prej tij. Procesverbali mbahet në gjuhën shqipe.
3. Shkelja e këtyre rregullave sjell pavlefshmërinë e aktit.

Neni 99

Nënshkrimi i akteve

1. Kur kërkohet nënshkrimi i një akti, në qoftë se ligji nuk disponon ndryshe, mjafton shkrimi me dorë në fund të aktit i emrit dhe mbiemrit të atij që duhet të nënshkruajë.
2. Është i pavlefshëm nënshkrimi i vënë me mjete mekanike ose me shenja të ndryshme nga shkrimi.
3. Kur personi nuk është në gjendje të nënshkruajë, nëpunësi para të cilit paraqitet akti i shkruar ose që regjistron aktin e bërë me gojë sigurohet për identitetin e personit dhe e pasqyron këtë fakt në fund të aktit, në praninë e një personi të tretë.

Neni 100
Data e akteve

1. Kur ligji kërkon datën e një akti, në akt tregohen dita, muaji, viti dhe vendi ku bëhet akti. Tregimi i orës është i domosdoshëm vetëm kur parashikohet shprehimisht.

2. Kur parashikohet pavlefshmëria e aktit për shkak se nuk është treguar data, ky rregull ka vlerë vetëm në rastin kur data nuk mund të saktësohet me siguri në bazë të elementeve që përmbahen në vetë aktin ose në aktet që lidhen me të.

Neni 101
Zëvendësimi i akteve origjinale

1. Kur origjinali i një akti procedural është prishur, ka humbur ose është zhdukur dhe për arsye të ndryshme nuk gjendet, kopja autentike e verifikuar ka vlerën e origjinalit dhe vihet në vendin ku ndodhej origjinali.

2. Për këtë qëllim, gjykata edhe kryesisht, me vendim, urdhëron personin që mban kopjen ta dorëzojë atë në sekretari.

Neni 102
Ribërja e akteve

1. Kur nuk mund të bëhet zëvendësimi i aktit, gjykata edhe kryesisht verifikon përmbajtjen e aktit që mungon dhe urdhëron nëse dhe në ç'mënyrë ai duhet të ribëhet.

2. Kur ekziston koncepti i aktit që mungon, ky ribëhet në bazë të konceptit, por me kusht që një nga gjyqtarët që e kanë nënshkruar vërteton se ai ka qenë i njëjtë me konceptin.

Neni 103

Ndalimi i publikimit të aktit

1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesëshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv.

2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesëshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake.

3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesëshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.

4. Ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe i fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur, të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale. Gjykata mund të lejojë publikimin vetëm kur e kërkojnë interesat e të miturit ose kur i mituri ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç.

Neni 104

Shkelja e ndalimit të publikimit

1. Shkelja e ndalimit të publikimit e bërë nga nëpunësi i shtetit ose i një entit publik, kur nuk përbën vepër penale, është shkelje disiplinore. Në këtë rast prokurori njofton organin që ka të drejtë të marrë masa disiplinore.

Neni 105

Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve

(Shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta apo të regjistrimeve audio ose audiovizive.

2. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak, ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor.

3. Lëshimi i kopjeve, ekstrakteve ose vërtetimeve nuk e heq ndalimin e publikimit.

Neni 106

Kërkesa e prokurorit për kopje të akteve dhe për informacione

1. Prokurori ka të drejtë, kur është e nevojshme të kryhen hetime, të kërkojë nga gjykata, edhe në rastet e detyrimit të sekretit, kopje të akteve që kanë lidhje me çështje të tjera penale që ai ndjek, si dhe informacione me shkrim mbi përmbajtjen e tyre.

2. Brenda pesë ditëve, gjykata i përgjigjet kërkesës ose e refuzon atë me vendim të arsyetuar.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 zbatohen edhe për kërkesat e bëra nga Ministri i Rendit Publik dhe kryetari i Shërbimit Informativ, kur kopje të akteve dhe informacionet u duhen atyre për parandalimin e veprave penale.

Neni 107

Pjesëmarrja e shurdhit, memecit dhe e shurdhmemecit në bërjen e akteve procedurale

1. Kur shurdhi, memeci apo shurdhmemeci dëshirojnë ose duhet të japin shpjegime, veprohet në këtë mënyrë:

a) shurdhit i paraqiten pyetjet dhe paralajmërimi me shkrim dhe ai përgjigjet me gojë;

b) memecit i bëhen pyetjet dhe paralajmërimi me gojë dhe ai përgjigjet me shkrim;

c) shurdhmemecit i paraqiten pyetjet dhe paralajmërimi me shkrim dhe ai përgjigjet me shkrim.

2. Në qoftë se shurdhi, memeci ose shurdhmemeci nuk dinë të lexojnë ose të shkruajnë, autoriteti procedues cakton një ose më shumë

interpretë të zgjedhur ndërmjet atyre personave që janë të mësuar të merren vesh me ta.

Neni 108

Dëshmitarët në aktet procedurale

(Shfuqizuar shkronja "b" e pikës 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Nuk mund të jenë dëshmitarë për të vërtetuar përmbajtjen e një akti procedural:

a) të miturit deri katërmbëdhjetë vjeç dhe personat që kanë sëmundje të dukshme mendore ose që janë në gjendje të rëndë dehjeje ose intoksikimi me lëndë narkotike e psikotrope;

b) Shfuqizuar.

Neni 109

Prokura për akte procedurale të caktuara

1. Kur ligji lejon që akti të bëhet me anën e një përfaqësuesi të posaçëm, prokura jepet me akt noterial ose me shkresë private të vërtetuar nga organet kompetente, ndryshe nuk pranohet dhe duhet të përmbajë, përveç të dhënave që kërkon posaçërisht ligji, përcaktimin e objektit për të cilin ajo është dhënë dhe të fakteve që u referohet. Prokura i bashkohet akteve.

2. Prokura e lëshuar nga organet shtetërore duhet të ketë nënshkrimin e drejtuesit dhe vulën e organit.

Neni 110

Memoriet dhe kërkesat e palëve

1. Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim.

2. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve.

Neni 111

Deklaratat dhe kërkesat e personave të izoluar

1. I pandehuri i izoluar me masë sigurimi ka të drejtë të paraqesë ankesa, kërkesa dhe deklaratata nëpërmjet drejtorit të institucionit, i cili lëshon dokument për marrjen në dorëzim të tyre. Ato regjistrohen në një libër të veçantë, i komunikohen menjëherë organit kompetent dhe kanë efekt njëloj sikur të ishin pranuar drejtpërdrejt nga ai organ.

2. I pandehuri që është në gjendje arresti në shtëpi ose që mbahet në ruajtje në një vend kurimi, ka të drejtë të paraqesë ankesa, kërkesa dhe deklaratata tek oficeri i policisë gjyqësore, i cili vërteton marrjen në dorëzim të tyre dhe kujdeset për dërgimin menjëherë tek autoriteti kompetent.

3. Po këto rregulla zbatohen edhe për kallëzimet, ankesat, kërkesat dhe deklaratat që paraqiten nga palët private ose nga viktimat.

SEKSIONI II

AKTET E GJYKATËS

Neni 112

Format e disponimit të gjykatës

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar pika 5, pika 6 numërohet pika 7 dhe shtuar pika 6, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata disponon me vendim dhe me urdhër.
2. Vendimi jepet në emër të Republikës.
3. Vendimi dhe urdhri arsyetohen, ndryshe janë të pavlefshëm.
4. Vendimi merret në dhomën e këshillimit, pa praninë e sekretarit dhe të palëve.

5. Kur një anëtar i trupit gjykues voton kundër vendimit të ndërmjetëm, ai arsyeton me shkrim mendimin e tij, i cili i bashkëlidhet procesverbalit të seancës.

6. Kur një anëtar i trupit gjykues voton kundër vendimit përfundimtar, ai arsyeton me shkrim mendimin e tij dhe akti qëndron në dosjen gjyqësore.

7. Urdhrat merren pa u respektuar formalitete të veçanta dhe kur nuk parashikohet ndryshe, jepen edhe me gojë.

Neni 113

Depozitimi i akteve të gjykatës

1. Origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërja e tyre. Për aktet e ankueshme njoftohen prokurori dhe personat që me ligj i njihet e drejta të bëjnë ankim.

Neni 114

Ndreqja e gabimeve materiale

1. Ndreqja e vendimeve dhe e urdhrave me gabime materiale bëhet edhe kryesisht nga gjykata që ka nxjerrë aktin. Kur ndaj këtij akti bëhet ankim, i cili pranohet, ndreqja bëhet me vendim të gjykatës që shqyrton ankimin, në bazë të të cilit bëhet shënim në origjinalin e aktit.

SEKSIONI III

DOKUMENTIMI I VEPRIMEVE

Neni 115

Procesverbali i seancës

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur është e mundur, aktet e kryera gjatë seancës gjyqësore, si dhe çdo akt tjetër i kryer jashtë saj, dokumentohen nëpërmjet

regjistrimit audio ose audioviziv. Regjistrimi fillon dhe mbaron në të njëjtën kohë me seancën gjyqësore.

2. Regjistrimi i seancës gjyqësore bëhet nga sekretari gjyqësor, nën udhëzimet dhe mbikëqyrjen e kryetarit të trupit gjykues.

3. Kur nuk është e mundur që procesverbali të mbahet nepermjet regjistrimit audio ose audioviziv, ai mbahet duke bërë një përmbledhje të sakte me shtypshkrim apo doreshkrim, nën mbikëqyrjen e kryetarit të trupit gjykues.

4. Procesverbali duhet të tregojë:

a) tregimin e vendit, vitit, muajit, ditës dhe orës, në të cilat ka filluar dhe është përfunduar;

b) përbërjen e gjykatës;

c) emrin e prokurorit;

ç) gjenealitetet e të pandehurit ose të dhëna të tjera personale që vlejné për ta identifikuar, gjenealitetet e mbrojtësve, viktimës akuzuese, palëve private dhe të përfaqësuesve të tyre.

d) gjenealitetet e personave që marrin pjesë në gjykim;

dh) kur është rasti, shkaqet e mungesës së palëve, përfaqësuesve të tyre dhe personave që janë thirrur për të marrë pjesë në seancën gjyqësore.

5. Procesverbali duhet të pershkruajë çdo akt të kryer gjatë gjykimit dhe të pasqyrojë në mënyrë të përmbledhur:

a) kerkimet dhe pretendimet e palëve;

b) pasqyrimin e saktë të emërimit të çdo parashtrimi, memorieje apo diskutimi përfundimtar të paraqitur me shkrim nga palët, duke treguar edhe numrin e fletëve;

c) pyetjet dhe deklaratimet e personave që marrin pjesë në gjykim, duke përfshirë deshmitaret dhe ekspertet;

c') provat e marra;

d) vendimet dhe urdhrat që ka dhënë gjykata gjatë gjykimit.

6. Kur procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo doreshkrim dhe njëra nga palët kërkon që pjesë nga theniet e saj apo të palës tjetër të përfshihen në procesverbal, gjykata duhet ta marrë parasysh këto kërkesë.

7. Memoriet me shkrim të paraqitura nga palët, në mbështetje të kërkesave dhe konkluzioneve të tyre, i bashkohen procesverbalit.

8. Kur procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim, ai nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga sekretari dhe në fund nga kryetari i trupit gjykues. Procesverbali është pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore dhe ruhet për atë kohë sa ruhet ajo.

9. Kur mbahet me regjistrim audio ose audioviziv, regjistrimi ruhet në programin elektronik përkatës për atë kohë sa ruhet dosja gjyqësore.

10. Palët kanë të drejtë në çdo kohë të marrin kopje të regjistrimit dhe procesverbalit të mbajtur me shtypshkrim apo dorëshkrim, kundrejt tarifave përkatëse.

Neni 116

Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive bëhet nga sekretari gjyqësor ose nën mbikqyrjen e tij nga teknike të caktuar nga gjykata për këtë qëllim, duke treguar në mënyrë të saktë të gjithë përmbajtjen e regjistrimit.

2. Transkripti nënshkruhet nga sekretari gjyqësor dhe personi që e ka kryer atë.

3. Transkriptimi i procesverbalit bëhet kur:

a) kërkohet nga anëtarët e trupit gjykues;

b) kërkohet me shkrim nga palët në gjykim dhe kjo kërkesë miratohet nga kryetari i trupit gjykues, pasi paguhet tarifat e vendosura për këtë qëllim, të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Kur transkriptimi i procesverbalit kërkohet pas përfundimit të gjykimit, mbi kërkesën vendos kryetari i gjykatës.

4. Transkriptimi i regjistrimit mund të bëhet për të gjitha seancat e një çështjeje, për seanca të veçanta ose për pjesë të shkëputura prej

tyre, sipas kërkesës së palës që kërkon transkriptimin. Nëse kryhen gjatë gjykimit, materialet e transkriptimit i bashkëlidhen dosjes gjyqësore dhe janë pjesë përbërëse e saj.

5. Për dokumentimin e akteve gjatë fazës së hetimeve paraprake zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e mësipërme.

Neni 117

Nënshkrimi i procesverbalit

(Shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Procesverbali i mbajtur në formë të shkruar, me përjashtim të atij që mbahet në seancën gjyqësore, pasi lexohet, nënshkruhet në fund të çdo flete nga ai që e ka përpiluar, nga ai që procedon dhe nga personat që kanë marrë pjesë.

2. Kur njëri nga pjesëmarrësit nuk do ose nuk është në gjendje të nënshkruajë, bëhet vërejtje ku tregohet edhe shkaku.

Neni 118

Transkriptimi i procesverbalit të redaktuar me mjete stenotipie

(Shfuqizuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Neni 119

Riprodhimi fonografik ose audioviziv

(Shfuqizuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Neni 120

Format e dokumentimit në raste të veçanta

(Shfuqizuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Neni 121

Deklarimet gojore të palëve

1. Kur ligji nuk kërkon formën e shkruar të dokumentit, palët mund të bëjnë, vetë ose me anë të përfaqësuesve të posaçëm, kërkesa

ose deklarime me gojë. Në këtë rast sekretari i gjykatës përpilon procesverbalin dhe regjistron deklaratimet. Procesverbalit i bashkohet, kur është rasti, prokura e posaçme.

2. Palës që e kërkon, i lëshohet me shpenzimet e veta një vërtetim ose kopja e deklaratimeve të bëra.

Neni 122

Pavlefshmëria e procesverbalit dhe regjistrimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Procesverbali i mbajtur me shtypshkrim ose dorëshkrim është i pavlefshëm kur ka dyshime për identitetin e personave që kanë marrë pjesë ose kur mungon nënshkrimi i nëpunësit që e ka përpiluar.

2. Veç përcaktimeve të pikës 1, të këtij neni, procesverbali i mbajtur me mjete audio ose audiovizive është i pavlefshëm për pjesën në të cilën përmbajtja e regjistrimit nuk është e kuptueshme.

SEKSIONI IV PËRKTHIMI I AKTEVE

Neni 123

Caktimi i përkthyesit

(Shtuar fjalia në pikën 1 dhe shtuar pika 4, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. I pandehuri që nuk njih gjuhën shqipe ka të drejtë të ndihmohet falas nga një përkthyes për të kuptuar akuzën dhe për të ndjekur veprimet ku merr pjesë. Nëpërmjet përkthyesit ai është i detyruar të bëjë një deklaratë me shkrim që nuk e njih gjuhën shqipe. Kur i pandehuri deklaron se e njih gjuhën shqipe, mund të heqë dorë nga kjo e drejtë.

2. Autoriteti procedues cakton, gjithashtu, një përkthyes kur duhet të përkthehet një shkrim në gjuhë të huaj.

3. Përkthyesi caktohet edhe kur gjykata, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore e njohin gjuhën që duhet të përkthehet.

4. Dispozitat për caktimin e përkthyesit për të pandehurin zbatohen edhe për viktimën.

Neni 124

Pazotësia dhe papajtueshmëria e përkthyesit

(Ndryshuar fjalia e dytë e shkronjës “c” në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Nuk mund të kryej detyrën e përkthyesit:

a) i mituri, ai që është ndaluar për të përkthyer, ai të cilit i është hequr zotësia juridike për të vepruar, personi i sëmurë mendërisht, ai të cilit i është ndaluar apo pezulluar ushtrimi i detyrave publike dhe i profesionit;

b) personi ndaj të cilit janë marrë masa sigurimi;

c) personi, i cili nuk mund të pyetet si dëshmitar, ai që është thirrur si dëshmitar dhe si ekspert në të njëjtin proces ose në një proces që lidhet me këtë. Megjithatë, kur pyetet një person që nuk dëgjon, nuk flet ose që nuk dëgjon dhe nuk flet, interpreti mund të merret nga të afërmit e tij, nëse nuk kanë papajtueshmëri.

Neni 125

Kërkesa për përjashtimin dhe për heqjen dorë të përkthyesit

1. Palët kanë të drejtë të kërkojnë përjashtimin e përkthyesit për shkaqet e treguara në nenin 124.

2. Kur ka shkak për të kërkuar përjashtimin ose heqjen dorë, përkthyesi është i detyruar ta deklarojë atë.

3. Kërkesa për përjashtimin ose heqjen dorë mund të paraqitet para caktimit të detyrës dhe, për shkaqet e njohura më vonë, para se përkthyesi të ketë mbaruar detyrën e tij.

4. Për kërkesën e përjashtimit ose të heqjes dorë organi procedues merr vendim.

Neni 126

Caktimi i detyrës së përkthyesit

1. Autoriteti procedues vërteton identitetin e përkthyesit dhe e pyet nëse ka shkaqe për përjashtimin e tij.

2. Përkthyesi paralajmërohet për detyrimin që ka për të bërë përkthim të saktë dhe për të mbajtur sekretin për veprimet që kryhen në prani të tij. Pas kësaj ai ftohet të kryejë detyrën.

Neni 127

Afati për përkthimet me shkrim. Zëvendësimi i përkthyesit

1. Autoriteti procedues i cakton përkthyesit një afat kur për përkthimin e shkrimeve kërkohet një punë e zgjatur. Përkthyesi mund të zëvendësohet kur nuk e paraqet përkthimin me shkrim brenda afatit.

2. Përkthyesi i zëvendësuar, pasi thirret për të paraqitur arsyet e mosplotësimit të detyrës, mund të dënohet nga gjykata me gjobë deri dhjetë mijë lekë.

SEKSIONI V

PAVLEFSHMËRIA E AKTEVE

Neni 128

Pavlefshmëria e akteve

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Aktet procedurale janë të pavlefshme vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht nga ky Kod.

Neni 128/a

Pavlefshmëria absolute

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me:

a) kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete dhe numrin e gjyqtarëve që janë të domosdoshëm për formimin e trupave gjykues, sipas parashikimeve të këtij Kodi;

b) të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim;

c) thirrjen e të pandehurit, viktimës ose praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme.

2. Një akt i cilësuar me ligj si absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm.

Neni 129

Pavlefshmëria relative

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Pavlefshmëritë e ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 128 mund të deklarohen mbi kërkesën e palëve.

2. Kur pala është e pranishme, pavlefshmëria e një akti duhet të kundërshtohet përpara se ai të bëhet ose, kur kjo nuk është e mundur, menjëherë pasi është bërë.

3. Pavlefshmëria lidhur me aktet e hetimeve paraprake dhe me ato të kryera për sigurimin e provës duhet të kundërshtohet në seancën paraprake ose në seancë gjyqësore përpara se të fillojë shqyrtimi gjyqësor, sipas nenit 355 të këtij Kodi.

4. Pavlefshmëria e vërtetuar në gjykim mund të kundërshtohet bashkë me ankimin kundër vendimit përfundimtar.

5. Afatet për të ngritur ose për të kundërshtuar pavlefshmërinë nuk mund të zgjaten.

Neni 130

Çmuarja e pavlefshmërisë relative

(Ndryshuar titulli, shkronja "b" e pikës 1 dhe pika 4, shtuar shkronja "c" në pikën 1, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe me ligj, pavlefshmëria nuk merret parasysh:

a) kur pala e interesuar ka hequr dorë shprehimisht nga kundërshtimi i saj ose ka pranuar pasojat e aktit;

b) kur pala ka përfituar nga e drejta, ushtrimin e së cilës akti i pavlefshëm synon të mbrojë;

c) kur është shkaktuar nga vetë pala, ose kur ajo nuk ka asnjë interes në ngritjen e saj.

2. Pavlefshmëria e lajmërimeve, komunikimeve dhe njoftimeve nuk merret parasysh në qoftë se pala e interesuar është paraqitur ose ka refuzuar të paraqitet.

3. Pala që deklaron se është paraqitur vetëm për të ngritur parregullsinë e aktit ka të drejtën e një afati, jo më pak se tri ditë, për t'u mbrojtur.

4. Gjatë hetimeve paraprake çmuarja e pavlefshmërisë bëhet nga prokurori dhe nëse nuk kryhet nga ky i fundit, çmohet nga gjyqtari i seancës paraprake.

Neni 131

Pasojat e deklarimit të pavlefshmërisë

1. Pavlefshmëria e një akti i bën të pavlefshme aktet e mëpasme që varen nga ai që është deklaruar i pavlefshëm.

2. Gjykata që deklaron pavlefshmërinë e një akti urdhëron përsëritjen e tij, kur është e nevojshme dhe e mundshme, duke ia ngarkuar shpenzimet atij që ka shkaktuar pavlefshmërinë me dashje ose nga pakujdesia e rëndë.

KREU II

NJOFTIMET

Neni 132

Organet dhe format e njoftimeve

1. Njoftimet e akteve bëhen nga ftuesi gjyqësor ose nëpërmjet shërbimit postar.

2. Gjyqtari, kur e çmon të nevojshme, mund të urdhërojë që njoftimet të bëhen nga policia gjyqësore.

3. Kur kopja e aktit i dorëzohet të interesuarit nga ana e sekretarisë së gjykatës, ajo ka vlerën e njoftimit. Në këtë rast sekretari i gjykatës bën shënim në aktin origjinal për dorëzimin dhe për datën.

4. Njoftimet që u bëhen nga gjykata të interesuarve në praninë e tyre shënohen në procesverbal.

Neni 133

Njoftimet e veçanta dhe me mjete të tjera teknike

(Ndryshuar titulli, pikat 2 dhe 4, shtuar pika 5 dhe shfuqizuar pika 3, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata në raste të ngutshme mund të urdhërojë që personat e kërkuar nga palët, përveç të pandehurit, të lajmërohen me telefon nga sekretaria e gjykatës ose nga policia gjyqësore. Në origjinalin e lajmërimit shënohet numri i telefonit të kërkuar, emri dhe detyra që kryen personi që merr njoftimin, marrëdhëniet e tij me atë që njoftohet, data dhe ora e telefonatës.

2. Njoftimi me telefon ka vlerë nga çasti kur është bërë, me kusht që të dokumentohet marrja e tij.

3. Shfuqizuar.

4. Gjykata, kur e çmon të përshtatshme, përveç të pandehurit, mund të disponojë njoftimin e personit, me mjete të tjera teknike që garantojnë njoftimin, me kusht që të dokumentohet marrja e tij.

5. Njoftimi i dëshmitarit me identitet të fshehur, dëshmitarit të mbrojtur dhe bashkëpunëtorit të drejtësisë bëhet nëpërmjet dorëzimit të kopjes së aktit prokurorit.

Neni 134

Njoftimi i akteve të prokurorit

1. Njoftimi i akteve të prokurorit, gjatë hetimeve paraprake, bëhet nga policia gjyqësore ose nëpërmjet shërbimit postar, në format e parashikuara nga neni 133.

2. Dorëzimi i kopjes së aktit të interesuarit nga ana e sekretarisë ka vlerën e njoftimit. Dorëzuesi shënon në origjinalin e aktit faktin e dorëzimit dhe datën.

3. Lajmërimet e bëra verbalisht nga prokurori zëvendësojnë njoftimet, me kusht që ky fakt të shënohet në procesverbal.

Neni 135

Njoftimet nga palët private

1. Njoftimet nga palët mund të bëhen edhe me dërgimin e kopjes së aktit nga përfaqësuesit e tyre nëpërmjet letrës rekomande me lajmërim marrje.

Neni 136

Njoftimet për prokurorin

1. Njoftimet për prokurorin bëhen edhe drejtpërsëdrejti nga palët, mbrojtësit ose përfaqësuesit e tyre nëpërmjet dorëzimit të kopjes së aktit në sekretari. Ai që e merr në dorëzim shënon në origjinal dhe në kopjen e aktit gjezimet e atij që ka bërë dorëzimin dhe datën.

Neni 137

Njoftimet për viktimën dhe palët private

(Ndryshuar titulli me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Njoftimet për personin e dëmtuar nga vepra penale bëhen njëjloj si për rastet kur njoftohet për herë të parë i pandehuri i lirë. Kur nuk dihen vendet e treguara në nenin 140, njoftimi bëhet me depozitimin e aktit në sekretari. Kur nga aktet del se vendbanimi ose vendqëndrimi i tij ndodhen jashtë shtetit, ai ftohet me anën e letrës rekomande me lajmërim marrje, me të cilën të deklarojë ose të zgjedhë banesën në territorin e shtetit shqiptar. Kur pas njëzet ditëve nga marrja e letrës rekomande nuk bëhet deklarimi ose zgjedhja e banesës, njoftimi bëhet me anën e depozitimit të aktit në sekretari.

2. Njoftimi i thirrjes së parë për të paditurin civil bëhet në format e caktuara për njoftimin e parë të të pandehurit të lirë.

3. Njoftimet për paditësin civil dhe të paditurin civil bëhen pranë përfaqësuesve të tyre.

Neni 138

Njoftimet nëpërmjet shpalljes publike për viktimat

(Ndryshuar titulli dhe pika 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur njoftimi i viktimave është i vështirë për shkak të numrit të tyre, pamundësisë të identifikimit të disave prej tyre ose kur njoftimi është i pamundur për shkak se nuk dihen vendet e treguara në nenin 140, gjykata mund të urdhërojë që ai të bëhet nëpërmjet shpalljes publike në këndin e njoftimeve dhe faqen e internetit të saj. Njoftimi qëndron i publikuar për jo më pak se 10 ditë.

2. Njoftimi quhet i bërë kur ftuesi i gjykatës depoziton në sekretari një kopje të aktit bashkë me dokumentet që vërtetojnë shpalljen publike.

Neni 139

Njoftimi i të pandehurit të burgosur

1. Njoftimi për të pandehurin e burgosur bëhet në vendin e burgimit duke i dorëzuar atij aktin.

2. Kur i pandehuri refuzon të marrë kopjen e aktit ose kur ai mungon për shkaqe të justifikuara, akti i dorëzohet përgjegjësit të institucionit, i cili për rastin e fundit njofton të interesuarin me mjetin më të shpejtë.

3. Dispozitat e mësipërme zbatohen edhe kur i pandehuri është i paraburgosur për një akuzë tjetër ose është duke vuajtur dënimin me burgim.

4. Kur i burgosuri lirohet për shkak të ndryshimit të masës së sigurimit, ai detyrohet të deklarojë ose të zgjedhë banesën. Kjo gjë shënohet në aktin e lirimimit dhe i njoftohet autoritetit procedues. Kur

njoftimi në banesën e deklaruar ose të zgjedhur nuk mund të bëhet, atëherë akti i dorëzohet mbrojtësit.

Neni 140

Njoftimi për herë të parë i të pandehurit të lirë

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij personalisht kopjen e aktit së bashku me letrën e të drejtave, sipas nenit 34/a, të këtij Kodi. Kur nuk mund t'i dorëzohet personalisht, njoftimi bëhet në banesën e tij ose në vendin e punës, duke ia dorëzuar aktin një personi që bashkëjeton me të ose një fqinji, ose një personi që punon me të. Në aktin e njoftimit tregohen gjenealitetet e personit që merr përsipër njoftimin dhe lidhja e tij me të pandehurin.

2. Kur vendet e treguara në paragrafin 1 nuk dihen, njoftimi bëhet në vendin ku i pandehuri ka banimin e përkohshëm ose vendin ku qëndron më shpesh, duke ia dorëzuar atë njërit prej personave të treguar në paragrafin 1.

3. Kopja e njoftimit nuk mund t'i dorëzohet një të mituri nën 14 vjeç ose një personi me paaftësi të dukshme intelektuale.

4. Nëse i pandehuri është i mitur, si rregull, ai njoftohet nëpërmjet prindërve ose kujdestarit të tij, si dhe sipas legjisllacionit të posaçëm për të miturit.

5. Kur personat e treguar në paragrafin 1 mungojnë ose nuk janë të përshtatshëm, ose refuzojnë të marrin aktin, atëherë procedohet me kërkimin e të pandehurit në vende të tjera. Në rast se edhe në këtë mënyrë nuk mund të bëhet njoftimi, akti depozitohet në qendrën administrative të lagjes ose të fshatit ku i pandehuri banon ose punon. Lajmërimi i depozitimit afishohet në portën e shtëpisë së të pandehurit ose të vendit ku punon, këndin e afishimit dhe në faqen e internetit të gjykatës. Ftuesi gjyqësor e lajmëron atë për depozitimin me letër rekomande me lajmërim marrje. Efektet e njoftimit rrjedhin që nga marrja e rekomandesë.

6. Njoftimi i të pandehurit që kryen shërbimin ushtarak bëhet duke i dorëzuar aktin atij vetë dhe kur nuk mund të bëhet dorëzimi, akti i njoftohet komandës e cila detyrohet të lajmërojë menjëherë të interesuarin.

7. Me aktin e njoftimit për herë të parë, organi procedues e fton të pandehurin të deklarojë ose të zgjedhë banesën apo vendin dhe mënyrën e njoftimeve të mëtejshme për efekte të procedimit. Për çdo ndryshim të tyre i pandehuri është i detyruar të njoftojë me shkrim ose të deklarojë përpara organit procedues.

Neni 140/a

Njoftimi i të pandehurit person juridik

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Njoftimi i të pandehurit person juridik bëhet në selinë e tij. Personi që e merr në dorëzim njoftimin shënon në aktin e njoftimit identitetin, detyrën që kryen në personin juridik dhe datën e marrjes së njoftimit.

2. Nëse njoftimi sipas paragrafit të mësipërm nuk është i mundur, ai kryhet nëpërmjet afishimit të njoftimit në adresën e deklaruar të selisë, këndin e afishimit të gjykatës dhe në faqen elektronike të saj, si dhe nëpërmjet afishimit në faqen elektronike të Qendrës Kombëtare të Bizneseve në rastet e personave juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar.

Neni 141

Njoftimi i të pandehurit kur nuk gjendet

1. Kur njoftimi nuk mund të bëhet sipas rregullave të caktuara për njoftimin e të pandehurit të lirë, autoriteti procedues urdhëron kërkimin e të pandehurit. Në qoftë se kërkimi nuk jep rezultat pozitiv, atëherë nxirret vendimi i mosgjetyes, me të cilin, pasi i caktohet një mbrojtës të pandehurit, urdhërohet që njoftimi të bëhet duke i dorëzuar një kopje mbrojtësit. I pagjeturi përfaqësohet nga mbrojtësi.

2. Vendimi i mosgjetjes i pushon efektet kur përfundojnë hetimet paraprake ose me dhënien e vendimit nga gjykata.

3. Njoftimi për të pandehurin e fshehur ose të arratisur bëhet nëpërmjet dorëzimit të kopjes së aktit mbrojtësit dhe kur ai nuk ka mbrojtës autoriteti procedues cakton një mbrojtës kryesisht, i cili e përfaqëson të pandehurin.

Neni 142

Njoftimi i të pandehurit jashtë shtetit

(Shtuar pika 2 dhe pika 2 ekzistuese bëhet pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur vendbanimi ose qëndrimi i të pandehurit jashtë shtetit është i njohur, autoriteti procedues i dërgon atij letër rekomande me lajmërim marrje, me të cilën e njofton për veprën penale që akuzohet dhe i kërkon të deklarojë ose të zgjedhë banesën në territorin shqiptar. Në qoftë se pas tri ditëve nga marrja e letrës rekomande nuk bëhet deklarimi ose zgjedhja e banesës ose kur kjo nuk lajmërohet, njoftimi bëhet nëpërmjet dorëzimit të mbrojtësi.

2. Kur i pandehuri njoftohet, sipas paragrafit 1, ai ftohet të deklarojë ose të zgjedhë banesën në territorin shqiptar. Njoftimi i kryer në adresën e deklaruar quhet i realizuar.

3. Kur del se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të vepruar sipas paragrafit 1, autoriteti procedues, para se të nxjerrë vendimin e mosgjetjes, urdhëron të bëhen kërkime edhe jashtë territorit të shtetit sipas rregullave të caktuara në marrëveshjet ndërkombëtare.

Neni 142/a

Njoftimi i personave të huaj që gëzojnë imunitet

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Përveçse kur parashikohet ndryshe nga marrëveshjet ndërkombëtare, njoftimi i personave të huaj që gëzojnë imunitet, sipas së drejtës ndërkombëtare, kryhet nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme.

Neni 143

Pavlefshmëria e njoftimeve

1. Njoftimi është i pavlefshëm:

a) kur akti është njoftuar jo i plotë, me përjashtim të rasteve kur ligji lejon njoftimin me ekstrakt;

b) kur në kopjen e aktit të njoftuar mungon nënshkrimi i atij që ka bërë njoftimin;

c) kur janë shkelur dispozitat e veçanta mbi personin të cilit duhet t'i dorëzohet kopja;

ç) kur nuk është bërë afishimi i njoftimit për të pandehurin në gjendje të lirë;

d) kur në origjinalin e aktit të njoftuar mungon nënshkrimi i personit që ka marrë përsipër njoftimin, sipas nenit 140 paragrafi 1;

dh) kur nuk janë respektuar format për njoftimin me mjete teknike të veçanta dhe që për këtë shkak ai që duhej njoftuar nuk ka ardhur në dijeni të aktit.

KREU III

AFATET

Neni 144

Rregulla të përgjithshme

1. Afatet procedurale caktohen në orë, në ditë, në muaj ose në vite.

2. Afatet llogariten sipas kalendarit të zakonshëm.

3. Afati i caktuar në ditë, kur ai mbaron në ditë pushimi ose feste, shtyhet deri në ditën pasardhëse të punës ose jofestive.

4. Me përjashtim të rasteve kur ligji disponon ndryshe, në afatin e caktuar nuk llogaritet ora ose dita në të cilën fillon të ecë afati. Llogariten ora e fundit ose dita e fundit.

5. Afati për bërjen e deklaratave, depozitimin e dokumenteve ose për kryerjen e veprimeve të tjera në gjykatë konsiderohet i mbaruar në momentin kur, sipas rregullit, zyrat mbyllen për publikun.

Neni 145

Afatet që nuk mund të zgjaten

1. Afatet që nuk mund të zgjaten janë ato që parashikohen nga ligji për raste të caktuara. Këto afate mund të zgjaten vetëm kur me ligj disponohet ndryshe.

2. Pala, në favor të së cilës është caktuar një afat, mund të kërkojë ose të lejojë shkurtimin e tij me deklaratë të dorëzuar në sekretarinë e autoritetit procedues.

Neni 146

Zgjatja e afatit të paraqitjes

1. Kur vendbanimi i të pandehurit, që rezulton nga aktet, ose banesa e deklaruar a e zgjedhur, është jashtë rrethit ku ka selinë organi procedues, afati për paraqitje zgjatet për aq ditë sa duhen për udhëtim. Në çdo rast, zgjatja e afatit nuk mund të jetë më shumë se tri ditë. Për të pandehurin me banim jashtë shtetit zgjatja e afatit caktohet nga autoriteti procedues, duke mbajtur parasysh largësinë dhe mjetet e komunikacionit që përdoren.

2. Këto rregulla zbatohen edhe për afatin e caktuar për paraqitjen e çdo personi tjetër, për të cilin autoriteti procedues ka lëshuar urdhër ose ftesë.

Neni 147

Rivendosja në afat

(Shfuqizuar shprehja në pikën 6 me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 17.5.2012; ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Prokurori, i pandehuri, viktimja, viktimja akuzuese dhe palët private rivendosen në afatin e caktuar kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit faktor ose të forcës madhore.

2. Rivendosja në afat nuk lejohet më shumë se një herë për secilën palë për çdo shkallë të procedimit.

3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zhdukja e faktit që përbënte rast faktor ose forcë madhore. Për kërkesën vendos organi që procedon në kohën e paraqitjes së saj.

4. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve. Gjykata shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve.

Neni 148

Efektet e rivendosjes në afat

(Shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata që ka vendosur rivendosjen në afat, me kërkesën e palës dhe për aq sa është e mundur, urdhëron përsëritjen e veprimeve në të cilat pala kishte të drejtë të merrte pjesë.

2. Shfuqizuar.

TITULLI IV

PROVAT

KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 149

Kuptimi i provës

(Shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.

2. Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë nëse prova vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit. Gjykata vendos për marrjen e provës pasi dëgjon palët mbi mënyrën e marrjes së saj.

Neni 150

Objekti i provave

1. Janë objekt prove faktet që kanë lidhje me akuzën, fajësinë e të pandehurit, caktimin e masave të sigurimit, dënimit dhe përgjegjësinë civile, si dhe faktet nga të cilat varet zbatimi i normave procedurale.

Neni 151

Marrja e provave

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

2. Në gjykim provat merren me kërkesën e palëve. Gjykata vendos menjëherë, duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë haptazi të panevojshme.

3. Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria e provave ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit.

Neni 152

Çmuarja e provave

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji. Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj.

2. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicjet përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën.

3. Deklarimet e bëra nga i bashkëpandehuri në të njëjtën vepër penale ose nga personi i marrë si i pandehur në një procedim që lidhet me të, vlerësohen në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

KREU II LLOJET E PROVAVE

SEKSIONI I DËSHMIA

Neni 153

Objekti dhe kufijtë e dëshmisë

1. Dëshmitari pyetet për faktet që përbëjnë objekt prove. Ai nuk mund të dëshmojë për qëndrimin moral të të pandehurit, përveçse kur çështja lidhet me fakte që vlejnë për përcaktimin e personalitetit të tij në lidhje me veprën penale dhe me rrezikshmërinë shoqërore.

2. Pyetja e dëshmitarit mund të shtrihet edhe në marrëdhëniet e farefisnisë dhe të interesave që ekzistojnë ndërmjet dëshmitarit dhe palëve apo dëshmitarëve të tjerë, si dhe mbi rrethanat, vërtetimi i të cilave është i nevojshëm për vlerësimin e besueshmërisë së tij. Dëshmia mbi faktet që shërbejnë për të përcaktuar personalitetin e viktimës nga vepra penale pranohet vetëm kur akuza e të pandehurit duhet të çmohet në raport me sjelljen e viktimës.

3. Dëshmitari pyetet për fakte të caktuara. Ai nuk mund të dëshmojë për çka flitet në publik dhe as të shprehë vlerësime personale, me përjashtim të rasteve kur ato nuk mund të ndahen nga dëshmia për faktet.

Neni 154
Dëshmia indirekte

1. Kur dëshmitari, për njohjen e fakteve, u referohet personave të tjerë, gjykata, me kërkesën e palës ose edhe kryesisht urdhëron që këta të thirren për të dëshmuar.

2. Mosrespektimi i dispozitës së paragrafit 1 i bën të papërdorshme thëniet mbi faktet, të cilat dëshmitari i ka mësuar nga persona të tjerë, me përjashtim të rasteve kur pyetja e tyre është e pamundur për shkak se kanë vdekur, janë të sëmurë rëndë ose nuk gjenden.

3. Dëshmitari nuk mund të pyetet për fakte që i ka mësuar nga personat që janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional ose shtetëror, me përjashtim të rasteve kur këta persona kanë deklaruar për të njëjtat fakte ose i kanë përhapur ato me ndonjë mënyrë tjetër.

4. Nuk mund të përdoret dëshmia e atij që refuzon ose që nuk është në gjendje të tregojë personin ose burimin nga të cilët ka marrë dijeni për faktet që pyetet.

Neni 155
Zotësia për të dëshmuar

1. Çdo person ka zotësi për të dëshmuar, me përjashtim të atyre që për shkak të të metave mendore ose fizike nuk janë në gjendje të dëshmojnë.

2. Kur për vlerësimin e thënieve është i nevojshëm verifikimi i aftësive fizike ose mendore për të bërë dëshmi, gjykata edhe kryesisht mund të urdhërojë verifikimet përkatëse.

Neni 156
Papajtueshmëria me detyrën e dëshmitarit
(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Nuk mund të pyeten si dëshmitarë:

a) personat që, për shkak të aftësive të kufizuara fizike ose psikike, nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt;

b) të pandehurit në një vepër penale të përbashkët ose në një procedim të lidhur, kur ndaj tyre është dhënë vendimi i mosfillimit të procedimit, i pushimit të akuzës ose çështjes, ose i dënimit, duke përfshirë edhe rastet e gjykimit me marrëveshje dhe të urdhrimit penal të dënimit, me përjashtim të rasteve kur vendimi i pafajësisë ka marrë formë të prerë;

c) ata që në të njëjtin procedim kryejnë ose kanë kryer funksionin e gjyqtarit ose të prokurorit;

ç) i padituri civil dhe personi civilisht përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga i pandehuri.

2. Rregulli i parashikuar në shkronjën “b”, të paragrafit 1, nuk gjen zbatim për bashkëpunëtorin e drejtësisë, i cili pyetet në çdo rast në cilësinë e dëshmitarit, sipas nenit 36/a të këtij Kodi.

Neni 157

Detyrimet e dëshmitarit

1. Dëshmitari është i detyruar të paraqitet në gjykatë, t’u përmbahet urdhrave të saj dhe t’u përgjigjet me vërtetësi pyetjeve që i bëhen.

2. Dëshmitari nuk mund të detyrohet të dëshmojë për fakte, nga të cilat mund të lindte përgjegjësia penale për të.

Neni 158

Përjashtimet nga detyrimi për të dëshmuar

(Ndryshuar shkronja “a” e paragrafit të parë me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; shtuar pika 1/1 dhe fjalë në shkronjën “c” të pikës 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Nuk janë të detyruar të dëshmojnë:

a) gjinia ose krushqia e afërt e të pandehurit, sipas përcaktimeve të nenit 16, me përjashtim të rasteve kur kanë bërë kallëzim ose ankim ose kur ata apo një i afërm i tyre janë të dëmtuar nga vepra penale;

b) bashkëshorti për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë jetës bashkëshortore;

c) bashkëshorti i ndarë nga i pandehuri për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë jetës bashkëshortore;

ç) ai që edhe pse nuk është bashkëshort i të pandehurit, bashkëjeton ose ka bashkëjetuar me të;

d) ai që është i lidhur me të pandehurin me marrëdhënie birësimi.

1/1. Përjashtimi nga detyrimi për të dëshmuar nuk zbatohet kur personat e përmendur në paragrafin 1, të këtij neni, kanë bërë kallëzim ose ankim ose kur ata ose një anëtar i familjes së tyre është viktimë e veprës penale.

2. Gjykata u bën të njohur personave të mësipërm të drejtën për të mos dëshmuar dhe i pyet ata nëse duan të përfitojnë nga kjo e drejtë. Mosrespektimi i këtij rregulli e bën të pavlefshme dëshminë.

Neni 159

Ruajtja e sekretit profesional

1. Nuk mund të detyrohen të dëshmojnë për sa dinë për shkak të profesionit, me përjashtim të rasteve kur kanë detyrimin që t'ua referojnë autoriteteve proceduese:

a) përfaqësuesit e besimeve fetare, statutet e të cilëve nuk janë në kundërshtim me rendin juridik shqiptar;

b) avokatët, përfaqësuesit ligjorë dhe noterët;

c) mjekët, kirurgët, farmacistët, obstetrët dhe kushdo që ushtron një profesion shëndetësor;

ç) ata që ushtrojnë profesione të tjera, të cilëve ligji u njeh të drejtën të mos dëshmojnë për ato që lidhen me sekretin profesional.

2. Gjykata, kur ka arsye të dyshojë se pretendimi i bërë nga këta persona për t'iu shmangur dëshmisë nuk ka baza, urdhëron verifikimet e nevojshme. Kur ai rezulton pa baza, gjykata urdhëron që dëshmitari të deponojë.

3. Dispozitat e parashikuara nga paragrafi 1 dhe 2 zbatohen edhe për gazetarët profesionistë lidhur me emrat e personave nga të cilët

ata kanë marrë të dhëna gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Por, kur të dhënat janë të domosdoshme për të provuar veprën penale dhe vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit, gjykata urdhëron gazetarin që të tregojë burimin e informacionit të tij.

Neni 160

Ruajtja e sekretit shtetëror

(Shtuar pika 6 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Nëpunësit shtetërorë, nëpunësit publikë dhe të ngarkuarit me një shërbim publik janë të detyruar të mos dëshmojnë për faktet që janë sekret shtetëror.

2. Kur dëshmitari pretendon se fakti përbën sekret shtetëror, organi procedues kërkon konfirmimin me shkrim të organit kompetent shtetëror.

3. Kur sekreti konfirmohet dhe prova nuk është thelbësore për zgjidhjen e çështjes, dëshmitari nuk pyetet, ndërsa kur prova është thelbësore, organi procedues vendos pezullimin e çështjes derisa të japë përgjigje organi më i lartë i administratës shtetërore. Pas kësaj dëshmitari detyrohet të dëshmojë.

4. Kur tridhjetë ditë nga njoftimi i kërkesës, organi shtetëror kompetent nuk jep konfirmimin e sekretit, dëshmitarit i kërkohet të dëshmojë.

5. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore, si dhe personeli i shërbimit informativ nuk mund të detyrohen të tregojnë emrat e informatorëve të tyre. Informacionet e dhëna prej tyre nuk mund të merren dhe as të përdoren në qoftë se këta zyrtarë nuk pyeten si dëshmitarë lidhur me informacionin.

6. Kur informatorët pranojnë të dëshmojnë, dëshmia merret duke respektuar rregullat mbi ruajtjen e fshehtësisë së identitetit të tyre. Zbatohen, për aq sa është e mundur, parashikimet e neneve 165/a dhe 361/b të këtij Kodi.

Neni 161
Përrjashtimi i sekretit

1. Nuk mund të jenë objekt i sekretit shtetëror të dhënat ose dokumentet që lidhen me veprat penale, të cilat synojnë përmbysjen e rendit kushtetues. Natyra e veprës penale përcaktohet nga organi procedues.

2. Kur nuk pranohet përjashtimi i sekretit njoftohet organi kompetent shtetëror.

Neni 162
Marrja e dëshmisë së Presidentit të Republikës dhe të nëpunësve të lartë të shtetit

(Shfuqizuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Neni 163
Marrja e dëshmisë së nëpunësve diplomatikë

1. Kur duhet të pyetet një nëpunës diplomatik ose një i ngarkuar me mision diplomatik jashtë shtetit, për kohën që ndodhen jashtë territorit të shtetit shqiptar, kërkesa për marrjen në pyetje i transmetohet, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, organit diplomatik ose konsullor shqiptar, përveç rasteve kur çmohet e domosdoshme paraqitja e tyre.

2. Për marrjen e deponimeve nga nëpunësit diplomatikë të një shteti të huaj të akredituar pranë shtetit shqiptar, respektohen konventat dhe zakonet ndërkombëtare.

Neni 164
Shoqërimi i detyrueshëm
(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur dëshmitari, i thirrur rregullisht, nuk paraqitet në vendin, ditën dhe orën e caktuar, pa pasur pengesa të ligjshme, gjykata mund

të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm ose të vendosë gjobë deri në masën 30 000 lekë.

2. Gjykata mund të revokojë vendimin e dhënë sipas paragrafit 1, të këtij neni, ose të pakësojë masën e gjobës, kur rezulton se ka pasur shkaqe të arsyeshme.

3. Personi i shoqëruar me detyrim nuk mund të mbahet në dispozicion tej kohës së nevojshme për praninë e tij dhe sidoqoftë jo më shumë se njëzet e katër orë.

4. Parashikimet e pikave 1, 2 dhe 3, të këtij neni, vlejnë edhe për ekspertin dhe përkthyesin.

5. Parashikimet e pikave 1, 2 dhe 3, të këtij neni, nuk zbatohen për dëshmitarët e mitur.

Neni 165

Përgjegjësia për dëshmi të rreme ose refuzim për të dëshmuar

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur gjatë pyetjes dëshmitari bën thënie kontradiktore, jo të plota ose që janë në kundërshtim me provat e marra, gjykata ia vë në dukje duke e paralajmëruar për përgjegjësinë penale për dëshmi të rreme.

2. Të njëjtin paralajmërim gjykata i bën edhe dëshmitarit që refuzon të dëshmojë. Kur dëshmitari ngul këmbë në mospranimin për të dëshmuar, gjykata i kërkon prokurorit që të procedojë sipas ligjit.

3. Kur dëshmitari refuzon të dëshmojë, pasi kërkon masa mbrojtjeje apo kërkon të vihet në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, sipas legjislacionit në fuqi, prokurori nuk regjistron procedimin penal për dëshmi të rreme, derisa të vendoset për kërkesën e tij.

4. Kur me vendimin përfundimtar gjykata çmon se dëshmitari ka bërë dëshmi të rreme, gjykata i përcjell aktet prokurorit për të proceduar sipas ligjit.

Neni 165/a

Dëshmitari me identitet të fshehur

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur dhënia e dëshmisë mund të vendosë dëshmitarin ose anëtarët e familjes së tij në rrezik serioz për jetën apo shëndetin dhe i pandehuri akuzohet për veprat penale të parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 234, 234/a, 234/b, 265/a, 265/b, 265/c, si dhe nuk zbatohet programi i mbrojtjes së dëshmitarëve, gjykata, me kërkesën e prokurorit, mund të vendosë zbatimin e teknikave të veçanta të marrjes në pyetje, sipas nenit 361/b të këtij Kodi.

2. Kërkesa e prokurorit i paraqitet kryetarit të trupit gjykues në një zarf të mbyllur, me shënimin: “Konfidenciale: dëshmitar me identitet të fshehur”. Në kërkesë prokurori parashtrohet arsyet për nevojën e përdorimit të një ose disa prej teknikave të veçanta të marrjes në pyetje.

3. Në zarfin me shënimin e mësipërm, prokurori depoziton edhe zarfin e mbyllur që përmban identitetin e plotë të dëshmitarit me identitet të fshehur. Vetëm kryetari i trupit gjykues njihet me identitetin e vërtetë të dëshmitarit me identitet të fshehur dhe verifikon zotësinë dhe papajtueshmërinë me detyrën e dëshmitarit, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Në çdo rast, mbi zarf shënohen në mënyrë të dukshme data, emri, nënshkrimi dhe funksioni i personave që kanë hapur zarfin dhe atyre që janë njohur me të dhënat që përmban zarfi. Pas kryerjes së verifikimeve, zarfi me identitetin e vërtetë të dëshmitarit me identitet të fshehur i kthehet prokurorit.

4. Gjukata shqyrton kërkesën e prokurorit në dhomë këshillimi dhe vendos me vendim të arsyetuar brenda dyzet e tetë orëve nga paraqitja e kërkesës.

5. Prokurori mund të ushtrojë ankim kundër vendimit të gjykatës brenda dyzet e tetë orëve nga njoftimi i vendimit. Gjukata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi dhe vendos mbi ankimin brenda dyzet e tetë orëve nga marrja e akteve. Ky vendim është i paankimueshëm.

6. Kur pranon kërkesën e prokurorit, gjykata vendos pseudonimin e dëshmitarit dhe procedurat e fshehjes së identitetit, njoftimit, paraqitjes dhe pjesëmarrjes në procedim. Pyetja e dëshmitarit kryhet sipas rregullave të parashikuara në nenin 361/b të këtij Kodi.

7. Dëshmitari merr pjesë në të gjitha fazat e gjykimit vetëm me pseudonimin e vendosur nga gjykata, përveç rastit të parashikuar nga paragrafi 8 i këtij neni.

8. Pyetja e dëshmitarit me identitet të fshehur dhe caktimi i pseudonimit të tij gjatë fazës së hetimeve bëhen nga prokurori. Aktet ku ai merr pjesë, nënshkruhen me pseudonimin e caktuar.

SEKSIONI II

PYETJA E TË PANDEHURIT DHE E PALËVE PRIVATE

Neni 166

Kërkesa për pyetjen

1. I pandehuri dhe i padituri civil pyeten në qoftë se bëjnë kërkesë ose kur u kërkohet dhe ata japin pëlqimin. Po kështu edhe paditësi civil, përveç rastit kur duhet të pyetet si dëshmitar.

Neni 167

Pyetja e një personi të marrë si i pandehur në një procedim të lidhur

(Shtuar pika 4/1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Personat e marrë si të pandehur në një procedim të lidhur, ndaj të cilëve procedohet ose është proceduar veç e veç, pyeten me kërkesën e palës ose edhe kryesisht.

2. Ata janë të detyruar të paraqiten në gjykatë, e cila, kur është e nevojshme, urdhëron shoqërimin e tyre forcërisht. Zbatohen dispozitat për thirrjen e dëshmitarëve.

3. Personat e treguar në paragrafin 1 ndihmohen nga mbrojtësi i zgjedhur dhe në mungesë të tij nga një mbrojtës i caktuar kryesisht.

4. Para se të fillojë pyetja, gjykata i njofton personat e treguar në paragrafin 1 se kanë të drejtë të mos përgjigjen.

4/1. Kur duhet të pyetet një person që është marrë si i pandehur në një procedim të lidhur dhe ekziston një nga kushtet e parashikuara nga shkronja “b”, e paragrafit 1, të nenit 156, të këtij Kodi, gjykata i garanton mbrojtjen nga deklaramet vetinkriminuese lidhur me faktet për të cilat ai është proceduar. Kur ai bën deklarime me vetëpërgjegjësi për fakte të reja, gjykata i bën të ditur të drejtat që parashikohen në nenin 37 të këtij Kodi.

5. Dispozitat e paragrafëve të mësipërm zbatohen edhe gjatë hetimit paraprak ndaj personave të marrë si të pandehur për një vepër penale të lidhur me atë për të cilën procedohet.

Neni 167/a

Pyetja në distancë e një personi të marrë si i pandehur në një procedim të lidhur ose që vuan dënimin jashtë shtetit

(Shtuar me ligjin nr.9276, datë 16.9.2004)

I pandehuri në një procedim të lidhur, i proceduar ose që vuan dënimin jashtë shtetit për një vepër tjetër penale, kur refuzohet ekstradimi i tij, mund të pyetet në distancë, me anë të lidhjes audiovizive, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, me kusht që shteti i huaj të garantojë pjesëmarrjen e mbrojtësit të të pandehurit në vendin ku kryhet marrja në pyetje.

Neni 168

Pyetja e palëve private

(Ndryshuar referenca me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Në pyetjen e palëve private zbatohen dispozitat e parashikuara nga nenet 153,154,157, paragrafi 2 dhe 361.

2. Kur pala refuzon t'i përgjigjet një pyetjeje, bëhet shënim në procesverbal.

SEKSIONI III BALLAFAQIMET

Neni 169

Kushtet e ballafaqimit

(Shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Ballafaqimi lejohet vetëm ndërmjet personave që janë pyetur, kur ka mospërputhje midis tyre për fakte dhe rrethana të caktuara.
2. Ndalohet ballafaqimi i të pandehurit të rritur me viktimën ose dëshmitarin e mitur.

Neni 170

Rregullat e ballafaqimit

1. Organi procedues, pasi u kujton deklaratimet e mëparshme personave që do të ballafaqohen, i pyet nëse i konfirmojnë ose i ndryshojnë ato, duke i ftuar, kur lind nevoja, për të bërë kundërshtimet reciproke.
2. Në procesverbal shënohen pyetjet e bëra nga organi procedues, deklaratimet e bëra nga personat e ballafaquar dhe gjithçka tjetër që ka ndodhur gjatë ballafaqimit.

SEKSIONI IV NJOHJET

Neni 171

Njohja e personave

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur lind nevoja për të proceduar në njohjen e një personi, organi procedues fton atë që duhet të bëjë njohjen që të përshkruajë personin, duke treguar të gjitha shenjat që mban mend dhe e pyet nëse ka qenë thirrur më parë për të bërë njohjen, si dhe për rrethana të tjera që mund të ndikojnë në vërtetësinë e njohjes.

2. Në procesverbal shënohen veprimet e parashikuara nga paragrafi 1 dhe deklaratimet e bëra nga personi që bën njohjen. Kur është e mundur, procedura e njohjes fotografohet ose regjistrohet.

3. Kur njohja bëhet nga një i mitur ose ndaj një të mituri, prania e psikologut është e detyrueshme. Organi procedues kryen njohjen në një mënyrë të tillë që personi që do të njihet të mos e shohë ose dëgjojë të miturin.

4. Njohja bëhet në praninë e mbrojtësit.

5. Mosrespektimi i rregullave të parashikuara nga ky nen përbën shkak për pavlefshmërinë e njohjes.

Neni 172

Zhvillimi i njohjes

1. Pasi largon atë që duhet të bëjë njohjen, organi procedues siguron praninë e të paktën dy personave sa më të ngjashëm me atë që duhet të njihet. E fton këtë të fundit të zgjedhë vendin e tij në raport me të tjerët duke u kujdesur që të paraqitet, sa të jetë e mundur, në të njëjtat kushte në të cilat do të kishte qenë parë nga personi i thirrur për njohje. Pasi paraqitet personi që do të bëjë njohjen gjykata e pyet nëse njeh ndonjërin nga ata që i paraqiten për njohje dhe, në rast se po, e fton të tregojë se cilin njeh dhe ta saktësojë nëse është i sigurt.

2. Kur ka arsye të mendohet se personi i thirrur për të bërë njohjen mund të frikësohet ose të ketë ndikime të tjera nga prania e personit që duhet njohur, organi procedues urdhëron që veprimi të kryhet pa e parë ky i fundit të parin.

3. Në procesverbal shënohen, me pasojë pavlefshmërie, mënyra e zhvillimit të njohjes. Organi procedues mund të urdhërojë që zhvillimi i njohjes të dokumentohet edhe me fotografime ose filmime.

Neni 172/a

Detyrimi për të marrë pjesë në njohje
(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Personat e thirrur janë të detyruar të marrin pjesë në procedurën e njohjes.
2. Organi procedues mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm të personit të thirrur rregullisht që nuk paraqitet në vendin, ditën dhe orën e caktuar për njohje pa pasur shkaqe të arsyeshme.
3. Ndalohet shoqërimi i detyrueshëm i të miturit kur procedohet sipas paragrafit 3, të nenit 171, të këtij Kodi.

Neni 173

Njohja e sendeve

1. Kur duhet proceduar në njohjen e provave materiale ose të sendeve të tjera që lidhen me veprën penale, organi procedues vepron duke respektuar rregullat për njohjen e personave, për aq sa mund të zbatohen.
2. Pasi gjenden, kur është e mundur, të paktën dy objekte të ngjashme me atë që duhet njohur, organi procedues e pyet personin e thirrur për njohje nëse njeh ndonjërin prej tyre dhe, në rast se po, e fton të deklarojë se cilin ka njohur dhe ta saktësojë nëse është i sigurt.
3. Në procesverbal shënohen, me pasojë pavlefshmërie, mënyra e zhvillimit të njohjes.

Neni 174

Njohjet e tjera

1. Kur vendos njohjen e zërave, të tingujve ose të çdo gjëje tjetër që mund të jetë objekt perceptimi shqisor, organi procedues vepron duke respektuar dispozitat për njohjen e personave, për aq sa mund të zbatohen.

Neni 175

Njohja nga disa persona ose e disa personave

(Shtuar referenca në pikën 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur disa persona thirren për të bërë njohjen e të njëjtit person ose të të njëjtit objekt, organi procedues kryen veprime veç e veç duke ndaluar çdo komunikim ndërmjet atij që ka kryer njohjen dhe atyre që duhet ta bëjnë atë më pas.

2. Kur një person duhet të bëjë njohjen e disa personave ose të disa objekteve, organi procedues urdhëron, që personi ose objekti që duhet njohur të futen ndërmjet personave ose objekteve të ndryshme.

3. Zbatohen dispozitat e neneve 171, 172, 172/a dhe 173.

SEKSIONI V EKSPERIMENTI

Neni 176

Kushtet e eksperimentit

1. Eksperimenti lejohet kur është e nevojshme të vërtetohet nëse një fakt ka ndodhur ose mund të ketë ndodhur në një mënyrë të caktuar.

2. Eksperimenti është riprodhimi, për aq sa është e mundur, i gjendjes në të cilën fakti ka ndodhur ose çmohet se ka ndodhur duke përsëritur mënyrat e zhvillimit të vetë faktit.

Neni 177

Rregullat e kryerjes së eksperimentit

1. Vendimi i organit procedues për kryerjen e eksperimentit përmban një njoftim përmbledhës për objektin e tij dhe tregimin e ditës, të orës dhe të vendit ku do të kryhen veprimet. Në të njëjtin vendim ose në një tjetër të mëvonshëm, mund të caktohet një specialist

për kryerjen e veprimeve të caktuara.

2. Organi procedues merr masa të përshtatshme për kryerjen e veprimeve, duke urdhëruar edhe fotografimet dhe filmimet, si dhe për të mos rrezikuar sigurinë e personave dhe atë publike.

SEKSIONI VI EKSPERTIMI

Neni 178

Objekti i ekspertimit

1. Ekspertimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore.

2. Nuk lejohen ekspertimet për të përcaktuar profesionizmin në veprën penale, prirjet kriminale, karakterin dhe personalitetin e të pandehurit dhe në përgjithësi cilësitë psikike që nuk varen nga shkaqet patologjike.

Neni 179

Caktimi i ekspertit

*(Shtuar fjalë në pikat 1 dhe 4 me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002;
ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

1. Caktimi i ekspertit bëhet duke e zgjedhur atë ndërmjet personave që janë regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në degën përkatëse. Kur ekspertimi shpallet i pavlefshëm ose duhet të bëhet ekspertim i ri, organi procedues merr masa, kur është e mundur, që detyra e re t'i besohet një eksperti tjetër.

2. Vendimi i organit procedues për caktimin e ekspertit i njoftohet të pandehurit ose mbrojtësit të tij, duke i bërë të ditur se ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e ekspertit, të propozojë ekspertë të tjerë, të marrë pjesë vetë në ekspertim, kur është e mundur, dhe të parashtrijë pyetje për ekspertin.

3. Kur kërkimet dhe vlerësimet paraqiten shumë komplekse ose kërkojnë njohuri të ndryshme në disa degë, organi procedues i ngarkon kryerjen e ekspertimit disa ekspertëve. Në raste të veçanta, kur ekspertimi nuk mund të kryhet nga lista e ekspertëve të regjistruar pranë gjykatës, organi procedues, pasi merr paraprakisht mendimin e palëve, cakton ekspertë të tjerë, vendas ose të huaj, jashtë kësaj liste.

4. Eksperti është i detyruar të kryejë detyrën e tij, me përjashtim të rasteve kur ekziston një nga shkaqet që e përjashtojnë atë nga qenia ekspert ose kur pretendon se nuk është kompetent ose nuk ka mundësi të kryejë ekspertimin dhe kërkesa e tij pranohet nga organi procedues.

Neni 180

Papajtueshmëria me detyrën e ekspertit

1. Nuk mund të kryejë detyrën e ekspertit:

a) i mituri, ai që ka ndalim ligjor ose i është hequr zotësia juridike për të vepruar ose vuan nga një sëmundje mendore;

b) ai që është pezulluar, qoftë edhe përkohësisht, nga detyrat publike ose nga ushtrimi i një profesioni;

c) ai, ndaj të cilit janë marrë masa sigurimi personal;

ç) ai që nuk mund të pyetet dëshmitar apo të merret përkthyes ose që ka të drejtë të mos bëjë dëshmi ose përkthim.

Neni 181

Përjashtimi i ekspertit

1. Palët mund të kërkojnë përjashtimin e ekspertit në rastet e parashikuara nga ky Kod për përjashtimin e gjyqtarit.

2. Kur ekziston një shkak përjashtimi, eksperti është i detyruar ta deklarojë.

3. Deklarimi i shkakut të përjashtimit nga vetë eksperti ose kërkimi i përjashtimit nga palët mund të paraqiten derisa të mos jetë bërë caktimi i detyrës dhe, kur shkaqet kanë lindur aty për aty ose

janë njohur më pas, para se eksperti të ketë dhënë mendimin e tij.

4. Mbi deklarinimin e ekspertit për përjashtim ose të kërkesës për përjashtimin e tij vendos, me urdhër, organi procedues që ka caktuar ekspertimin.

Neni 182

Disponimet e organit procedues

1. Organi procedues disponon ekspertimin me vendim të motivuar, i cili përmban caktimin e ekspertit, paraqitjen e përmbledhur të çështjes, tregimin e ditës, të orës dhe të vendit të caktuar për paraqitjen e ekspertit.

2. Organi procedues urdhëron thirrjen e ekspertit dhe merr masat e nevojshme për paraqitjen e personave që i nënshtrohen ekspertimit.

Neni 183

Caktimi i detyrës

1. Organi procedues, pasi sigurohet për identitetin e ekspertit, e pyet nëse ka shkaqe përjashtimi nga detyra e ekspertit, e paralajmëron për detyrimet e përgjegjësitë e parashikuara nga ligji penal, i formulon kërkesat e ekspertimit dhe e fton të bëjë këtë deklaratë: “I vetëdijshëm për përgjegjësinë morale dhe juridike për detyrën që marr përsipër, do ta kryej atë me ndershmëri e drejtësi dhe do të ruaj sekretin për të gjitha veprimet që lidhen me ekspertimin”.

2. Shpërblimi i ekspertit caktohet me urdhër të organit që ka disponuar për ekspertimin.

Neni 184

Veprimet e ekspertit

(Shtuar pika 4 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

1. Për t’iu përgjigjur kërkesave të ekspertimit, eksperti mund të autorizohet nga organi procedues që të shohë aktet, dokumentet dhe gjithçka që përfshihet në fashikullin e prokurorit ose të gjykatës.

2. Eksperti mund të autorizohet të marrë pjesë edhe në pyetjen e palëve dhe marrjen e provave.

3. Kur eksperti kërkon të dhëna nga i pandehuri, viktimi ose nga persona të tjerë, këto të dhëna përdoren vetëm për qëllimet e ekspertimit.

4. Kur për nevojat e ekspertimit është i domosdoshëm shkatërrimi ose ndryshimi i thelbit të sendit, kur është e mundur, ekspertët detyrohen të ruajnë atë pjesë të tij, si dhe të dokumentojnë pjesën e përdorur për ekspertim, duke vënë në dijeni organin procedues dhe palët.

Neni 185

Akti i ekspertimit

1. Mendimi i ekspertit jepet me shkrim.

2. Kur ekspertët e caktuar janë më shumë se një dhe kanë mendime të ndryshme, secili parashtron me akt të veçantë mendimin e tij.

3. Kur faktet janë komplekse dhe eksperti nuk mund të japë përgjigje menjëherë, organi procedues i jep atij një afat jo më të gjatë se gjashtëdhjetë ditë. Kur ka nevojë për verifikime veçanërisht komplekse ky afat mund të zgjatet edhe më shumë se një herë për periudha jo më të gjata se tridhjetë ditë, por pa kaluar afatin maksimal prej gjashtë muajsh.

Neni 186

Zëvendësimi i ekspertit

1. Eksperti mund të zëvendësohet kur nuk jep mendimin e vet në afatin e caktuar ose kur kërkesa e zgjatjes nuk është pranuar ose kur neglizhon në kryerjen e detyrës.

2. Vendimi i organit procedues për zëvendësimin jepet pasi dëgjohet eksperti. Eksperti i zëvendësuar mund të dënohet me gjobë deri dhjetë mijë lekë.

3. Eksperti zëvendësohet edhe kur pranohet kërkesa për përjashtimin e tij.

4. Eksperti i zëvendësuar detyrohet të dorëzojë në organin procedues dokumentacionin dhe rezultatet e veprimeve të kryera.

SEKSIONI VII PROVAT MATERIALE

Neni 187

Kuptimi i provës materiale

(Ndryshuar me ligjin nr. 9085, datë 19.6.2003)

1. Prova materiale janë sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmë apo që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër, që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal, si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes.

Neni 188

Marrja e provave materiale

1. Provat materiale përshkruhen hollësisht në procesverbal, kur ka mundësi fotografohen ose filmohen dhe me urdhër të organit procedues i bashkohen fashikullit gjyqësor.

Neni 189

Ruajtja e provave materiale

1. Provat materiale, që për shkak të natyrës së tyre mund të prishen, në qoftë se nuk mund t'u kthehen personave që u përkasin, u dorëzohen për t'i përdorur enteve të caktuara, të cilët detyrohen t'i kthejnë të njëjto ose të japin vlerën e tyre.

Neni 190

Disponimi për provat materiale

1. Në vendimin përfundimtar ose në atë të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori caktonë se çfarë duhet bërë me provat materiale duke urdhëruar:

a) sendet që kanë shërbyer ose ishin caktuar si mjet për kryerjen e veprës penale dhe sendet që përbëjnë përfitimin e nxjerrë nga ajo ose shpërblimin e dhënë a të premtuar për kryerjen e saj, merren dhe i kalojnë shtetit, përveç rastit kur këto sende janë të personave që nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale;

b) sendet, mbajtja ose qarkullimi i të cilave është i ndaluar, u dorëzohen enteve përkatëse ose zhduken;

c) sendet që nuk kanë asnjë vlerë zhduken;

ç) sendet e tjera u kthehen personave që u takojnë dhe, kur ka konflikt për pronësinë e tyre, ruhen gjersa ai të zgjidhet nga gjykata.

2. Provat materiale mund t'u kthehen personave që u përkasin edhe para mbarimit të procedimit, kur nuk dëmtohet zgjidhja e çështjes.

SEKSIONI VIII DOKUMENTET

Neni 191

Marrja e dokumenteve

1. Lejohet marrja e dokumenteve që përfaqësojnë fakte, persona ose sende nëpërmjet fotografimit, filmimit, fonografimit ose çdo mjeti tjetër.

2. Kur origjinali i një dokumenti është prishur, ka humbur ose është zhdukur, mund të merret kopja.

3. Dokumentet që përbëjnë provë materiale duhet të merren cilidoqoftë personi që i ka krijuar ose që i mban.

Neni 191/a

Detyrimi për paraqitjen e të dhënave kompjuterike

(Shtuar me ligjin nr.10 054, datë 29.12.2008)

1. Gjykata, në rastin e procedimeve për vepra penale në fushën e teknologjisë së informacionit, me kërkesë të prokurorit ose të viktimës akuzuese, urdhëron mbajtësin ose kontrolluesin të dorëzojnë të dhënat kompjuterike të memorizuara në një sistem kompjuterik apo në një mjet tjetër memorizimi.

2. Gjykata, në këto procedime, urdhëron edhe dhënësin e shërbimit për dorëzimin e çdo informacioni për abonentët e pajtuar, për shërbimet e ofruara nga dhënësi.

3. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se nga vonesa mund t'u vijë një dëm i rëndë hetimeve, prokurori vendos, me akt të motivuar, detyrimin për paraqitjen e të dhënave kompjuterike, të përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni dhe njofton menjëherë gjykatën. Gjykata vlerëson vendimin e prokurorit brenda 48 orëve nga njoftimi.

Neni 192

Dokumentet mbi personalitetin

1. Lejohet marrja e vërtetimeve për gjendjen gjyqësore dhe e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për të gjykuar mbi personalitetin e të pandehurit dhe të viktimës, kur fakti për të cilin procedohet duhet të vlerësohet në lidhje me sjelljen ose cilësitë morale të tyre.

2. Këto dokumente mund të merren edhe për vlerësimin e besueshmërisë së një dëshmitari.

Neni 193

Marrja e procesverbaleve të procedimeve të tjera

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Lejohet marrja e procesverbaleve të marrjes së provës të procedimeve të tjera penale që kanë të bëjnë me sigurimin e provës ose me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

2. Lejohet marrja e procesverbalit të provës në një gjykim civil të përfunduar me vendim të formës së prerë.

3. Në rastet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2, procesverbalet e deklarimeve mund të përdoren kundër të pandehurit vetëm nëse mbrojtësi i tij ka qenë i pranishëm në marrjen e tyre.

4. Lejohet marrja e akteve të veprimeve që nuk mund të përsëriten, përfshirë edhe deklaratimet e të pandehurit, kur provohet pamundësia objektive e marrjes, e pa parashikueshme në kohën e kryerjes së veprimit.

5. Përveç rasteve të parashikuara në paragrafët e mësipërm, procesverbalet e provës mund të përdoren në shqyrtimin gjyqësor vetëm kur i pandehuri jep pëlqimin. Në rast të kundërt, ato mund të përdoren për bërjen e kundërshtimeve të parashikuara nga nenet 362 dhe 365 të këtij Kodi.

6. Palët kanë të drejtë të kërkojnë pyetjen e personave, deklaratimet e të cilëve janë marrë sipas parashikimeve të këtij neni.

7. Vendimet e formës së prerë mund të merren për qëllime të provës lidhur me ekzistencën e faktit, duke u vlerësuar në unitet me provat e tjera.

Neni 194

Dokumentet anonime

1. Dokumentet që përbëjnë njoftime anonime nuk mund të merren dhe as të përdoren, përveçse kur përbëjnë provë materiale ose janë bërë nga i pandehuri.

Neni 195

Dokumentet false

1. Gjykata, kur çmon se një dokument i marrë është fals, pas përfundimit të procedimit njofton prokurorin duke i dërguar edhe dokumentin.

Neni 196

Përkthimi i dokumenteve

1. Kur është marrë një dokument i shkruar në gjuhë të huaj, organi procedues urdhëron përkthimin e tij.

2. Organi procedues urdhëron, kur është e nevojshme, transkriptimin e shiritit magnetofonik.

Neni 197

Lëshimi i kopjeve

1. Kur urdhëron marrjen e një dokumenti organi procedues, me kërkesën e të interesuarit, mund të autorizojë sekretarinë të lëshojë kopje të vërtetuar të dokumentit.

KREU III

MJETET E KËRKIMIT TË PROVËS

SEKSIONI I

KËQYRJET

Neni 198

Rastet dhe format e këqyrjes

1. Këqyrja e personave, e vendeve dhe e sendeve vendoset nga organi procedues kur është e nevojshme të zbulohen gjurmët dhe pasojat e tjera materiale të veprës penale.

2. Kur vepra penale nuk ka lënë gjurmë ose pasoja materiale ose kur këto janë zhdukur, kanë humbur, janë ndryshuar a lëvizur, organi procedues përshkruan gjendjen dhe, kur është e mundur, verifikon se si ka qenë ajo para ndryshimeve, si dhe merr masa që të saktësojë mënyrën, kohën dhe shkaqet e ndryshimeve që mund të kenë ndodhur.

3. Organi procedues mund të urdhërojë fotografime, filmime dhe çdo veprim tjetër teknik.

Neni 199

Këqyrja e personave

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Këqyrja bëhet në vende të përshtatshme duke respektuar, me sa është e mundur, dinjitetin dhe integritetin personal të atij që këqyret.

2. Para se të bëhet këqyrja, personit që do të këqyret i bëhet e njohur e drejta për të kërkuar praninë e një të besuari, me kusht që ky të mund të gjendet menjëherë dhe të jetë i përshtatshëm.

3. Këqyrja mund të bëhet edhe me anën e një mjeku me pëlqimin e personit. Në këtë rast organi procedues mund të mos marrë pjesë në veprimin e këqyrjes. Nëse pëlqimi nuk jepet ose personi është i mitur, këqyrja bëhet duke ndjekur procedurën e parashikuar në nenin 201/ a të këtij Kodi.

Neni 200

Këqyrja e kufomës

1. Këqyrja e kufomës bëhet nga organi procedues në prani të mjekut ligjor.

2. Për të bërë këqyrjen e kufomës, gjyqtari ose prokurori mund të urdhërojnë zhvarrimin, duke njoftuar një pjesëtar të familjes së të vdekurit për të marrë pjesë, me përjashtim të rasteve kur kjo pjesëmarrje mund të dëmtojë qëllimin e këqyrjes.

Neni 201

Këqyrja e vendeve dhe e sendeve

(Shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Të pandehurit kur është i pranishëm dhe atij që ka në dispozicion vendin ku do të bëhet këqyrja ose sendin që do të këqyret u dorëzohet në fillim kopja e vendimit për kryerjen e këqyrjes.

2. Në këqyrjen e vendeve, organi procedues mund të urdhërojë, për arsye të motivuara, që të pranishmit të mos largohen para se të ketë përfunduar këqyrja dhe t'i kthejë forcërisht ata që largohen.

Neni 201/a

Marrja me detyrim e kampionëve biologjikë ose kryerja e procedurave mjekësore të detyruara

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Marrja me detyrim e kampionëve biologjikë nga i pandehuri ose persona të tjerë, apo kryerja e një procedure mjekësore të detyruar behet vetëm në përputhje me parashikimet e këtij neni.

2. Prokurori, pasi merr pëlqimin e të pandehurit ose personave të tjerë, mund të kërkojë marrjen e kampionëve biologjikë, me qëllim përcaktimin e profilit të AND-së. I njëjti parashikim zbatohet edhe për kryerjen e procedurës mjekësore.

3. Pëlqimi i personit jepet me shkrim. Personi, të cilit i merret kampioni ose i cili do i nënshtrohet procedurës mjekësore, nënshkruan përpara prokurorit një deklaratë, nëpërmjet së cilës jep pëlqimin dhe konfirmon se është njoftuar në lidhje me arsyen e marrjes së kampionëve biologjikë ose kryerjes së procedurës mjekësore.

4. Për personin e mitur pëlqimin e jep prindi ose kujdestari ligjor.

5. Mbi bazën e kërkesës së prokurorit, gjykata mund të vendosë që marrja e kampionëve biologjikë ose procedura mjekësore të kryhet pa pëlqimin e personit, kur është e nevojshme dhe duke kufizuar lirinë e tij, nëse nuk dëmtohet shëndeti i tij dhe nëse është e domosdoshme për të provuar faktet në procedim. Nuk mund të kryhen procedura mjekësore që vënë në rrezik jetën e personit, integritetin fizik ose shëndetin e tij, që mund të dëmtojnë fëmijën e palindur ose që sipas protokolleve mjekësore, mund të shkaktojnë vuajtje të pa përligjura.

6. Vendimi i gjykatës mbi marrjen e kampionit biologjik ose procedurën mjekësore duhet të përmbajë:

a) të dhënat personale të personit që i nënshtrohet marrjes së kampionit biologjik ose procedurës mjekësore ose informacionin e nevojshëm për identifikim;

b) veprën penale për të cilën ka nisur procedimi dhe një përshkrim të përmbledhur të fakteve përkatëse;

c) një përshkrim të detajuar të llojit të kampionit biologjik që do të merret ose të procedurës mjekësore që do të kryhet, si edhe arsytet përse prova nuk mund të merret në mënyrë tjetër;

ç) të drejtën e personit që i nënshtrohet marrjes së kampionit biologjik ose procedurës tjetër mjekësore të ndihmohet nga një mbrojtës ose një person i besuar;

d) vendin, datën, kohën dhe mënyrën e saktë të marrjes së kampionit biologjik ose kryerjes së procedurës tjetër mjekësore;

dh) njoftimin që personi që i nënshtrohet marrjes së kampionit biologjik ose procedurës tjetër mjekësore është i detyruar të paraqitet dhe paralajmërimin për shoqërim të detyrueshëm nëse nuk paraqitet pa shkaqe të ligjshme;

e) nëse i pandehuri ose personi ka dhënë pëlqimin për marrjen e kampionit biologjik ose procedurës mjekësore, prokurori e bashkëngjit pëlqimin me shkrim në dosje.

7. Të paktën tre ditë përpara marrjes së kampionit biologjik ose kryerjes së procedurës mjekësore, vendimi i parashikuar në paragrafin 5, të këtij neni, i njoftohet personit përkatës.

8. Kur personi që i nënshtrohet marrjes së kampionit biologjik ose procedurës mjekësore është i pandehuri ose viktimë, vendimi i njoftohet të pandehurit, avokatit mbrojtës dhe viktimës. Në rast se personi nuk është i pandehuri apo viktimë, vendimi i njoftohet personit, të pandehurit, viktimës dhe avokatit të tij. Në rastin e të miturit, vendimi u njoftohet prindërve ose kujdestarit të tij ligjor.

9. Në rast se personi që i nënshtrohet procedurave të mësipërme nuk paraqitet në vendin e caktuar pa arsye të ligjshme, prokurori menjëherë mund t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë shoqërimin e tij të detyrueshëm dhe të vendosë marrjen e kampionit ose kryerjen e procedurës mjekësore. Policia gjyqësore ekzekuton urdhrin e gjykatës.

10. Në raste të ngutshme, kur ka arsye për të besuar se vonesa mund të shkaktojë humbjen ose dëmtimin e vërtetësisë së provës, vendimi merret nga prokurori, i cili mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm të personit.

11. Brenda 48 orëve nga kryerja e veprimit, prokurori i kërkon gjykatës vleftësimin e urdhrave të nxjerrë sipas paragrafit 9 të këtij neni. Gjykata vleftëson veprimet e prokurorit brenda 48 orëve, duke njoftuar prokurorin dhe mbrojtësin.

12. Kur kampioni biologjik ose procedura mjekësore merret ose kryhet tek i dyshuari ose i pandehuri, prania e mbrojtësit është e detyrueshme.

13. Në rast të marrjes së kampionit biologjik ose kryerjes së procedurës mjekësore mbi të miturin, prania e prindit, kujdestarit ligjor ose e një personi të besuar prej tij është e detyrueshme.

14. Rezultatet e analizave të kampionëve biologjikë ose procedurës mjekësore të marrë në shkelje të parashikimeve të këtij neni janë të papërdorshme.

Neni 201/b

Asgjësimi i kampionëve biologjikë

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kampionët biologjikë ruhen për aq kohë sa i shërbejnë qëllimeve të procedimit. Asgjësimi i tyre bëhet në përputhje me rregullat e këtij Kodi.

2. Në rastet kur i pandehuri deklarohet i pafajshëm me vendim të formës së prerë, gjykata urdhëron asgjësimin e kampionëve biologjikë të marra prej tij.

3. Brenda 60 ditëve nga vendimi i pafajësisë, prokurori, viktima ose përfaqësuesi ligjor i viktimës mund t'i kërkojë gjykatës që të urdhërojë ruajtjen e kampionëve biologjikë të marra nga persona të tjerë, të ndryshëm nga i pandehuri, nëse kampionët duhet të përdoren në një procedim penal tjetër. Në të kundërt gjykata urdhëron asgjësimin.

4. Kur i pandehuri deklarohet fajtor, kampionët biologjikë të marra prej tij ruhen për 20 vjet nga dita që vendimi merr formë të prerë.

5. Gjykata mund të urdhërojë ruajtjen e kampionëve deri në 40 vjet kur i pandehuri është deklaruar fajtor për një vepër për të cilën në Kodin Penal parashikohet një dënim me burgim jo më pak se 10 vjet në maksimum.

6. Profilët e ADN-së të kampionëve që janë marrë në vendin e ngjarjes dhe që nuk i atribuohen një personi të caktuar mbahen deri në plotësimin e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale.

7. Në rast se marrja e kampionëve kryhet në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi, organi procedues urdhëron shkatërrimin e tyre.

8. Mënyra e ruajtjes së kampionëve, procedura dhe organi kompetent për asgjësimin e tyre, parashikohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

SEKSIONI II KONTROLLET

Neni 202

Kushtet për kryerjen e kontrolleve

*(Ndryshuar referenca në pikën 3 me ligjin nr. 35/2017,
datë 30.3.2017)*

1. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se dikush fsheh në personin e tij prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale gjykata merr vendim për kontrollin personal. Kur këto sende ndodhen në një vend të caktuar, vendoset kontrolli i vendit ose banesës.

2. Gjykata që ka nxjerrë vendimin mund të veprojë vetë ose të urdhërojë që veprimi të kryhet nga oficerët e policisë gjyqësore, të caktuar në vendimin e kontrollit.

3. Në rast flagrance ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur, që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontroll, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 298.

Neni 202/a

Vendimi për lejimin e kontrollit

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Vendimi për lejimin e kontrollit duhet të tregojë llojin e kontrollit, personin që kontrollohet dhe gjenealitetet e tij, vendin apo banesën objekt kontrolli, provat materiale apo sendet që kërkohen, arsyet që lejojnë kontrollin, si edhe autoritetin që do të kryejë atë.

2. Kur ka arsye të bazuara se të dhënat, informacionet, programet informatike ose gjurmë të tyre, gjenden në një sistem informatik ose telematik, edhe kur ky është i mbrojtur me masa sigurie, gjykata merr vendim për kontrollin, duke urdhëruar masa teknike të përshtatshme, të cilat sigurojnë ruajtjen e të dhënave origjinale dhe nuk lejojnë ndryshimin e tyre. Vendimi i kontrollit duhet të përcaktojë llojin e informacionit që kërkohet dhe mënyrën e marrjes së tij.

3. Gjykata merr vendim të arsyetuar në dhomë këshillimi, brenda 24 orëve nga kërkesa e prokurorit. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për kontroll mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit brenda 24 orëve. Gjykata e apelit shqyrton ankimin brenda 48 orëve nga marrja e akteve.

4. Kontrolli duhet të përfundojë brenda 72 orëve nga momenti i marrjes së vendimit për kryerjen e tij.

Neni 203

Kërkesa e dorëzimit

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur kërkohet një send i caktuar, organi procedues mund të kërkojë dorëzimin e tij. Në qoftë se sendi dorëzohet, kontrolli nuk

bëhet, me përjashtim të rasteve kur pas dorëzimit të sendit ka arsye të bazuara për të besuar se nga kontrolli mund të zbulohen gjurmë apo sende të tjera që lidhen me veprën penale.

2. Për të përcaktuar sendet që mund të sekuestrohen ose për të verifikuar rrethana të caktuara të nevojshme për hetimin, organi procedues ose oficerët e policisë gjyqësore të autorizuar prej tij, mund të kontrollojnë veprimet, dokumentet dhe korrespondencën pranë bankave.

Neni 204

Kontrolli i personit

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Para se të bëhet kontrolli i personit, atij që do të kontrollohet i dorëzohet një kopje e vendimit të kontrollit, duke i bërë të ditur të drejtën për të kërkuar praninë e një personi të besuar, me kusht që ai të gjendet shpejt dhe të jetë i përshtatshëm.

2. Kontrolli bëhet duke respektuar dinjitetin dhe integritetin personal të atij që kontrollohet. Kontrolli i personit bëhet nga një person i së njëjtës gjini, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është e mundur për shkak të rrethanave.

Neni 205

Kontrolli i vendeve

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Të pandehurit, kur është i pranishëm, dhe atij që ka në dispozicion vendin u dorëzohet kopja e vendimit të kontrollit, duke e njohur me të drejtën për të kërkuar praninë e një personi të besuar, i cili ndodhet aty dhe është i përshtatshëm, sipas nenit 108, të këtij Kodi, ose mbrojtësit të tij.

2. Kur i pandehuri kërkon praninë e mbrojtësit gjatë kryerjes së kontrollit, organi procedues shtyn kryerjen e kontrollit deri në mbërritjen e mbrojtësit, por jo më shumë se 2 orë nga momenti që

mbrojtësi ka marrë dëjoni për kontrollin. Gjatë kësaj kohe, organi procedues mund të kufizojë lëvizjen e personit të interesuar dhe personave të tjerë që ndodhen në vendin që do të kontrollohet.

3. Shtyrja e kontrollit, sipas paragrafit 2, të këtij neni, zgjat afatin përkatës të parashikuar në paragrafin 4, të nenit 202/a, të këtij Kodi.

4. Organi procedues mund të kontrollojë personat e pranishëm, kur çmon se këta mund të fshehin provën materiale ose sendet që i përkasin veprës penale. Ai mund të urdhërojë që të pranishmit të mos largohen para se të mbarojë kontrolli dhe të kthehen forcërisht ata që largohen.

5. Kur nuk njihet ose nuk gjendet pronari ose poseduesi i sendit, organi procedues kryen kontrollin në praninë e detyrueshme të mbrojtësit të caktuar kryesisht.

Neni 206

Koha për kryerjen e kontrollit të banesës

1. Kontrolli në një banesë ose në një vend të mbyllur ngjitur me të nuk mund të fillojë para orës shtatë dhe pas orës njëzet. Në raste të ngutshme organi procedues mund të urdhërojë me shkrim që kontrolli të bëhet tej këtyre caqeve.

Neni 207

Sekuestrimi gjatë kontrollit

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Sendet e gjetura gjatë kontrollit sekuestrohen, me kusht që të jenë të përcaktuara në vendimin për lejimin e kontrollit.

2. Sendet e tjera të gjetura gjatë kontrollit, që nuk përfshihen në vendimin përkatës, por që lidhen me të njëjtën veprë penale, mund të sekuestrohen duke respektuar dispozitat për sekuestrimet.

3. Kur gjatë kontrollit zbulohen sende që nuk kanë lidhje me veprën penale për të cilat është dhënë vendimi i kontrollit, por që lidhen me një veprë tjetër penale që ndiqet kryesisht, sendet e zbuluara sekuestrohen.

4. Për sekuestrimet e kryera në kushtet e paragrafëve 2 dhe 3, të këtij neni, zbatohen kriteret e nenit 301 të këtij Kodi.

SEKSIONI III SEKUESTRIMET

Neni 208

Objekti i sekuestrimit

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve.
2. Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim.
3. Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit.

Neni 208/a

Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike

(Shtuar me ligjin nr.10 054, datë 29.12.2008; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Në rastin e procedimeve për krime që lidhen me teknologjinë e informacionit, gjykata, me kërkesën e prokurorit, urdhëron sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike. Në këtë vendim gjykata përcakton të drejtën për të hyrë, kërkuar dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme apo sigurimin e të dhënave ose të sistemit kompjuterik.
2. Kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të menduar se të dhënat e kërkua kompjuterike janë memorizuar në një sistem tjetër kompjuterik apo në një pjesë të tij dhe këto të dhëna janë në mënyrë të ligjshme të kapshme prej ose janë të disponueshme nga sistemi kompjuterik fillestar, që kontrollohet, gjykata, me kërkesë të

prokurorit, urdhëron menjëherë kërkimin ose hyrjen edhe në këtë sistem kompjuterik.

3. Në zbatim të vendimit të gjykatës, prokuroria ose oficeri i policisë gjyqësore, i deleguar nga prokurori, merr masa:

a) për të ndaluar kryerjen e veprimeve të mëtejshme ose për të siguruar sistemin kompjuterik, vetëm të një pjese të tij ose të një mjeti tjetër memorizimi të dhënash;

b) për të nxjerrë dhe marrë kopje të të dhënave kompjuterike;

c) për të penguar hyrjen në të dhënat kompjuterike, ose për t'i hequr këto të dhëna nga sistemet kompjuterike me të drejtë hyrjeje;

ç) për të siguruar paprekshmërinë e të dhënave përkatëse, të memorizuara.

4. Për zbatimin e këtyre veprimeve, prokurori mund të urdhërojë thirrjen e një eksperti, i cili ka njohuri rreth funksionimit të sistemeve kompjuterike apo të masave të zbatuara për mbrojtjen e të dhënave kompjuterike në të. Eksperti i thirrur nuk mund të refuzojë detyrën pa shkaqe të arsyeshme.

Neni 209

Sekuestrimi i korrespondencës

(Shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 9085, datë 19.6.2003)

1. Kur gjykata ka arsye të bazuara të mendojë se në zyrat postare ose telegrafike gjenden letra, letra me vlerë, zarfe, pako, telegrame dhe objekte të tjera të korrespondencës që janë dërguar nga i pandehuri ose që i drejtohen atij, qoftë edhe me emër tjetër ose nëpërmjet një personi tjetër, vendos sekuestrimin e tyre.

2. Kur sekuestrimin e kryen një oficer i policisë gjyqësore, ai duhet t'i dorëzojë organit gjyqësor objektet e sekuestruara të korrespondencës pa i hapur dhe pa u njohur me ndonjë mënyrë tjetër me përmbajtjen e tyre.

3. Objektet e sekuestruara që nuk hyjnë në korrespondencën e sekuestrueshme i kthehen atij që i takojnë dhe nuk mund të përdoren.

Neni 210

Sekuestrimi pranë bankave

(Shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr.9085, datë 19.6.2003)

1. Gjykata mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumenteve, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjëje tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur nuk i përkasin të pandehurit ose kur nuk janë në emër të tij. Në raste të ngutshme ky vendim mund të merret nga prokurori.

Neni 211

Detyrimi i dorëzimit dhe ruajtja e sekretit

(Shtuar fjalë në pikën 1 dhe 2 e ndryshuar në pikën 3, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Personat e detyruar për ruajtjen e sekretit profesional ose shtetëror detyrohen t'i dorëzojnë menjëherë organit procedues aktet dhe dokumentet, edhe në origjinal, dhe çdo gjë tjetër që ruhet pranë tyre për shkak të detyrës, shërbimit ose profesionit, përveç kur deklarojnë me shkrim se është sekret shtetëror ose sekret që lidhet me detyrën a profesionin e tyre. Në rastin e fundit bëhen verifikimet e nevojshme dhe kur del që deklarimi është i pabazuar, organi procedues urdhëron sekuestrimin.

2. Kur sekreti shtetëror konfirmohet nga organi kompetent, organi procedues informon autoritetin kompetent, duke kërkuar dhenien e konfirmimit dhe prova është thelbësore për zgjidhjen e çështjes, organi procedues vendos marrjen e provës.

3. Kur brenda tridhjetë ditëve nga kërkesa organi kompetent nuk jep konfirmimin e sekretit, organi procedues urdhëron sekuestrimin.

Neni 211/a

Sekuestrimi në zyrat e shërbimeve informative

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur lind nevoja e sekuestrimit të dokumenteve, akteve ose sendeve të tjera në zyrat e shërbimeve informative, veprimtaria e të cilave lidhet me sigurinë kombëtare, në arsyetimin e vendimit të sekuestrimit, gjykata tregon në mënyrë të detajuar dokumentet, aktet ose sendet objekt sekuestrimi.

2. Gjkata autorizon prokurorin për shqyrtimin e dokumenteve, akteve dhe sendeve që duhet të sekuestrohen, i cili merr vetëm ato që janë të domosdoshme për qëllimet e hetimit.

3. Kur ka arsye të bazuara për të besuar se dokumentet, aktet ose sendet nuk janë vënë në dispozicion ose janë të paplota, gjykata informon organin kompetent, i cili disponon dhënien e dokumenteve, akteve apo sendeve të tjera, ose konfirmon mungesën e tyre.

4. Kur lind nevoja të merret origjinali ose kopja e një dokumenti, akti ose sendi të krijuar nga një shërbim informativ i huaj, i dhënë me kushtin e mospërhapjes së tij, shqyrtimi dhe dorëzimi pezullohen. Në këtë rast, njoftohet menjëherë organi kompetent, me qëllim komunikimin me autoritetin e huaj për të vendosur lidhur me ruajtjen e mëtejshme të sekretit. Brenda 60 ditëve, organi kompetent autorizon dhënien e dokumentit, aktit ose sendit ose konfirmon nevojën e ruajtjes së sekretit shtetëror.

5. Kur organi kompetent nuk shprehet brenda afatit të parashikuar në paragrafin 4, të këtij neni, gjykata urdhëron marrjen e dokumentit, aktit ose sendit objekt i sekuestrimit.

Neni 212

Kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. I pandehuri, personi tek i cili janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë në kërkimit të tyre, mund të bëjë ankim në gjykatë, e cila merr vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve.

2. Kundër vendimit të gjykatës lejohet ankim brenda 5 ditëve. Gjykata e apelit jep vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve nga marrja e akteve.

3. Ankimi nuk e pezullon zbatimin e vendimit.

Neni 213

Kopjet e dokumenteve të sekuestruara

1. Organi procedues mund të urdhërojë nxjerrjen e kopjeve të akteve dhe të dokumenteve të sekuestruara, duke kthyer origjinalet dhe kur origjinalet duhet të mbahen urdhëron sekretarinë të lëshojë kopje të vërtetuar.

2. Në çdo rast personi ose zyra pranë të cilit është bërë sekuestrimi ka të drejtë të ketë një kopje të procesverbalit të sekuestrimit.

3. Kur dokumenti i sekuestruar bën pjesë në një vëllim ose në një regjistër, nga i cili nuk mund të ndahet dhe organit procedues i duhet origjinali, vëllimi ose regjistri qëndron në dispozicion të organit procedues. Sekretari i organit procedues u lëshon të interesuarve, kur ata i kërkojnë, kopje, ekstrakte ose vërtetime të pjesëve të vëllimit a të regjistrit që nuk i janë nënshtruar sekuestrimit.

Neni 214

Ruajtja e sendeve të sekuestruara

1. Sendet e sekuestruara ruhen në sekretari. Kur kjo nuk është e mundur ose e përshtatshme, organi procedues urdhëron që ato të ruhen në një vend tjetër, duke përcaktuar mënyrën e ruajtjes.

2. Gjatë veprimit të dorëzimit, ruajtësi paralajmërohet për detyrimin e ruajtjes dhe të paraqitjes së sendeve kur kërkohen nga organi procedues, si dhe për dënimin e parashikuar nga ligji penal për atë që shkel detyrimin e ruajtjes.

Vulosja e sendeve të sekuestruara

(Shtuar pika 4, 5 dhe 6 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Sendet e sekuestruara sigurohen me vulën e organit procedues ose, në varësi nga natyra e sendeve, me mjete të tjera të përshtatshme që tregojnë se ato ruhen për nevojat e drejtësisë.

2. Organi procedues nxjerr kopje të dokumenteve dhe fotografi ose riprodhime të tjera të sendeve të sekuestruara që mund të ndryshojnë ose që ruhen me vështirësi, të cilat i bashkon me aktet dhe urdhëron ruajtjen e tyre në sekretari.

3. Për sendet që mund të ndryshojnë, organi procedues urdhëron, sipas rastit, tjetërsimin ose asgjësimin e tyre.

4. Me kërkesë të organit procedues, gjykata mund të urdhërojë asgjësimin e sendeve të ndaluara për t'u prodhuar, zotëruar, mbajtur apo tregtuar, në rast se ruajtja e tyre është e vështirë, veçanërisht e kushtueshme ose përbën rrezik për sigurinë, shëndetin apo higjienën publike. Në këtë rast, gjykata urdhëron marrjen e kampionëve dhe ruajtjen e tyre për qëllime të procedimit.

5. Organi procedues informon mbrojtësin e zgjedhur ose të caktuar kryesisht mbi vendin dhe datën e marrjes së kampionëve, të paktën 24 orë përpara. Mosparaqitja e mbrojtësit në marrjen e kampionëve nuk e ndalon organin procedues për marrjen e tyre.

6. Procedura për asgjësimin e sendeve të sekuestruara, afati, si edhe organi kompetent përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Ministrit të Drejtësisë. Kur është e mundur, veprimet e kryera dokumentohen me mjete audiovizive dhe në çdo rast mbahet procesverbal, kopje e së cilit i dërgohet prokurorisë pranë gjykatës që ka vendosur asgjësimin.

Neni 216

Heqja dhe vënia e vulave

1. Organi procedues, kur do që të heqë vulat, verifikon nëse ato janë të cenuara ose jo dhe kur konstaton ndryshimin e tyre mban procesverbal. Pasi kryhet veprimi për të cilin është bërë e nevojshme heqja e vulave, sendet e sekuestruara vulosen përsëri, duke vënë pranë vulës datën e veprimit.

Neni 217

Kthimi i sendeve të sekuestruara

1. Kur nuk është e nevojshme mbajtja e sekuestros për qëllime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë edhe para se të merret vendimi përfundimtar. Kur është e nevojshme, organi procedues urdhëron të sillen sendet e kthyer.

2. Gjykata mund të disponojë që kthimi i sendeve të mos bëhet kur, me kërkesën e prokurorit ose të paditësit civil, duhet të mbahet sekuestrimi për të siguruar padinë civile.

3. Pasi vendimi merr formë të prerë, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë, përveç rasteve kur vendoset konfiskimi.

Neni 218

Rregullat për kthimin e sendeve të sekuestruara

1. Gjykata vendos kthimin e sendeve të sekuestruara kur nuk ka dyshim për përkatësinë e tyre.

2. Kur sendet janë sekuestruar pranë një të treti, kthimi nuk mund të urdhërohet në dobi të të tjerëve, pa u dëgjuar i treti nga gjykata.

3. Gjatë hetimeve paraprake, kthimi i sendeve të sekuestruara urdhërohet nga prokurori. Kundër këtij urdhri të interesuarit mund të bëjnë ankim në gjykatë.

Neni 219

Disponimet në rast moskthimi

1. Pas një viti nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë, në qoftë se kërkesa e kthimit nuk është paraqitur ose nuk është pranuar, gjykata që ka dhënë vendimin urdhëron që paratë dhe letrat me vlerë të depozitohen në bankë, në një llogari të veçantë. Për sendet urdhërohet shitja e tyre, por kur ato kanë interes shkencor ose vlera arti, u kalohen institucioneve përkatëse.

2. Shitja mund të urdhërohet edhe para afatit të treguar në paragrafin 1, kur sendet nuk mund të ruhen pa rrezik prishjeje ose pa shpenzime të mëdha.

3. Shuma e fituar nga shitja derdhet në bankë, në llogari të veçantë.

Neni 220

Shpenzimet për sendet e sekuestruara

1. Shpenzimet që nevojiten për ruajtjen e sendeve të sekuestruara përballohen nga shteti, i cili ka preferenca ndaj çdo kreditori tjetër për shumat e depozituara nga sendet dhe vlerat e pakthyera.

SEKSIONI IV

PËRGJIMET

(Ndryshuar titulli me ligjin nr. 9187, datë 12.2.2004)

Neni 221

Kufijtë e lejimit

(Ndryshuar me ligjin nr.9187, datë 12.2.2004; ndryshuar shkronja "b" e pikës 1 dhe pika 2 e shtuar shkronja "c" në pikën 1, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Përgjimi i komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni me telefon, faks, kompjuter ose me mjete të tjera të çdo lloji, përgjimi

i fshehtë me mjete teknike i bisedave në vende private, përgjimi me audio dhe video në vende private dhe regjistrimi i numrave të telefonit, hyrës dhe dalës, lejohen vetëm kur procedohet:

a) për krimet e kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet;

b) për çdo veprë penale me dashje kur kryhet me anën e mjeteve të telekomunikimit apo përdorimit të teknologjive informatike ose telematike.

c) për veprat penale të parashikuara nga shkronja “a”, paragrafi 1, i nenit 75/a, të këtij Kodi.

2. Regjistrimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike dhe përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes lejohen vetëm kur procedohet për vepra të kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se tre vjet.

3. Përgjimi mund të urdhërohet kundër:

a) të dyshuarit për kryerjen e një veprë penale;

b) personit që dyshohet se merr ose transmeton komunikime nga i dyshuari;

c) personit që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin;

ç) personit, vëzhgimi i të cilit mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose të identitetit të të dyshuarit.

4. Rezultati i përgjimit është i vlefshëm për të gjithë komunikuesit.

5. Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si provë.

Neni 222

Vendimi për lejimin e përgjimit

(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 nr.9187, datë 12.2.2004 dhe nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Me kërkesën e prokurorit, për rastet e lejuara në paragrafin 1, të nenit 221, gjykata autorizon përgjimin me vendim të arsytuar, kur

ai është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara dhe kur në ngarkim të personit ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova se ka kryer një vepër penale.

2. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se nga vonesa mund t'i vijë një dëm i rëndë hetimeve dhe plotësohen kushtet e paragrafit 1, të këtij neni, prokurori vendos përgjimin me akt të motivuar dhe njofton gjykatën menjëherë, por jo më vonë se njëzet e katër orë nga marrja e vendimit. Kur vleftësimi nuk bëhet në afatin e caktuar, përgjimi nuk mund të vazhdojë dhe rezultatet e tij nuk mund të përdoren.

3. Kur njëri nga dy personat që do të përgjohen është i gatshëm të kryejë dhe të regjistrojë veprimin përkatës, sipas marrëveshjes me oficerin e policisë gjyqësore, veprimi lejohet me autorizim të prokurorit.

4. Në rastet e parashikuara në paragrafët 1, 2 dhe 3, të këtij neni, gjykata merr vendim të arsyetuar në dhomë këshillimi, brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës së prokurorit. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për përgjim mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit brenda 24 orëve. Gjykata e apelit shqyrton ankimin brenda 48 orëve nga marrja e akteve. Paraqitja e kërkesës për vleftësimin e përgjimit nuk shkakton ndërprerjen e tij.

5. Vendimi për përgjimin tregon mënyrën e kryerjes dhe kohëzgjatjen e veprimeve, e cila nuk mund t'i kalojë pesëmbëdhjetë ditët. Ky afat, me kërkesë të arsyetuar të prokurorit, mund të zgjatet nga gjykata sa herë është e nevojshme, për një periudhë prej 15 ditësh, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në paragrafin 1, të këtij neni, dhe rezultatet e përgjimit diktojnë nevojën e zgjatjes së afatit.

6. Në vendimin e gjykatës për përgjimin e fshehtë, fotografik ose me video, ose për përgjimin e bisedave në vende private mund të autorizohet oficeri i policisë gjyqësore ose specialisti i kualifikuar për të hyrë në këto vende, në mënyrë të fshehtë, duke vepruar në përputhje me vendimin. Ky autorizim duhet të zbatohet brenda 15 ditëve.

7. Në regjistrin që mbahet në prokurori shënohen aktet që urdhërojnë, autorizojnë, vleftësojnë ose zgjasin përgjimet, si dhe fillimin e mbarimin e veprimeve të çdo përgjimi.

8. Në rastet e parashikuara nga neni 221, paragrafi 2, veprimi autorizohet nga prokurori.

Neni 222/a

Ankimi kundër vendimit që pranon përgjimin

(Shtuar me ligjin nr.9187, datë 12.2.2004; ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kundër vendimit që pranon përgjimin mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga i interesuari që ka ardhur në dijeni të përgjimit, për shkelje të kriterëve të parashikuara në nenin 221.

2. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi nga gjykata e apelit. Kur ankimi gjendet i bazuar, gjykata e apelit prish vendimin që lejon përgjimin dhe urdhëron fshirjen e çdo materiali të marrë nga përgjimi.

Neni 223

Veprimet e përgjimit

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; shtuar paragrafi 1/1 me ligjin nr.9187, datë 12.2.2004; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Veprimet e përgjimit mund të kryhen vetëm me anën e pajisjeve të instaluar në vende të caktuara, të autorizuar dhe të kontrolluara nga prokurori. Kryerja e përgjimit dhe procesverbalet e transkriptimit bëhen nga oficerë të policisë gjyqësore, nën drejtimin dhe kontrollin e prokurorit të çështjes.

1/1. Kur njëri nga kushtet e përgjimit nuk ekziston më, oficeri i policisë gjyqësore njofton menjëherë prokurorin, i cili urdhëron ndalimin e përgjimit dhe vë në dijeni gjykatën, kur urdhri është dhënë nga gjykata.

2. Komunikimet e përgjuara regjistrohen dhe për veprimet e kryera mbahet procesverbal. Në procesverbal transkriptohet përmbajtja e komunikimeve të përgjuara.

3. Procesverbalet dhe regjistrimet i dorëzohen menjëherë prokurorit dhe brenda pesë ditëve nga mbarimi i veprimeve ato depozitohen në sekretari bashkë me aktet që kanë urdhëruar, autorizuar, vleftësuar dhe zgjatur përgjimin. Kur nga depozitimi mund të dëmtohen hetimet, gjykata autorizon prokurorin që ta shtyjë depozitimin deri në përfundimin e hetimeve paraprake.

4. Mbrojtësit dhe përfaqësuesit e palëve lajmërohen menjëherë për depozitimin në sekretari dhe për të drejtën që kanë për të shqyrtuar aktet e për të dëgjuar regjistrimet. Gjykata, pasi dëgjon prokurorin dhe mbrojtësit, vendos për heqjen e regjistrimeve dhe të procesverbaleve, përdorimi i të cilave ndalohet.

5. Gjykata urdhëron transkriptimin e plotë të regjistrimeve që duhen marrë. Transkriptimet futen në fashikullin e gjykimit. Mbrojtësit mund të nxjerrin kopje të transkriptimeve.

Neni 224

Ruajtja e dokumentacionit

(Shtuar pika 2 me ligjin nr.9187, datë 12.2.2004)

1. Procesverbalet dhe regjistrimet ruhen pranë prokurorisë që ka urdhëruar përgjimin derisa vendimi të marrë formë të prerë, me përjashtim të atyre që ndalohet përdorimi. Por, kur ky dokumentacion nuk është i nevojshëm, të interesuarit mund të kërkojnë asgjësimin e tij. Mbi këtë kërkesë vendos gjykata që ka bërë vleftësimin e përgjimit. Asgjësimi bëhet nën kontrollin e gjyqtarit dhe për veprimin mbahet procesverbal.

2. Kur prokurori vendos pushimin e çështjes, duhet të njoftojë për këtë vendim, me shkrim, gjykatën. Gjykata vendos për asgjësimin e procesverbaleve dhe regjistrimeve në afatin e caktuar prej saj dhe vë në dijeni personin e përgjuar. Me kërkesë të prokurorit, ky njoftim mund të mos bëhet në rastet kur ka rrezik për jetën ose shëndetin e të tjerëve, ose kur vihet në rrezik një hetim i nisur.

Neni 225

Përdorimi i rezultateve të përgjimit në procedimet e tjera

(Ndryshuar me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002)

1. Rezultatet e përgjimit mund të përdoren në procedime të tjera vetëm kur janë të domosdoshme për hetimin e krimeve. Në këto raste, procesverbalet dhe regjistrimet e përgjimeve depozitohen pranë organit tjetër që procedon.

Neni 226

Ndalimi i përdorimit

1. Rezultatet e përgjimit nuk mund të përdoren kur janë bërë jashtë rasteve të lejuara nga ligji ose kur nuk janë respektuar dispozitat e këtij seksioni.

2. Nuk mund të përdoren përgjimet e bisedave ose të komunikimeve të atyre që janë të detyruar të ruajnë sekretin për shkak të profesionit apo detyrës, me përjashtim të rasteve kur këta persona kanë deponuar mbi të njëjtat fakte ose i kanë përhapur në ndonjë mënyrë tjetër.

3. Gjykata urdhëron asgjësimin e dokumentacionit të përgjimeve që ndalohet të përdoren, me përjashtim të rasteve kur përbëjnë provë materiale.

TITULLI V
MASAT E SIGURIMIT

KREU I
MASAT E SIGURIMIT PERSONAL

SEKSIONI I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 227

Ndarja e masave të sigurimit personal

1. Masat e sigurimit personal ndahen në masa shtrënguese dhe masa ndaluese.

Neni 228

Kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal

(Hequr lidhëzat e shtuar fjalë në pikën 2 dhe shtuar fjalë dhe shenja e pikësimit në shkronjën "a" në pikën 3, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova.

2. Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie të shuarjes së veprës penale, ose dënimit.

3. Masat e sigurimit personal vendosen:

a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;

b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;

c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Neni 229

Kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal

(Shtuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysht përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret.

2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysht edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal.

3. Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysht interesin e tij më të lartë dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.

Neni 230

Kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg

(Ndryshuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit.

2. Nuk mund të vendoset arresti në burg ndaj një gruaje që është shtatzënë ose me fëmijë nën moshën 3 vjeç dhe që jeton me të, ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë ose që ka kaluar moshën shtatëdhjetë vjeç ose një personi toksikoman apo të alkoolizuar, për të cilin zbatohet një program terapeutik në një institucion të posaçëm.

3. Në rastet e parashikuara në pikën 2 arresti në burg mund të vendoset vetëm kur ka shkaqe të një rëndësie të veçantë për krimet që dënohen jo më pak në maksimum se dhjetë vjet burgim.

4. Të miturit nuk mund të arrestohen kur akuzohen për kundërvajtje penale.

Neni 231

Zëvendësimi ose bashkimi i masave të sigurimit personal

1. Në rast shkelje të detyrimeve që lidhen me një masë sigurimi, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë tjetër më të rëndë, duke mbajtur parasysh rëndësinë, motivet dhe rrethanat e shkeljes. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë shtrënguese.

SEKSIONI II MASAT SHTRËNGUESE

Neni 232

Llojet e masave shtrënguese

1. Masat shtrënguese janë:
 - a) ndalimi i daljes jashtë shtetit;
 - b) detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore;
 - c) ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar;
 - ç) garancia pasurore;
 - d) arresti në shtëpi;
 - dh) arresti në burg;
 - e) shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik.

Neni 233

Ndalimi i daljes jashtë shtetit

1. Me vendimin që urdhëron ndalimin e daljes jashtë shtetit gjyqtari urdhëron të pandehurin të mos largohet nga territori shtetëror shqiptar pa autorizimin e tij.

2. Gjkata cakton detyrat e nevojshme për të siguruar zbatimin e vendimit dhe për të ndaluar përdorimin e pasaportës e të dokumenteve të tjera identifikuese të vlefshme për daljen jashtë shtetit.

Neni 234

Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore

1. Me vendimin për paraqitjen në policinë gjyqësore, gjykata urdhëron të pandehurin të paraqitet në një zyrë të caktuar të policisë gjyqësore.

2. Gjkata cakton ditët dhe orët e paraqitjes, duke mbajtur parasysh punën dhe vendbanimin e të pandehurit.

Neni 235

Ndalimi dhe detyrimi i qëndrimit në një vend të caktuar

(Hequr fjalë me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Me vendimin që disponon ndalimin e qëndrimit, gjykata urdhëron të pandehurin të mos qëndrojë në një vend të caktuar dhe të mos shkojë atje pa autorizimin e tij.

2. Me vendimin që disponon detyrimin e qëndrimit, gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet pa autorizimin e saj nga territori i bashkisë ku qëndron zakonisht. Kur, për shkak të personalitetit të të pandehurit ose të kushteve të terrenit, qëndrimi në këtë vend nuk garanton nevojat e sigurimit, detyrimi i qëndrimit mund të urdhërohet në territorin e një bashkie tjetër.

3. Kur vendos detyrimin e qëndrimit, gjykata tregon organin e policisë të cilit i pandehuri duhet t'i paraqitet pa vonesë dhe të deklarojë vendin ku do të caktojë banesën e vet. Gjkata mund të urdhërojë të pandehurin t'u deklarojë organeve të policisë oraret dhe vendet ku mund të gjendet çdo ditë.

4. Për urdhrat e gjykatës njoftohet organi i policisë që të mbikëqyrë respektimin dhe t'i raportojë prokurorit çdo shkelje.

Garancia pasurore

(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur është caktuar masa e sigurimit arrest në burg ose arrest në shtëpi, për shkak të ekzistencës së rrezikut të ikjes, gjykata mund të vendosë zëvendësimin e saj, duke urdhëruar lirimin e personit, nëse është ofruar garanci pasurore nga ai vetë ose një person tjetër për moslargimin e tij deri në përfundimin e gjykimit.

2. Gjkata pranon garancinë pasurore në të njëjtat kushte si në paragrafin e mësipërm edhe kur ndaj personit duhet të caktohet masa e sigurimit arrest në burg ose arrest në shtëpi, për shkak të ekzistencës së rrezikut të ikjes, duke lejuar qëndrimin e tij në gjendje të lirë.

3. Shuma e garancisë pasurore përcaktohet nga gjykata, pasi merr mendimin e palëve, bazuar në nevojat reale të sigurimit, rrethanat personale dhe familjare të të pandehurit, si dhe gjendjen e tij financiare.

4. Kur pranon kërkesën për garanci pasurore gjykata përcakton shumën që duhet të depozitohet dhe afatin brenda të cilit duhet të kryhet depozitimi dhe, nëse e çmon të përshtatshme, përcakton edhe një nga masat shtrënguese të parashikuara nga shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të nenit 232, të këtij Kodi. I pandehuri qëndron në masë sigurimi arrest në burg ose në shtëpi deri në depozitimin e garancisë pasurore. Për depozitimin njoftohet menjëherë prokurori.

5. Menjëherë pas njoftimit të depozitimit, në çdo rast jo më vonë se 24 orë nga njoftimi për depozitimin e shumës së garancisë pasurore, prokurori verifikon dokumentacionin përkatës, duke urdhëruar, sipas rastit, lirimin e menjëhershëm të të pandehurit ose konfirmimin e masës së sigurimit arrest në burg ose në shtëpi.

6. Kur i pandehuri shkel kushtet e garancisë pasurore, gjykata urdhëron konfiskimin e shumës së vendosur si garanci dhe caktimin e masës së sigurimit arrest në burg.

Neni 237

Arresti në shtëpi

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Me vendimin e arrestit në shtëpi, gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet nga banesa e tij ose nga një vend i caktuar ku ai banon, kurohet ose mbahet me asistencë.
2. Kur cakton këtë masë, gjykata përcakton edhe mënyrën e ekzekutimit dhe të mbikëqyrjes së saj.
3. Prokurori dhe policia gjyqësore kontrollojnë respektimin e urdhrave që i janë dhënë të pandehurit.
4. Për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejné rregullat e caktuara për paraburgimin.
5. Koha e qëndrimit në arrest në shtëpi llogaritet në caktimin e dënimit.

Neni 238

Arresti në burg

1. Me vendimin e arrestit në burg, gjykata urdhëron policinë gjyqësore që ta kapë të pandehurin dhe ta çojë menjëherë në një institut paraburgimi për të qëndruar aty në dispozicion të autoritetit procedues.
2. Koha e paraburgimit llogaritet në caktimin e dënimit.

Neni 239

Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik

(Shtuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur personi që duhet arrestuar është i sëmurë mendërisht dhe për këtë shkak përjashtohet ose pakësohet shumë zotësia e të kuptuarit ose e vullnetit, gjykata në vend të paraburgimit mund të urdhërojë shtrimin e përkohshëm në një institucion psikiatrik, duke caktuar masat e nevojshme për të parandaluar rrezikun e ikjes.

2. Shtrimi nuk mund të vazhdojë kur rezulton se i pandehuri nuk është më i sëmurë mendërisht.

3. Zbatohen rregullat e paragrafit 2, të nenit 238, të këtij Kodi.

SEKSIONI III MASAT NDALUESE

Neni 240

Llojet e masave ndaluese

1. Masat ndaluese janë:

- a) pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik;
- b) ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste.

Neni 241

Kushtet e zbatimit të masave ndaluese

1. Masat ndaluese mund të zbatohen vetëm kur procedohet për vepra penale, për të cilat ligji cakton dënim me burgim më të lartë në maksimum se një vit.

Neni 242

Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik

1. Me vendimin që disponon pezullimin e ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, gjykata i ndalon përkohësisht të pandehurit, plotësisht ose pjesërisht, veprimtarinë që lidhet me to.

2. Kjo masë nuk zbatohet ndaj personave të zgjedhur sipas ligjit elektoral.

Neni 243

Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste

1. Me vendimin që disponon ndalimin për të ushtruar profesione ose detyra të caktuara drejtuese në persona juridikë, gjykata e ndalon përkohësisht të pandehurin, plotësisht ose pjesërisht, të ushtrojë veprimtaritë që lidhen me to.

KREU II

CAKTIMI DHE ZBATIMI I MASAVE TË SIGURIMIT

Neni 244

Kërkesa për caktimin e masave të sigurimit

(Shtuar pika 3 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; shtuar fjali në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa. Vendimi merret në dhomë këshillimi dhe jepet i arsyetuar.

2. Edhe kur gjykata deklaron moskompetencën e vet për çdo lloj shkak, në qoftë se janë kushtet dhe ekziston urgjenca për marrjen e masës ajo vendos marrjen e saj dhe i dërgon aktet gjykatës kompetente.

3. Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori.

Neni 245

Vendimi i gjykatës

(Ndryshuar fjali dhe shenja e pikësimit e shtuar shkronja “ç” në pikën 1, shkronja “ç” bëhet shkronja “d”, shkronja “d” bëhet shkronja “dh”, shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Vendimi që cakton masën e sigurimit përmban, me pasojë pavlefshmërie:

a) gjeneralitetet e personit ndaj të cilit merret masa ose çdo gjë tjetër që vlen për ta identifikuar atë dhe, kur është e mundshme, tregimin e vendit ku ndodhet;

b) parashtrimin përmbledhës të fakteve, duke treguar nenet e ligjit që konsiderohen të shkelura;

c) parashtrimin e shkaqeve të posaçme dhe të të dhënave që përlligjin masën e sigurimit;

ç) parashtrimin e shkaqeve pse nuk merren parasysh pretendimet e parashtruara nga mbrojtja, si dhe arsyetimi i papërshtatshmërisë së masave të tjera të sigurimit, kur caktohen masat e sigurimit shtrënguese të parashikuara nga nenet 237, 238 dhe 239 të këtij Kodi;

d) caktimi i kohëzgjatjes së masës, kur ajo është urdhëruar për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës;

dh) datën, nënshkrimin e kryetarit, të sekretarit që e asiston dhe vulën e gjykatës.

2. Kur vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, gjykata disponon në një vendim, duke arsyetuar kushtet dhe kriteret për secilin prej tyre.

Neni 246

Zbatimi i masave të sigurimit

(Ndryshuar pika "2" dhe "6" me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar fjali e shtuar fjalia e dytë në pikën 1, ndryshuar pika 6 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Oficeri ose agjenti i policisë i ngarkuar me zbatimin e vendimit të arrestit i dorëzon personit ndaj të cilit është marrë masa kopjen e vendimit dhe e njeh menjëherë me letrën e të drejtave, sipas paragrafit 2, të nenit 34/b, të këtij Kodi. Policia gjyqësore mban procesverbal për veprimet e kryera. Procesverbali i dërgohet gjykatës që ka dhënë vendimin dhe prokurorit.

2. Në rast se dyshohet për vërtetësinë e vendimit që ka caktuar masën e sigurimit ose për vërtetësinë e identitetit të personit ndaj të cilit është dhënë masa, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore të ngarkuar nuk e zbatojnë atë.

3. Vendimet për masat e tjera të sigurimit i njoftohen të pandehurit nga gjykata.

4. Pas njoftimit ose zbatimit të tyre, vendimet depozitohen në sekretarinë e gjykatës që i ka dhënë. Për depozitim njoftohen edhe mbrojtësit.

5. Kopja e vendimit, me të cilin është caktuar një masë ndaluese i dërgohet organit që është kompetent për të vendosur caktimin e një mase të tillë në rastet e zakonshme.

6. Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori informon me shkrim gjykatën që ka caktuar masën mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit. Informacioni përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit. Kur prokurori nuk informon në afatin e përcaktuar, gjykata verifikon nevojat e sigurimit me kërkesë të të pandehurit ose kryesisht. Gjkata, pasi dëgjon palët, vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. Zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 248 dhe 249 të këtij Kodi.

Neni 247

Kërkimi i personit që nuk gjendet

(Shtuar pika 3/1 dhe 3/2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur personi ndaj të cilit është marrë masa nuk gjendet, oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore mban procesverbal, në të cilin tregon kërkimet e bëra dhe ia dërgon atë gjykatës që ka dhënë vendimin.

2. Kur gjykata çmon se kërkimet janë bërë të plota, deklaron ikjen e personit.

3. Me aktin që deklaron ikjen, gjykata i cakton personit që ka ikur një mbrojtës dhe urdhëron që të depozitohet në sekretari kopja e vendimit me të cilin është caktuar masa e zbatuar.

3/1. I ikur konsiderohet personi që megjithëse ka dijeni, i shmanget me vullnet zbatimit të masave të sigurimit, të parashikuara nga nenet 233, 235, 237 dhe 238 të këtij Kodi, ose dënimit me burgim.

3/2. Pasojat procedurale të ikjes vepronë vetëm brenda procedimit për të cilin ajo është deklaruar. Gjendja e ikjes ruhet derisa masa e sigurimit ekzekutohet, revokohet, humbet fuqinë, ose kur shuhet vepra penale apo dënimi për të cilin është vendosur masa.

4. Me të ikurin barazohet, për çdo efekt, i larguari nga vendi ku ruhet.

5. Për të lehtësuar kërkimin e personit të ikur, gjykata mund të urdhërojë përgjimin e bisedave telefonike dhe të formave të tjera të komunikimit.

Neni 248

Marrja në pyetje e personit të arrestuar

(Shtuar fjalia në pikën 1 e pika 4 dhe 6, ndryshuar pika 2 e pika 4 numërohet pika 5, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i masës, gjykata e merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur arrestin në burg ose në shtëpi. Për masat e tjera të sigurimit, shtrënguese ose ndaluese, gjykata procedon me marrjen në pyetje brenda pesë ditëve nga zbatimi i masës. Mbrojtja ka të drejtë të njihet me aktet dhe të marrë kopje të tyre.

2. Nëpërmjet marrjes në pyetje, gjykata verifikon kushtet dhe kriteret e caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të këtij Kodi. Kur këto kushte nuk ekzistojnë, gjykata vendos revokimin ose zëvendësimin e masës. Në të kundërt, gjykata vendos vazhdimin e zbatimit të saj. Gjkata depoziton vendimin e arsyetuar brenda 48 orëve.

3. Në pyetjen e të arrestuarit marrin pjesë prokurori dhe mbrojtësi, të cilët lajmërohen nga sekretaria e gjykatës.

4. Gjatë debatit gjyqësor palët kanë të drejtë të paraqesin prova, me përjashtim të provave me dëshmitarë.

5. Kur pyetja e të arrestuarit duhet të bëhet në gjykatën e një rrethi tjetër, gjykata kërkon që pyetja të bëhet nga një gjyqtar i asaj gjykate.

6. Prokurori nuk mund të marrë në pyetje personin e arrestuar përpara se gjykata të procedojë, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 249

Ankimi kundër masave të sigurimit

(Ndryshuar pikat 1, 3, 5, 9 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar pika 1, shtuar pika 1/1, ndryshuar, bequr dhe shtuar fjalë në pikën 3, ndryshuar e shtuar fjalë në pikën 5, 9 dhe 10, shtuar fjalë e dytë në pikën 6 e fjalë në pikën 8, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kundër vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, sipas nenit 244 të këtij Kodi, lejohet ankim brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit të gjykatës.

1/1. Kundër vendimit të gjykatës për vazhdimin, revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit, sipas nenit 248 të këtij Kodi, prokurori, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim brenda pesë ditëve.

2. Për të pandehurin e ikur afati fillon të ecë nga data e njoftimit të bërë sipas nenit 141.

3. Ankimi paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, e cila detyrohet që brenda 3 ditëve nga realizimi i njoftimeve të dorëzojë aktet në gjykatën që do të shqyrtojë ankimin.

4. Data e caktuar për seancën i njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij të paktën tri ditë përpara.

5. Ankimi shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve.

6. Gjykata vendos, sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit, edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit. Gjykata depoziton vendimin e arsyetuar brenda 10 ditëve.

7. Kur vendimi nuk shpallet ose nuk zbatohet brenda afatit të caktuar, akti në bazë të të cilit është marrë masa shtrënguese e humbet fuqinë.

8. Kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet rekurs për shkelje të ligjit në Gjykatën e Lartë, brenda kompetencës së saj.

9. Me kalimin e gjashtë muajve nga zbatimi i vendimit të arrestit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit për kohëzgjatjen e paraburgimit.

10. Gjykata e apelit vendos brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve.

Neni 250

Llogaritja e afateve të kohëzgjatjes së masave

1. Efektet e paraburgimit fillojnë të ecin nga çasti i arrestimit ose i ndalimit.

2. Kur i pandehuri është paraburgosur për një vepër penale tjetër, efektet e masës fillojnë të ecin nga dita në të cilën është njoftuar vendimi.

3. Efektet e masave të tjera fillojnë të ecin nga çasti në të cilin vendimi është i njoftuar.

4. Kur ndaj një të pandehuri janë dhënë disa vendime që caktojnë të njëjtën masë për të njëjtin fakt, afatet fillojnë të ecin nga dita në të cilën është zbatuar ose njoftuar i pari.

KREU III

ARRESTIMI NË FLAGRANCË DHE NDALIMI

Neni 251

Arrestimi në flagrancë

1. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet.

2. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të

kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet ose për një veprë penale të kryer nga pakujdesia, për të cilën ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dhjetë vjet.

3. Kur lind nevoja e domosdoshme, për shkak të rëndësisë së faktit ose të rrezikshmërisë së subjektit, e motivuar me akt të veçantë, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë, edhe kur nuk janë kushtet e pikës 2.

4. Në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, çdo person është i autorizuar të kryejë arrestimin në flagrancë për krimet që ndiqen kryesisht. Ai që ka kryer arrestimin duhet të dorëzojë menjëherë të arrestuarit në policinë gjyqësore, e cila mban procesverbal për dorëzimin dhe i jep një kopje të tij.

Neni 252

Gjendja e flagrancës

1. Është në gjendje flagrante ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale.

Neni 253

Ndalimi i të dyshuarit për një krim

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur ka shkaqe të bazuara për të menduar se ka rrezik ikjeje, prokurori urdhëron ndalimin e personit që dyshohet për një krim, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se katër vjet.

2. Policia gjyqësore kryen ndalimin me iniciativën e vet kur nuk është e mundur, për shkak të gjendjes së ngutshme, të pritët urdhri i prokurorit.

Neni 254

Moslejimi i arrestimit dhe ndalimit në rrethana të caktuara

1. Arrestimi ose ndalimi nuk lejohet kur nga rrethanat e faktit del se veprimi është bërë gjatë kryerjes së një detyre ose gjatë ushtrimit të një të drejte të ligjshme ose kur ekziston një shkak padënueshmërie.

Neni 255

Detyrat e policisë gjyqësore në rastet e arrestimit ose ndalimit

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

(Shtuar fjalia në pikën 1 e fjalë në pikën 4, shtuar pika 3 dhe ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që kanë kryer një arrestim ose ndalim ose kanë marrë në dorëzim të arrestuarin, njoftojnë menjëherë prokurorinë e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi. Ata i bëjnë të ditur të arrestuarit ose të ndaluarit se nuk ka asnjë detyrim të bëjë deklaratat dhe në qoftë se do të flasë, çfarëdo që ai thotë, mund të përdoret ndaj tij në gjykim. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore i bëjnë të ditur të ndaluarit ose të arrestuarit edhe të drejtën që ai ka për të zgjedhur mbrojtës dhe njoftojnë menjëherë mbrojtësin e zgjedhur ose, kur është rasti, atë të caktuar nga prokurori. Data, ora dhe emri i oficerit të policisë gjyqësore që ka kryer arrestimin ose ndalimin shënohet në procesverbal.

2. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore informojnë menjëherë personin e arrestuar për arsyet e arrestimit ose ndalimit dhe për të drejtat e tij, sipas nenit 34/b, të këtij Kodi, përveçse kur kjo është absolutisht e pamundur për shkak të rrethanave.

3. Kur i arrestuari ose i ndaluari është i sëmurë ose i mitur, prokurori mund të urdhërojë që ai të mbahet në ruajtje në banesën e tij ose në një vend tjetër të ruajtur. Kur të arrestuarit ose të ndaluarit nuk i është dhënë letra e të drejtave, ajo i jepet menjëherë pas mbërritjes në dhomat e paraburgimit. Nëse i arrestuari ose i ndaluari nuk mund

të lexojë, letra e të drejtave i lexohet nga njëri prej të pranishmëve. Ky fakt pasqyrohet në procesverbal kundrejt nënshkrimit.

4. Policia gjyqësore, me pëlqimin e të arrestuarit ose të ndaluarit, duhet të lajmërojë pa vonesë familjarët. Kur i arrestuari ose i ndaluari është i mitur lajmërohet detyrimisht prindi ose kujdestari si dhe zbatohen rregullat e Kodit të Drejtësisë për të Miturit.

Neni 256

Marrja në pyetje e të arrestuarit ose të ndaluarit

(Shtuar pika 2 dhe 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Prokurori merr në pyetje të arrestuarit ose të ndaluarin në prani të mbrojtësit të zgjedhur ose të caktuar kryesisht. Ai i njofton të arrestuarin ose të ndaluarit faktin për të cilin procedohet dhe arsyet e marrjes në pyetje, duke i treguar të dhënat në ngarkim të tij dhe, kur nuk i shkaktohet dëm hetimeve, edhe burimet.

2. Prokurori fillimisht e pyet të arrestuarin ose të ndaluarin nëse e ka marrë letrën e të drejtave dhe sigurohet që ai i ka kuptuar të drejtat e tij. Kur i arrestuari ose i ndaluari nuk e ka marrë letrën e të drejtave, prokurori ia jep atë përpara marrjes së parë në pyetje dhe i sqaron të drejtat e tij.

3. Deklarimet e bëra nga i arrestuari ose i ndaluari përpara se të ketë marrë letrën e të drejtave ose përpara takimit me mbrojtësin e tij, nuk mund të përdoren.

Neni 257

Rastet e lirimit të menjëhershëm të të arrestuarit ose të ndaluarit

1. Kur del e qartë se arrestimi ose ndalimi është bërë për shkak se është ngatërruar personi ose nuk janë respektuar kërkesat e ligjit ose kur masa e arrestit ose e ndalimit e ka humbur fuqinë për shkak të shkeljes së afatit të kërkesës për vleftësimin e masës, prokurori urdhëron, me vendim të motivuar, që i arrestuari ose i ndaluari të

lirohet menjëherë. Në këto raste lirim i urdhërohet edhe nga oficeri i policisë gjyqësore, i cili njofton menjëherë prokurorin e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Neni 258

Kërkesa e vleftësimit të arrestimit ose ndalimit

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

1. Kur nuk urdhëron lirim i menjëhershëm, prokurori, brenda dyzet e tetë orëve nga arrestimi ose ndalimi, kërkon vleftësimin e masës në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi. Mosrespektimi i këtij afati bën që arrestimi ose ndalimi të humbasë fuqinë.

2. Gjykata cakton seancën e vleftësimit sa më shpejt duke lajmëruar prokurorin dhe mbrojtësin.

Neni 259

Seanca e vleftësimit

(Shtuar pika 2, ndryshuar pikat 3, 4 e 5 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; shtuar fjalia në fund të pikës 2, ndryshuar pika 3 dhe fjalia e dytë në pikën 4 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Seanca e vleftësimit zhvillohet me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe të mbrojtësit. Kur mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar kryesisht nuk është gjetur ose nuk është paraqitur, gjykata cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër.

2. Prokurori tregon shkaqet e arrestimit ose të ndalimit. Pas kësaj gjykata dëgjon të arrestuarin ose të ndaluarin dhe mbrojtësin ose vetëm këtë të fundit, kur i arrestuari a i ndaluari ka refuzuar të paraqitet. Provat e marra në këtë seancë konsiderohen si të marra në gjykim por, me kërkesën e palëve, ato mund t'i nënshtrohen debatit gjyqësor gjatë shqyrtimit të çështjes në themel.

3. Kur del se arrestimi në flagrancë ose ndalimi janë bërë në mënyrë të ligjshme, gjykata merr vendim për vleftësimin e tij. Kur ka

kërkesë nga prokurori, gjykata mund të caktojë masë sigurimi. Kundër vendimit të gjykatës lejohet ankimi sipas nenit 249 të këtij Kodi.

4. Kur arrestimi ose ndalimi nuk është i ligjshëm, gjykata vendos lirimin e menjëhershëm të të arrestuarit ose të ndaluarit. Kundër vendimit prokurori mund të bëjë ankim sipas nenit 249 të këtij Kodi.

5. Arrestimi ose ndalimi e humbet fuqinë kur vendimi i gjykatës për vleftësimin nuk është shpallur brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë.

KREU IV REVOKIMI, ZËVENDËSIMI DHE SHUARJA E MASAVE TË SIGURIMIT

(Ndryshuar titulli i krenit me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Neni 260

Revokimi, zëvendësimi dhe bashkimi i masave të sigurimit

(Ndryshuar titulli i nenit dhe pikat 3 e 4 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Masat shtrënguese dhe ndaluese revokohen menjëherë kur del se mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit të tyre.

2. Kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë.

3. Kur nevojat e sigurimit rëndohen apo personi shkel detyrimet që lidhen me masën e sigurimit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, mund të vendosë zëvendësimin e saj me një masë më të rëndë ose caktimin e një mase sigurimi shtrënguese ose ndaluese shtesë. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë caktimin e një mase ndaluese shtesë ose zëvendësimin e saj me një masë shtrënguese.

4. Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga

gjykata ku ndodhen aktet, brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj. Kur është rasti, gjykata vendos edhe kryesisht revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit gjatë marrjes në pyetje të personit të arrestuar, sipas nenit 248, të këtij Kodi, në rastet e parashikuara nga paragrafi 6, i nenit 246, të tij, gjatë procedimit për sigurimin e provës, gjatë seancës paraprake ose gjatë gjykimit.

Neni 261

Shuarja e masave të sigurimit

(Ndryshuar shkronja “ç” në pikën 1, pika 3 numërohet pika 4 e shtuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Masat e sigurimit shuhen:

a) kur për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person është vendosur pushimi i çështjes ose është dhënë vendimi i pafajësisë;

b) kur dënimi i caktuar shpallet i shuar ose i pezulluar me kusht;

c) kur kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur është më e madhe se masa e dënimit të caktuar;

c) kur pas mbarimit të afatit të parashikuar nga shkronja “d”, e paragrafit 1, të nenit 245, të këtij Kodi, nuk është urdheruar përsëritja, brenda kufijve të parashikuar nga nenet 264 dhe 267.

2. Paraburgimi i urdhëruar gjatë hetimeve paraprake humbet fuqinë në qoftë se gjykata nuk procedon në marrjen në pyetje brenda afatit të parashikuar nga neni 248.

3. Kërkesa për shuarjen e masës së sigurimit paraqitet së bashku me provat në gjykatën ku ndodhen aktet në momentin e paraqitjes së saj. Gjykata vendos brenda 48 orëve, pasi njofton palët. Mosparaqitja e palëve, pa shkaqe të arsyeshme, nuk e pengon gjykatën të vendosë pa praninë e tyre. Për afatin e arsyetimit të vendimit dhe ankimit zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 248 dhe 249 të këtij Kodi.

4. Shuarja e masave të sigurimit nuk pengon ushtrimin e të drejtave që ligji i njeh gjykatës ose ndonjë autoriteti tjetër në zbatimin e dënimeve plotësuese ose të masave të tjera ndaluese.

Neni 262

Pasojat e shuarjes së masave të sigurimit

1. Kur arrestimi e humbet fuqinë, gjykata vendos lirimin e menjëhershëm të personit ndaj të cilit është marrë masa.

2. Në rastet e humbjes së fuqisë së masave të tjera të sigurimit, gjykata vendos heqjen e menjëhershme të tyre.

Neni 263

Afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit

(Ndryshuar me ligjin nr.8570, datë 20.1.2000, shtuar pika 7 e 8 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar fjalë në shkronjat "c" të pikave 1, 2, 3 dhe në shkronjën "b" të pikës 6 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga fillimi i zbatimit të tij kanë kaluar afatet e mëposhtme, pa u dorëzuar aktet në gjykatë:

a) tre muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;

b) gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimumin deri në dhjetë vjet burgim;

c) dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

2. Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dorëzimit të akteve në gjykatë kanë kaluar afatet e mëposhtme, pa u dhënë vendimi i dënimit në shkallë të parë:

a) dy muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;

b) nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;

c) dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

3. Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë kanë kaluar afatet e mëposhtme pa u dhënë vendimi i dënimit në gjykatën e apelit:

- a) dy muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimumin deri në dhjetë vjet burgim;
- c) nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

4. Në rastin kur vendimi priset nga Gjykata e Lartë dhe çështja i dërgohet gjykatës së shkallës së parë ose apelit, si dhe kur vendimi priset nga gjykata e apelit dhe i dërgohet gjykatës së shkallës së parë, nga dita e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë apo të apelit, fillojnë përsëri afatet e parashikuara, për secilën shkallë të procedimit.

5. Në rast ikje të të pandehurit të paraburgosur, afatet fillojnë të ecin përsëri nga çasti në të cilin ai paraburgoset përsëri.

6. Kohëzgjatja tërësore e paraburgimit, duke marrë parasysh edhe zgjatjen e parashikuar nga neni 264 pika 2, nuk mund të kalojë këto afate:

- a) dhjetë muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) dy vjet, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;
- c) tre vjet, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

7. Kur në mbarim të afatit të paraburgimit prokurori i komunikon të pandehurit një akuzë të re, për të cilën parashikohen afate më të gjata paraburgimi se ato të akuzës së parë, ai i kërkon gjykatës të caktojë afatin e ri të paraburgimit. Gjykata vendos në seancë gjyqësore pasi të ketë dëgjuar palët.

8. Kur akuza e re lidhet me një fakt të ri, që nuk dihej në fillim të procedimit, gjykata cakton një afat të ri, i cili fillon të llogaritet nga e para, ndërsa kur ndryshon vetëm cilësimi ligjor i veprës penale, gjykata cakton masën e sigurimit dhe fillimi i llogaritjes së afatit është ai i masës së mëparshme të sigurimit.

Neni 264

Zgjatja e paraburgimit

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.8570, datë 20.1.2000)

1. Në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, kur është urdhëruar ekspertimi i gjendjes mendore të të pandehurit, afatet e paraburgimit zgjaten për kohën që është caktuar për kryerjen e ekspertimit. Zgjatja vendoset nga gjykata, mbi kërkesën e prokurorit, pasi dëgjohet mbrojtësi. Kundër vendimit mund të bëhet apel ose rekurs i drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë.

2. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori mund të kërkojë zgjatjen e afateve të paraburgimit, që janë në mbarim e sipër, kur ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi dhe verifikimet veçanërisht komplekse e bëjnë të domosdoshme këtë zgjatje. Gjykata pasi dëgjon prokurorin dhe mbrojtësin merr vendim. Zgjatja mund të bëhet vetëm një herë dhe nuk mund të jetë më shumë se tre muaj.

3. Kohëzgjatja e paraburgimit nuk mund të kalojë gjysmën e maksimales së dënimit të parashikuar për veprën penale që procedohet.

Neni 265

Pezullimi i afateve të paraburgimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 8570, datë 20.1.2000)

1. Afatet e parashikuara nga neni 263 pezullohen me vendim të ankimueshëm të gjykatës:

a) për kohën që shqyrtimi gjyqësor është pezulluar ose shtyrë për shkak të veprimeve apo kërkesave të padrejta të bëra nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij, përveç rasteve kur kërkesa bëhet për marrjen e provës;

b) për kohën që shqyrtimi gjyqësor është pezulluar ose shtyrë për shkak të mosparaqitjes ose të largimit të një a më shumë mbrojtësve, që lënë pa ndihmë një a më shumë të pandehur.

Neni 266

Disponimet në rastet e lirimit nga burgu

1. Ndaj të pandehurit të liruuar nga burgu për shkak të mbarimit të afateve, gjykata, kur ekzistojnë ende arsyet për të cilat ishte vendosur paraburgimi, cakton masa të tjera sigurimi në qoftë se janë kushtet e kërkuara.

2. Paraburgimi, kur është i nevojshëm, rivihet në fuqi:

a) kur i pandehuri i ka shkelur me dashje urdhrat e dhëna në lidhje me një masë sigurimi të marrë në bazë të paragrafit 1, por gjithnjë kur ekzistojnë nevojat e sigurimit;

b) me vendimin e dënimit, kur ekziston nevoja e sigurimit të parashikuar nga neni 228, paragrafi 3.

3. Me rivënien në fuqi të paraburgimit, afatet fillojnë të ecin përsëri, por për efekt të llogaritjes së afatit të kohëzgjatjes së përgjithshme të paraburgimit mbahet parasysh edhe paraburgimi i vuajtur më parë.

4. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore mund të ndalojnë të pandehurin, i cili, duke shkelur urdhrat që lidhen me një masë sigurimi të marrë në bazë të paragrafit 1, ka ikur. Zbatohen, për aq sa pajtohen, dispozitat mbi ndalimin e personit të dyshuar për veprën penale.

Neni 267

Afatet e kohëzgjatjes maksimale të masave të tjera të sigurimit

1. Masat shtrënguese, të ndryshme nga paraburgimi, e humbasin fuqinë kur nga fillimi i zbatimit të tyre ka kaluar një kohë e barabartë me dyfishin e afateve të parashikuara nga neni 263.

2. Masat ndaluese e humbasin fuqinë kur kanë kaluar tre muaj nga fillimi i zbatimit të tyre. Kur ato janë marrë për arsye që të mos dëmtohen provat, gjykata mund të urdhërojë përsëritjen e tyre deri në kufijtë e parashikuar nga paragrafi 1.

KREU V KOMPENSIMI PËR BURGIM TË PADREJTË

Neni 268

Kushtet e zbatimit

1. Ai që është deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë ka të drejtën e kompensimit për paraburgimin e vuajtur, me përjashtim të rasteve kur është provuar që vendimi i gabuar ose moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij.

2. E njëjta e drejtë i takon edhe të dënuarit që ka qenë i paraburgosur, kur me vendim të formës së prerë vërtetohet se akti me të cilin është caktuar masa është nxjerrë pa qenë kushtet e parashikuara nga nenet 228 dhe 229.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 zbatohen edhe në favor të personit për të cilin është vendosur pushimi i çështjes nga gjykata ose prokurori.

4. Kur me vendim të gjykatës është vërtetuar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, për shkak të shfuqizimit të dispozitës përkatëse, e drejta e kompensimit nuk njihet për atë pjesë të paraburgimit të vuajtur para shfuqizimit.

Neni 269

Kërkesa për kompensim

1. Kërkesa për kompensim duhet të bëhet, ndryshe nuk pranohet, brenda tre vjetëve nga data në të cilën vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes ka marrë formë të prerë.

2. Masa e kompensimit dhe mënyra e llogaritjes, si dhe rastet e kompensimit për arrestin në shtëpi caktohen me ligj të veçantë.

KREU VI
MASAT E SIGURIMIT PASUROR

SEKSIONI I
SEKUESTROJA KONSERVATIVE

Neni 270

Kushtet dhe efektet e masës

1. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se nuk ka garanci për pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit, prokurori kërkon sekuestron konservative të pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme të të pandehurit ose të shumave a sendeve që të tjerët i detyrohen atij, në caqet që ligji lejon sekuestrimin e tyre.

2. Paditësi civil mund të kërkojë sekuestron konservative të pasurisë së të pandehurit ose të të paditurit civil, kur janë arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

3. Sekuestroja e vendosur me kërkesën e prokurorit është e vlefshme edhe për paditësin civil.

Neni 271

Vendimi i gjykatës për sekuestron

1. Sekuestroja konservative vihet me vendim të gjykatës kompetente.

2. Kur është dhënë vendim në shkallë të parë, sekuestroja vihet para se aktet t'i dërgohen gjykatës së apelit.

3. Sekuestroja zbatohet nga përmbaruesi gjyqësor në mënyrat e përcaktuara nga Kodi i Procedurës Civile.

4. Efektet e sekuestros pushojnë kur vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes ka marrë formë të prerë.

Neni 272

Oferta për garantimin e detyrimit

1. Kur i pandehuri ose i padituri civil ofron një mjet të përshtatshëm ligjor për të garantuar detyrimin (peng, dorëzani, kapar, hipotekë), gjykata nuk e vë sekuestron konservative ose e revokon atë dhe cakton mënyrën e ekzekutimit të detyrimit.

2. Kur oferta propozohet bashkë me kërkesën e ankimit, gjykata revokon sekuestron në qoftë se çmon se oferta e garantimit është në përpjesëtim me vlerën e sendeve të sekuestruara.

Neni 273

Ekzekutimi i masës së sekuestrës

1. Sekuestroja konservative shndërrohet në sekuestro të ekzekutueshme kur merr formë të prerë vendimi i dënimit me gjobë apo ai i detyrimit të të pandehurit dhe të paditurit civil me shpërblimin e dëmit.

2. Ekzekutimi i detyrueshëm i pasurisë së sekuestruar bëhet në mënyrat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. Nga të ardhurat e shitjes së pasurisë së sekuestruar dhe nga ato të mjeteve të ofruara për garantimin e detyrimit, paguhen, sipas radhës, shumat që i takojnë paditësit civil për shpërblimin e dëmit dhe shpenzimet gjyqësore, dënimet me gjobë, shpenzimet e procedimit dhe çdo shumë tjetër në favor të shtetit.

SEKSIONI II

SEKUESTROJA PREVENTIVE

Neni 274

Objekti i sekuestrës preventive

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.9085, datë 19.6.2003)

1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të

lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.

2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.

3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.

Neni 275

Humbja e fuqisë së sekuestros

1. Me vendimin e pafajësisë ose të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori urdhëron që sendet e sekuestruara t'i kthehen atij që i takojnë, kur nuk duhet të urdhërojë konfiskimin e tyre sepse kanë shërbyer ose ishin të destinuara për të kryer një vepër penale ose sepse kanë qenë prodhim ose përfitim nga vepra penale.

2. Kur është dhënë vendimi i dënimit, efektet e sekuestros vazhdojnë në rast se është vendosur konfiskimi i sendeve të sekuestruara.

3. Sendet e sekuestruara nuk kthehen kur gjykata vendos që të mbahet sekuestroja për garantimin e kredive.

Neni 276

Ankimi kundër vendimit

1. Kundër vendimit për vënien ose mosvënien e sekuestros cilido që ka interes mund të bëjë ankim.

2. Kërkesa e ankimit paraqitet brenda dhjetë ditëve nga dhënia e vendimit ose nga dita që i interesuari ka marrë dijëni për sekuestron e vënë.

3. Kërkesa paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin.

4. Ankimi nuk pezullon zbatimin e masës.

5. Mbi kërkesën e ankimit vendos gjykata e apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve.

6. Gjkata vendos, sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit të ankimuar.

7. Kur vendimi nuk shpallet ose nuk zbatohet brenda afatit të caktuar, vendimi për vënien e sekuestros e humbet fuqinë.

PJESA E DYTË

TITULLI VI HETIMET PARAPRAKE

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 277

Organet e ngarkuara për hetimet paraprake

(Shtuar pika 3 me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002 dhe shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale.

2. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore.

3. Shfuqizuar.

Neni 278

Kompetencat e gjykatës së shkallës së parë në hetimet paraprake

(Shtuar pika 2 me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002; shtuar fjalë në titull dhe ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.

2. Kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, sipas paragrafit 1, të këtij neni, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar.

Neni 279

Detyrimi për të ruajtur sekretin

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe shtuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Aktet hetimore janë sekrete derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijëni për to. Në rast nevojë për vazhdimin e hetimeve prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit për akte të veçanta deri në përfundim të hetimeve.

2. Prokurori mund të lejojë, me vendim të arsyetuar, publikimin e akteve të veçanta ose të pjesëve të tyre. Aktet e publikuara depozitohen në sekretarinë e prokurorit.

3. Edhe kur aktet nuk mbrohen më nga sekreti, sipas paragrafit 1, të këtij neni, në rastet kur është e nevojshme për vazhdimësinë e hetimeve, prokurori mund të disponojë me vendim të arsyetuar:

a) detyrimin e ruajtjes së sekretit për akte të veçanta, kur i pandehuri jep pëlqimin ose kur njohja e përmbajtjes së aktit mund të pengojë hetimet ndaj personave të tjerë;

b) ndalimin e publikimit të përmbajtjes së akteve të veçanta apo të dhënave të posaçme që lidhen me veprime hetimore të caktuara.

Neni 279/a

E drejta e viktimës për informim

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Për shkaqe të ligjshme, viktimë, përfaqësuesi ligjor ose mbrojtësi i saj kanë të drejtë të kërkojnë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihen dhe të marrin kopje të akteve dhe provave që ndodhen në fashikullin e prokurorit.

2. Prokurori mund të refuzojë kërkesën kur:

a) interesi i ruajtjes së fshehtësisë së hetimit tejkalon interesin e viktimës;

b) interesi i të pandehurit tejkalon interesin e viktimës;

c) viktima nuk është pyetur ende si dëshmitar.

2. Viktima, përfaqësuesi ligjor ose mbrojtësi i saj kanë të drejtë të kërkojnë informacion në lidhje me vendosjen, vazhdimin, zëvendësimin apo heqjen e masave të sigurimit ndaj të pandehurit, përveçse kur njoftimi për këto fakte mund të rrezikojë jetën ose shëndetin e të pandehurit.

KREU II

MARRJA DIJENI PËR VEPRËN PENALE

Neni 280

Marrja dijani për veprën penale

1. Prokurori dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.

Neni 281

Kallëzimi nga nëpunësit publikë

1. Nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, marrin dijani për një veprë penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale.

2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore.

3. Kur, gjatë një procedimi civil ose administrativ, zbulohet një fakt që përbën veprë penale që ndiqet kryesisht, organi përkatës bën kallëzim te prokurori.

4. Kallëzimi përmban elementet thelbësore të faktit, burimet e provës, gjeneralitetet, banimin dhe çdo gjë tjetër që vlen për

identifikimin e personit të cilit i atribuohet fakti, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të sqarojnë rrethanat e faktit.

Neni 282

Kallëzimi nga personeli mjekësor

1. Personeli mjekësor që është i detyruar ligjërisht të bëjë kallëzim duhet ta paraqesë atë brenda dyzet e tetë orëve dhe t'ia dërgojë prokurorit ose çdo oficeri të policisë gjyqësore të vendit ku ka kryer ndërhyrjen ose ka dhënë ndihmën dhe kur ka rrezik nga vonesa, oficerit të policisë gjyqësore më të afërt.

2. Kallëzimi nga personeli mjekësor tregon personin të cilit i është dhënë ndihma dhe, kur është e mundur, gjeneralitetet, banimin e tij dhe çdo gjë tjetër që vlen për ta identifikuar, si dhe rrethanat e faktit, mjetet me të cilat është kryer dhe pasojat që ka shkaktuar.

3. Kur disa persona kanë dhënë ndihmën e tyre mjekësore për të njëjtin rast, të gjithë janë të detyruar të bëjnë kallëzim, me të drejtë që të përpilojnë dhe të nënshkruajnë një akt të vetëm.

Neni 283

Kallëzimi nga ana e shtetasve

(Ndryshuar numri dhe shtuar fjalia në pikën 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Çdo person që ka marrë dijëni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.

2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.

3. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 194. Të dhënat e përmbajtjes së kallëzimit anonim mund të verifikohen nga prokurori ose policia gjyqësore për të siguruar elementë të provës, që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

Neni 284

Ankimi

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; shtuar numrat e fjalë dhe hequr numrat në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Për veprat penale të parashikuara nga nenet 84, 89, 102 paragrafi i parë, 105, 106, 130, 148, 149, 243, 254, 264, 275, 290 paragrafi i parë dhe 318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e viktimës, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit.

2. Ankimi bëhet nga viktima te prokurori ose në policinë gjyqësore me anën e një deklaratë, në të cilën personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm, shfaqet vullneti që të procedohet në lidhje me një fakt të parashikuar nga ligji si vepër penale.

3. Kur ankimi bëhet me gojë procesverbali që mbahet për këtë qëllim nënshkruhet nga ankuesi ose përfaqësuesi i tij.

4. Ai që merr ankimin sigurohet për identitetin e ankuesit dhe i dërgon aktet prokurorit.

5. Për rastet e parashikuara nga neni 59, ankimi bëhet në gjykatë nga viktima akuzuese.

Neni 285

Heqja dorë nga e drejta e ankimit

1. Heqja dorë nga e drejta e ankimit bëhet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit me deklaratë të nënshkruar ose me gojë para prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore, i cili mban procesverbal të nënshkruar detyrimisht nga deklaruesi.

2. Heqja dorë me afat ose me kusht nuk është e vlefshme.

3. Në të njëjtën deklaratë mund të bëhet heqja dorë edhe nga padia civile.

Neni 286

Tërheqja e ankimit

1. Tërheqja e ankimit bëhet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit me deklaratë të paraqitur në organin që procedon.
2. Tërheqja e ankimit mund të bëhet në çdo fazë të procedimit, gjersa vendimi i gjykatës nuk ka marrë formën e prerë.
3. Shpenzimet e procedimit janë në ngarkim të atij që tërheq ankimin, përveçse kur në aktin e tërheqjes është parashikuar, me marrëveshje, që ato të jenë tërësisht ose pjesërisht në ngarkim të atij kundër të cilit është bërë ankimi.

Neni 287

Regjistrimi i njoftimit të veprave penale

(ndryshuar pika 2 dhe ndryshuar numërtimi me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.
2. Kur gjatë hetimeve paraprake ndryshon cilësimi juridik ose ndonjë rrethanë e kryerjes së veprës penale, prokurori urdhëron pasqyrimin e tyre në shënimet e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Ndalohet publikimi i regjistrimeve të bëra deri në marrjen si të pandehur të personit që i atribuohet vepra penale.

KREU III
KUSHTET E PROCEDIMIT

Neni 288

*(Ndryshuar me ligjin nr. 21, datë 10.3.2014 dhe nr. 35/2017,
datë 30.3.2017)*

1. Kur ndaj një deputeti duhet të caktohet masa e sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqja e lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrolli personal ose i banesës, prokurori kërkon autorizim nga Kuvendi.

2. Kërkesa për autorizim paraqitet kur plotësohen kushtet ligjore të parashikuara në këtë Kod për kryerjen e veprimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Ajo shoqërohet me një relacion të arsyetuar, të shoqëruar me provat që mbështesin kërkesën e tij.

3. Kur deputeti është arrestuar në flagrancë, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton menjëherë Kuvendin. Kur Kuvendi vendos heqjen e masës së arrestit në flagrancë, deputeti lirohet menjëherë.

Neni 289

Lejimi për të kryer veprime

*(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 21, datë 10.3.2014; ndryshuar me ligjin
nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

1. Mosdhënia e autorizimit, sipas nenit 288, të këtij Kodi, nuk e pengon prokurorin që të kërkojë një masë tjetër sigurimi, sipas nenit 244, dhe as të procedojë ndaj tij ose personave të tjerë, ndaj të cilëve zhvillohen hetime për të njëjtin fakt.

2. Kur nevojat e sigurimit rëndohen apo kur nga hetimet rezultojnë fakte ose rrethana të reja, prokurori mund t'i kërkojë Kuvendit autorizim, sipas paragrafit 1, të nenit 288, të këtij Kodi.

3. Heqja e masës së arrestit në flagrancë, sipas paragrafit 3, të nenit 288, të këtij Kodi, nuk e pengon prokurorin t'i kërkojë Kuvendit autorizim, sipas paragrafit 1 të nenit 288.

Neni 290

Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit

(Hequr fjalë dhe ndryshuar fjalë në shkronjën "c" të pikës 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Procedimi penal nuk mund të fillojë kur:
 - a) personi ka vdekur;
 - b) personi është i papërgjegjshëm ose nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale;
 - c) mungon ankimi i viktimës ose ajo e tërheq ankimin;
 - ç) kur fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston;
 - d) vepra penale është shuar;
 - dh) është dhënë amnisti;
 - e) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 291

Vendimi për mosfillimin e procedimit

(Shtuar pikat 3, 4, 5 dhe fjalë në pikën 1, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit.
2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.
3. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, i cili jep vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit. Ankimi shqyrtohet në seancë gjyqësore, por kur palët nuk paraqiten pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos mbi aktet e paraqitura.
4. Kur e gjen të bazuar ankimin, gjykata urdhëron prokurorin të regjistrojë procedimin dhe të kryejë hetimet e nevojshme, duke përcaktuar edhe drejtimin e tyre.

5. Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve. Gjykata e apelit vendos brenda 30 ditëve nga marrja e akteve.

Neni 292

Rifillimi i hetimeve

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Vendimi i mosfillimit të procedimit ose i pushimit, të dhënë për shkak të mungesës së ankimit, nuk pengojnë kryerjen e hetimeve për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në qoftë se më pas bëhet ankim.

KREU IV

VEPRIMTARIA ME INICIATIVË E POLICISË GJYQËSORE

Neni 293

Referimi i veprës penale te prokurori

(Ndryshuar fjalia e parë në pikën 1 dhe shtuar fjalitë në pikën 1 dhe 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Me marrjen e njoftimit për një vepër penale, policia gjyqësore, pa vonesë, por jo më vonë se 72 orë, i referon prokurorit, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, duke treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera, si dhe vë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e marra. Ajo njofton, kur është e mundur, edhe gjeneralitetet, banesën dhe çdo gjë që vlen për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit.

2. Kur ka urgjencë dhe në rastet e krimeve të rënda, njoftimi bëhet menjëherë edhe me gojë, i cili nuk përjashton detyrimin për të referuar me shkrim.

3. Me njoftimin, policia gjyqësore, gjithashtu, tregon ditën dhe orën në të cilën ka marrë dijeni për veprën penale.

Neni 294

Sigurimi i burimeve të provave

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.9276, datë 16.9.2004; ndryshuar pika 2 dhe 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Edhe pas referimit të veprës penale policia gjyqësore vazhdon të kryejë funksionet e treguara në nenin 30, duke grumbulluar e fiksuar çdo element të vlefshëm për rindërtimin e faktit dhe për individualizimin e fajtorit. Ajo procedon sidomos:

a) për kërkimin dhe fiksimin e sendeve dhe të gjurmëve të veprës penale, si dhe për ruajtjen e tyre dhe të vendit të ngjarjes për aq kohë sa kjo gjë është e domosdoshme;

b) për kërkimin dhe pyetjen e personave që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit;

c) për kryerjen e veprimeve të caktuara në nenet vijuese.

2. Pas ndërhyrjes së prokurorit, policia gjyqësore kryen çdo veprim të urdhëruar ose të deleguar posaçërisht nga prokurori, si dhe kryen me iniciativë çdo veprim hetimor të nevojshëm dhe siguron burime të reja të provës.

3. Kur kryen veprime që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, me iniciativën e saj ose të deleguara nga prokurori, policia gjyqësore mund të caktojë ekspertë, të cilët nuk mund të refuzojnë detyrën e ngarkuar, pa shkaqe të ligjshme.

Neni 294/a

Veprimet simuluese

(Shtuar me ligjin nr.9187, datë 12.2.2004; ndryshuar pika 1 dhe shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Oficeri i policisë gjyqësore ose një person i autorizuar, mund të ngarkohet për të kryer blerje ose shitje të simuluar të sendeve që

janë të ndaluara për t'u prodhuar, zotëruar, mbajtur apo tregtuar, apo sende që rrjedhin nga një krim, ose simulimin e një akti korruptiv ose të kryejnë veprime të tjera simuluese, për të zbuluar dhe mbledhur prova për personat e dyshuar për kryerjen e një krimi, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose detyrën e tyre si punonjës policie.

2. Këto veprime bëhen me autorizimin dhe nën mbikëqyrjen e prokurorit që kontrollon hetimet ose të prokurorit që ka në juridiksion territorin ku do të zhvillohet veprimi. Pas kryerjes së këtyre veprimeve, policia gjyqësore duhet t'i dorëzojë prokurorit të gjitha provat e mbledhura dhe një raport përmbledhës.

3. Nuk duhet provokuar një akt kriminal, duke shtyrë një person të kryejë një krim, të cilin nuk do ta kishte kryer po të mos ishte ndërhyrja e policisë. Kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret.

Neni 294/b

Infiltrimi në përbërje të grupit kriminal

(Shtuar me ligjin nr.9187, datë 12.2.2004; ndryshuar titulli dhe shtuar fjalë në pikën 1, 2 dhe fjalë e fjalë në pikën 4, ndryshuar fjalë në pikën 3, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Për qëllimet e zbulimit të krimeve të rënda, oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore, me autorizimin dhe nën mbikëqyrjen e prokurorit, mund të futet në përbërjen e një grupi kriminal për të individualizuar pjesëtarët e grupit dhe për të mbledhur të dhënat e nevojshme për hetimin, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose detyrën e vet si punonjës policie.

2. Punonjësi i policisë gjyqësore i infiltruar nuk duhet të provokojë një akt kriminal, i cili, pa ndërhyrjen e tij, nuk do të ishte kryer. Kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret.

3. Autorizimi i prokurorit duhet të përcaktojë afatin e infiltrimit, që lejohet të zgjatet nga prokurori deri në gjashtë muaj dhe hapësirën e lejueshme për punonjësin e infiltruar, duke treguar, sipas rastit, veprimet e paligjshme që mund të kryejë ai, pa rrezikuar jetën e të tjerëve.

4. Punonjësi i policisë gjyqësore i infiltruar mund të pyetet si dëshmitar. Nëse marrja e dëshmisë nga personat e infiltruar është thelbësore për zgjidhjen e çështjes, dëshmia merret duke respektuar rregullat mbi ruajtjen e fshehtësisë së identitetit të informatorit. Kur këta të fundit nuk janë thirrur si dëshmitarë, informacionet e dhëna prej tyre nuk mund të përdoren.

Neni 294/c

Dorëzimi i kontrolluar

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Dorëzimi i kontrolluar autorizohet nga prokurori që drejton hetimet paraprake, me kërkesë të autoriteteve të huaja.

2. Dorëzimi i kontrolluar mund të autorizohet në rastet e mëposhtme:

a) kur personat që dyshohet se janë përfshirë në transportin e paligjshëm të lëndëve narkotike, armëve, sendeve të vjedhura, materialeve eksplozive ose bërthamore, materialeve radioaktive, shumave të parave dhe të ardhurave të tjera produkte të veprës penale ose të sendeve të përdorura si mjet për kryerjen e veprave penale, nuk mund të identifikohen ose arrestohen në mënyra të tjera, si dhe kur identifikimi apo arrestimi i tyre do të dëmtonte hetimet ose do të rrezikonte sigurinë e personave apo dëmtimin ose humbjen e sendeve që transportohen;

b) kur zbulimi i veprave penale dhe marrja e provave është i pamundur ose i vështirë për t'u kryer në mënyra të tjera.

3. Dorëzimi i kontrolluar kryhet sipas kushteve të përcaktuara nga prokurori, i cili urdhëron kryerjen e tij me akt të arsyetuar, pasi sigurohet se autoritetet e huaja:

a) kanë dhënë pëlqimin që sendet e paligjshme apo të dyshimta të hyjnë, të kalojnë transit ose të dalin nga territori i tyre;

b) garantojnë mbikëqyrjen e vazhdueshme të hyrjes, kalimit transit ose daljes së sendeve nga territori i tyre.

4. Urdhri i prokurorit që autorizon dorëzimin e kontrolluar duhet të përmbajë:

a) emrin e të dyshuarit ose të pandehurit, nëse është i ditur;

b) provat që vërtetojnë natyrën e paligjshme të sendeve që duhet të hyjnë, kalojnë ose dalin nga territori i shtetit dhe mënyrat në të cilat do të kryhet kontrolli ose mbikëqyrja e tyre.

5. Kur është rasti, urdhrin të prokurorit i bashkëlidhet akti që autorizon zëvendësimin e plotë ose të pjesshëm të sendeve të paligjshme dhe vendin ku vendosen kampionet e marra.

6. Dorëzimi i kontrolluar ekzekutohet nga policia gjyqësore, nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e prokurorit.

Neni 295

Identifikimi i personit ndaj të cilit zhvillohen hetime dhe i personave të tjerë

(Ndryshuar titullit, pika 1 numërohet pika 2, pika 2 numërohet pika 4, pika 3 numërohet pika 5 e shtuar fjalë dhe shtuar pika 1 dhe 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Policia gjyqësore identifikon personin ndaj të cilit zhvillohen hetime dhe personat që mund të referojnë të dhëna të dobishme për rindërtimin e faktit.

2. Për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet policia gjyqësore kryen të gjitha veprimet e nevojshme, duke përfshirë edhe rilevimet daktiloskopike, fotografike dhe antropometrike.

3. Kur identifikimi përfshin marrjen e kampionëve biologjikë, policia gjyqësore procedon sipas nenit 201/a të këtij Kodi.

4. Kur ai refuzon të identifikohet ose jep gjeneralitete apo dokumente identifikimi që dyshohet se janë të rreme, policia gjyqësore e shoqëron në zyrat e saj dhe e mban atje për aq kohë sa është e domosdoshme për identifikimin, por jo më tepër se dymbëdhjetë orë.

5. Për shoqërimin dhe lirimimin ose për çdo veprim të kryer sipas këtij neni vihet menjëherë në dijeni prokurori.

Neni 296

Të dhëna mbi personin ndaj të cilit zhvillohen hetimet

(Shtuar fjalë në pikën 1, ndryshuar dhe shtuar fjalë në pikën 2 dhe ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Oficerët e policisë gjyqësore marrin të dhëna nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet në praninë e detyrueshme të mbrojtësit të tij, me përjashtim të rasteve të personit të arrestuar në flagrancë ose të ndaluar, të cilët merren në pyetje sipas rregullave të nenit 256. Kur mbrojtësi nuk është gjetur ose nuk është paraqitur, policia gjyqësore kërkon nga prokurori që të caktojë një mbrojtës tjetër. Në çdo rast përpara se të procedohet me marrjen në pyetje atij i jepet letra e të drejtave. Zbatohen rregullat e neneve 34/a dhe 38 të këtij Kodi.

2. Në vendin e ngjarjes ose menjëherë pas konstatimit të faktit oficerët e policisë gjyqësore, edhe pa praninë e mbrojtësit, mund të marrin nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, qoftë edhe i arrestuar në flagrancë ose i ndaluar, të dhëna të nevojshme për vazhdimin e hetimeve. Të dhënat e marra nuk dokumentohen dhe ndalohej përdorimi i tyre si provë.

3. Kur personi ndaj të cilit zhvillohen hetime paraqitet vetë dhe kërkon të japë deklaramë, policia gjyqësore procedon me marrjen tyre. Nuk lejohet përdorimi i tyre në gjykim, me përjashtim të rastit kur kundërshtohet përmbajtja e deklaramit të bërë para gjykatës.

Neni 297

Marrja e të dhënave të tjera

(Shtuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Policia gjyqësore merr të dhëna nga personat që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit.

2. Zbatohen dispozitat e neneve 155 deri 160.

3. Nëse të dhënat duhet të merren nga një i mitur, duhet të sigurohet prania e prindit ose kujdestarit, ose e një personi të rritur, të zgjedhur nga i mituri, si dhe prania e psikologut.

Neni 298

Kontrollimet

(Shtuar pika 3 dhe pika 3 numërohet pika 4 e ndryshuar fjalë me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Në rast flagrante ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të lokalit kur kanë arsye të bazuara të mendojnë se mbi personin gjenden të fshehura sende ose gjurmë të veprës penale që mund të zhduken a të humbasin ose që këto sende a gjurmë ndodhen në një vend të caktuar ose atje ku gjendet personi nën hetim ose i ikur.

2. Kur duhet të kryhet një ndalim, të ekzekutohet një vendim arresti ose një vendim dënimi me burgim, oficerët e policisë gjyqësore mund të bëjnë kontrollin e personit ose të lokalit, kur ekzistojnë kushtet e treguara në paragrafin 1 dhe ka arsye të veçanta urgjence që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontrolli. Kur vonesa mund të dëmtojë përfundimin e suksesshëm të hetimeve, kontrolli i banesës mund të bëhet edhe jashtë kohës së parashikuar në nenin 206.

3. Në rastet e flagrancës apo ndjekjes së personit në ikje ose kur duhet të kryhet një ndalim ose të ekzekutohet një vendim arresti ose një vendim dënimi me burgim, policia gjyqësore merr të gjitha masat teknike, me qëllim sigurimin dhe ruajtjen e të dhënave origjinale kompjuterike dhe mbrojtjen e tyre nga humbja, dëmtimi dhe tjetërsimi, si dhe kryen kontrollimet e mëtejshme të të dhënave kompjuterike, kur ka shkaqe të arsyeshme se ato përmbajnë informacion, programe apo gjurmë të veprës penale.

4. Procesverbali i veprimeve të kryera i dërgohet menjëherë, por jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është bërë kontrolli, i cili brenda dyzet e tetë orëve vijuese procedon sipas nenit 301 të këtij Kodi.

Neni 299

Marrja e plikove dhe e korrespondencës

1. Kur është e nevojshme për qëllimet e procedimit që të merren pliko të vulosura ose të mbyllura me ndonjë mënyrë tjetër, oficeri i policisë gjyqësore ia dërgon ato prokurorit të paprekura për sekuestro eventuale. Në qoftë se ka shkaqe të bazuara për të menduar se plikot përmbajnë të dhëna që mund të humbasin për shkak të vonesës, oficeri i policisë gjyqësore informon me mjetin më të shpejtë prokurorin, i cili mund të autorizojë hapjen e menjëhershme.

2. Për letrat, zarfet, pakot, vlerat monetare e pasurore, telegramet ose mjetet e tjera të korrespondencës, për të cilat lejohet sekuestroja, oficerët e policisë gjyqësore, në raste të ngutshme, urdhërojnë atë që kryen shërbimin postar të pezullojë dërgimin. Në qoftë se brenda dyzet e tetë orëve nga urdhri i policisë gjyqësore prokurori nuk vendos sekuestron, objektet e korrespondencës dërgohen në destinacion.

Neni 299/a

Ruajtja e përshpejtuar dhe mirëmbajtja e të dhënave kompjuterike

(Shtuar me ligjin nr. 10 054, datë 29.12.2008)

1. Prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e përshpejtuar të të dhënave kompjuterike të caktuara, duke përfshirë të dhënat e trafikut, kur ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se të dhënat mund të humbasin, dëmtohen ose ndryshohen.

2. Në rastin kur të dhënat kompjuterike janë në zotërim ose në kontroll të një personi, prokurori mund ta urdhërojë këtë person t'i ruajë dhe t'i mirëmbajë këto të dhëna kompjuterike, për një periudhë deri në 90 ditë, me qëllim zbulimin dhe nxjerrjen e tyre. Ky afat, për shkaqe të arsyeshme, mund të zgjatet vetëm një herë.

3. Personi i ngarkuar për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave kompjuterike detyrohet të mbajë sekret procedurat dhe veprimet e kryera, sipas pikës 2 të këtij neni, deri në përfundim të hetimeve.

Neni 299/b

Ruajtja e përshpejtuar dhe zbulimi i pjeshëm i të dhënave kompjuterike

(Shtuar me ligjin nr. 10 054, datë 29.12.2008)

Personi i ngarkuar me ruajtjen e përshpejtuar të të dhënave të trafikut detyrohet të marrë të gjitha masat e nevojshme, për të garantuar se të dhënat e ruajtura janë të vlefshme, pavarësisht nëse një apo më tepër dhënës shërbimesh kanë qenë të përfshirë në transmetimin e komunikimit, si dhe t'i sigurojë prokurorisë ose oficerit të policisë gjyqësore, të autorizuar, zbulimin e një sasive të mjaftueshme të të dhënave të trafikut, në mënyrë që të mundësohet identifikimi i dhënësit të shërbimit dhe shtegu, nëpërmjet të cilit komunikimi është transmetuar.

Neni 300

Verifikimet e ngutshme në vend

1. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen e të ruhen dhe që gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve të mos ndryshojnë para ndërhyrjes së prokurorit, kur ai ka njoftuar se do të marrë pjesë.

2. Kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë veprimet hetimore të domosdoshme dhe, kur është rasti, sekuestrojnë provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale.

Neni 301

Vleftësimi i sekuestros

*(Ndryshuar fjalia e dytë në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017,
datë 30.3.2017)*

1. Kur vë sekuestron, sipas nenit 300, policia gjyqësore shënon në procesverbal shkaku dhe i dorëzon një kopje të aktit personit, të

cilit i janë sekuestruar sendet. Procesverbali i dërgohet pa vonesë dhe sidoqoftë jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestroja.

2. Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 72 orë, të pandehurit, mbrojtësit dhe personit të cilit i janë sekuestruar sendet. Kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t'i kthehen ato. Ankimi nuk pezullon zbatimin e sekuestros.

Neni 302

Ndihma e mbrojtësit

1. Mbrojtësi i personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet ka të drejtë të asistojë, pa pasur të drejtën që të lajmërohet që më parë, në kontrollimet dhe verifikimet e ngutshme në vend, përveç rasteve të hapjes së menjëhershme të plikos të autorizuar nga prokurori.

Neni 303

Dokumentimi i veprimeve të policisë gjyqësore

1. Policia gjyqësore dokumenton, qoftë edhe në formë të përmbledhur, të gjitha veprimet e kryera.

2. Policia gjyqësore mban procesverbal për:

a) kallëzimet dhe ankimet e paraqitura me gojë;

b) të dhënat përmbledhëse dhe deklaratimet e marra nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet;

c) të dhënat e marra nga personat që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit;

ç) këqyrjet, njohjet, kontrollimet dhe sekuestrimet;

d) aktet për identifikimin dhe njohjen e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, për marrjen e plikove ose të korrespondencës dhe për vënien e sekuestros;

e) veprimet hetimore të deleguara nga prokurori.

3. Dokumentacioni i veprimeve të policisë gjyqësore, provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale vihen në dispozicion të prokurorit.

KREU V VEPRIMTARIA E PROKURORIT

Neni 304

Veprimtaria hetimore e prokurorit

(Shtuar fjalia e dytë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Prokurori drejton veprimtarinë hetimore dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm. Ai kryen hetime edhe për verifikimin e fakteve ose rrethanave në favor të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime.

2. Ai mund të kërkojë nga policia gjyqësore kryerjen e veprimeve të deleguara posaçërisht, përfshirë edhe marrjen në pyetje të të pandehurit dhe ballafaqimet, në të cilat merr pjesë i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Në këtë rast policia gjyqësore respekton dispozitat për caktimin dhe pjesëmarrjen e mbrojtësit në veprimet hetimore.

3. Për veprime të veçanta që duhen kryer në një rreth tjetër, kur nuk mendon të procedojë personalisht, mund të delegojë, sipas kompetencës lëndore përkatëse, prokurorin e atij rrethi. Kur ka arsye të ngutshme ose shkaqe të rëndësishme, prokurori i deleguar ka të drejtë të kryejë me iniciativën e tij çdo veprim të domosdoshëm për qëllimet e hetimit.

Neni 305

Marrja përsipër e hetimeve

(Shfuqizuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Neni 306

Marrëdhëniet ndërmjet prokurorive të ndryshme

1. Prokuroritë që procedojnë në hetime të lidhura bashkërendojnë punën midis tyre. Për këtë qëllim shkëmbejnë akte dhe informacione si dhe njoftime për udhëzimet që i jepen policisë gjyqësore. Ato mund të procedojnë edhe bashkërisht në kryerjen e veprimeve të veçanta.

2. Hetimet e dy prokurorive të ndryshme quhen të lidhura:

- a) në rastet e bashkimit të procedimeve ose kur është fjala për vepra penale të kryera nga disa persona në dëm të njëri-tjetrit;
- b) kur prova e një vepre penale ose e ndonjë rrethane të saj ndikon mbi provën e një vepre penale tjetër ose të një rrethane tjetër;
- c) kur prova e disa veprave penale rrjedh, edhe pjesërisht, nga i njëjti burim.

Neni 307

Paraqitja vetë për të bërë deklarime

(Shtuar pika 3 dhe pika 3 ekzistuese numërohet pika 4, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Ai që ka marrë dijëni se ndaj tij zhvillohen hetime, ka të drejtë të paraqitet te prokurori dhe të bëjë deklarime.

2. Kur ai që paraqet vetë e kundërshton faktin për të cilin procedohet dhe lejohet të parashtrijë shfajësimet e tij, veprimi i kryer barazohet me marrjen në pyetje.

3. Zbatohen parashikimet e neneve 34/a dhe 38 të këtij Kodi.

4. Paraqitja vetë nuk pengon zbatimin e masave të sigurimit.

Neni 308

Ftesa për paraqitje

(Shtuar shkronja “d” dhe ndryshuar fjalë në pikën 4, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Prokurori fton personin ndaj të cilit zhvillohen hetime të paraqitet kur do ta marrë në pyetje ose kur duhet të kryejë veprime që kërkojnë praninë e tij.

2. Ftesa për t’u paraqitur përmban:

a) gjeneralitetet ose të dhëna të tjera personale që vlejné për identifikim;

b) ditën, orën dhe vendin e paraqitjes;

c) llojin e veprimit për të cilin është ftuar;

ç) paralajmërimin se prokurori mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm në rast mosparaqitje, pa pasur pengesë të ligjshme.

d) letrën e të drejtave në formë të shkruar, sipas nenit 34/a të këtij Kodi.

3. Ftesa përmban edhe parashtrimin e përmbledhur të faktit që rezulton nga hetimet e bëra deri në atë çast.

4. Ftesa njoftohet të paktën tri ditë para asaj që është caktuar për paraqitje, me përjashtim të rasteve të ngutshme.

Neni 309

Caktimi dhe ndihma e mbrojtësit

(Shtuar fjalë dhe shënja e pikësimit “,” në pikën 1 dhe fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. I pandehuri që nuk ka mbrojtës njoftohet nga prokurori se ndihmohet nga një mbrojtës i caktuar kryesisht, sipas rasteve të parashikuara nga ky Kod.

2. Mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar kryesisht lajmërohet të paktën njëzet e katër orë përpara kur procedohet me marrje në pyetje, këqyrje ose ballafaqim. Kur vonesa mund të dëmtojë hetimet lajmërimi i mbrojtësit bëhet urgjentisht.

3. Procesverbalet e veprimeve të kryera nga prokurori dhe nga policia gjyqësore, në të cilat mbrojtësi ka të drejtë të asistojë, depozitohen në sekretarinë e prokurorisë brenda tri ditëve nga kryerja e veprimit, me të drejtën për mbrojtësin që t'i shqyrtojë dhe të nxjerrë kopje.

Neni 310

Njoftimi i të pandehurit për të marrë pjesë në kontrollime e sekuestrime

(Shtuar paragrafi 2 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

1. Prokurori, kur do të kryejë kontroll ose sekuestrim njofton të pandehurin që të jetë i pranishëm së bashku me mbrojtësin e zgjedhur dhe, kur nuk e ka këtë, cakton një mbrojtës kryesisht.

2. Kur i pandehuri dhe mbrojtësi i tij janë njoftuar rregullisht, por nuk janë të pranishëm pa shkak të arsyeshëm, caktohet një mbrojtës kryesisht. Kjo gjendje pasqyrohet në procesverbalin përkatës.

Neni 311

Marrja në pyetje e personit të pandehur në një procedim të lidhur

1. Personi i marrë si i pandehur në një procedim të lidhur merret në pyetje nga prokurori në format e parashikuara nga neni 167.

Neni 312

Marrja e të dhënave

(Shtuar pika 4 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Prokurori merr të dhëna nga personi i dëmtuar dhe nga ata që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit, duke zbatuar rregullat e caktuara për marrjen e dëshmisë.

2. Thirrja e këtyre personave bëhet me urdhër, i cili përmban:
- a) gjeneralitetet e personit;

- b) ditën, orën dhe vendin e paraqitjes;
- c) paralajmërimin se prokurori mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm në rast mosparaqitje pa patur pengesë të ligjshme.

3. Prokurori urdhëron në të njëjtën mënyrë edhe për thirrjen e përkthyesit dhe ekspertit.

4. Thirrja bëhet të paktën tre ditë përpara ditës së paraqitjes, me përjashtim të rasteve të ngutshme.

Neni 313

Njohja e personave dhe e sendeve

1. Kur është e nevojshme, prokurori procedon në njohjen e personave, të sendeve ose të çdo gjëje tjetër që mund të jetë objekt i perceptimit shqisor.

2. Personat, sendet dhe objektet e tjera i paraqiten ose i tregohen me figurë atij që duhet të bëjë njohjen.

3. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se personi i thirrur për të bërë njohjen mund të ketë druajtje ose ndikim tjetër nga prania e atij që duhet të njihet, prokurori merr masa që veprimi të kryhet pa u parë nga ai që duhet të njihet.

Neni 314

Caktimi i ekspertit

(Ndryshuar fjalë në fjalinë e parë dhe të dytë të pikës 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Prokurori, kur procedon në veprime, për të cilat kërkohen njohuri teknike, mund të caktojë ekspert, sipas parashikimeve të nenit 179 të këtij Kodi. Eksperti nuk mund të refuzojë detyrën pa shkaqe të ligjshme.

2. Eksperti mund të autorizohet nga prokurori që të asistojë në veprime të veçanta hetimore.

3. Kur verifikimet teknike kanë të bëjnë me persona, sende ose vende, gjendja e të cilëve është ndryshuar, prokurori lajmëron të

pandehurin dhe mbrojtësin, viktimën dhe përfaqësuesin e tij për ditën, orën dhe vendin ku do të kryhet veprimi.

Neni 315

Dokumentimi i veprimeve të prokurorit

1. Prokurori mban procesverbal:
 - a) për kallëzimet dhe ankesat e paraqitura me gojë;
 - b) për këqyrjet, kontrollimet dhe sequestrimet;
 - c) për marrjen në pyetje dhe ballafaqimet me të pandehurin;
 - ç) për të dhënat e marra nga personat që tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit;
 - d) për verifikimet që kanë të bëjnë me persona, sende ose vende, gjendja e të cilëve është ndryshuar.
2. Veprimet dokumentohen gjatë kryerjes së tyre ose menjëherë më pas, kur ekzistojnë rrethana të pakapërcyeshme që pengojnë dokumentimin aty për aty.
3. Akti që përmban marrjen në dijeni për veprën penale dhe dokumentacioni që lidhet me hetimet, si urdhrat e porosinë për policinë gjyqësore, kërkesat drejtuar gjykatës, njoftimet etj. ruhen në një fashikull të posaçëm në sekretarinë e prokurorisë së bashku me aktet e ardhura nga policia gjyqësore.

KREU VI

SIGURIMI I PROVËS

Neni 316

Rastet e sigurimit të provës

1. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori dhe i pandehuri mund të kërkojnë nga gjykata që të procedohet me sigurimin e provës në këto raste:
 - a) në marrjen e dëshmisë së një personi, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ai nuk mund të pyetet në shqyrtimin gjyqësor për shkak sëmundjeje ose pengesë tjetër serioze;

b) në marrjen e dëshmisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se personi mund të jetë objekt dhune, kanosje ose premtimi për t'i dhënë para ose përfitime të tjera me qëllim që të mos bëjë dëshmi ose të bëjë dëshmi të gënjeshtërt;

c) në pyetjen e të pandehurit për faktet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e të tjerëve, kur ekziston një nga rrethanat e parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b";

ç) në ballafaqimin ndërmjet personave që para prokurorit kanë bërë deklarime kundërtë, kur ekziston një nga rrethanat e parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b";

d) për një ekspertim apo eksperiment gjyqësor, kur prova ka të bëjë me një person, një send a një vend, gjendja e të cilëve mund të pësojë ndryshime të pashmangshme. Ekspertimi mund të kërkohet edhe kur është rasti që po të bëhet gjatë shqyrtimit gjyqësor do të sillte një pezullim të gjykimit mbi gjashtëdhjetë ditë;

dh) në një paraqitje për njohje, kur për arsye të veçanta nuk mund të shtyhet veprimi deri në shqyrtimin gjyqësor.

Neni 317

Kërkesa për sigurimin e provës

(Shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kërkesa për sigurimin e provës paraqitet brenda afateve për përfundimin e hetimeve ose në fillim të seancës paraprake dhe përmban:

a) provën që duhet marrë dhe rëndësinë e saj për vendimin gjyqësor;

b) personat ndaj të cilëve procedohet për faktet objekt prove;

c) rrethanat që nuk lejojnë që marrja e provës të shtyhet për në shqyrtimin gjyqësor.

2. Kërkesa e bërë nga prokurori tregon edhe mbrojtësit e personave të interesuar në bazë të paragrafit 1, shkronja "b", personin e dëmtuar dhe mbrojtësin e tij.

3. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 respektohen me pasojë mospranimi.

4. Prokurori mund të vendosë zgjatjen e hetimeve paraprake për qëllimet e sigurimit të provës.

Neni 318

Kërkesa e personit të dëmtuar

1. Personi viktimë mund t'i drejtohet prokurorit që ai të kërkojë sigurimin e provës.

2. Kur nuk e pranon kërkesën, prokurori merr vendim të arsyetuar dhe vë në dijeni personin viktimë, i cili mund të bëjë ankim në gjykatë.

3. Viktima akuzuese mund t'i kërkojë gjykatës që të procedojë në sigurimin e provës para fillimit të gjykimit.

Neni 319

Paraqitja e kërkesës

(Shtuar fjalë në pikën 2 dhe ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kërkesa për sigurimin e provës depozitohet në sekretarinë e gjykatës bashkë me sendet e dokumentet e mundshme. Ajo u njoftohet palëve dhe personave të interesuar nga ai që e ka bërë.

2. Brenda dy ditëve nga njoftimi i kërkesës, prokurori dhe i pandehuri mund të paraqesin argumente lidhur me bazueshmërinë e kërkesës, të depozitojnë sende dhe dokumente, si dhe të tregojnë fakte të tjera që duhet të përbëjnë objekt prove dhe persona të tjerë të interesuar, sipas shkronjës “b”, të paragrafit 1, të nenit 317, të këtij Kodi.

3. Prokurori mund të kërkojë nga gjykata shtyrjen e afatit për sigurimin e provës së kërkuar nga i pandehuri, kur marrja e saj do të dëmtonte hetimet. Gjykata vendos mbi kërkesën pasi dëgjon të pandehurin dhe mbrojtësin e tij. Shtyrja e afatit nuk pranohet kur nga kjo mund të rrezikohet marrja e provës.

Disponimi mbi kërkesën për sigurimin e provës

(Shtuar një paragraf pas pikës 1 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; shtuar një fjali në pikën 1 dhe ndryshuar shkronja "a" në pikën 2 dhe pika 2/1, shfuqizuar shkronja "b" në pikën 2 dhe ndryshuar fjale në pikën 4, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Brenda dy ditëve nga ardhja e përgjigjes për marrjen e njoftimit për kërkesën për sigurimin e provës, gjykata merr vendim, me të cilin pranon ose rrëzon kërkesën për sigurimin e provës.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit brenda 5 ditëve. Gjykata e apelit e shqyrton ankesën brenda 10 ditëve nga dorëzimi i akteve në këtë gjykatë. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

2. Me vendimin që pranon kërkesën gjykata cakton:

a) objektin e provës dhe personat e interesuar për marrjen e saj, sipas parashikimeve të nenit 319 të këtij Kodi;

b) Shfuqizuar.

c) datën e seancës, e cila nuk mund të kalojë një afat më të gjatë se dhjetë ditë nga data e dhënies së vendimit.

2/1. Gjykata njofton prokurorin, të pandehurin, viktimën dhe mbrojtësit të paktën dy ditë para datës së seancës dhe i njeh ata me të drejtën për të shqyrtuar dhe marrë kopje të deklarimeve që do të sigurohen.

3. Kur i pandehuri, prania e të cilit është e domosdoshme për sigurimin e provës, nuk paraqitet pa një shkak të ligjshëm, gjykata urdhëron shoqërimin e tij të detyrueshëm.

4. Kur ekzistojnë arsye të ngutshme dhe sigurimi i provës nuk mund të kryhet në rrethin e gjykatës kompetente, kjo e fundit mund të delegojë gjykatën e vendit ku duhet të merret prova.

Neni 321

Marrja e provës

(Ndryshuar pika 3 dhe ndryshuar fjalë në pikën 4 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Seanca për marrjen e provës zhvillohet me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe të mbrojtësit të të pandehurit. Ka të drejtë të marrë pjesë edhe përfaqësuesi i viktimës.

2. I pandehuri dhe viktimja kanë të drejtë të marrin pjesë kur duhet të pyetet një dëshmitar ose një person tjetër. Në rastet e tjera ata mund të marrin pjesë me autorizim paraprak të gjykatës.

3. Provat merren sipas rregullave të caktuara për shqyrtimin gjyqësor, nga e njëjta gjykatë që do të gjykojë çështjen. Përveç rasteve të parashikuara nga neni 321/1, ndalohe marrja e provave mbi faktet që kanë të bëjnë me persona që nuk përfaqësohen nga mbrojtësit në seancë.

4. Procesverbali, sendet dhe dokumentet e marra për sigurimin e provës i dërgohen prokurorit. Mbrojtësit kanë të drejtë t'i shqyrtojnë ato dhe të nxjerrin kopje të tyre.

Neni 321/1

Shtrirja e sigurimit të provës

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Kur prokurori ose mbrojtësi i të pandehurit kërkon që marrja e provës të shtrihet mbi fakte që kanë të bëjnë me persona që nuk përfaqësohen nga mbrojtësit në seancë, kur janë kushtet, gjykata kryen njoftimet dhe e shtyn seancën për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më shumë se tri ditë. Kërkesa nuk pranohet nëse shtyrja e seancës do të dëmtonte marrjen e provës.

Neni 322

Përdorimi i provave të marra

(Shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Provat e marra sipas rregullave të këtij kreu mund të përdoren në shqyrtimin gjyqësor vetëm ndaj të pandehurve, mbrojtësit e të cilëve kanë asistuar në marrjen e tyre.

2. Vendimi i dhënë mbi bazën e një prove të marrë sipas rregullave të këtij kreu, në të cilin viktimat nuk ka qenë në gjendje të marrë pjesë, nuk sjell pasoja në gjykimin civil ose administrativ përveçse kur vetë viktimat ka pranuar qoftë edhe në heshtje.

KREU VII

AFATET E PËRFUNDIMIT TË HETIMEVE

Neni 323

Afati i hetimeve paraprake

(Ndryshuar pika 1 dhe 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Brenda përfundimit të afatit ligjor të hetimeve, prokurori vendos sipas paragrafit 6, të nenit 327, të këtij Kodi.

2. Afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, dhe gjashtë muaj për veprat penale të parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 75/a, të këtij Kodi.

Neni 324

Zgjatja e afatit

(Shtuar një paragraf në pikën 2 me ligjin nr.8460, datë 11.2.1999; shtuar fjali në pikën 1, ndryshuar fjalia e dytë në pikën 2 dhe pika 4, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj. Në rastin e Prokurorisë së Posaçme ky afat është deri në gjashtë muaj.

2. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Tej afatit 2-vjeçar, për raste të akuzave për krim të organizuar dhe për krime që gjykohen me trup gjykues, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cenuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit.

Tej afatit 2-vjeçar, në raste të jashtëzakonshme, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cenuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit.

3. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe viktimës.

4. Provat e marra pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren.

Neni 325

Ankimi për zgjatjen e afatit të hetimeve

(Ndryshuar fjalë në pikën 2, ndryshuar pika 3 dhe shtuar pika 3/1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. I pandehuri dhe viktimat kanë të drejtë, brenda dhjetë ditëve nga njoftimi, të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit kundër vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve.

2. Ankimi shqyrtohet nga gjykata brenda dhjetë ditëve, duke u dëgjuar i pandehuri, mbrojtësi, viktimat dhe prokurori.

3. Kur ankimi pranohet dhe hetimet nuk duhet të vazhdojnë, gjykata urdhëron prokurorin që t'i përfundojë ato brenda një afati jo më të gjatë se 15 ditë.

3/1. Kur ankimi pranohet, por hetimet duhet të vazhdojnë, gjykata urdhëron prokurorin t'i përfundojë ato brenda një afati të caktuar prej saj. Provat e marra brenda këtij afati janë të përdorshme.

4. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim, i cili nuk pezullon zbatimin e tij.

Neni 326

Pezullimi i hetimeve

*(Ndryshuar pika 3 dhe shtuar pikat 4 dhe 5 me ligjin nr. 35/2017,
datë 30.3.2017)*

1. Kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm, prokurori vendos pezullimin e hetimeve.

2. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme.

3. Vendimi i arsyetuar i njoftohet viktimës ose personit që ka bërë kallëzimin, të cilët mund të bëjnë ankim brenda 10 ditëve nga marrja dijani para gjyqtarit të seancës paraprake. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve. Kundër vendimit nuk lejohet ankim.

4. Kur ankimi pranohet, gjykata vendos rifillimin e hetimeve.

5. Përveç rastit të parashikuar në paragrafin 4, të këtij neni, hetimi i pezulluar rifillon me vendim të prokurorit.

KREU VIII

PËRFUNDIMI I HETIMEVE

Neni 327

Veprimet e policisë gjyqësore dhe të prokurorit

*(Ndryshuar pika 2 dhe shtuar pika 3, 4, 5 dhe 6, me ligjin nr. 35/2017,
datë 30.3.2017)*

1. Pasi kryen veprimet e nevojshme hetimore, policia gjyqësore i dërgon aktet prokurorit bashkë me një relacion shpjegues për faktin dhe provat, si dhe me sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të hetimeve.

2. Brenda afatit të parashikuar nga neni 324, i këtij Kodi, prokurori njofton mbi përfundimin e hetimeve paraprake të pandehurin, mbrojtësin e tij, si dhe viktimën ose trashëgimtarët e saj,

kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit.

3. Njoftimi përmban përshkrimin e përmbledhur të faktit penal për të cilin procedohet, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin juridik, lajmërimin për depozitimin e akteve në sekretari dhe të drejtën për t'u njohur me aktet dhe për të marrë kopje.

4. I pandehuri njoftohet gjithashtu, se ka të drejtë që brenda dhjetë ditëve të paraqesë memorie e dokumente, t'i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, të bëjë deklaratime apo të kërkojë që të merret në pyetje. Kur i pandehuri kërkon të pyetet, prokurori është i detyruar të procedojë me pyetjen e tij.

5. Kur prokurori pranon kërkesën e të pandehurit për të kryer hetime shtesë, ato duhet të përfundojnë brenda tridhjetë ditëve nga paraqitja e kërkesës. Ky afat mund të zgjatet vetëm një herë dhe jo më shumë se dy muaj dhe në çdo rast pa kaluar afatin tërësor të hetimit. Kur nuk e pranon kërkesën e të pandehurit, prokurori merr vendim të arsyetuar, sipas paragrafit 2, të nenit 110, të këtij Kodi.

6. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori procedon si më poshtë:

a) vendos pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, ose i kërkon gjykatës pushimin e akuzës apo çështjes, në rastet e parashikuara nga neni 329/a i Kodit;

b) i kërkon gjykatës dërgimin e çështjes në gjyq, kur nuk procedon sipas neneve 400, 406/a dhe 406/dh të këtij Kodi.

Neni 328

Pushimi i akuzës ose çështjes

(Shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 8460, datë 11.2.1999; ndryshuar titulli dhe pika 1 e shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:

a) del qartë se fakti nuk ekziston;

- b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;
- c) viktimi nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij;
- ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet;
- d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë;
- dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai;
- e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale;
- ë) i pandehuri vdes;
- f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj.

2. Prokurori, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të pushimit, njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, duke u bërë të ditur të drejtën për t'u njohur me aktet, për të marrë kopje të tyre dhe për të paraqitur ankim në gjykatë.

Neni 329

Ankimi kundër vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes

(Shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 8460, datë 11.2.1999, neni 5; shfuqizuar fjali në pikën 1 me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 6.3.2009; ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kundër vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga marrja dijeni para gjyqtarit të seancës paraprake. Në rastet kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, por për njëjërën ose disa nga akuzat ka vendosur pushimin, ankimi ndaj vendimit të pushimit shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq.

2. Në sekretarinë e gjykatës depozitohen kopje të akteve dhe provave që përmban fashikulli i hetimeve paraprake, duke përfshirë

edhe vendimet e marra nga gjyqtari i hetimeve paraprake, si dhe provat materiale, përveç rastit kur ato ruhen në vend tjetër.

3. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve. Gjykata vendos sipas rastit:

a) lënien në fuqi të vendimit të pushimit, kur çmon se janë kushtet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi;

b) kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, kur çmon se ato janë të paplota, duke përcaktuar drejtimit e thellimit të tyre dhe, kur është rasti, edhe veprimet që duhet të kryhen, si dhe cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë;

c) kthimin e akteve prokurorit, duke e urdhëruar që të formulojë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes, kur çmon se hetimet janë të plota dhe rezulton se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjyq.

4. Gjykata nuk mund të urdhërojë prokurorin që të formulojë akuzë për persona të tjerë, emri i të cilëve nuk është regjistruar sipas nenit 287 të këtij Kodi. Kur nga aktet rezultojnë të dhëna për vepra penale të tjera, që ndiqen kryesisht ose në ngarkim të personave të tjerë, gjykata mund të kërkojë që të kryhen hetime, edhe në rastet kur vendos sipas shkronjës “c”, të paragrafit 3, të këtij neni.

5. Në rastet e parashikuara nga paragrafi 3, shkronjat “b” dhe “c”, dhe paragrafi 4, të këtij neni, vendimi i njoftohet edhe drejtuesit të prokurorisë.

6. Kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake sipas shkronjës a) të paragrafit 3 të këtij neni, mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit i pandehuri dhe viktima, ndërsa sipas shkronjave “b” dhe “c” të paragrafit 3, të këtij neni, mund të bëjë ankim prokurori.

7. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 15 ditëve nga data e marrjes së akteve.

8. Kur pranon ankimin e të pandehurit, gjykata e apelit vendos ndryshimin e vendimit të pushimit me formulimin më të favorshëm për të. Kur pranon ankimin e viktimës, gjykata urdhëron vazhdimin e hetimeve ose dërgimin e çështjes në gjyq. Kur pranon ankimin e prokurorit, gjykata vendos lënien në fuqi të vendimit të pushimit.

Neni 329/a

Kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes.

2. Në rastet kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq.

3. Kërkesës së prokurorit i bashkëlidhen aktet dhe provat që përmban fashikulli i hetimeve, duke përfshirë edhe aktet e kryera para gjyqtarit të hetimeve paraprake, si dhe provat materiale, përveç rastit kur ato ruhen në vend tjetër.

4. Kërkesa i njoftohet të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim. Ata kanë të drejtë të njihen me aktet dhe provat, si dhe të marrin kopje të tyre.

Neni 329/b

Shqyrtimi i kërkesës

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Brenda pesë ditëve nga depozitimi i kërkesës, gjykata njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, për datën dhe orën e gjykimit.

2. Kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve. Kur pala nuk paraqitet, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet, pa parashtruar shkaqe të arsyeshme, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj.

3. Kur janë kushtet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, gjykata vendos pushimin e akuzës ose çështjes. Në rast të kundërt, gjykata vendos sipas parashikimeve të shkronjës “b” ose “c”, të paragrafit 3, të nenit 329, të këtij Kodi.

4. Kur gjykata vendos sipas shkronjës “b”, të paragrafit 3, të nenit 329, të këtij Kodi, i cakton prokurorit një afat për kryerjen e hetimeve.

5. Kur është rasti, zbatohen rregullat e parashikuara nga paragrafi 4, i nenit 329, të këtij Kodi.

6. Kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit. Zbatohen për aq sa janë të pajtueshme rregullat e përcaktuara në nenin 329 të këtij Kodi.

Neni 329/c

Revokimi i vendimit të pushimit

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur pas vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar, ai mund të revokohet nga gjyqtari i seancës paraprake me kërkesë të prokurorit, të viktimës ose trashëgimtarëve të saj. Kërkesa, së bashku me aktet dhe provat e reja, depozitohet në sekretarinë e gjykatës.

2. Kërkesa shoqërohet me provat e reja me pasojë mospranimi.

3. Kërkesa shqyrtohet në dhomë këshillimi. Kur vendos pranimin e kërkesës, gjykata revokon vendimin e pushimit dhe i kthen aktet prokurorit, i cili rifillon hetimet.

4. Në përfundim të hetimeve, kur nuk procedon sipas neneve 328, 329/a, 406/a ose 406/dh, të këtij Kodi, prokurori paraqet në gjykatë kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq.

Neni 329/ç

Ankimi ndaj vendimit

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Kundër vendimit të mospranimit ose të rrëzimit të kërkesës për revokimin e vendimit të pushimit, prokurori, viktima ose trashëgimtarët e saj, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit, e cila shqyrton ankimin në dhomë këshillimi.

Neni 330

Detyrimi i ankuesit me shpenzimet dhe dëmet

1. Kur pushimi i çështjes bëhet për shkak se fakti nuk ekziston, personi i dëmtuar, me ankimin e të cilit ka filluar procedimi, ngarkohet me pagimin e shpenzimeve të procedimit të bëra nga shteti.

2. Ankuesi ngarkohet edhe me shpenzimet e bëra nga i pandehuri dhe i padituri civil, kur ata i kërkojnë këto, si dhe me shpërblimin e dëmit.

3. Kur çështja është pushuar për shkak të tërheqjes së ankimit, shpenzimet i ngarkohen ankuesit, përveç rastit që në aktin e tërheqjes është parashikuar me marrëveshje që ato të jenë tërësisht ose pjesërisht në ngarkim të atij kundër të cilit është bërë ankimi.

4. Shpenzimet dhe dëmet caktohen nga prokurori. Kundër vendimit të tij mund të bëjnë ankim në gjykatë, viktima, i pandehuri dhe i padituri civil.

Neni 331

Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur nuk procedon sipas neneve 328, 329/a, 400, 406/a ose 406/dh të Kodit, prokurori kërkon dërgimin e çështjes në gjyq.

2. Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq është e pavlefshme kur nuk respektohen përcaktimet e paragrafëve 2, 3 dhe 4, të nenit 327, të këtij Kodi.

3. Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq përmban:
- a) gjenealogjetet e të pandehurit dhe të viktimës, kur është e mundur, si dhe çdo element tjetër që shërben për identifikimin e tyre;
 - b) parashtrimin e faktit penal dhe cilësimin juridik të veprës penale;
 - c) burimet e provës dhe faktet që ato u referohen;
 - ç) kërkimin që gjyqtari i seancës paraprake të vendosë dërgimin e çështjes në gjyq;
 - d) datën dhe nënshkrimin e prokurorit.
4. Kërkesës së prokurorit i bashkëlidhen aktet dhe provat që përmban fashikulli i hetimeve, duke përfshirë edhe aktet e kryera para gjyqtarit të hetimeve paraprake, si dhe provat materiale, përveç rastit kur ato ruhen në vend tjetër.

KREU IX SEANCA PARAPRAKE

(Shtuar kreu me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Ne
ni 332

Caktimi i seancës paraprake

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Brenda pesë ditëve nga depozitimi i kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, gjyqtari i seancës paraprake cakton datën e zhvillimit të saj. Në rastet kur i pandehuri nuk ka zgjedhur mbrojtës, zbatohen rregullat e nenit 49 të këtij Kodi.
2. Nga data e depozitimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, deri në datën e seancës nuk duhet të kalojë një afat më i gjatë se 10 ditë.
3. Gjykata vendos mbi kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të saj.

Neni 332/a
Veprimet përgatitore

1. Gjyqtari i seancës paraprake njofton të pandehurin dhe viktimën ose trashëgimtarët e saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, duke treguar ditën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet seanca, me paralajmërimin për të pandehurin se nëse nuk paraqitet, seanca do të zhvillohet në mungesë të tij.

2. Data e seancës i njoftohet gjithashtu prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit, duke i bërë të ditur këtij të fundit të drejtën për t'u njohur me aktet e depozituara, si dhe për të paraqitur memorie ose dokumente. Prokurori ftohet të depozitojë të gjitha aktet e kryera pas paraqitjes së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq.

3. Njoftimet sipas paragrafëve 1 dhe 2 duhet të bëhen të paktën dhjetë ditë para datës së seancës.

Neni 332/b
Verifikimi i paraqitjes së palëve

1. Seanca zhvillohet me dyer të mbyllura, me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit.

2. Gjykata verifikon paraqitjen e palëve, duke urdhëruar përsëritjen e njoftimeve në rast se ato nuk kanë marrë njoftim ose kur njoftimi është i dyshimtë apo është deklaruar i pavlefshëm.

3. Kur mbrojtësi i të pandehurit nuk është i pranishëm, gjykata vendos sipas paragrafit 5, të nenit 49, të këtij Kodi.

4. Kur i pandehuri, në gjendje të lirë apo i paraburgosur, nuk është paraqitur pa shkaqe të arsyeshme, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet, gjykata deklaron me vendim mungesën e tij. Në këto raste i pandehuri quhet i pranishëm, me kusht që të përfaqësohet nga mbrojtësi. Quhet i pranishëm edhe i pandehuri që, pasi është paraqitur, largohet nga seanca ose i pandehuri i pranishëm

në një seancë, por që nuk paraqitet në seancat vijuese.

5. Vendimi për deklarimin e mungesës revokohet, edhe kryesisht, kur i pandehuri paraqitet.

6. Kur i pandehuri nuk paraqitet në seancë dhe del se mungesa është shkaktuar për shkak të ndonjë pengese të ligjshme, gjykata, edhe kryesisht, shtyn seancën dhe urdhëron përsëritjen e njoftimeve.

7. Zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 265 të këtij Kodi.

Neni 332/c

Zhvillimi i seancës

1. Pasi kryen verifikimin e paraqitjes së palëve, gjykata e deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor.

2. Prokurori paraqet në mënyrë të përmbledhur rezultatet e hetimeve paraprake dhe provat ku mbështetet kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq.

3. I pandehuri mund të parashtrojë kërkesa për pavlefshmërinë e akteve të hetimeve paraprake, papërdorshmërinë e provave, nevojën për marrjen e provave të tjera, kërkesë për gjykimin e shkurtuar, si dhe mund të bëjë deklaratimet që i çmon të nevojshme ose të kërkojë që të pyetet, duke zbatuar rregullat e parashikuara nga nenet 38 dhe 39 të këtij Kodi.

4. Pas të pandehurit paraqesin pretendimet e tyre viktime dhe palët e tjera private, kur janë të pranishme.

5. Palët mund të paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit, si dhe kërkesën për sigurimin e provës, apo padinë civile në procesin penal.

6. Kur palët paraqesin kërkesë për sigurimin e provës, gjyqtari i seancës paraprake vendos për marrjen e saj dhe nëse e pranon kërkesën, ia përcjell atë gjykatës kompetente, si dhe cakton datën e seancës së re.

7. Kur palët nuk kanë kërkesa apo pretendime për prova të tjera, gjykata deklaron të mbyllur shqyrtimin gjyqësor.

8. Palët parashtrojnë diskutimet e tyre mbi vlerën e provave

dhe kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq.

Neni 332/ç

Vendimi për plotësimin e hetimeve

1. Kur çmon se hetimet paraprake nuk janë të plota, gjykata urdhëron plotësimin e tyre, duke përcaktuar drejtimin dhe, kur është rasti, edhe aktet që duhet të kryhen. Kur konstaton akte të pavlefshme ose prova të papërdorshme, gjykata i deklaron ato me vendim dhe, kur është e mundur, urdhëron përsëritjen e tyre. Gjykata cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë dhe datën e seancës së re.

2. Vendimi i njoftohet drejtuesit të prokurorisë.

Neni 332/d

Ndryshimi i akuzës në seancën paraprake

1. Kur gjatë seancës paraprake fakti del ndryshe nga ç'është përshkruar në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, rezulton një veprë tjetër penale, sipas shkronjës "b", të paragrafit 1, të nenit 79, apo del një rrethanë rënduese që nuk është përmendur, prokurori ndryshon akuzën dhe ia komunikon të pandehurit të pranishëm. Kur i pandehuri nuk është i pranishëm, akuza e re i komunikohet mbrojtësit të tij, të cilit i jepen jo më shumë se 10 ditë kohë për të komunikuar me të pandehurin.

2. Kur gjatë seancës paraprake në ngarkim të të pandehurit del një fakt i ri penal që nuk është përmendur në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq dhe për të cilin duhet të procedohet kryesisht, gjykata lejon komunikimin e akuzës për faktin e ri, kur prokurori paraqit kërkesë dhe i pandehuri jep pëlqimin. Në rast të kundërt, gjykata i kthen prokurorit aktet që lidhen me akuzën e re dhe njofton drejtuesin e prokurorisë.

3. Kur gjatë seancës paraprake del se cilësimi juridik i faktit është i gabuar, ose kur akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, gjykata fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata

vendos t'i kthejë aktet. Ky vendim i njoftohet drejtuesit të prokurorisë.

Neni 332/dh

Vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake

1. Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos:

a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq, kur çmon se ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës;

b) dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit;

c) dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi;

ç) pushimin e akuzës ose të çështjes kur janë rastet e paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi.

2. Vendimi depozitohet në sekretari brenda 10 ditëve nga shpallja e tij. Palët kanë të drejtë të marrin kopje të tij.

3. Procedura e shqyrtimit në seancë paraprake nuk zëvendëson gjykimin e çështjes në themel dhe as paragjykon vendimin përfundimtar të saj.

Neni 332/e

Elementet e vendimit

1. Vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq përmban:

a) gjenealitetet e të pandehurit dhe të dhëna të tjera personale që vlejné për identifikimin e tij, si dhe gjenealitetet e palëve private dhe të mbrojtësve të tyre;

b) gjenealitetet e viktimës, në rast se rezulton e identifikuar;

c) parashtrimin e faktit penal dhe rrethanave të tij, duke treguar dispozitat përkatëse të ligjit;

ç) burimet e provës dhe faktet që ato u referohen;

d) dispozitivin, duke treguar dhe gjykatën kompetente për gjykimin e çështjes;

dh) përcaktimin e adresës së të pandehurit, viktimës ose trashëgimtarët e tij dhe palëve të tjera në proces, për efekt të njoftimeve të mëtejshme;

e) datën dhe nënshkrimin e gjyqtarit dhe të sekretarit të seancës gjyqësore.

2. Vendimi është i pavlefshëm kur i pandehuri nuk identifikohet me saktësi, ose kur mungojnë ose janë të pamjaftueshme kërkesat e parashikuara në shkronjën “c”, pika 1, të këtij neni.

Neni 332/ë

Fashikulli i gjykimit

1. Kur gjykata vendos dërgimin e çështjes në gjyq, pasi dëgjon palët, përcakton aktet që duhet të përmbajë fashikulli i gjykimit.

2. Fashikulli i gjykimit përmban:

a) aktet që i përkasin kushteve për ushtrimin e ndjekjes penale dhe kërkesave për pranimin e padisë civile;

b) procesverbalet e veprimeve të papërsëritshme, të kryera nga policia gjyqësore dhe prokurori;

c) procesverbalet e veprimeve të kryera për sigurimin e provës dhe të atyre të plotësuara jashtë shtetit në ekzekutim të letërporosisë;

ç) dëshminë e penaltetit dhe dokumente të tjera që lidhen me personalitetin e të pandehurit dhe identifikimin e tij;

d) provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, kur nuk duhet të ruhen në vend tjetër;

dh) procesverbalet për veprimet e këqyrjes, njohjes dhe eksperimentit hetimor;

e) aktet e ekspertimit;

ë) procesverbalet e provës të procedimeve të tjera të lidhura;

f) procesverbalet dhe regjistrimet e përgjimit të bisedimeve e komunikimeve;

g) çdo akt tjetër të rëndësishëm për gjykimin.

3. Kopjet e këtyre akteve dhe provat e tjera të marra gjatë

hetimeve paraprake qëndrojnë në fashikullin e prokurorit.

4. Në rastet e parashikuara nga shkronjat “b” dhe “c”, të paragrafit 1, të nenit 332/dh, fashikulli përmban të gjitha aktet e kryera gjatë hetimit paraprak dhe ato të kryera gjatë seancës paraprake.

Neni 332/f

Depozitimi i fashikullit të gjykimit

Vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq, së bashku me fashikullin e gjykimit dhe me aktet e masave të sigurimit, depozitohen pa vonesë në sekretarinë e gjykatës kompetente dhe në çdo rast jo më vonë se 10 ditë.

Neni 332/g

Fashikulli i prokurorit

Aktet që nuk përfshihen në fashikullin e gjykimit, së bashku me aktet dhe procesverbalin e seancës paraprake, i dërgohen prokurorit.

Neni 332/gj

Ankimi

1. Kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq nuk lejohet ankimi.

2. Kundër vendimit për pushimin e akuzës ose çështjes prokurori, i pandehuri dhe viktima ose trashëgimtarët e saj mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit.

TITULLI VII GJYKIMI

KREU I VEPRIMET PËRGATTORE

Neni 333

Caktimi i seancës

1. Brenda dhjetë ditëve nga depozitimi i kërkesës së prokurorit ose të viktimës akuzuese, kryetari i trupit gjykues, i ngarkuar për gjykimin e çështjes cakton datën e seancës gjyqësore.

2. Data e seancës i njoftohet prokurorit, të pandehurit, mbrojtësit, viktimës, palëve private dhe përfaqësuesve të tyre të paktën dhjetë ditë para datës së caktuar për gjykim.

Neni 334

Kërkesa për gjykim të shpejtë

1. Kur janë kushtet e parashikuara në ligj, prokurori mund të kërkojë gjykimin e drejtpërdrejtë, kurse i pandehuri gjykimin e shkurtuar.

2. Në këto raste zbatohen rregullat e caktuara në këtë Kod për gjykimet e posaçme.

Neni 335

Të drejtat e palëve

1. Deri në datën e caktuar për gjykim palët, mbrojtësit dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë të shikojnë sendet e sekuestruara, të shqyrtojnë, në sekretari, aktet dhe dokumentet e mbledhura në fashikullin për shqyrtimin gjyqësor, si dhe të nxjerrin kopje të tyre.

Neni 336

Veprimet e ngutshme

1. Për rastet që kërkohet sigurimi i provës, kryetari me kërkesën e palëve urdhëron marrjen e provave, të cilat më vonë rrezikohen të mos merren, duke respektuar rregullat e parashikuara për shqyrtimin gjyqësor.

2. Për ditën, orën dhe vendin e caktuar për marrjen e provës lajmërohen, të paktën njëzet e katër orë përpara, prokurori, i pandehuri, viktima dhe mbrojtësi.

3. Procesverbalet e veprimeve të kryera përfshihen në fashikullin e shqyrtimit gjyqësor.

Neni 337

Thirrja e dëshmitarëve dhe ekspertëve

1. Palët që kërkojnë pyetjen e dëshmitarëve dhe të ekspertëve duhet të depozitojnë në sekretarinë e gjykatës, të paktën pesë ditë para datës së caktuar për gjykim, listën e tyre.

2. Kryetari urdhëron, edhe kryesisht, thirrjen e ekspertit të caktuar gjatë hetimit paraprak për sigurimin e provës.

Neni 338

Përpjekja për pajtim

1. Në rastin e veprave që ndiqen me kërkesën e viktimës akuzuese, gjykata thërret viktimën dhe atë kundër të cilit është bërë kërkesa për gjykim dhe u propozon zgjidhjen e çështjes me pajtim. Në qoftë se viktima e tërheq kërkesën dhe ai që akuzohet e pranon tërheqjen, gjykata vendos pushimin e çështjes. Në të kundërtën ajo cakton datën e seancës dhe u bën të njohur atyre se mund të ndihmohen nga mbrojtës.

KREU II
SHQYRTIMI GJYQËSOR

SEKSIONI I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 339
Publiciteti i seancës

1. Seanca gjyqësore është publike, përndryshe quhet e pavlefshme.

2. Nuk pranohen në seancë të miturit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe ata që janë në gjendje dehje, intoksikimi ose çrregullimi mendor.

3. Ndalohet prania në seancë e personave të armatosur, me përjashtim të pjesëtarëve të forcave të ruajtjes së rendit.

Neni 340
Rastet e gjykimit me dyer të mbyllura

*(Shtuar fjalë në shkronjën “ç” dhe shkronja “d” në pikën 1, pika 2 ,
ndryshuar numërtimi me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

1. Gjykata vendos që shqyrtimi gjyqësor ose disa veprime të tij të zhvillohen me dyer të mbyllura:

a) kur publiciteti mund të dëmtojë moralin shoqëror ose mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen sekret në interes të shtetit, në qoftë se një gjë e tillë kërkohet nga organi kompetent;

b) kur nga ana e publikut ka shfaqje që prishin zhvillimin e rregullt të seancës;

c) kur është e nevojshme të mbrohet siguria e dëshmitarëve ose e të pandehurve;

ç) kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e të miturve si dëshmitarë.

d) kur viktimja e përcaktuar në nenin 58/b, të këtij Kodi, kërkon të zhvillohet me dyer të mbyllura.

2. Shqyrtimi gjyqësor zhvillohet gjithmonë me dyer të mbyllura kur:

a) gjykohen të miturit;

b) gjykohen të pandehur të rritur, të cilët akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve si viktimë, pavarësisht moshës së viktimës gjatë gjyqimit.

3. Vendimi i gjykatës për zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura revokohet kur pushojnë shkaqet që e sollën atë.

4. Kryetari i trupit gjykues informon personat që marrin pjesë në një gjykim me dyer të mbyllura për detyrimin që kanë për të mbajtur konfidencial informacionin e mësuar në seancë.

Neni 341

Drejtimi i seancës

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Drejtimi i seancës bëhet nga kryetari i trupit gjykues. Urdhrat e tij për ruajtjen e rendit e të qetësisë në seancë janë të detyrueshme për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim.

2. Kryetari ka për detyrë të marrë masa për garantimin e respektimit të autoritetit të gjykatës, solemnitetit të gjyqimit dhe sigurisë në sallë, si dhe për shmangien e çdo fyerjeje, kërcënimi apo sulmi tjetër të palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në gjykim.

3. Kur i pandehuri, mbrojtësi, viktimja, dëshmitari, eksperti apo përkthyesi nuk zbaton urdhrat e gjykatës për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë, fyen autoritetin e gjykatës apo kryen veprime që cenojnë solemnitetin e gjyqimit, kryetari e paralajmëron atë për pasojat. Kur personi vijon të prishë rregullin e qetësinë dhe të mos bindet, gjykata mund t'i caktojë gjobë deri në shumën 30 000 lekë. Përsëritja e shkeljes përbën shkak për largimin nga sallja.

4. Ndaj urdhrat të mësipërm mund të bëhet ankim me shkrim

brenda 3 ditëve. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi nga e njëjta gjykatë. Kur e çmon të arsyeshme, gjykata vendos revokimin e gjobës. Kundër vendimit për revokimin e gjobës nuk lejohet ankim.

5. Vendimi për caktimin e gjobës përbën titull ekzekutiv.

6. Gjkata njofton dhomën e avokatëve ose institucionin apo entin përkatës për ekspertët dhe përkthyesit për sjelljen e papërshtatshme.

7. Kur prokurori me veprimet e tij cenon rregullat e seancës gjyqësore, gjykata i tërheq vëmendjen dhe në rast përsëritje, njofton drejtuesin e prokurorisë.

8. Ndaj pjesëmarrësve të tjerë në gjykim që nuk zbatojnë urdhrat e kryetarit për ruajtjen e rendit e qetësisë apo fyejnë autoritetin e gjykatës, kryetari i paralajmëron ata dhe, kur nuk respektojnë urdhërimin e gjykatës, kryetari urdhëron largimin e tyre nga seanca dhe kur e çmon të nevojshme, u cakton gjobë deri në shumën 30 000 lekë.

Neni 342

Gjykimi i pandërprerë

(Shtuar pika 4 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar fjalë në fund të pikës 4 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundohet në një seancë të vetme, gjykata vendos që të vazhdojë ditën e mëpasme të punës.

2. Gjkata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor, vetëm për arsye të veçanta, deri në pesëmbëdhjetë ditë.

3. Shtyrja dhe ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor shpallen nga kryetari në seancë. Shpallja zëvendëson njoftimin për ata që janë të pranishëm ose që duhet të quhen të pranishëm.

4. Kur për shkaqe të përligjura ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari i ri duhet të njihet me përmbajtjen e procesit gjyqësor, përveç rastit kur kërkohet prej tij që çështja të shqyrtohet nga fillimi. Kur ndryshon më shumë se një nga anëtarët e trupit gjykues që gjykon me tre gjyqtarë dhe më shumë se tre nga anëtarët e trupit gjykues që

gjykon me pesë gjyqtarë, gjykimi fillon nga e para.

Neni 343

Pezullimi i shqyrtimit gjyqësor

1. Kur përfundimi i çështjes penale varet nga zgjidhja e një mosmarrëveshje civile ose administrative, për të cilën zhvillohet një gjykim, gjykata mund të vendosë pezullimin e shqyrtimit gjyqësor derisa çështja të zgjidhet me vendim të formës së prerë.

2. Kundër vendimit të pezullimit mund të bëhet ankim.

3. Kur gjykimi civil ose administrativ nuk përfundohet brenda gjashtë muajve, gjykata mund të revokojë vendimin e pezullimit, edhe kryesisht.

Neni 344

Prania e të pandehurit në seancë

(Shtuar pika "4" me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar pika 2, 3 dhe 4 e shtuar pika 5 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. I pandehuri merr pjesë në seancë si person i lirë edhe kur është i paraburgosur, me përjashtim të rasteve kur duhen marrë masa të domosdoshme për të parandaluar rrezikun e ikjes a të dhunës.

2. Kur i pandehuri me sjelljen e tij pengon zhvillimin e rregullt të seancës, pavarësisht masave të marra, sipas paragrafit 3, të nenit 341, të këtij Kodi, gjykata mund të urdhërojë largimin e tij nga salla për një kohë të caktuar. Kur i pandehuri vijon të pengojë zhvillimin normal të gjykimit edhe pas kthimit, gjykata mund të urdhërojë largimin e tij deri në shpalljen e vendimit.

3. Kur është e mundur, i pandehuri i larguar, sipas paragrafit 2, të këtij neni, e ndjek seancën nëpërmjet lidhjes audio dhe/ose video.

4. I pandehuri i larguar nga seanca, sipas paragrafit 2, të këtij neni, quhet i pranishëm dhe përfaqësohet nga mbrojtësi. Ai mund të ripranohet në sallë në çdo kohë.

5. Mungesa e të pandehurit që largohet nga salla dhe që nuk ka pranuar të ketë mbrojtës, nuk e pengon zhvillimin e gjykimit. Në këtë

rast caktohet një mbrojtës kryesisht dhe vazhdon gjykimi. I pandehuri ose mbrojtësi i zgjedhur prej tij mund të pranohet në sallë në çdo kohë.

Neni 345

Procesverbali i seancës

(Shfuqizuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Neni 346

Përmbajtja e procesverbalit

(Shfuqizuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Neni 347

Kërkesat e palëve për procesverbalin

(Shfuqizuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

**SEKSIONI II
VEPRIMET PARAPRAKE**

Neni 348

Verifikimi i paraqitjes së palëve

(Shtuar fjalia e dytë në pikën 1 e pikat 2 e 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor, kryetari kontrollon paraqitjen e palëve. Në rast se palët nuk janë paraqitur, kryetari verifikon nëse njoftimet janë të rregullta dhe nëse mungesa është e justifikuar.

2. Kur mbrojtësi i caktuar kryesisht nuk është i pranishëm, zbatohen paragrafët 5 dhe 6, të nenit 49, të këtij Kodi.

3. Nëse prokurori nuk paraqitet në gjykim, gjykata shtyn seancën dhe njofton drejtuesin e prokurorisë.

Neni 349

Përsëritja e thirrjes

1. Gjykata urdhëron, edhe kryesisht, që të përsëritet thirrja për gjykim kur del që i pandehuri ose personi ndaj të cilit është bërë kërkesë për gjykim nga viktima akuzuese nuk ka marrë njoftim ose njoftimi është i dyshimtë.

Neni 350

Mungesa e të pandehurit ose e mbrojtësit

(Ndryshuar pika 3, pika 4 numërohet pika 6 dhe shtuar pikat 4 e 5 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur i pandehuri, qoftë edhe i paraburgosur, ose personi ndaj të cilit ka bërë kërkesë për gjykim viktima akuzuese, nuk paraqitet në seancë dhe del se mungesa është shkaktuar nga forca madhore ose ndonjë pengesë tjetër që e përjashton nga përgjegjësia, gjykata, edhe kryesisht, shtyn ose pezullon shqyrtimin gjyqësor, cakton datën e seancës së re dhe urdhëron që të përsëritet thirrja.

2. Leximi i vendimit që cakton seancën e re zëvendëson njoftimin për të gjithë ata që janë ose duhet të quhen të pranishëm.

3. Gjykata vendos sipas paragrafit 1, të këtij neni, edhe kur mbrojtësi mungon dhe mungesa është shkaktuar nga forca madhore, përveçse kur i pandehuri kërkon që të procedohet në mungesë të mbrojtësit dhe prania e tij nuk është e detyrueshme. Kur i pandehuri ndihmohet nga dy mbrojtës dhe pengesa për t'u paraqitur lidhet vetëm me njërin prej tyre, thirrja konsiderohet e vlefshme dhe gjykimi zhvillohet me praninë e njërit mbrojtës.

4. Kur mbrojtësi i njoftuar rregullisht nuk paraqitet në seancë dhe nuk ka pengesa që e përjashtojnë nga përgjegjësia për t'u paraqitur ose nëse mbrojtësi ikën nga seanca pa leje, gjykata mund të caktojë ndaj tij gjobë nga 5 000 deri në 100 000 lekë dhe mund ta urdhërojë të paguajë shpenzimet e seancës.

5. Ndaj urdhrat të mësipërm mund të bëhet ankimi me shkrim brenda 3 ditëve. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi nga e njëjta gjykatë. Kur e shih të arsyeshme gjykatë vendos revokimin e gjobës. Kundër vendimit për revokimin e gjobës nuk lejohet ankimi.

6. Kur del që njoftimi nuk ka qenë i rregullt, gjykatë vendos shqyrtimin e shqyrtimit gjyqësor dhe urdhëron përsëritjen e njoftimit.

Neni 351

Mosparaqitja ose largimi i vullnetshëm i të pandehurit

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur i pandehuri i lirë ose i paraburgosur nuk paraqitet në seancë, ndonëse është njoftuar dhe nuk ka pasur shkaqe të ligjshme për të mos u paraqitur, gjykatë shtyn seancën dhe urdhëron shoqërimin e detyrueshëm, përveç rastit kur ka deklaruar vullnetin e tij për të mos marrë pjesë në gjykim përpara noterit ose autoritetit shtetëror përgjegjës. Në këtë rast gjykimi vazhdon pa pjesëmarrjen e tij.

2. Kur i pandehuri i pranishëm në seancë heq dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, gjykimi vazhdon pa pjesëmarrjen e tij.

3. Në rastet e parashikuara nga pikat 1 dhe 2, të këtij neni, i pandehuri konsiderohet i pranishëm, me kusht që gjykimi të zhvillohet në praninë e mbrojtësit.

4. I njëjti rregullim zbatohet edhe kur i pandehuri ikën në çdo moment të shqyrtimit gjyqësor ose gjatë intervaleve të tij.

Neni 352

Gjykimi në mungesë

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur i pandehuri në gjendje të lirë, me gjithë kërkimet, sipas neneve 140 -142, të këtij Kodi, nuk paraqitet në seancë dhe rezulton se nuk ka marrë dijenë personalisht për gjykimin, gjykatë vendos

pezullimin e tij dhe urdhëron policinë gjyqësore të vazhdojë kërkimin e të pandehurit. Me kalimin e një viti nga data e pezullimit të gjykimit për këtë shkak, si dhe në çdo moment kur ka informacione për vendndodhjen e të pandehurit, gjykata rifillon gjykimin, duke urdhëruar përsëritjen e njoftimit. Kur edhe pas kërkimeve të kryera rishtazi i pandehuri nuk gjendet, gjykata deklaron mungesën. Në këtë rast gjykimi zhvillohet në praninë e mbrojtësit.

2. Kur provohet se i pandehuri i fshihet drejtësisë, gjykata deklaron mungesën. Në këtë rast gjykimi zhvillohet në praninë e mbrojtësit.

3. Gjkata deklaron mungesën edhe kur provohet se i pandehuri ndodhet jashtë vendit dhe ekstradimi i tij nuk është i mundur.

4. Vendimi që deklaron mungesën është i pavlefshëm kur provohet se ajo ka ardhur nga pamundësia absolute për t'u paraqitur.

5. Kur i pandehuri paraqitet pas shpalljes së vendimit të mungesës, gjykata e revokon atë. Kur i pandehuri paraqitet pasi shqyrtimi gjyqësor është deklaruar i mbyllur, ai mund të kërkojë të pyetet. Mbeten të vlefshme veprimet e kryera më parë, por kur i pandehuri e kërkon dhe gjykata e çmon të nevojshme për marrjen e vendimit, mund të vendosë riçeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e provave të kërkuara nga i pandehuri ose përsëritjen e veprimeve procedurale.

6. Gjykimi në mungesë nuk zhvillohet për të pandehurin e mitur. Në këtë rast, pasi ka bërë kërkimet, sipas neneve 140 – 142, të këtij Kodi, gjykata, vendos pezullimin e gjykimit. Zbatohen për aq sa janë të pajtueshme rregullat e paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 353

Shoqërimi i detyrueshëm i të pandehurit

1. Gjkata mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm të të pandehurit ose të personit ndaj të cilit është bërë kërkesë për gjykim nga viktima akuzuese, kur nuk është paraqitur ose është deklaruar në mungesë, në qoftë se prania e tij është e domosdoshme për marrjen e një prove, por jo për pyetjen e tij.

Neni 354

Kërkesat paraprake

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kërkesat që kanë të bëjnë me juridiksionin, kompetencën, me bashkimin ose ndarjen e procedimeve, me legjitimimin e paditësit dhe të të paditurit civil, nuk mund të parashtrihen më vonë në qoftë se nuk janë ngritur menjëherë pas legjitimitit të palëve përveçse kur mundësia për t'i ngritur lind vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor.

2. Për kërkesat paraprake kanë të drejtë të flasin prokurori, viktima akuzuese, i pandehuri ose mbrojtësi i tij dhe nga një përfaqësues për çdo palë private. Nuk lejohet replika.

3. Për kërkesat paraprake gjykata disponon me vendim menjëherë pasi dëgjon palët. Kur e çmon të nevojshme, gjykata mund ta shtyjë vendimmarrjen e saj deri në seancën e ardhshme.

Neni 355

Deklarimi i hapjes së shqyrtimit gjyqësor

1. Pasi kryhen veprimet e treguara në nenet e mësipërme, kryetari e deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe tregon identitetin e të pandehurit dhe akuzën në ngarkim të tij.

Neni 356

Parashtrimi hyrës dhe kërkesat për prova

1. Prokurori ose viktima akuzuese parashtron në mënyrë të përmbledhur faktet objekt akuze dhe tregon provat që kërkon të shqyrtohen.

2. Sipas radhës, mbrojtësi i të pandehurit, përfaqësuesit e paditësit dhe të paditurit civilë tregojnë faktet që synojnë të provojnë dhe kërkojnë marrjen e provave.

3. Lejohet marrja e provave që nuk janë kërkuar paraprakisht

kur pala që i kërkon pretendon se nuk ka pasur mundësi t'i kërkonte.

Neni 357

Disponimet e gjykatës lidhur me provat

1. Gjykata, pasi dëgjon palët, jep vendim për marrjen e provave.
2. Gjatë shqyrtimit gjyqësor palët mund të bëjnë pretendime lidhur me marrjen e provave. Gjykata mund të revokojë me vendim marrjen e provave që dalin të panevojshme ose të pranojë marrjen e provave që kanë qenë refuzuar.

Neni 358

Deklarimet e të pandehurit

1. Kryetari i bën të ditur të pandehurit se ai ka të drejtë të bëjë në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor deklarinimet që çmon të përshtatshme. Kur gjatë deklarinimeve i pandehuri nuk i përmbahet objektit të akuzës, kryetari e paralajmëron dhe kur ai vazhdon i heq të drejtën e fjalës.

2. Sekretari riprodhon tërësisht deklarinimet e të pandehurit, përveçse kur kryetari urdhëron që procesverbali të mbahet në formë të përmbledhur.

SEKSIONI III MARRJA E PROVAVE

Neni 359

Radha e marrjes së provave

1. Hetimi gjyqësor fillon me marrjen e provave të kërkuara nga prokurori ose viktima akuzuese dhe vazhdon me marrjen e atyre që kërkojnë nga i pandehuri, mbrojtësi dhe palët e tjera.

Neni 360

Paraqitja dhe betimi i dëshmitarit

1. Para se të fillojë pyetja, kryetari e paralajmëron dëshmitarin për detyrimin dhe përgjegjësinë ligjore që ka për të thënë të vërtetën, me përjashtim të rasteve kur dëshmitari është i mitur deri katërmbëdhjetë vjeç.

2. Sekretari i gjykatës lexon deklaratën e betimit të dëshmitarit: “Betohem se do të them të vërtetën, të gjithë të vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë.”

Pas kësaj dëshmitari deklaron: “betohem” dhe tregon gjeneralitetet e tij.

3. Mosrespektimi i dispozitave të paragrafëve 2 dhe 3 sjell pavlefshmërinë e veprimit të kryer.

Neni 361

Pyetja e dëshmitarëve

(Shtuar pika 7 me ligjin nr.9276, datë 16.9.2004; shtuar fjalë në pikën 3 dhe pika 8, shfuqizuar pika 5 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Pyetja e dëshmitarëve bëhet fillimisht nga prokurori ose nga mbrojtësi a përfaqësuesi që ka kërkuar pyetjen. Më pas pyetja vazhdon nga palët, sipas radhës.

2. Kush ka kërkuar pyetjen mund të bëjë pyetje edhe mbasi mbarojnë palët e tjera.

3. Palës që ka kërkuar pyetjen i ndalohen pyetjet që ndikojnë keq në paanësinë e dëshmitarit ose që synojnë në sugjerimin e përgjigjeve.

4. Për të ndihmuar kujtesën, dëshmitari mund të lejohet nga kryetari që të shikojë dokumentet e hartuara prej tij.

5. Shfuqizuar.

6. Gjatë pyetjes së dëshmitarit kryetari mund të bëjë pyetje dhe, kur është rasti, ndërhyr për të siguruar radhën e pyetjeve, vërtetësinë e përgjigjeve, saktësinë e pyetjeve dhe të kundërshtimeve, si dhe për

të garantuar respektimin e personit.

7. Dëshmitari mund të pyetet në distancë, brenda ose jashtë vendit, me anë të lidhjes audiovizive, duke respektuar rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitat e këtij Kodi. Personi i autorizuar nga gjykata qëndron në vendin ku ndodhet dëshmitari dhe bën vërtetimin e identitetit të tij, si dhe kujdeset për zhvillimin e rregullt të marrjes në pyetje e për zbatimin e masave të mbrojtjes. Këto veprime ai i pasqyron në procesverbal.

8. Viktimat e veprave penale seksuale, veprave të trafikimit ose veprave të kryera brenda familjes, kur e kërkojnë, mund të pyeten si dëshmitarë nëpërmjet mjeteve audio dhe audiovizive.

Neni 361/a

Pyetja e dëshmitarit të mitur

(Shtuar me ligjin nr. 9276, datë 16.9.2004 dhe ndryshuar neni me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Pyetja e dëshmitarit të mitur nën 14 vjeç bëhet pa praninë e gjyqtarit dhe të palëve në ambientin në të cilin ndodhet i mituri, kur është e mundur nëpërmjet mjeteve audiovizive. Pyetja bëhet nëpërmjet një psikologu, edukatori ose ndonjë eksperti tjetër dhe kur nuk është në kundërshtim me interesat e gjykimit ose të fëmijës, prindërit ose kujdestari mund të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje. Palët mund të kërkojnë dhe gjykata mund të vendosë kryesisht që i mituri të merret në pyetje nga gjyqtari në prani të ekspertit. I mituri mund të merret në pyetje sërish vetëm në raste të veçanta dhe në të njëjtën mënyrë.

2. Pyetja e dëshmitarit të mitur 14 deri në 18 vjeç kryhet nga kryetari i trupit gjykues. Gjatë marrjes në pyetje të të miturit tregohet kujdes i veçantë për të shmangur pasojat e dëmshme mbi shëndetin mendor të tij, veçanërisht kur është viktimë e veprës penale. Në përputhje me rrethanat, pyetja mund të bëhet në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Në pyetjen e dëshmitarit të mitur deri në 14 vjeç, kryetari i

trupit gjykues nuk zbaton rregullin për paralajmërimin për detyrimin dhe përgjegjësinë ligjore që ka për të thënë të vërtetën. Ky përjashtim zbatohet edhe për dëshmitarët e tjerë të mitur, kur kryetari i trupit gjykues çmon se ai nuk është në gjendje të kuptojë pasojat e bërjes së betimit. Në këto raste, kryetari i trupit gjykues i ofron të miturit mundësinë që të thotë të vërtetën dhe gjykata procedon me dëgjimin e dëshmisë së të miturit.

4. Kur i mituri është dëgjuar gjatë hetimit dhe deklaratimet e tij janë regjistruar sipas paragrafit 4, të nenit 58/a, të këtij Kodi, ato përdoren si provë në gjykim nëse i pandehuri dhe mbrojtësi japin pëlqimin. Deklarimet e të miturit mund të përdoren si provë edhe nëse mbrojtësi është lejuar të pyesë të miturin nëpërmjet profesionistëve dhe eksperti shpreh mendim se përsëritja e pyetjes mund të dëmtojë kushtet psikologjike të të miturit.

Neni 361/b

Teknikat e veçanta të marrjes në pyetje

(Shtuar me ligjin nr.9276, datë 16.9.2004; ndryshuar titulli, shtuar fjalë në pikën 1 dhe pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Pyetja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë, personave të infiltëruar ose personave nën mbulim, dhe e dëshmitarëve të mbrojtur dhe dëshmitarëve me identitet të fshehur zhvillohet nën masa të veçanta për mbrojtjen e tyre, të cilat përcaktohen nga gjykata, kryesisht ose me kërkesën e palëve.

Kur disponon mjete teknike, gjykata mund të vendosë që marrja në pyetje e tyre të zhvillohet në distancë me anë të lidhjes audiovizive, sipas rregullave të parashikuara në pikën 7 të nenit 361.

2. Kur ndaj personit që do të pyetet është vendosur ndryshimi i identitetit, gjykata urdhëron marrjen e masave të përshtatshme për të bërë të mundur që fytyra dhe zëri i personit të mos jenë të dallueshme për palët.

Në rast se është e domosdoshme njohja e identitetit ose këqyrja e personit, gjykata urdhëron thirrjen ose shoqërimin e detyrueshëm

për përmbushjen e këtij veprimi. Në këtë rast gjykata urdhëron marrjen e masave të nevojshme për të mënjeluar pamjen e dallueshme të fytyrës së personit, të cilit i është ndryshuar identiteti.

3. Gjykata nuk lejon që dëshmitarit, sipas paragrafit 1, të këtij neni, t'i bëhen pyetje që mund të zbulojnë identitetin e tij.

Neni 362

Kundërshtimi i dëshmisë

(Shtuar fjalë në pikat 1, 2 dhe shtuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

1. Për të kundërshtuar, tërësisht ose pjesërisht, përmbajtjen e dëshmisë ose kur refuzon të dëshmojë, palët mund të përdorin thëniet e bëra më parë nga dëshmitari para prokurorit ose policisë gjyqësore dhe që ndodhen në fashikullin e prokurorit, por vetëm pasi dëshmitari ka deponuar mbi faktet dhe rrethanat që kundërshtohen.

2. Këto thënie nuk përbëjnë provë në vetvete për faktet që pohohen në to, por ato mund të vlerësohen nga gjykata për të përcaktuar besueshmërinë e personit të pyetur dhe përfshihen në fashikullin e shqyrtimit gjyqësor.

3. Deklarimet e dhëna para prokurorit ose policisë gjyqësore mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

4. Deklarimet e mëparshme, të përfshira në fashikullin e gjykimit, sipas pikës 2 të këtij neni, çmohen si prova edhe kur rezulton se dëshmitari qoftë edhe gjatë pyetjes në seancë i nënshtrohet dhunës, kanosjes, premtimit për t'i dhënë para ose përfitime të tjera, me qëllim që të mos dëshmojë ose të bëjë dëshmi të rreme, si dhe kur rezultojnë rrethana të tjera që kanë dëmtuar sinqeritetin e përgjigjeve të tij.

Neni 363

Pyetja e ekspertëve

(Shtuar pika 3 me ligjin nr.9276, datë 16.9.2004)

1. Për pyetjen e ekspertëve respektohen dispozitat mbi pyetjen e dëshmitarëve, për aq sa janë të zbatueshme.
2. Eksperti ka të drejtë në çdo rast të konsultohet me dokumentet, shënimet dhe botimet që mund të merren edhe kryesisht.
3. Eksperti mund të pyetet në distancë, duke respektuar rregullat e parashikuara në pikën 7 të nenit 361 të këtij Kodi.

Neni 364

Pyetja në shtëpi e dëshmitarëve dhe ekspertëve

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

1. Në rast pamundësie absolute për t'u paraqitur, me kërkesën e palëve, gjykata mund të vendosë që pyetja e dëshmitarit ose e ekspertit të bëhet në vendin ku ndodhet duke njoftuar ditën, orën dhe vendin e pyetjes. Pyetja mund të bëhet edhe vetëm nga një anëtar i trupit gjykues, në prani të palëve.
2. Pyetja bëhet në format e parashikuara nga nenet e mësipërme pa praninë e publikut. I pandehuri dhe palët private përfaqësohen nga mbrojtësi dhe përfaqësuesit e tyre. Gjykata mund të lejojë ndërhyrjen e të pandehurit në pyetje.

Neni 365

Pyetja e palëve private

1. Pyetjen e palëve private e fillon ai që e ka kërkuar këtë gjë dhe vazhdon me pyetjet e prokurorit, të mbrojtësve, të përfaqësuesve të palëve dhe të pandehurit. Ai që ka filluar pyetjen mund të bëjë pyetje edhe pas palëve të tjera.
2. Për të kundërshtuar përmbajtjen e deponimit, mund të

shfrytëzohen deklaratimet e bëra gjatë hetimeve paraprake nga pala e pyetur dhe që ndodhen në fashikullin e prokurorit, me kusht që pala të ketë deponuar mbi faktet dhe rrethanat që kundërshtohen.

Neni 366

Caktimi i ekspertimit gjatë gjykimit

1. Në qoftë se gjykata, kryesisht ose me kërkesën e palëve, disponon për një ekspertim, eksperti thirret menjëherë dhe duhet të shprehë mendimin e tij në të njëjtën seancë. Kur nuk është e mundur të veprohet në këtë mënyrë, gjykata ndërpret shqyrtimin gjyqësor dhe cakton datën e seancës së re, jo më larg se tridhjetë ditë.

Neni 367

Marrja e provave të reja

1. Pas marrjes së provave të kërkuara, gjykata, në qoftë se është e nevojshme, mund të bëjë pyetje shtesë dhe të disponojë, edhe kryesisht, marrjen e provave të reja. Kur nuk është e mundur të procedohet në të njëjtën seancë, ndërpritet gjykimi dhe caktohet data e seancës së re.

Neni 368

Procesverbali i marrjes së provës

1. Në procesverbalin e marrjes së provës shënohen gjeneralitetet e dëshmitarëve, ekspertëve e të përkthyesve, si dhe paralajmërimi që u bëhet për të thënë të vërtetën dhe për përgjegjësinë që kanë në rast se bëjnë dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë.

2. Sekretari i gjykatës riprodhon pyetjet e bëra nga palët dhe nga kryetari, si dhe përgjigjet e personave të pyetur.

3. Kur gjykata vendos që procesverbali të mbahet në formë të përmbledhur, kontrolli për saktësinë e tij bëhet nga kryetari.

Neni 369

Leximet e lejueshme

(Shtuar pika 3 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar fjalë dhe shtuar fjalë në pikën 5 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata edhe kryesisht, vendos që të lexohen, tërësisht ose pjesërisht aktet që përmbahen në fashikullin për shqyrtimin gjyqësor.

2. Me kërkesën e palëve, gjykata mund të vendosë që të lexohen aktet e marra gjatë hetimeve paraprake kur për shkak të rrethanave të paparashikuara ato nuk mund të përsëriten më.

3. Leximi i deklarimeve të bëra nga shtetasi shqiptar ose i huaj, banues jashtë shtetit, mund të bëhet në qoftë se ai është thirrur dhe nuk është paraqitur ose kur nuk gjendet, me gjithë kërkimet e bëra nga policia gjyqësore, si dhe kur refuzon të dëshmojë. Në këtë rast akti vlerësohet duke u lidhur me provat e tjera.

4. Oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore, që pyetet si dëshmitar, mund t'i përdorë aktet e policisë gjyqësore për të ndihmuar kujtesën.

5. Në vend të leximit, gjykata, edhe kryesisht, mund të tregojë aktet që lejohet të përdoren për dhënien e vendimit. Tregimi i akteve barazohet me leximin e tyre.

Neni 370

Leximi i deklarimeve të bëra nga i pandehuri

(Shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Për të kundërshtuar, tërësisht ose pjesërisht, përmbajtjen e deklarimeve të të pandehurit, palët mund të përdorin deklaratimet e bëra më parë nga ai dhe që ndodhen në fashikullin e prokurorit, në qoftë se ka folur për faktet dhe rrethanat që kundërshtohen.

2. Kur i pandehuri është deklaruar në mungesë ose nuk është paraqitur ose refuzon të përgjigjet për deklaratimet që ka bërë në prani të mbrojtësit në përputhje me paragrafin 3, të nenit 38, të këtij Kodi, gjykata vendos që të lexohen procesverbalet e deklarimeve të bëra

nga ai gjatë hetimeve paraprake.

3. Kur deklaratimet janë bërë nga persona të marrë si të pandehur në një procedim të lidhur, gjykata vendos shoqërimin e detyrueshëm. Kur nuk mund të sigurohet prania e deklaruesit, gjykata, pasi dëgjon palët, vendos leximin e procesverbaleve që përmbajnë deklaratimet.

Neni 371

Futja e akteve në fashikullin e gjykatës

1. Procesverbalet dhe aktet që janë lexuar, si dhe dokumentet e paraqitura nga palët e të pranuar nga gjykata, futen bashkë me procesverbalin e seancës në fashikullin e gjykatës.

SEKSIONI IV AKUZAT E REJA

Neni 372

Ndryshimi i akuzës

1. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor fakti del ndryshe nga ç'është përshkruar në kërkesën për gjykim dhe gjykimi i tij është në kompetencën e asaj gjykate, prokurori ndryshon akuzën dhe procedon me akuzën përkatëse.

Neni 373

Akuza për një vepër tjetër

1. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del një vepër penale tjetër që ka lidhje me atë që gjykohej, sipas nenit 79 germa "b", ose një rrethanë rënduese që nuk është përmendur në kërkesën për gjykim, prokurori i komunikon të pandehurit veprën penale ose rrethanën, por me kusht që gjykimi të mos jetë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

Neni 374

Akuza për një fakt të ri

1. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del një fakt i ri në ngarkim të të pandehurit që nuk është përmendur në kërkesën për gjykim dhe për të cilin duhet proceduar kryesisht, prokurori procedon në format e zakonshme, duke tërhequr dosjen për të vazhduar hetimet paraprake. Megjithatë, në qoftë se prokurori kërkon, gjykata mund të lejojë shqyrtimin në të njëjtën seancë kur i pandehuri jep pëlqimin dhe nuk dëmtohet shpejtësia e procedimit.

Neni 375

Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale

(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; shtuar pikat 2 dhe 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori ose viktima akuzuese, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

2. Kur në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata vlerëson se fakti për të cilin akuzohet i pandehuri mund të ketë cilësim juridik më të rëndë se ai që ka bërë prokurori ose viktima akuzuese, njofton palët mbi këtë mundësi dhe u jep kohën e nevojshme për t'u mbrojtur. Palët kanë të drejtë të paraqesin prova të reja.

3. Kur gjykimi zhvillohet në mungesë të të pandehurit, sipas nenit 352, të këtij Kodi, gjykata zbaton rregullat e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të tij.

Neni 376

Të drejtat e palëve

(Shtuar shenja e pikësimit, lidhëza dhe numri në pikën 1 e fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Në rastet e parashikuara nga nenet 372, 373, 374 dhe 375, kryetari i bën të ditur të pandehurit se mund të kërkojë një afat për mbrojtjen. Kur i pandehuri kërkon afat, kryetari ndërpret shqyrtimin gjyqësor për një kohë të përshtatshme, por jo më shumë se dhjetë ditë. Edhe palët e tjera mund të kërkojnë marrjen e provave të reja.

2. Kryetari urdhëron thirrjen e viktimës, duke respektuar një afat jo më të vogël se pesë ditë.

3. Kur i pandehuri gjykohet në mungesë sipas neneve 351 dhe 352 të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjykatës që akuza e re të përfshihet në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor dhe që ekstrakti i procesverbalit t'i njoftohet të pandehurit. Në këtë rast kryetari ndërpret shqyrtimin gjyqësor dhe cakton një seancë të re, duke respektuar afatet e treguara në paragrafin 1.

Neni 377

Kalimi i akteve prokurorit

(Hequr fjalia e dytë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur prokurori e tërheq akuzën dhe në gjendjen që janë provat vërtetohet se i pandehuri nuk ka faj ose del që ekziston një nga rastet e pushimit të çështjes, gjykata vendos pafajësinë e të pandehurit ose pushimin e çështjes.

SEKSIONI V
DISKUTIMI PËRFUNDIMTAR

Neni 378

Zhvillimi i diskutimit

(Shfuqizuar pika 5 dhe 6 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Pas marrjes së provave, prokurori, mbrojtësi i të pandehurit dhe përfaqësuesit e palëve të tjera formulojnë dhe parashtrojnë konkluzionet përkatëse.

2. Padihtësi civil paraqet konkluzione me shkrim, të cilat duhet të përfshijnë, kur është kërkuar shpërblimi i dëmit, edhe përcaktimin e fitimit të munguar.

3. Prokurori, mbrojtësit dhe përfaqësuesit e palëve mund të bëjnë replikë.

4. Në çdo rast i pandehuri dhe mbrojtësi duhet të kenë fjalën e fundit në qoftë se e kërkojnë.

5. Shfuqizuar.

6. Shfuqizuar.

Neni 378/a

Kërkesa për riçeljen e hetimit gjyqësor

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Pasi i është dhënë fund shqyrtimit gjyqësor nuk mund të merren prova të tjera.

2. Shqyrtimi gjyqësor mund të riçelet me kërkesën e palëve, kur ato kërkojnë marrjen e provave të dala rishtazi, apo të cilat kanë qenë të pamundura të siguroheshin më parë prej tyre.

3. Gjykata pranon kërkesën kur çmon se provat kanë rëndësi për zgjidhjen e çështjes.

KREU III
VENDIMI

SEKSIONI I
MARRJA E VENDIMIT

Neni 379

Menjëhershmeria e marrjes së vendimit

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Vendimi merret menjëherë pas diskutimeve përfundimtare të palëve.
2. Marrja e vendimit nuk mund të shtyhet përveçse në rast pamundësie absolute. Shtyrja vendoset nga kryetari me urdhër të motivuar.

Neni 380

Provat që mund të përdoren për të marrë vendimin

1. Për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor.

Neni 381

Marrja e vendimit kolegjisht

(Shtuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Trupi gjykues, nën drejtimin e kryetarit, vendos veças për çdo çështje që lidhet me faktin dhe me ligjin, me zbatimin e masave të sigurimit, me dënimet dhe me përgjegjësinë civile.
2. Gjyqtarët dhe ndihmësgjyqtarët parashetrojnë mendimin e tyre dhe votojnë për çdo çështje. Kryetari mbledh votat, duke filluar nga gjyqtari ose ndihmësgjyqtari me vjetërsinë më të vogël në shërbim dhe vetë voton i fundit.

3. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues. Gjyqtari që është në pakicë nënshkruan vendimin, duke vënë shënimin “kundër”.

Neni 382

Përpilimi i vendimit

(Shtuar pika 2, 3 dhe 4 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Pas marrjes së vendimit bëhet arsyetimi i tij duke u bazuar në provat dhe ligjin penal, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.

2. Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

3. Kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur ose brenda 30 ditëve kur është gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

4. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përlegjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës.

Neni 383

Elementet e vendimit

(Ndryshuar shenja e pikësimit dhe shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Vendimi përmban:
a) gjykatën që e ka dhënë;
b) gjeneralitetet e të pandehurit ose të dhëna të tjera personale që vlejné për ta identifikuar, si dhe gjeneralitetet e palëve të tjera private;

- c) akuzën;
 - ç) parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta;
 - d) dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit;
 - dh) datën dhe nënshkrimin anëtarëve të trupit gjykues.
2. Vendimi është i pavlefshëm kur mungon dispozitivi ose nënshkrimi i anëtarëve të trupit gjykues, si dhe kur ka haptazi kontradiktë mes arsyetimit dhe dispozitivit të tij.

Neni 384

Shpallja e vendimit

(Shtuar fjalë në pikën 1 dhe pika 3 e ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Vendimi shpallet në seancë nga kryetari ose një anëtar i trupit gjykues me anë të leximit të dispozitivit.
2. Pas dispozitivit kryetari lexon vendimin e arsyetuar. Arsyetimi i vendimit mund të jepet me shkrim edhe në mënyrë të përmbledhur, duke treguar shkaqet kryesore mbi të cilat bazohet vendimi. Në këtë rast, gjykata u jep palëve në seancë vendimin e përmbledhur me shkrim.
3. Shpallja e vendimit, sipas kësaj dispozite, vlen si njoftim për palët që janë të pranishme në seancë.

Neni 385

Ndreqja e vendimit

1. Gjykata, edhe kryesisht, procedon për ndreqjen e vendimit kur duhet korrigjuar ndonjë gabim material.

Neni 385/a

Plotësimi i vendimit

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Secila nga palët, brenda tridhjetë ditëve nga shpallja e vendimit në rastet kur kanë qenë të pranishme ose nga marrja dijeni kur vendimi është shpallur në mungesë të tyre, mund të kërkojë plotësimin e tij, në rast se gjykata nuk është shprehur mbi të gjitha kërkesat për disponimin e provave.

2. Gjykata e shqyrton kërkesën me të njëjtin trup gjykues, pasi thërret palët.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë.

Neni 386

Depozitimi i vendimit

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas arsyetimit, brenda afateve të parashikuara në nenin 382 të këtij Kodi. Nëpunësi i caktuar vë nënshkrimin dhe shënon datën e depozitimit.

2. Vendimi u njoftohet palëve që nuk kanë qenë të pranishme në shpalljen e tij në adresën e deklaruar prej tyre. Njoftimi i kryer në adresën e deklaruar nga palët konsiderohet i realizuar.

SEKSIONI II

VENDIMI I PUSHIMIT TË ÇËSHTJES DHE I PAFAJËSISË

Neni 387

Vendimi i pushimit të çështjes

(Ndryshuar pika 1 dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të

vazhdojë, sipas rasteve të parashikuara në shkronjat “c”, “ç”, “e” dhe “ë”, të paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi, ose kur vepra penale është shuar dhe i pandehuri nuk pretendon pafajësi, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke treguar edhe shkakun.

2. Shfuqizuar.

Neni 388

Vendimi i pafajësisë

1. Gjkata merr vendim pafajësie kur:
 - a) fakti nuk ekziston ose nuk provohet se ekziston;
 - b) fakti nuk përbën vepër penale;
 - c) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;
 - ç) vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose të dënohet;
 - d) nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën që akuzohet;
 - e) fakti është kryer në prani të një shkakut të përligjur ose të një shkakut padënueshmërie, si dhe kur ekziston dyshimi për qenien e tyre.

Neni 389

Disponimet mbi masat e sigurimit

1. Me vendimin e pafajësisë a të pushimit, gjykata urdhëron lirimin e të pandehurit të paraburgosur dhe deklaron heqjen e masave të tjera të sigurimit. Në të njëjtën mënyrë disponohet edhe kur vendoset pezullimi me kusht i vendimit.

SEKSIONI III
VENDIMI I DËNIMIT

Neni 390

Dënimi i të pandehurit

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar fjalë në pikën 1, pika 2 numërohet pika 4 e hequr fjalë dhe shtuar pika 2 e 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur fajësia e të pandehurit provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, gjykata jep vendim dënimi, duke caktuar llojin dhe masën e dënimit.

2. Gjykata nuk mund të bazojë vendimin e fajësisë vetëm mbi deklaratimet e bëra nga personi, i cili, me vullnetin e tij, nuk ka pranuar të pyetet nga i pandehuri ose nga mbrojtësi i tij në asnjërën nga fazat e procedimit.

3. Gjykata nuk mund të bazojë vendimin e fajësisë vetëm ose kryesisht në deklaratimet e bashkëtëpandehurit, apo dëshmitë e marra nëpërmjet teknikave të veçanta për fshehjen e identitetit të dëshmitarit, sipas nenit 361/b të këtij Kodi.

4. Kur i pandehuri ka kryer disa vepra penale, gjykata cakton dënimin për secilën prej tyre dhe zbaton normat mbi bashkimin e dënimeve.

Neni 391

Deklarimi për falsitetin e dokumenteve

1. Falsiteti i një akti ose i një dokumenti të vërtetuar me vendimin e gjykatës, deklarohet në dispozitiv, në të cilin urdhërohet, sipas rastit, fshirja tërësore ose e pjesshme, rivënia në fuqi, përsëritja ose ndryshimi i aktit apo dokumentit, duke caktuar edhe mënyrën me të cilën duhet bërë.

2. Deklarimi i falsitetit mund të ankimohet bashkë me vendimin

përfundimtar.

Neni 392

Detyrimi për pagimin e gjobës

1. Kur i dënuari nuk ka të ardhura ose pasuri të sekuestrueshme, gjykata ngarkon atë që përgjigjet civilisht për detyrimet e të pandehurit që të paguajë një shumë të barabartë me gjobën.

Neni 393

Detyrimi për shpenzimet

1. I dënuari ngarkohet me pagimin e shpenzimeve procedurale që lidhen me veprat penale, të cilave u referohet dënimi.

2. Të dënuarit për të njëjtën vepër penale ose për vepra penale të lidhura detyrohen solidarisht të paguajnë shpenzimet. Të dënuarit në të njëjtin gjykim për vepra penale që nuk lidhen midis tyre detyrohen solidarisht vetëm për shpenzimet e përbashkëta që lidhen me veprat penale për të cilat është dhënë dënimi.

Neni 394

Detyrimi i të paditurit civil

1. Në vendimin e dënimit gjykata disponon edhe mbi kërkesën për kthimin e sendit dhe shpërblimin e dëmit, si dhe për mënyrën e likuidimit të detyrimit.

2. Kur pranohet përgjegjësia e të paditurit civil, ai detyrohet solidarisht me të pandehurin për kthimin e sendit dhe shpërblimin e dëmit.

Neni 395

Saktësimi i dëmit

1. Kur provat e marra nuk mundësojnë saktësimin e dëmit, gjykata disponon për të drejtën e shpërblimit të dëmit në tërësi dhe ia

dërgon aktet gjykatës civile.

2. Me kërkesën e paditësit civil, i pandehuri dhe i padituri civil mund të detyrohen të paguajnë një shumë të përafërt me dëmin që çmohet se është provuar. Ky detyrim ekzekutohet menjëherë.

Neni 396

Ekzekutimi i përkohshëm i detyrimit civil

1. Me kërkesën e paditësit civil, kur ekzistojnë shkaqe të përligjura, detyrimi për kthimin e sendit dhe shpërblimin e dëmit shpallet i ekzekutueshëm përkohësisht.

Neni 397

Detyrimi i palëve private me shpenzimet procedurale

1. Me vendimin që pranon kërkesën e kthimit të sendit ose të shpërblimit të dëmit, gjykata detyron solidarisht të pandehurin dhe të paditurin civil për pagimin e shpenzimeve procedurale në dobi të paditësit civil, përveçse kur çmon se duhet të vendosë kompensimin tërësor ose të pjesshëm të tyre.

2. Kur rrëzohet kërkesa ose kur i pandehuri deklarohet i pafajshëm, përveç rastit që është i papërgjegjshëm, gjykata detyron paditësin civil me pagimin e shpenzimeve procedurale të bëra nga i pandehuri dhe nga i padituri civil për efekt të padisë civile, por gjithnjë kur nuk ekzistojnë shkaqe për kompensimin tërësor a të pjesshëm. Kur vërtetohet pakujdesia e rëndë, gjykata mund ta detyrojë edhe me shpërblimin e dëmeve të shkaktuara të pandehurit ose të paditurit civil.

Neni 398

Detyrimi i ankuesit me shpenzimet dhe me dëmet

1. Kur gjykata vendos pafajësinë e të pandehurit për një veprë penale që ndiqet mbi ankim, sepse fakti nuk ekziston ose se i

pandehuri nuk e ka kryer, ankuesi detyrohet me pagimin e shpenzimit të procedimit të bëra nga shteti, si dhe me shpenzimet dhe me shpërblimin e dëmit në dobi të të pandehurit dhe të paditurit civil.

Neni 399

Publikimi i vendimit për të riparuar dëmin jopasuror

1. Me kërkesën e paditësit civil, gjykata urdhëron publikimin e vendimit të dënimit, si mënyrë e riparimit të dëmit jopasuror të rrjedhur nga vepra penale.

2. Publikimi i vendimit bëhet i plotë ose me shkurtime, në gazetata e treguara nga gjykata, me shpenzimet e të pandehurit dhe të paditurit civil.

3. Në qoftë se publikimi nuk bëhet në afatin e caktuar, paditësi civil mund të veprojë vetë me të drejtën për të kërkuar shpenzimet nga i dënuari.

KREU IV

GJYKIMET E POSAÇME

SEKSIONI I

GJYKIMI I DREJTPËRDREJTË

Neni 400

Rastet e gjykimit të drejtpërdrejtë

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002; ndryshuar pika 1 dhe 3 e ndryshuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur i pandehuri është arrestuar në flagrancë dhe hetohet për kryerjen e një vepre penale që gjykohet nga një gjyqtar, prokurori paraqet në gjykatë brenda dyzet e tetë orëve nga arrestimi, kërkesën për vleftësimin e tij dhe gjykimin e njëkohshëm, kur çmon se nuk ka nevojë për hetime të mëtejshme.

2. Në qoftë se arrestimi vleftësohet i ligjshëm dhe nuk ka nevojë

për hetime të tjera, procedohet menjëherë në gjykim, ndërsa kur ai nuk gjendet i bazuar aktet i kthehen prokurorit. Por edhe në rastin e fundit, kur i pandehuri dhe prokurori japin pëlqimin gjykata procedon në gjykimin e drejtpërdrejtë.

3. Kur i pandehuri është arrestuar në flagrancë dhe ai vleftësohet i ligjshëm, si dhe kur gjykata vendos njëren nga masat e sigurimit të parashikuara nga nenet 237, 238 ose 239, të Kodit, prokurori paraqet në gjykatë kërkesë për gjykimin e drejtpërdrejtë, jo më vonë se tridhjetë ditë nga data e arrestimit, me përjashtim të rastit kur duhet të kryhen hetime të mëtejshme.

4. Kur vepra penale, për të cilën kërkohet gjykimi i drejtpërdrejtë lidhet me vepra penale të tjera, për të cilat mungojnë kushtet për këtë lloj gjykimi, procedohet ndaras për veprat e tjera dhe ndaj të pandehurve të tjerë, përveçse kur kjo ndarje dëmton hetimet. Kur bashkimi është i domosdoshëm zbatohen rregullat e gjykimit të zakonshëm.

Neni 401

Përgatitja e gjykimit të drejtpërdrejtë

(Ndryshuar pika 1 dhe 2 e shtuar pika 4 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur procedon me gjykim të drejtpërdrejtë, prokurori urdhëron paraqitjen në seancë të të pandehurit të arrestuar në flagrancë ose nën masën e sigurimit të parashikuar nga nenet 237, 238 ose 239, të këtij Kodi. Kur i pandehuri është i lirë, afati për t'u paraqitur nuk mund të jetë më i shkurtër se tri ditë.

2. Urdhri përmban, me pasojë pavlefshmërie, të dhënat e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të nenit 332/e, si dhe caktimin e vendit, datës dhe orës për t'u paraqitur, me paralajmërimin se nëse i pandehuri nuk paraqitet, do të shoqërohet me detyrim, si dhe datën e nënshkrimit të prokurorit.

3. Mbrojtësit i njoftohet pa vonesë data e gjykimit nga prokurori. Ai ka të drejtë të shikojë dhe të nxjerrë kopje të dokumentacionit që

lidhet me hetimet e zhvilluara.

4. Urdhri së bashku me fashikullin e gjykimit dërgohen në gjykatë. Në rastin e parashikuar nga paragrafi 3, i nenit 400, prokurori njoftohet të paktën dhjetë ditë përpara mbi datën dhe orën e gjykimit, si dhe për gjykatën që do të gjykojë çështjen.

Neni 402

Zhvillimi i gjykimit të drejtpërdrejtë

(Shtuar pika 1/1 e pika 4, ndryshuar fjalë në pikën 2, ndryshuar pika 3 dhe pika 4 numërohet pika 5 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjatë gjykimit të drejtpërdrejtë zbatohen dispozitat e kreut për shqyrtimin gjyqësor.

1/1. Viktima dhe dëshmitarët njoftohen nga policia gjyqësore edhe me gojë. Në rastin e parashikuar nga paragrafi 1, i nenit 400, prokurori mund t'ia komunikojë akuzën të arrestuarit në seancë gjyqësore.

2. Prokurori, i pandehuri dhe paditësi civil mund të paraqesin gjatë shqyrtimit gjyqësor dëshmitarë, pa u thirrur paraprakisht nga gjykata.

3. Gjkata e njuh të pandehurin me të drejtën për të kërkuar gjykimin e shkurtuar ose për të kërkuar arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. I pandehuri njoftohet, gjithashtu, se ka të drejtë të kërkojë afat për të përgatitur mbrojtjen deri në pesë ditë. Në këtë rast shqyrtimi gjyqësor shtyhet deri në seancën e re, të caktuar pas mbarimit të këtij afati.

4. Kur gjykimi i drejtpërdrejtë është kërkuar jashtë rasteve të parashikuara nga neni 400, i këtij Kodi, gjykata i kthen aktet prokurorit.

5. I pandehuri mund të kërkojë gjykimin e shkurtuar. Gjkata, pasi merr mendimin e prokurorit dhe e gjen të drejtë kërkesën, vendos vazhdimin e gjykimit, duke respektuar rregullat e caktuara për gjykimin e shkurtuar. Në të kundërtën vazhdon gjykimin e drejtpërdrejtë.

SEKSIONI II
GJYKIMI I SHKURTUAR

Neni 403

Kërkesa për gjykimin e shkurtuar

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kërkesa për gjykimin e shkurtuar paraqitet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm në seancën paraprake ose në seancë gjyqësore kur procedohet sipas nenit 400 dhe paragrafit 3, të nenit 406/ç, të këtij Kodi, me pasojë mospranimi.

2. Nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm.

Neni 404

Disponimet e gjykatës për kërkesën

(Shfuqizuar pika 2 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; shfuqizuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Neni 405

Seanca e gjykimit të shkurtuar

(Ndryshuar pika 1, 5, 6 dhe 7, shtuar fjalë në pikën 3 e shtuar pikat 8 dhe 9 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur i pandehuri apo mbrojtësi, me autorizim të posaçëm, kanë paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar në seancën paraprake, sipas parashikimeve të nenit 332/c, të këtij Kodi, seanca gjyqësore zhvillohet me pjesëmarrjen e prokurorit, të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës ose trashëgimtarët e saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe palëve private.

2. Gjykata bën verifikimet lidhur me legjitimitimin e palëve.

3. Kur mbrojtësi i të pandehurit nuk është i pranishëm dhe mbrojtja është e detyrueshme sipas kriteve të përcaktuara në këtë

Kod, gjykata cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër.

4. Kur i pandehuri nuk paraqitet në seancë për arsye të përligjura, gjykata cakton datën e seancës së re dhe urdhëron që të lajmërohet i pandehuri.

5. Pasi dëgjon palët mbi kërkesat paraprake, gjykata lexon kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe pyet të pandehurin nëse i qëndron asaj. Kur i pandehuri deklaron se i qëndron kërkesës, gjykata deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe i jep fjalën prokurorit që në mënyrë të përmbledhur të parashtrojë rezultatet e hetimeve paraprake.

6. Pasi dëgjon parashtrimin e prokurorit, në të njëjtën seancë gjykata vendos pranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar kur çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Në të kundërtën refuzon kërkesën dhe vazhdon me gjykim të zakonshëm. Kundër vendimit lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar.

7. Kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet nëse i pandehuri apo mbrojtësi i tij ngrenë pretendime mbi vlefshmërinë e akteve apo përdorshmërinë e provave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, apo kur kërkojnë marrjen e provave të reja në gjykim. Kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet edhe në rastet kur gjykata kryesisht konstaton pavlefshmëri absolute apo papërdorshmëri të provave, si rezultat i të cilave çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen e akteve. Në këtë rast, në vendimin e saj për refuzimin e kërkesës gjykata përcakton edhe aktet absolutisht të pavlefshme apo provat e papërdorshme në gjykim. Ky rregull nuk zbatohet kur kërkohen prova lidhur me personalitetin e të pandehurit, apo gjendjen e tij personale, familjare ose ekonomike.

8. Kur gjykata pranon kërkesën për gjykim të shkurtuar, gjykata fton palët të paraqesin diskutimet përfundimtare.

9. Kur gjykata pranon kërkesën për gjykim të shkurtuar, padia civile nuk shqyrtohet.

Neni 406

Vendimi

(Ndryshuar pika 1 me ligjin 8813, datë 13.6.2002 dhe me ligjin nr.145, datë 2.5.2013; shfuqizuar fjalia e dytë në pikën 1 dhe pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur jep vendim dënimi gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën.
2. Shfuqizuar.
3. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëjnë ankim prokurori dhe i pandehuri.
4. Respektohet për aq sa janë të pajtueshme dispozitat e kreut III të këtij titulli.

SEKSIONI III

(Shtuar seksioni III dhe seksioni IV me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Neni 406/a

Kërkesa për miratimin e urdhrin penal

1. Kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e një kundërvajtjeje penale, brenda tre muajve nga regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale, prokurori nxjerr urdhrin penal të arsyetuar për caktimin e dënimit dhe i kërkon gjykatës miratimin e tij, në rastet kur çmon se nuk duhet të zbatohet dënimi me burgim.
2. Në urdhrin penal prokurori cakton dënimin kryesor me gjobë. Sipas rastit, mund të caktojë edhe një ose më shumë dënime plotësuese. Në varësi të gjendjes ekonomike të të pandehurit, prokurori mund të urdhërojë që gjoba të paguhet me këste, duke caktuar edhe afatet e pagimit të tyre.
3. Dënimi me gjobë nuk mund të kalojë gjysmën e maksimumit që parashikon Kodi Penal për këtë lloj dënimi.

4. Në përfundim të hetimeve, kërkesa për miratimin e urdhrit penal depozitohet në sekretarinë e gjykatës, së bashku me të gjitha aktet e fashikullit të hetimeve paraprake. Kërkesa për miratimin e urdhrit penal i njoftohet të pandehurit. Nuk gjejnë zbatim rregullimet e paragrafëve 2 e vijues, të nenit 327, të këtij Kodi.

Neni 406/b

Vendimi për miratimin e urdhrit penal

1. Gjykata e shqyrton kërkesën pa praninë e palëve dhe vendos brenda dhjetë ditëve nga depozitimi i saj. Vendimi për miratimin e urdhrit penal arsyetohet në mënyrë të përmbledhur dhe përmban:

- a) gjenealitetet e të pandehurit;
- b) parashtrimin e faktit dhe cilësimin juridik të veprës penale;
- c) burimet e provës dhe faktet që ato u referohen;
- ç) masën e dënimit me gjobë, modalitetet e ekzekutimit të saj dhe llojin e dënimit plotësues të caktuar;
- d) të drejtën e të pandehurit për të kundërshtuar vendimin e gjykatës, si dhe afatin brenda të cilit ky vendim mund të kundërshtohet;
- dh) disponimet për provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale;
- e) datën dhe nënshkrimin e gjyqtarit.

2. Gjykata nuk mund të ndryshojë dënimet e caktuara nga prokurori në urdhrin penal, por duke çmuar rrethanat e gjendjes ekonomike të të pandehurit, në fazën e ekzekutimit, me kërkesën e të dënuarit, mund të zbatojë dispozitat e paragrafëve 8 e vijues të nenit 34 të Kodit Penal.

3. Vendimi për miratimin e urdhrit penal nuk shkakton pasojat e parashikuara nga neni 70 i këtij Kodi. Ai nuk mund të ngarkojë të dënuarin me pagimin e shpenzimeve të procedimit.

4. Dënimi i dhënë nuk shënohet në vërtetimin e gjendjes gjyqësore, përveç rastit kur i dënuari është përsëritës.

Neni 406/c

Vendimi për refuzimin e miratimit të urdhrit penal

1. Gjykata refuzon miratimin e urdhrit penal kur:

a) ekziston njëri nga rastet e pushimit të akuzës ose çështjes;

b) i pandehuri akuzohet për një vepër penale, për të cilën ligji nuk lejon zbatimin e urdhrit penal të dënimit;

c) prokurori ka kërkuar një masë dënimi me gjobë ose një apo më shumë dënime plotësuese të papërshtatshme;

ç) krijon bindjen se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet e hetimeve paraprake që i bashkëlidhen kërkesës për miratim.

2. Në rastet e parashikuara nga shkronja “a”, e paragrafit 1, të këtij neni, gjykata vendos pushimin e çështjes, kurse në rastet e tjera vendos kthimin e akteve prokurorit. Ky vendim u njoftohet prokurorit dhe të pandehurit.

Neni 406/ç

Kundërshtimi i vendimit të gjykatës

1. Vendimi i gjykatës për miratimin e urdhrit penal të dënimit u njoftohet të pandehurit dhe personit civilisht përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej tij, të cilët kanë të drejtë ta kundërshtojnë atë tek e njëjta gjykatë, brenda dhjetë ditëve nga marrja dijani.

2. Kundërshtimi nuk mund të refuzohet, me përjashtim të rasteve kur bëhet nga një person i palegjitimuar ose kur paraqitet jashtë afatit.

3. Kur gjykata procedon sipas paragrafit të 2, të këtij neni, cakton datën e gjykimit dhe njofton palët e mbrojtësit e tyre. Gjykata procedon me gjykim të zakonshëm, nëse i pandehuri nuk paraqet kërkesë për gjykim të shkurtuar. Në këtë rast, zbatohen parashikimet e neneve 333 e vijues të këtij Kodi.

SEKSIONI IV
GJYKIMI ME MARRËVESHJE

Neni 406/d

Përmbajtja e marrëveshjes

1. Nga çasti i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor, prokurori, i pandehuri, ose përfaqësuesi i tij i posaçëm mund të propozojnë arritjen e një marrëveshjeje mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit.

2. Në bisedimet për arritjen e marrëveshjes prania e mbrojtësit të të pandehurit është e detyrueshme. Arritja e marrëveshjes lejohet për veprat penale, për të cilat ligji parashikon një dënim në maksimum jo më shumë se 7 vjet burgim. Ky kufizim nuk gjen zbatim në rastin e bashkëpunëtorit të drejtësisë.

3. Marrëveshja bëhet me shkrim dhe përmban me pasojë pavlefshmërie:

a) përshkrimin e qartë të faktit penal, për të cilin akuzohet i pandehuri dhe cilësimin e tij juridik;

b) deklarin e pohimit të fajësisë nga ana e të pandehurit;

c) llojin dhe masën e dënimit penal kryesor, dënimit plotësues, si dhe mënyrën e ekzekutimit të tyre, për të cilat palët kanë rënë dakord;

ç) disponimet për provat materiale dhe sendet që i përkasin veprës penale, si dhe për konfiskimin e mjeteve e produkteve të veprës penale, sipas nenit 36 të Kodit Penal;

d) në rastin kur është legjitimuar paditësi civil, pëlqimin e tij me shkrim për masën e shpërblimit të dëmit nga i pandehuri;

dh) shumën e shpenzimeve procedurale;

e) nënshkrimet e palëve dhe të mbrojtësit.

4. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, prokurori njofton viktimën ose trashëgimtarët e saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë

nga aktet e procedimit, duke i dërguar kopje të saj.

5. Marrëveshja me kusht për pranimin e pjesshëm të akuzave është e papranueshme.

Neni 406/dh **Shqyrtimi nga gjykata**

1. Me arritjen e marrëveshjes, prokurori e dërgon atë për miratim në gjykatë, së bashku me të gjitha aktet e hetimeve paraprake. Kur marrëveshja paraqitet në seancën paraprake, gjykata vendos sipas parashikimeve të paragrafit 4, të nenit 332/c, të këtij Kodi.

2. Gjykata e shqyrton kërkesën në seancë gjyqësore brenda tridhjetë ditëve nga paraqitja e saj. Seanca zhvillohet me praninë e detyrueshme të prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Viktima njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë. Mosparaqitja e viktimës nuk pengon shqyrtimin e çështjes.

3. Pas verifikimit të paraqitjes së palëve, gjykata e deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe fton prokurorin për të paraqitur, në mënyrë të përmbledhur, rezultatet e marrëveshjes së arritur. Mbrojtësi e merr fjalën, nëse e kërkon.

4. Gjykata e pyet posaçërisht të pandehurin lidhur me sa më poshtë:

- a) nëse e ka bërë marrëveshjen me vullnetin e tij të lirë;
- b) nëse ka qenë i përfaqësuar nga mbrojtësi në bisedimet për arritjen dhe nënshkrimin e saj;
- c) nëse e kupton marrëveshjen dhe përmbajtjen e saj;
- ç) nëse i ka kuptuar pasojat që vijnë prej miratimit të marrëveshjes;
- d) nëse jep pëlqimin që marrëveshja të miratohet dhe të vihet në ekzekutim.

5. Në rastet kur viktima është e pranishme, gjykata e fton të japë mendim mbi përmbajtjen e marrëveshjes.

Neni 406/e

Miratimi i marrëveshjes

1. Kur nuk vendos pushimin e çështjes ose kthimin e akteve prokurorit, gjykata vendos miratimin e marrëveshjes.

2. Vendimi përmban në mënyrë të përmbledhur, me pasojë pavlefshmërie:

a) gjenealitetet e të pandehurit dhe të dhënat e tjera personale të nevojshme për identifikimin e tij, si dhe gjenealitetet e viktimës, nëse është e pranishme;

b) faktin që i pandehuri ka qenë i përfaqësuar dhe identitetin e mbrojtësit të tij;

c) faktin që i pandehuri e ka kuptuar përmbajtjen e marrëveshjes dhe pasojat që vijnë prej saj dhe ka nënshkruar me vullnet të lirë;

ç) faktin se cilësimi juridik i veprës dhe rrethanat e saj, përshtatshmëria e dënimit të caktuar, si dhe mungesa e shkaqeve të padënueshmërisë apo të shuarjes së veprës penale, janë vlerësuar drejt nga prokurori;

d) deklarin e fajtor të të pandehurit, caktimin e dënimit dhe disponime të tjera, sipas përmbajtjes së marrëveshjes;

dh) datën dhe nënshkrimin e vendimit.

3. Kur është arritur marrëveshja për dëmin civil, ajo është pjesë e përmbajtjes së vendimit gjyqësor.

4. Gjkata nuk mund të ndryshojë kushtet e marrëveshjes së arritur mes palëve.

Neni 406/ë

Refuzimi i marrëveshjes

1. Gjkata vendos të refuzojë miratimin e marrëveshjes kur:

a) i pandehuri tërheq pëlqimin;

b) provohet se vullneti i të pandehurit ka qenë i vesuar;

c) i pandehuri i thirrur rregullisht nuk merr pjesë në gjyq, pa

shkaqe të përligjura;

ç) ekziston një nga shkaqet e mosfillimit të procedimit ose të pushimit të akuzës ose çështjes;

d) provat në fashikullin e hetimeve vijnë në kundërshtim me pohimin e të pandehurit se ai e ka kryer veprën penale;

dh) cilësimi juridik i veprës penale dhe i rrethanave të kryerjes së saj është i gabuar;

e) dënimi i caktuar në marrëveshje është i papërshtatshëm, në raport me veprën e kryer dhe personalitetin e të pandehurit.

2. Vendimi për refuzimin e miratimit të marrëveshjes arsyetohet. Në rastin e parashikuar nga shkronja “ç”, e paragrafit 1, të këtij neni, gjykata vendos pushimin e çështjes, ndërsa në rastet e tjera i kthen aktet prokurorit. Kur gjykata refuzon miratimin e marrëveshjes, nuk lejohet paraqitja e një kërkesë të re.

3. Deklarimet e të pandehurit gjatë seancës nuk mund të përdoren kundër tij.

Neni 406/f

Ankimi ndaj vendimit të gjykatës

1. Kundër vendimit të gjykatës nuk lejohet ankim.

2. Prokurori mund të bëjë ankim vetëm ndaj vendimit të gjykatës për pushimin e çështjes.

3. Për ankimin zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, nenet 407 e vijues të këtij Kodi.

TITULLI VIII ANKIMET

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 407

Rastet dhe mjetet e ankimit

1. Ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e ankimit.
2. Ankimi i urdhrave të gjykatës, kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, mund të bëhet vetëm me ankimin kundër vendimit.
3. Mjetet e ankimit janë: apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikim.
4. E drejta e ankimit i takon vetëm atij që ligji ia njeh shprehimisht. Kur ligji nuk bën dallim ndërmjet palëve, kjo e drejtë i takon secilës prej tyre.
5. Kur ankimi bëhet në gjykatën jokompetente, ajo ia dërgon aktet gjykatës kompetente.

Neni 408

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Prokurori mund të bëjë ankim në gjykatën më të lartë, sipas rasteve të parashikuara nga ky Kod.

Neni 409

Ankimi i viktimës akuzuese

1. Viktima akuzuese mund të bëjë ankim, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, si për efekte penale, ashtu dhe për ato civile. Ai mund ta tërheqë ankimin e bërë nga përfaqësuesi.

Neni 410

Ankimi i të pandehurit

(Ndryshuar pika "2" me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; shfuqizuar pjesërisht pika 2 me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.15, datë 17.4.2003; shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. I pandehuri mund të bëjë ankim vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të tij. Kujdestari i të pandehurit mund të bëjë çdo ankim që i takon të pandehurit.

2. Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i autorizuar posaçërisht nga i pandehuri, është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji ose me deklaram në seancë.

3. I pandehuri mund ta tërheqë ankimin e bërë nga mbrojtësi i tij, por kur ai nuk ka zotësinë juridike për të vepruar duhet të merret edhe pëlqimi i kujdestarit.

4. Ankimi i të pandehurit kundër dënimit penal ose pafajësisë i shtrin efektet e veta edhe në pjesën e vendimit që cakton detyrimin për kthimin e pasurisë, shpërblimin e dëmit dhe pagimin e shpenzimeve procedurale.

Neni 411

Ankimi i paditësit civil dhe të paditurit civil

(Ndryshuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Paditësi civil mund të bëjë ankim kundër pikave të vendimit të dënimit që kanë të bëjnë me padinë civile dhe në rastin e vendimit të pafajësisë vetëm për efektet e përgjegjësisë civile.

2. I padituri civil mund të bëjë ankim kundër disponimit të vendimit që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e të paditurit civil për kthimin e pasurisë, shpërblimin e dëmit dhe shpenzimet procedurale.

Neni 412
Forma e ankimit

1. Ankimi bëhet me akt të shkruar, në të cilin tregohen vendimi i ankimuar, dita e tij, gjykata që e ka dhënë, si dhe pikat e vendimit që kundërshtohen, shkaqet e ankimit dhe çfarë kërkohet.

Neni 413
Paraqitja e ankimit

1. Akti i ankimit paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin e ankimuar. Sekretari i gjykatës shënon në të ditën kur merr aktin dhe personin që e paraqet, e bashkon me aktet dhe, kur i kërkohet, lëshon vërtetimin e marrjes.

2. Palët private, mbrojtësit dhe përfaqësuesit, mund ta paraqesin aktin e ankimit edhe në sekretarinë e gjykatës së vendit ku ata ndodhen ose pranë një nëpunësi konsullor jashtë shtetit. Në këto raste, akti dërgohet menjëherë në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin.

3. Akti i ankimit mund të dërgohet me postë rekomande në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin. Sekretari i gjykatës shënon në zarf ditën e marrjes dhe e bashkëngjit atë me aktet. Ankimi quhet i bërë në datën e dërgimit të aktit me postë rekomande.

Neni 414
Njoftimi i ankimit

1. Akti i ankimit u njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe palëve private nga sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin.

Neni 415

Afatet e ankimit

(Ndryshuar fjalia e parë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë Kod, afati për të bërë ankim është pesëmbëdhjetë ditë. Ky afat fillon nga dita e nesërme e shpalljes ose njoftimit të vendimit.

2. Ai që ka bërë ankim ka të drejtë që deri pesë ditë para seancës të paraqesë në sekretarinë e gjykatës që do të shqyrtojë çështjen, arsye të tjera që lidhen me ankimin.

3. Afatet e parashikuara nga ky nen nuk mund të zgjaten për asnjë shkak, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

Neni 416

Shtirirja e ankimit

(Ndryshuarr fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Ankimi i bërë nga një i pandehur, kur nuk bazohet vetëm në motive personale, vlen edhe për të pandehurit e tjerë.

2. Ankimi i bërë nga i pandehuri vlen edhe për të paditurin civil.

3. Ankimi i të paditurit civil vlen për të pandehurin edhe për efektet penale.

Neni 417

Pezullimi i ekzekutimit

(Shtuar fjalë në fjalinë e parë dhe shfuqizuar fjalia e dytë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

2. Ankimet kundër vendimeve që lidhen me lirinë personale nuk

kanë efekt pezullues.

Neni 418

Heqja dorë nga ankimi

1. Prokurori që ka bërë ankimin mund të heqë dorë prej tij deri në fillimin e shqyrtimit gjyqësor, kurse heqja dorë nga prokurori pranë gjykatës që shqyrton ankimin mund të bëhet deri para fillimit të diskutimit përfundimtar.

2. I pandehuri dhe palët private mund të heqin dorë nga ankimi edhe nëpërmjet mbrojtësit ose përfaqësuesit.

3. Deklarata për heqjen dorë paraqitet në format dhe mënyrat e parashikuara për paraqitjen e ankimit, sipas rastit, në gjykatën që ka dhënë vendimin ose në gjykatën që shqyrton ankimin.

Neni 419

Dërgimi i akteve

(Ndryshuar e shtuar fjalë me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata që ka dhënë vendimin i dërgon, brenda pesë ditëve nga realizimi i njoftimeve, gjykatës që do të shqyrtojë çështjen, aktet e procedimit dhe ankimin nëse nuk është hequr dorë nga ankimi.

Neni 420

Mospranimi i ankimit

(Ndryshuar fjalia në pikën 1, shtuar fjalë në pikën “ç”, shkronja “d” e pika 4 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Me përjashtim të rasteve kur konstatohet në seancë, ankimi nuk pranohet në dhomë këshillimi:

a) kur është bërë nga ai që nuk është i legjitimuar;

b) kur vendimi është i paankimueshëm;

c) kur nuk janë respektuar dispozitat për formën, paraqitjen, dërgimin, njoftimin dhe afatin e ankimit;

ç) kur është hequr dorë nga ankimi gjatë gjykimit.

d) kur ankimi nuk ka më objekt.

2. Mospranimi mund të deklarohet, edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit.

3. Vendimi i mospranimit i njoftohet atij që ka bërë ankimin dhe kundër tij lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda kompetencës së saj.

4. Kur gjykata vendos mospranimin e ankimit, vendimi konsiderohet i paankimuar për efekt të vënies në ekzekutim.

Neni 420/1

Rivendosja në afatin e ankimit

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Palët rivendosen në afatin e ankimit kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit faktor ose të forcës madhore. Kërkesa shoqërohet së bashku me ankimin, me pasojë mospranimi.

2. Kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të nenit 351, të këtij Kodi, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijëni për vendimin.

3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zhdukja e faktit që përbënte rast ose forcë madhore, kurse në rastet e parashikuara në paragrafin 2, të këtij neni, nga dita kur i pandehuri ka marrë dijëni efektivisht për vendimin. Rivendosja në afat nuk lejohet më shumë se një herë për secilën palë dhe për çdo shkallë të procedimit.

4. Nëse ankuesi nuk paraqitet në seancë, pa shkaqe të arsyeshme, megjithëse ka dijëni rregullisht për datën dhe orën e saj ose heq dorë nga kërkesa, gjykata vendos mospranimin e kërkesës.

5. Kur kërkesa pranohet dhe vendimi për të cilin është lejuar rivendosja në afat është një vendim dënimi me burgim, i cili është ekzekutuar, ekzekutimi i dënimit pezullohet. Gjykata urdhëron lirimin e menjëhershëm të të pandehurit në rast se nuk mbahet për shkak të një mase sigurimi me arrest.

6. Gjykata arsyeton vendimin brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.
7. Kundër vendimin që lejon rivendosjen në afat bëhet ankim së bashku me vendimin përfundimtar.

8. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 15 ditëve nga data e marrjes së akteve.

Neni 421

Detyrimi me shpenzimet

1. Me vendimin që rrëzon ose deklaron të papranueshëm ankimin, pala private që e ka bërë detyrohet për shpenzimet e procedimit.

2. Bashkëtpandehurit që kanë marrë pjesë në gjykim detyrohen me shpenzimet solidarisht me të pandehurin që ka bërë ankimin.

3. Në gjykimet e ankimit vetëm për interesa civile, pala private gjyqumbëse detyrohet me shpenzimet.

KREU II

APELI

Neni 422

E drejta e apelit

(Ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Prokurori, i pandehuri dhe, paditësi dhe i padituri civil kanë të drejtë të apelojnë vendimet e gjykatës së shkallës së parë.

Neni 423

Apeli kundërshtues

1. Pala që nuk ka bërë ankim brenda afatit mund të bëjë apel kundërshtues brenda pesë ditëve nga dita kur ka marrë njoftimin për

apelin e palës tjetër.

2. Apeli kundërshtues paraqitet dhe njoftohet sipas rregullave të përgjithshme për ankimet.

3. Apeli kundërshtues i prokurorit nuk ka efekt për bashkëtepandehurin joapelues që nuk ka bërë apel.

4. Apeli kundërshtues e humbet fuqinë në rast mospranimi për shqyrtim të apelit të palës tjetër ose të heqjes dorë prej tij.

Neni 424

Gjykata kompetente

(Shtuar pika 3 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar pika 3 me ligjin nr.9085, datë 19.6.2003; shfuqizuar pika 2 me ligjin nr.9911, datë 5.5.2008 dhe ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Mbi apelin e bërë kundër vendimeve të gjykatës së rrethit gjyqësor vendos gjykata e apelit.

2. Shfuqizuar.

3. Për ankimin e bërë kundër vendimeve të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar vendos Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Neni 425

Kufijtë e shqyrtimit të çështjes

(Ndryshuar pika 1, ndryshuar fjalë në shkronjën “c” të pikës 2, shtuar shkronja “ç” e fjalë në pikën 2 dhe 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht, si dhe për shkaqet e ngritura në ankim që nuk bazohen në motive personale, gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtepandehurve që nuk kanë bërë apel.

2. Kur apelues është prokurori ose viktima akuzuese, gjykata e apelit:

a) mund t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë, të ndryshojë llojin ose ta rrisë masën e dënimit, të ndryshojë masat e sigurimit dhe të marrë çdo masë tjetër që urdhëron ose lejon ligji;

b) mund t'i japë dënim atij që është deklaruar i pafajshëm, t'i japë pafajësi për një shkak të ndryshëm nga ai që pranohet në vendimin e apeluar, të marrë masat e treguara në shkronjën "a";

c) mund të zbatojë, të ndryshojë ose të përjashtojë dënimet plotësuese ose dënimet alternative;

ç) mund t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë se ai i kërkuar nga prokurori kur çështja është në kompetencën e saj lëndore. Në këtë rast, gjykata riçel shqyrtimin gjyqësor dhe zbaton parashikimet e paragrafit 2, të nenit 375, të këtij Kodi.

3. Kur apeluar është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar dhe as t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë.

Neni 426

Veprimet paraprake të gjykimit

1. Kryetari i kolegjit të gjykatës së apelit urdhëron thirrjen e të pandehurit, paditësit civil dhe të paditurit civil, si dhe të mbrojtësve e të përfaqësuesve të tyre. Afati i paraqitjes nuk mund të jetë më i vogël se dhjetë ditë.

2. Urdhri i thirrjes është i pavlefshëm kur i pandehuri nuk është identifikuar në mënyrë të sigurtë ose kur nuk është saktësuar vendi, dita dhe ora e paraqitjes.

Neni 426/a

Shqyrtimi gjyqësor në gjykatën e apelit

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Përpara se të fillojë shqyrtimin gjyqësor, kryetari i trupit

grykues kontrollon paraqitjen e palëve. Në rast se palët nuk janë paraqitur, kryetari verifikon nëse njoftimet janë të rregullta dhe nëse mungesa është e justifikuar.

2. Pas verifikimit të palëve dhe legjitimit të tyre, grykata shpall trupin grykues dhe deklaron të hapur diskutimin.

3. Kryetari ose anëtari i trupit grykues relaton në mënyrë të përmbledhur dosjen gryqësore dhe shkaqet e ngritura në ankim.

4. Kur është bërë ankim vetëm nga njëra prej palëve, fjalën e para e merr ajo. Kur kanë bërë ankim si prokurori, ashtu dhe i pandehuri, i pari e merr fjalën prokurori.

5. Në shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysht, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e grykimit në shkallë të parë.

6. Grykata mund të urdhërojë palët që të parashtrojnë pretendimet e tyre në mënyrë të përmbledhur, duke caktuar edhe kohën e vlerësuar të mjaftueshme. Palët nuk mund të parashtrojnë në seancë shkaqe tej atyre të ngritura në apel.

Neni 427

Përsëritja e shqyrtimit gryqësor

(Shtuar e ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur një palë në aktin e apelit ose plotësimin e tij, kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gryqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja, grykata në qoftë se çmon se nuk mund të vendosë në gjendjen që janë aktet, përsërit shqyrtimin gryqësor.

2. Për provat që zbulohen pas grykimit të shkallës së parë ose të atyre që dalin aty për aty, grykata vendos, sipas rastit, marrjen ose jo të tyre.

3. Përsëritja e shqyrtimit gryqësor vendoset edhe kryesisht kur grykata e çmon të domosdoshme.

4. Kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, grykata e apelit

nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor.

5. Për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, të vendosur në bazë të paragrafëve të mësipërm, procedohet menjëherë dhe kur kjo nuk është e mundur, shqyrtimi gjyqësor shtyhet për një afat jo më të gjatë se dhjetë ditë.

Neni 428

Vendimi i gjykatës së apelit

(Hequr fjalë në shkronjën “c” dhe “ç” e ndryshuar fjalë në shkronjën “ç” të pikës 1 dhe shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata e apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos:

- a) lënien në fuqi të vendimit;
- b) ndryshimin e vendimit;
- c) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes kur janë rastet që nuk lejojnë fillimin ose vazhdimin e procedimit;

ç) prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete, me numrin e gjyqtarëve që është i domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod, me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, me pjesëmarrjen e të pandehurit, të mbrojtësit të tij, ose përfaqësuesit të viktimës akuzuese, me shkeljen e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja, si dhe në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet menjëherë gjykatës së shkallës së parë.

Neni 429

Kthimi i akteve gjykatës së shkallës së parë

(Hequr fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur vendoset sipas pikës “ç” të nenit 428, gjykata e apelit

urdhëron dërgimin e akteve një kolegji tjetër të së njëjtës gjykatë.

2. Kur nuk është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, fashikulli me aktet i dërgohet gjykatës që ka dhënë vendimin.

Neni 430

Disponimet lidhur me ekzekutimin e detyrimit civil

Me kërkesën e paditësit civil, gjykata e apelit mund të vendosë për ekzekutimin e përkohshëm të detyrimit kur gjykata e shkallës së parë nuk është shprehur ose e ka refuzuar kërkesën. Ajo mund të vendosë, gjithashtu, pezullimin e ekzekutimit të detyrimit kur ka rrezik që të ndodhë një dëm i rëndë dhe i pandreqshëm.

Neni 430/1

Shpallja dhe depozitimi i vendimit

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Vendimi shpallet në seancë nga kryetari ose një anëtar i trupit gjykues me anë të leximit të dispozitivit.

2. Pas dispozitivit kryetari lexon vendimin e arsyetuar. Arsyetimi i vendimit mund të jepet me shkrim edhe në mënyrë të përmbledhur, duke treguar shkaqet kryesore mbi të cilat bazohet vendimi. Në këtë rast gjykata u jep palëve në seancë vendimin e përmbledhur me shkrim.

3. Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas shpalljes. Nëpunësi i caktuar vë nënshkrimin dhe shënon datën e depozitimit.

4. Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

5. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikës 4, të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës.

KREU III
REKURSI NË GJYKATËN E LARTË

SEKSIONI I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 431

Rekursi i drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë

(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Neni 432

Rekursi kundër vendimeve të gjykatës së apelit

(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 dhe nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe:

a) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;

b) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave;

c) kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

2. Kur e çmon të nevojshme, gjykata u kërkon palëve memorie me shkrim.

Neni 432/a

Rekursi në interes të ligjit

(Shtuar me ligjin nr.8180, datë 23.12.1996 dhe shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.55, datë 21.11.1997)

Neni 433

Mospranimi i rekursit

(Shtuar shenja e pikësimit dhe fjalia në pikën 1 e ndryshuar e bequr fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, si dhe kur Gjykata e Lartë çmon se çështja nuk duhet të shqyrtohet prej saj, sipas përcaktimeve të paragrafit 1, të nenit 432, të këtij Kodi.

2. Mospranimi i rekursit vendoset nga një trup gjykues me tre gjyqtarë në dhomën e këshillimit.

Neni 434

Kufijtë e shqyrtimit në Gjykatën e Lartë

(Ndryshuar pika 1 dhe shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në recurs.

2. Nëse recursi pranohet për shqyrtim, Gjykata e Lartë ka të drejtë të vendosë edhe për çështje të ligjit që konstatohen kryesisht.

Neni 435

Paraqitja e rekursit

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Rekursi duhet të paraqitet me shkrim brenda 45 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës së apelit.

2. Akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi, nga mbrojtësit. Kur i pandehuri nuk ka mbrojtës të zgjedhur, kryetari i kolegjit cakton një mbrojtës kryesisht dhe në këtë rast lajmërimet i bëhen edhe të pandehurit.

SEKSIONI II SHQYRTIMI NË GJYKATËN E LARTË

Neni 436

Veprimet paraprake

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kryetari i Gjykatës së Lartë cakton kolegjet përkatëse për shqyrtimin e rekurseve.
2. Kryetari i kolegjit cakton datën për shqyrtimin e rekursit.
3. Sekretaria e gjykatës njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykimit të paktën 30 ditë përpara. Kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara apo të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresa.

Neni 437

Shqyrtimi gjyqësor

(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata e Lartë gjykon çështjet me përbërje sipas përcaktimeve të nenit 14/a të këtij Kodi.
2. Normat që lidhen me publicitetin, rregullin e seancës dhe me drejtimin e diskutimit në gjykimet e shkallës së parë dhe të dytë respektohen në Gjykatën e Lartë, për aq sa janë të zbatueshme.
3. I pandehuri dhe palët private përfaqësohen nga mbrojtësit.
4. Kryetari i kolegjit bën verifikimin e legjitimitetit të palëve dhe të rregullsisë së lajmërimeve.

5. Gjyqtari i ngarkuar relatton çështjen. Pas fjalës së prokurorit, mbrojtësit dhe përfaqësuesit e palëve private bëjnë mbrojtjen. Replika nuk lejohet.

Neni 438

Ndryshimi i praktikës gjyqësore

(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar titulli, pika 1 dhe 3 e shtuar fjalë në pikën 4, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata e Lartë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur lind nevoja për ndryshimin e praktikës gjyqësore, ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në kolegjet e bashkuara çështje të ardhura për gjykim në Kolegjin Penal.

2. Tërheqja e çështjeve bëhet me vendim të Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjit Penal.

3. Kolegjet e bashkuara gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin kur marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

4. Vendimi i Kolegjit Penal dhe kolegjeve të bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme.

SEKSIONI III

VENDIMI

Neni 439

Marrja e vendimit

1. Vendimi merret menjëherë pas mbarimit të seancës, me përjashtim të rasteve kur për shkak të natyrës së ndërlikuar ose të rëndësisë së çështjes kryetari i kolegjit e çmon të domosdoshme ta shtyjë marrjen e vendimit për aq ditë sa është e nevojshme.

2. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e kolegjit dhe shpallet në seancë duke u lexuar nga kryetari ose një gjyqtar.

Neni 440

Zbatimi i detyrueshëm i detyrave të vendimit

1. Detyrat dhe konkluzionet e vendimit të Gjykatës së Lartë janë të detyrueshme për gjykatën që rishqyrton çështjen.

Neni 441

Vendimet e Gjykatës së Lartë

(Shtuar shkronja “d” me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Pas shqyrtimit të çështjes Kolegji Penal ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin në seancë gjyqësore:

- a) lënien në fuqi të vendimit;
- b) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
- c) prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rishqyrtim;
- ç) prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim.

Neni 442

Prishja e vendimit dhe zgjidhja e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim

(Shfuqizuar shkronjat “b” dhe “c” e ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata e Lartë vendos prishjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim kur:

- a) fakti nuk parashikohet si vepër penale, vepra penale është shuar ose ndjekja penale nuk duhet të fillonte e të vazhdonte;
- b) shfuqizuar
- c) shfuqizuar
- ç) ka kontradikta midis vendimit të ankimuar dhe një tjetri të mëparshëm, lidhur me të njëjtin person dhe me të njëjtën vepër penale,

të dhëna nga e njëjta ose një tjetër gjykatë penale.

2. Në rastin e parashikuar nga shkronja “a” gjykata vendos pushimin e çështjes, kurse në rastin e parashikuar nga shkronja “ç” vendos që të zbatohet vendimi që ka caktuar dënimin më pak të rëndë.

Neni 443

Prishja e vendimit dhe kthimi i akteve për rishqyrtim

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 442 Gjykata e Lartë, kur prish një vendim ia dërgon aktet gjykatës që ka dhënë vendimin e prishur.

2. Kur prishja nuk është bërë për të gjitha disponimet e vendimit, Gjykata e Lartë deklaron në dispozitiv se cilat pjesë të vendimit prishen.

Neni 444

Prishja e vendimit vetëm për pasojat civile

1. Kur prish vetëm disponimet ose pikat që kanë të bëjnë me padinë civile ose kur pranon rekursin e paditësit civil kundër vendimit të pafajësisë së të pandehurit, Gjykata e Lartë ia dërgon aktet përkatëse gjykatës civile kompetente.

Neni 445

Ndreqja e gabimeve

1. Gabimet ligjore në arsyetimin e vendimit ose tregimi i gabuar i tekstit të ligjit nuk sjellin prishjen e vendimit të ankimuar, në qoftë se nuk kanë pasur ndikim vendimtar mbi dispozitivin. Por, gjykata specifikon në vendim gabimet dhe ndreqjet e duhura.

Neni 446

Pasojat e vendimit mbi masat e sigurimit

1. Kur në bazë të vendimit të Gjykatës së Lartë duhet të pushojë

vazhdimi i një burgimi, ose i një dënimi plotësues, ose një mase sigurimi, sekretaria ia komunikon menjëherë dispozitivin e vendimit prokurorit pranë gjykatës përkatëse.

Neni 447

Rigjykimi pas prishjes

1. Në rigjykim nuk lejohet diskutimi i kompetencës së njohur me vendimin e prishjes.
2. Gjykata e rigjykimit i përmbahet vendimit të Gjykatës së Lartë për çdo çështje të së drejtës që është vendosur me të.
3. Në rigjykim nuk mund të ngrihen pavlefshmëritë e vërtetuara në gjykimet e mëparshme ose gjatë hetimeve paraprake.
4. Prishja e vendimit vlen edhe për të pandehurin që nuk ka bërë rekurs, përveçse kur shkaku i prishjes është personal.

Neni 448

Ankimi kundër vendimit të gjykatës së rigjykimit

1. Vendimi i gjykatës së rigjykimit mund të ankimohet me rekurs në Gjykatën e Lartë kur është dhënë nga gjykata e apelit dhe me apel kur është dhënë nga gjykata e shkallës së parë.
2. Vendimi i gjykatës së rigjykimit mund të ankimohet vetëm për shkaqet që nuk lidhen me pikat e vendosura nga Gjykata e Lartë ose për mosrespektimin e nenit 447, paragrafi 2.

Neni 448/1

Shpallja dhe depozitimi i vendimit

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Vendimi shpallet në seancë nga kryetari ose një anëtar i trupit gjykues me anë të leximit të dispozitivit.
2. Pas dispozitivit kryetari lexon vendimin e arsyetuar. Arsyetimi i vendimit mund të jepet me shkrim edhe në mënyrë të përmbledhur,

duke treguar shkaqet kryesore mbi të cilat bazohet vendimi.

3. Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas shpalljes. Nëpunësi i caktuar vë nënshkrimin dhe shënon datën e depozitimit.

4. Kur shpallet i përmbledhur, vendimi arsyetohet brenda 60 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar nga Kolegjet e Bashkuara.

5. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikës 4, të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës.

KREU IV RISHIKIMI

Neni 449

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ky Kod, rishikimi i vendimeve që kanë marrë formë të prerë lejohet në çdo kohë, edhe kur dënimi është ekzekutuar ose shuar.

2. Nuk lejohet rishikimi i vendimit të pafajësisë dhe as rishikimi i vendimit të dënimit kur synohet rëndimi i pozitës së të dënuarit.

Neni 450

Rastet e rishikimit

(Shtuar fjalë në shkronjën “b” e shkronjat “d”, “dh” dhe “e” në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Rishikimi mund të kërkohet:

a) kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë;

b) kur vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës civile ose administrative, i cili është revokuar më pas;

c) kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë

se vendimi është i gabuar;

ç) kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjyqimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale.

d) kur shkakua për rishikimin e vendimit të formës së prerë rezulton nga një vendim i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut që e bën të domosdoshëm rigjykimin e çështjes. Kërkesa paraqitet brenda 6 muajve nga njoftimi i vendimit;

dh) kur ekstradimi i të dënuarit të gjykuar në mungesë jepet me kushtin e shprehur të rigjyqimit të çështjes. Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda tridhjetë ditëve nga data kur personi është ekstraduar. Kërkesa e paraqitur brenda afatit nuk mund të refuzohet;

e) kur personi është gjykuar në mungesë sipas nenit 352 të këtij Kodi dhe kërkon rigjykimin e çështjes. Kërkesa paraqitet brenda tridhjetë ditëve nga data e marrjes dijeni. Kërkesa e paraqitur brenda afatit nuk mund të refuzohet.

Neni 451

Kërkesa e rishikimit

(Shtuar fjalë në shkronjën "a" të pikës 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Mund të kërkojnë rishikimin:

- a) i dënuari, mbrojtësi i autorizuar posaçërisht prej tij ose kujdestari i tij, dhe kur ai ka vdekur, trashëgimtari ose një i afërm i tij;
- b) prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin.

Neni 452

Forma e kërkesës

(Ndryshuar pikat 1 e 3 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe 3 e shtuar shkronjat "d" dhe "dh" me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kërkesa e rishikimit bëhet personalisht ose nëpërmjet

përfaqësuesit. Ajo duhet të përmbajë provat që e përlligjin dhe duhet të paraqitet, bashkë me dokumentet eventuale, në sekretarinë e gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin.

2. Në rastet e parashikuara nga neni 450, paragrafi 1, shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh” kërkesës duhet t’i bashkohen kopjet e vërtetuara të akteve të përmendura në to.

3. Në rast vdekje të të gjykuarit pas paraqitjes së kërkesës së rishikimit, gjykata cakton një kujdestar, i cili ushtron të drejtat që në procesin e rishikimit do t’i takonin të gjykuarit.

Neni 453

Shqyrtimi i kërkesës

(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002; bequr fjalë në titull e në pikën 3, ndryshuar fjalë në pikën 2 dhe 3 e shtuar pika 4 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kërkesa e rishikimit shqyrtohet nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve.

2. Kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 450 ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë ose kur rezulton haptazi e pambështetur, gjykata vendos mospranimin e saj.

3. Kur kërkesa pranohet, gjykata vendos dërgimin e çështjes për rigjykim nga një tjetër trup gjykues i së njëjtës gjykatë ose në gjykatën e apelit, kur kërkesa është bërë vetëm kundër vendimit të saj. Kundër vendimit nuk lejohet ankim.

4. Deri në dhënien e vendimit nga gjykata e rishikimit, sipas nenit 456, të këtij Kodi, i dënuari ruan të njëjtën pozitë procedurale.

Neni 454

(Ndryshuar me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002; ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata që pranon kërkesën mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të dënimit.

2. Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit, vendimi i së cilës është i paankimueshëm.

3. Me kërkesë të të paditurit civil, gjykata e ngarkuar me rigjykimin e çështjes mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të detyrimeve civile për aq kohë sa zgjat gjykimi.

Neni 455

Gjykimi i rishikimit

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

1. Gjykata, e caktuar për rigjykimin e çështjes, cakton datën e seancës gjyqësore dhe urdhëron thirrjen e palëve.

2. Respektohen dispozitat e gjykimit të shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve të parashtruara në kërkesën e rishikimit.

Neni 456

Vendimi

1. Vendimi merret sipas dispozitave për marrjen e vendimit nga gjykata e shkallës së parë.

2. Kur pranohet kërkesa e rishikimit, gjykata prish vendimin. Nuk mund të jepet vendim vetëm duke bërë një vlerësim tjetër të provave të marra në gjykimin e mëparshëm.

3. Kur rrëzohet kërkesa, gjykata detyron atë që e ka bërë me shpenzimet procedurale dhe kur është urdhëruar pezullimi, vendos rivënien në ekzekutim të dënimit ose të masës së sigurimit.

4. Me kërkesën e të interesuarit, vendimi i pafajësisë afishohet i shkurtuar në rrethin ku është dhënë vendimi dhe në vendbanimin e fundit të të dënuarit. Kryetari i gjykatës mund të urdhërojë që ky vendim të shpallet në një gazetë të caktuar.

Neni 457

Disponimet në rastin e pranimit të kërkesës

(Ndryshuar me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002)

1. Gjykata, kur jep vendim pafajësie, urdhëron kthimin e shumave të paguara për ekzekutimin e dënimit me gjobë, për shpenzimet procedurale, heqjen e masave të sigurimit pasuror, si dhe për shpërblimin e dëmeve në dobi të paditësit civil që ka marrë pjesë në gjykimin e rishikimit. Ajo urdhëron edhe kthimin e sendeve që janë konfiskuar, me përjashtim të sendeve, prodhimi, përdorimi, transportimi, mbajtja e të cilave përbën vepër penale.

Neni 458

Ankimi kundër vendimit

(Ndryshuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

1. Vendimi i dhënë në gjykimin e rishikimit mund të ankimohet.

Neni 459

Kompensimi për dënim të padrejtë

(Ndryshuar pika 5 me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

1. Ai që ka marrë pafajësinë gjatë rishikimit, kur nuk ka dhënë shkak me dashje ose pakujdesi të rëndë për gabimin gjyqësor, ka të drejtë për një kompensim në përpjesëtim me kohëzgjatjen e dënimit dhe me pasojat personale dhe familjare që rrjedhin nga dënimi.

2. Kompensimi bëhet me pagimin e një shume parash ose me dhënien e një të ardhure jetësore.

3. Kërkesa për kompensim bëhet, me pasojë mospranimi, brenda dy vjetëve nga dita që vendimi i rishikimit ka marrë formë të prerë dhe paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin.

4. Kërkesa i komunikohet prokurorit dhe të gjithë të interesuarve.

5. Kundër vendimit për kompensim mund të bëhet ankim.

Neni 460

Kompensimi në rast vdekje

1. Kur i dënuari vdes, qoftë edhe para procedimit të rishikimit, e drejta për kompensim u përket trashëgimtarëve të tij. Këtë të drejtë nuk e përfitojnë trashëgimtarët e padenjë.

Neni 461

Pasojat e mospranimit ose të rrëzimit të kërkesës së rishikimit

1. Mospranimi i kërkesës ose vendimi që e rrëzon atë nuk cenon të drejtën e paraqitjes së një kërkesë të re të bazuar në prova të tjera.

TITULLI IX

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE

KREU I

VËNIA NË EKZEKUTIM E VENDIMEVE

Neni 462

Vendimet e ekzekutueshme

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë.

2. Vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes.

3. Janë vendime të formës së prerë:

a) vendimi i gjykatës së shkallës së parë kur nuk ankimohet nga

palët brenda afatit ligjor, kur është i paankimueshëm ose kur nuk pranohet ankimi për shkaqet e parashikuara nga neni 420 i këtij Kodi. Në çështjet me bashkëtëpandehur, vendimi merr formë të prerë për të pandehurin që nuk ka bërë ankim, pavarësisht ankimit të bashkëtëpandehurve të tjerë, me kusht që prokurori të mos ketë bërë ankim. Kur prokurori nuk ka ushtruar ankim dhe çështja shqyrtohet mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurve të tjerë, për të pandehurin që nuk ka ushtruar ankim në një gjykim me bashkëtëpandehur, vendimi merr formë të prerë pavarësisht ankimit të ushtruar nga bashkëtëpandehurit e tjerë;

b) vendimi i gjykatës së apelit kur zgjidh përfundimisht çështjen, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 428, të këtij Kodi;

c) vendimi i Gjykatës së Lartë në rastet e ekstradimit dhe transferimit të personave të dënuar.

4. Mënyra e ekzekutimit të vendimeve penale rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 462/a

Vënia në ekzekutim e vendimeve për të miturit

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Prokurori dhe gjykata e seksioneve për të miturit pranë gjykatave të rretheve gjyqësore janë kompetente për marrjen e masave dhe shqyrtimin e kërkesave që lidhen me ekzekutimin e vendimeve të dhëna ndaj të miturve.

2. Mënyra e ekzekutimit të masave dhe çdo vendimi të dhënë ndaj të miturve, përveç sa parashikohet në këtë Kod, rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 463

Veprimet e prokurorit

1. Prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë

vendimin, merr masa për ekzekutimin e vendimit. Ai bën kërkesa në gjykatën kompetente dhe ndërhyt në të gjitha veprimet e ekzekutimit.

2. Vendimet e prokurorit i njoftohen, brenda tridhjetë ditëve, mbrojtësit të caktuar nga i interesuari ose, kur nuk ka të tillë, atij të caktuar nga prokurori.

3. Kur është e nevojshme, prokurori mund të kërkojë kryerjen e veprimeve të veçanta nga prokurori i një rrethi tjetër.

4. Kur fillon ekzekutimi, prokurori njofton me shkrim gjykatën që ka dhënë vendimin.

Neni 464

Ekzekutimi i vendimeve me burgim

1. Për ekzekutimin e një vendimi me burgim, prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit.

2. Urdhri i ekzekutimit përmban gjeneralitetet e të dënuarit, dispozitivin e vendimit dhe disponimet e nevojshme për ekzekutimin.

3. Kur i dënuari është i paraburgosur, urdhri i dërgohet organit shtetëror që administron burgjet dhe i njoftohet të interesuarit, ndërsa kur i dënuari nuk është i paraburgosur urdhërohet burgimi i tij.

4. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për rastet e ekzekutimit të vendimeve të mbylljes së detyrueshme në institucione mjekësore ose edukimi.

Neni 465

Llogaritja e paraburgimit dhe e dënimeve të shlyera

1. Në caktimin e kohës së dënimit me burgim, prokurori llogarit periudhën e paraburgimit të vuajtur për të njëjtën vepër ose për një vepër penale tjetër, periudhën e dënimit me burgim të shlyer për një vepër penale tjetër, kur dënimi përkatës është revokuar ose kur për veprën penale është dhënë amnisti apo falje.

2. Në çdo rast llogariten vetëm paraburgimi ose dënimi i shlyer pas kryerjes së veprës penale, për të cilën duhet të caktohet dënimi

që do të ekzekutohet.

3. Pasi bën llogaritjet, prokurori nxjerr urdhrin, i cili i njoftohet të dënuarit dhe mbrojtësit të tij.

Neni 466

Ekzekutimi i masave të sigurimit të urdhëruara nga gjykata

1. Masat e sigurimit të urdhëruara nga gjykata, ekzekutohen nga prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin.

Neni 467

Ekzekutimi i dënimeve me gjobë

1. Vendimet që përmbajnë dënimin me gjobë ekzekutohen nga zyra e përmbarimit.

2. Kur vërtetohet pamundësia e marrjes së gjobës ose e një pjese të saj, prokurori i bën kërkesë gjykatës që ka dhënë vendimin për të bërë konvertimin. Me kërkesën e të dënuarit, gjykata mund ta shtyjë konvertimin deri në gjashtë muaj. Kjo periudhë nuk llogaritet në afatet e parashkrimit.

3. Kundër vendimit të konvertimit mund të bëhet ankim, i cili pezullon ekzekutimin e tij.

Neni 468

Ekzekutimi i dënimeve plotësuese

1. Për ekzekutimin e dënimeve plotësuese, prokurori u dërgon shkurtimin e vendimit të dënimit organeve të policisë gjyqësore dhe organeve të tjera të interesuara.

Neni 469

Ekzekutimi i disa dënimeve

1. Kur i njëjti person është dënuar me disa vendime për vepra

penale të ndryshme, prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin e fundit i kërkon gjykatës që të caktojë dënimin që duhet të ekzekutohet, duke respektuar normat mbi bashkimin e dënimeve.

2. Kërkesa e prokurorit i njoftohet të dënuarit dhe mbrojtësit të tij.

KREU II SHQYRTIMI NGA GJYKATA I ÇËSHTJEVE QË LIDHEN ME EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE

Neni 470

Gjykata kompetente për ekzekutimin

*(Ndryshuar fjalë në pikën 1 e shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017,
datë 30.3.2017)*

1. Gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij.

2. Shfuqizuar.

Neni 471

Mënyra e procedimit nga gjykata

*(Pika 5 numërohet pika 6 e shtuar pika 5, me ligjin nr. 35/2017,
datë 30.3.2017)*

1. Gjykata procedon me kërkesën e prokurorit, të interesuarit ose të mbrojtësit.

2. Kur kërkesa është haptazi e pabazuar ose përsëritje e një kërkesë të rrëzuar, të mbështetur mbi të njëjtat shkaqe, gjykata, pasi dëgjon prokurorin e deklaron atë të papranueshme me vendim, i cili i njoftohet brenda pesë ditëve të interesuarit. Kundër vendimit mund të bëhet ankim.

3. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga paragrafi 2, gjykata cakton datën e seancës dhe lajmëron palët dhe mbrojtësit, të

paktën dhjetë ditë para seancës.

4. Seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësve. I interesuari, kur e kërkon, dëgjohet personalisht ose me letërporosi.

5. Kur kërkuesi nuk paraqitet në seancë pa ndonjë shkak të arsyeshëm, megjithëse ka dijeni rregullisht për datën dhe orën e saj, heq dorë nga kërkesa, ose ndryshon objektin e saj, gjykata e deklaron atë të papranueshme.

6. Gjykata merr vendim, i cili u njoftohet palëve edhe mbrojtësve. Kundër vendimit mund të bëhet ankim, por ai nuk e pezullon ekzekutimin, përveçse kur gjykata që e ka dhënë vendos ndryshe.

Neni 472

Dyshimi për identitetin fizik të personit të burgosur

1. Kur ka arsye për të dyshuar mbi identitetin e personit të arrestuar për ekzekutimin e dënimit, gjykata e merr në pyetje, kryen hetimet e nevojshme për identifikimin e tij dhe merr vendim, i cili i njoftohet të interesuarit.

2. Kur konstaton se ai nuk është personi ndaj të cilit duhet të bëhet ekzekutimi, gjykata urdhëron menjëherë lirimin e tij. Në qoftë se identiteti mbetet i paqartë, ajo urdhëron pezullimin e ekzekutimit, lirimin e të burgosurit dhe njofton prokurorin që të bëjë hetime të mëtejshme.

3. Kur është i qartë gabimi për identitetin e personit, prokurori urdhëron lirimin e tij dhe i dërgon menjëherë aktet gjykatës.

Neni 473

Gabimi në emër

1. Kur një person është dënuar në vend të një tjetri për gabim në emër, gjykata vendos korigjimin vetëm kur personi kundër të cilit duhej të procedohej është thirrur si i pandehur edhe me një emër tjetër në gjykim. Në rast të kundërt vendoset rishikimi i çështjes në bazë të nenit 450, paragrafi 1, shkronja “c”. Në çdo rast ekzekutimi

kundër personit të dënuar gabimisht pezullohet.

Neni 474

Disa vendime për të njëjtin fakt

1. Kur disa vendime janë dhënë kundër të njëjtit person për të njëjtin fakt, gjykata urdhëron ekzekutimin e vendimit me të cilin është dhënë dënimi më i lehtë, duke i deklaruar të tjerët të pazbatueshëm. Kur dënimet kryesore janë të barabarta, mbahet parasysht dënimi plotësues.

2. Kur ka disa vendime pushimi ose pafajësie, i interesuari tregon vendimin që duhet ekzekutuar dhe kur ai nuk e bën këtë, prokurori për rastin e pushimit dhe gjykata për rastin e pafajësisë, urdhërojnë ekzekutimin e vendimit më të favorshëm.

3. Kur bëhet fjalë për një vendim pafajësie dhe për një vendim dënimi, gjykata urdhëron ekzekutimin e vendimit të pafajësisë, duke revokuar vendimin e dënimit, ndërsa kur është fjala për një vendim mosfillimi të dhënë nga prokurori dhe një vendim të dhënë në gjykim, gjykata urdhëron ekzekutimin e vendimit të dhënë në gjykim.

Neni 475

Bashkimi i dënimeve

1. Në rastin e disa vendimeve, të dhëna në procedime të ndryshme kundër të njëjtit person, i dënuari ose prokurori mund të kërkojnë nga gjykata zbatimin e rregullave për bashkimin e dënimeve.

Neni 476

Shtyrja e ekzekutimit të vendimit

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjkata që ka dhënë vendimin e dënimit, me kërkesën e të dënuarit, të mbrojtësit ose të prokurorit, mund të vendosë shtyrjen e ekzekutimit të vendimit në këto raste:

a) kur i dënuari vuan nga një sëmundje që pengon ekzekutimin

e vendimit. Ekzekutimi shtyhet gjer në shërimin e të dënuarit;

b) kur e dënuara është shtatzënë ose me fëmijë nën një vjeç. Ekzekutimi shtyhet gjer sa fëmija të bëhet një vjeç;

c) kur vuajtja e menjëhershme e dënimit mund të sjellë pasoja të rënda për të dënuarin ose familjen e tij. Shtyrja e ekzekutimit në këto raste nuk mund të zgjatet më tepër se gjashtë muaj;

ç) në çdo rast tjetër që çmohet nga gjykata si i veçantë, duke u shtyrë ekzekutimi gjer në tre muaj.

2. Me paraqitjen e kërkesës gjykata ka të drejtë të pezullojë ekzekutimin e vendimit gjer në shqyrtimin e saj.

3. Gjkata arsyeton vendimin brenda 5 ditëve. Kundër vendimit lejohet ankim brenda 5 ditëve. Gjkata e apelit vendos mbi ankimin brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve.

Neni 477

Lirimi me kusht

1. Gjkata e vendit të ekzekutimit vendos për lirimin me kusht dhe revokimin e vendimit të lirimit me kusht, sipas kriterëve të caktuara në Kodin Penal.

2. Kërkesa nuk mund të përsëritet para se të kenë kaluar gjashtë muaj nga dita kur vendimi i rrëzimit të kërkesës ka marrë formë të prerë.

Neni 478

Lirimi i të burgosurit

(Shfuqizuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Neni 479

Revokimi i vendimit për shkak të shfuqizimit të veprës penale

(Shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Në rastin e shfuqizimit ose të deklarimit të paligjshmërisë kushtetuese të normës penale, gjykata revokon vendimin e dënimit, duke deklaruar se fakti nuk parashikohet si vepër penale. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe kur është dhënë vendim mosfillimi ose pafajësie

për shkak të shuarjes së veprës penale.

2. Kërkesa shqyrtohet menjëherë dhe në çdo rast jo më vonë se 24 orë nga momenti i depozitimit të kërkesës nga gjykata ku është paraqitur ajo, edhe nëse kjo e fundit nuk është kompetente nga pikëpamja tokësore.

Neni 480

Kompetenca të tjera

1. Në fazën e ekzekutimit, gjykata është kompetente të vendosë për shuarjen e veprës penale pas dënimit, për shuarjen e dënimit, për dënimet plotësuese, për konfiskimin ose kthimin e sendeve të sekuestruara, si dhe për çdo rast të parashikuar me ligj.

2. Kur vërtetohet shuarja e veprës penale ose të dënimit, gjykata e deklaron këtë edhe kryesisht, duke marrë masat përkatëse.

KREU III

GJENDJA GJYQËSORE

Neni 481

Zyra e gjendjes gjyqësore

(Shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Pranë Ministrisë së Drejtësisë, në zyrën e regjistrit gjyqësor, depozitohen shkurtimet e vendimeve për personat e gjykuar penalisht.

2. Gjkata e shkallës së parë dërgon në zyrën e regjistrit gjyqësor shkurtimin e vendimit të dënimit brenda 10 ditëve nga data që vendimi merr formë të prerë, kur ndaj tij nuk ushtrohet ankim dhe brenda 10 ditëve nga data e mbërritjes së akteve, kur ndaj vendimit është ushtruar ankim.

Neni 482

Shënimet në regjistrin gjyqësor

1. Në regjistrin gjyqësor regjistrohen me shkurtim:
 - a) vendimet e dënimit me të marrë formë të prerë;
 - b) vendimet e dhëna nga gjykata në fazën e ekzekutimit;
 - c) vendimet që lidhen me zbatimin e vendimeve plotësuese;
 - ç) vendimet gjyqësore të pafajësisë e të pushimit të çështjes.

Neni 483

Heqja e shënimeve

(Shtuar shkronja “ç” me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Shënimet në regjister hiqen pas marrjes së njoftimit zyrtar të vdekjes së personit, të cilit i referohen kur ai bëhet tetëdhjetë vjeç.

2. Hiqen edhe shënimet lidhur me:

a) vendimet e revokuara për shkak të rishikimit ose të shfuqizimit të veprës penale;

b) vendimet e pafajësisë ose të pushimit kur kanë kaluar dhjetë vjet nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë;

c) vendimet e dënimit për kundërvajtje kur është dhënë dënimi me gjobë, me kalimin e dhjetë vjetëve nga dita kur vendimi është ekzekutuar.

ç) masat dhe vendimet e dënimit për kundërvajtje penale të kryera nga të miturit, kur ata arrijnë moshën 21 vjeç.

Neni 484

Vërtetimet e gjendjes gjyqësore

1. Organet e drejtësisë, të administratës shtetërore dhe entet e ngarkuara me shërbime publike kanë të drejtë të marrin vërtetimin e shënimeve për një person të caktuar, kur vërtetimi është i nevojshëm për kryerjen e funksioneve të tyre.

2. Prokurori mund të kërkojë vërtetimin e sipërm për të pandehurin ose të dënuarin dhe, me autorizim të gjykatës ai dhe mbrojtësi mund të kërkojnë vërtetim edhe për personin e dëmtuar dhe dëshmitarët.

3. Personi të cilit i referohet shënimi në regjistër ka të drejtë të marrë vërtetimin përkatës pa qenë i detyruar të tregojë shkaqet në kërkesë.

KREU IV SHPENZIMET PROCEDURALE

Neni 485

Shpenzimet e bëra nga shteti

1. Shpenzimet procedurale penale parapagohen nga shteti, me përjashtim të atyre që lidhen me aktet e kërkuara nga palët private.

2. Në shpenzimet procedurale përfshihen shpenzimet e bëra në të gjitha fazat e procedimit për këqyrjet, eksperimentet, ekspertimet, njoftimet, për mbrojtësit e caktuar kryesisht dhe çdo shpenzim tjetër i dokumentuar rregullisht.

3. Në vendimin përfundimtar gjykata cakton detyrimin për pagimin e shpenzimeve të parapaguara nga shteti.

Neni 486

Pagimi i shpenzimeve procedurale

1. Detyrimi për shpenzimet procedurale ekzekutohet nga zyra e përmbarimit.

2. Në rastin e paaftësisë paguese zyra e përmbarimit njofton policinë financiare, e cila merr të dhëna për gjendjen reale të të detyruarit dhe për çdo ndryshim të saj.

Neni 487

Zgjidhja e ankesave për shpenzimet

1. Për ankesat lidhur me shpenzimet procedurale vendos gjykata që ka dhënë vendimin, e cila procedon sipas rregullave të caktuara në

nenin 471.

TITULLI X
MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET
E HUAJA

KREU I
EKSTRADIMI

SEKSIONI I
EKSTRADIMI PËR JASHTË SHETETIT

Neni 488

Kuptimi i ekstradimit

1. Dorëzimi i një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një veprë penale, mund të bëhet vetëm nëpërmjet ekstradimit.

Neni 489

Kërkesa për ekstradim

1. Ekstradimi lejohet vetëm mbi bazën e një kërkesë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

2. Kërkesës për ekstradim i bashkëngjiten:

a) kopja e vendimit të dënimit me burgim ose e aktit të procedimit;

b) një relacion mbi veprën penale që i ngarkohet personit për të cilin kërkohet ekstradimi, duke treguar kohën dhe vendin e kryerjes së veprës dhe cilësimin ligjor të saj;

c) teksti i dispozitave ligjore që do të zbatohen, duke treguar nëse për veprën për të cilën kërkohet ekstradimi është parashikuar nga ligji i shtetit të huaj dënimi me vdekje;

ç) të dhënat individuale dhe çdo informacion tjetër të mundshëm që shërben për të përcaktuar identitetin dhe shtetësinë e personit, për

të cilin kërkohet ekstradimi.

3. Kur konkurrojnë disa kërkesa ekstradimi, Ministria e Drejtësisë cakton radhën e shqyrtimit. Për këtë qëllim ajo mban parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe veçanërisht datën e marrjes së kërkesës, rëndësinë dhe vendin e kryerjes së veprës penale ose shtetësinë dhe vendbanimin e personit të kërkuar, si dhe mundësinë e një riekstradimi nga shteti kërkuar.

4. Në qoftë se për një shkelje të vetme ekstradimi kërkohet në të njëjtën kohë nga shumë shtete, ai i jepet shtetit ndaj të cilit është drejtuar vepra penale ose atij shteti mbi territorin e të cilit është kryer vepra.

Neni 490

Kushtet e ekstradimit

(Shtuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 99, datë 31.7.2014)

1. Ekstradimi lejohet me kusht të shprehur se i ekstraduari nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe as do t'i dorëzohet një shteti tjetër për një vepër penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi.

2. Kushtet e treguara nga paragrafi 1 nuk merren parasysh:

a) kur pala dorëzuese jep pëlqim të shprehur që i ekstraduari të ndiqet edhe për një vepër penale tjetër dhe i ekstraduari nuk ka kundërshtim;

b) kur i ekstraduari, edhe pse ka patur mundësi, nuk ka lënë territorin e shtetit të cilit i është dorëzuar, pasi kanë kaluar dyzet e pesë ditë nga lirimi i tij ose pasi e ka lënë atë është kthyer vullnetarisht.

3. Ministria e Drejtësisë mund të vërë edhe kushte të tjera që i çmon të përshtatshme pa tejkalluar parashikimet e akteve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe rezervat e deklarimet ligjore.

Neni 491

Mospranimi i kërkesës për ekstradim

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Nuk mund të jepet ekstradimi:

a) për një veper me karakter politik ose kur rezulton që ai kërkohej për qëllime politike;

b) kur ka arsye të mendohet se personi që kërkohej do t'u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të races, fese, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose denimeve a trajtimeve të egra, c'njerezore a poshteruese ose veprimeve që përbejnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut;

c) kur personi që kërkohej ka kryer një veper penale në Shqipëri;

c') kur ka filluar procedimi ose është gjykuar në Shqipëri edhe pse vepra është kryer jashtë shtetit;

d) kur vepra penale nuk parashikohet si e tillë nga legjislacioni shqiptar;

dh) kur për veprën penale është dhënë amnisti nga shteti shqiptar;

e) kur personi i kërkuar është shtetas shqiptar dhe nuk ka marrëveshje që të parashikojë ndryshe;

ë) kur është parashkruar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit të kërkuar;

f) kur personi i kërkuar është dënuar në mungesë, me përjashtim të rastit kur shteti kërkues jep garanci për rishikimin e vendimit.

Neni 492

Veprimet e prokurorit

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur merr nga një shtet i huaj një kërkesë ekstradimi, Ministria e Drejtësisë, në qoftë se nuk e refuzon atë, ia përcjell aktet brenda 10 ditëve prokurorit pranë gjykatës kompetente, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Prokurori pasi merr kërkesën urdhëron paraqitjen e të interesuarit për të bërë identifikimin e tij dhe për të marrë pëlqimin eventual për ekstradimin. Të interesuarit i bëhet e ditur se ka të drejtë të ndihmohet nga një mbrojtës.

3. Prokurori u kërkon autoriteteve të huaja, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, dokumentacionin dhe informacionin që çmon të nevojshëm.

4. Brenda tre muajve nga data kur ka ardhur kërkesa për ekstradim, prokurori i paraqet gjykatës kërkesën për shqyrtim.

5. Kërkesa e prokurorit depozitohet në sekretarinë e gjykatës bashkë me aktet dhe sendet e sekuestruara. Sekretaria kujdeset për njoftimin e personit për të cilin është kërkuar ekstradimi, mbrojtësit të tij dhe përfaqësuesit eventual të shtetit kërkuar, të cilët, brenda dhjetë ditëve, kanë të drejtë të shikojnë dhe të nxjerrin kopje të akteve, si dhe të këqyrin sendet e sekuestruara dhe të paraqesin memorie.

Neni 493

Masat shtrënguese dhe sekuestrimet

(Shtuar fjali në pikën 4 e pika 6 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, të paraqitur nëpërmjet prokurorit, ndaj personit për të cilin është kërkuar ekstradimi mund të merren masa shtrënguese dhe të vendoset sekuestrimi i provave materiale dhe i sendeve që i përkasin veprës penale, për të cilin është kërkuar ekstradimi.

2. Në caktimin e masave shtrënguese respektohen dispozitat e titullit V të këtij Kodi, për aq sa mund të zbatohen, duke mbajtur parasysh kërkesat për të garantuar që personi për të cilin është kërkuar ekstradimi të mos i shmanget dorëzimit.

3. Masat shtrënguese dhe sekuestroja nuk vendosen kur ka arsye të çmohet se nuk ekzistojnë kushtet për dhënien e një vendimi në favor të ekstradimit.

4. Masat shtrënguese revokohen kur brenda tre muajve nga fillimi

i ekzekutimit të tyre nuk ka përfunduar procedimi para gjykatës. Me kërkesë të prokurorit afati mund të zgjatet, por jo më shumë se një muaj, kur është e nevojshme të bëhen verifikime veçanërisht komplekse. Nëse bëhet ankim në gjykatën e apelit apo Gjykatën e Lartë, masa shtrënguese revokohet nëse gjykimi nuk ka përfunduar brenda 3 muajve nga marrja e akteve respektivisht për secilën gjykatë.

5. Kompetenca për të vendosur në bazë të paragrafëve të mësipërm i përket gjykatës së rrethit ose, gjatë procedimit para gjykatës së apelit, kësaj të fundit.

6. Gjykata që shqyrton kërkesën për caktimin e masës shtrënguese shqyrton edhe kërkesën për ekstradim. Në çdo rast, nëse Ministria e Drejtësisë e kërkon, gjykata revokon masën e sigurimit të caktuar prej saj.

Neni 494

Zbatimi i përkohshëm i masave shtrënguese

(Ndryshuar fjalë në pikën 6 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Me kërkesën e shtetit të huaj, të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë nëpërmjet prokurorit pranë gjykatës kompetente, gjykata mund të vendosë përkohësisht një masë shtrënguese para se të vijë kërkesa e ekstradimit.

2. Masa mund të vendoset kur:

a) shteti i huaj ka deklaruar se kundër personit është marrë një masë për kufizimin e lirisë personale ose një vendim dënimi me burgim dhe se ka ndër mend të paraqesë kërkesë për ekstradim;

b) shteti i huaj ka paraqitur të dhëna të hollësishme për veprën penale dhe elemente të mjaftueshme për identifikimin e personit;

c) kur ka rrezik i keje.

3. Kompetenca për të vendosur masën u takon, sipas radhës, gjykatës së rrethit në territorin e së cilës personi ka vendbanimin, vendqëndrimin apo banesën ose gjykatës së rrethit gjyqësor ku ai gjendet. Në qoftë se kompetenca nuk mund të përcaktohet në mënyrat e treguara më sipër kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor të

Tiranës.

4. Gjykata mund të vendosë edhe sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që i përkasin veprës penale.

5. Ministria e Drejtësisë njofton shtetin e huaj për zbatimin e përkohshëm të masës shtrënguese dhe të sekuestros eventuale.

6. Masat shtrënguese revokohen në qoftë se brenda tetëmbëdhjetë ditëve dhe gjithsesi në maksimum dyzet ditë nga arrestimi nuk vjen në Ministrinë e Drejtësisë kërkesa e ekstradimit dhe dokumentet që i bashkëlidhen asaj.

Neni 495

Arrestimi nga policia gjyqësore

(Ndryshuar pikat 2 dhe 3 me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002; ndryshuar fjalia e parë e pikës 1, ndryshuar fjalë e shtuar fjalia e dytë në pikën 3, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur ka një urdhër arresti ndërkombëtar, policia gjyqësore bën arrestimin e përkohshëm të personit. Ajo bën edhe sekuestrimin e provave materiale të veprës penale dhe të sendeve që i përkasin asaj.

2. Autoriteti që ka bërë arrestimin njofton menjëherë prokurorin dhe Ministrin e Drejtësisë. Brenda dyzet e tetë orëve prokurori e vë të arrestuarin në dispozicion të gjykatës në territorin e së cilës është bërë arrestimi, duke i dërguar edhe dokumentacionin përkatës.

3. Gjykata, brenda dyzet e tetë orëve nga paraqitja e kërkesës e vleftëson atë si dhe cakton një masë sigurimi shtrënguese, kur janë kushtet ose vendos lirimin e të arrestuarit. Kur i arrestuari është shtetas shqiptar dhe nuk ka marrëveshje dypalëshe për ekstradimin e shtetasve me shtetin që ka urdhër arrestin, gjykata urdhëron lirimin e menjëhershëm të tij. Për vendimin që merr ajo njofton Ministrin e Drejtësisë.

4. Masa e arrestit revokohet në qoftë se Ministria e Drejtësisë nuk kërkon, brenda dhjetë ditëve nga miratimi, mbajtjen e saj.

5. Kopja e vendimit të dhënë nga gjykata për masat shtrënguese dhe sekuestrimet, në bazë të këtyre neneve, u njoftohet prokurorit, personit të interesuar dhe mbrojtësit të tij, të cilët mund të bëjnë

ankim në gjykatën e apelit.

Neni 496

Dëgjimi i personit ndaj të cilit është marrë masë shtrënguese

*(Ndryshuar dhe hequr fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017,
datë 30.3.2017)*

1. Kur është zbatuar një masë shtrënguese, gjykata, sa më shpejt dhe sidoqoftë jo më vonë se tre ditë nga ekzekutimi i masës, sigurohet për identitetin e personit dhe merr pëlqimin eventual të tij për ekstradimin, duke e shënuar këtë në procesverbal.

2. Gjykata i bën të ditur të interesuarit të drejtën për të patur mbrojtës dhe në mungesë të tij i cakton një mbrojtës kryesisht. Mbrojtësi duhet të lajmërohet, të paktën njëzet e katër orë përpara, për veprimet e sipërme dhe ka të drejtë të marrë pjesë në to.

Neni 497

Shqyrtimi i kërkesës për ekstradim

1. Pasi merr kërkesën e prokurorit gjykata cakton seancën dhe njofton, të paktën dhjetë ditë përpara, prokurorin, personin me të cilin është kërkuar ekstradimi, mbrojtësin e tij dhe përfaqësuesin eventual të shtetit kërkuar.

2. Gjykata merr të dhëna dhe bën verifikimet që i çmon të nevojshme, si dhe dëgjon personat e thirrur në gjykim.

Neni 498

Vendimi i gjykatës

(Ndryshuar pikat 1 dhe 5 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata jep vendim në favor të ekstradimit kur në ngarkim të personit të kërkuar ka një masë shtrënguese, kur ka të dhëna të rëndësishme fajësie ose kur ekziston një vendim dënimi i formës së prerë. Në këtë rast, kur ka kërkesë nga Ministria e Drejtësisë, të paraqitur nëpërmjet prokurorit, gjykata vendos paraburgimin e personit

që duhet të ekstradohet dhe që ndodhet në gjendje të lirë, si dhe sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që i përkasin veprës penale.

2. Gjykata jep vendim kundër ekstradimit kur janë rastet e parashikuara për mospranimin e kërkesës së ekstradimit.

3. Kur gjykata jep vendim kundër ekstradimit, ekstradimi nuk mund të bëhet.

4. Vendimi kundër ekstradimit ndalon dhënien e një vendimi të mëposhëm në favor të ekstradimit si rezultat i një kërkesë të re të paraqitur për të njëjtat fakte nga i njëjti shtet, përveçse kur kërkesa mbështetet në elemente që nuk kanë qenë vlerësuar nga gjykata.

5. Kundër vendimit të gjykatës, lidhur me kërkesën e ekstradimit, mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit nga personi i interesuar, nga mbrojtësi i tij dhe nga prokurori brenda 10 ditëve.

Neni 499

Disponimi për ekstradimin

1. Ministria e Drejtësisë disponon për ekstradimin brenda tridhjetë ditëve nga data që vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë. Me mbarimin e këtij afati, edhe kur nuk është disponuar nga Ministri, personi për të cilin është kërkuar ekstradimi, në qoftë se është i burgosur, lirohet.

2. Personi lirohet edhe në rast refuzimi të kërkesës së ekstradimit.

3. Ministria e Drejtësisë i komunikon shtetit kërkuar vendimin dhe, kur ky është pozitiv, vendin e dorëzimit dhe datën nga fillimi i së cilës do të jetë e mundur të veprohet. Afati i dorëzimit është pesëmbëdhjetë ditë nga data e caktuar dhe me kërkesë të arsyetuar të shtetit kërkuar mund të zgjatet edhe pesëmbëdhjetë ditë të tjera. Kur ka shkaqe që nuk varen nga palët, mund të caktohet një datë tjetër dorëzimi, por gjithmonë duke u zbatuar afatet e caktuara në këtë paragraf.

4. Vendimi i ekstradimit e humbet fuqinë dhe i ekstraduari lirohet kur shteti kërkuar nuk vepron, në afatin e caktuar, për marrjen në

dorëzim të të ekstraduarit.

Neni 500

Pezullimi i dorëzimit

1. Ekzekutimi i ekstradimit pezullohet kur i ekstraduari duhet të gjykohet në territorin e shtetit shqiptar ose duhet të vuajë një dënim për vepra penale të kryera para ose pas asaj për të cilën është dhënë ekstradimi. Por, Ministria e Drejtësisë pasi dëgjon autoritetin procedues kompetent të shtetit shqiptar ose atë të ekzekutimit të dënimit, mund të urdhërojë dorëzimin e përkohshëm në shtetin kërkues të personit që duhet ekstraduar, duke përcaktuar afatet dhe mënyrën e veprimit.

2. Ministria mund të bjerë dakord që dënimi i mbetur të vuhet në shtetin kërkues.

Neni 501

Zgjerimi i ekstradimit të dhënë dhe riekstradimi

1. Në rast kërkesë të re të ekstradimit, të paraqitur pas dorëzimit të të ekstraduarit dhe që ka si objekt një vepër penale të ndodhur para dorëzimit, të ndryshme nga ajo për të cilin ekstradimi është dhënë, respektohen për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat e këtij kreu. Kërkesës duhet t'i bashkëlidhen deklaratat e të ekstraduarit, të bëra përpara një gjyqtari të shtetit kërkues për zgjerimin e ekstradimit.

2. Gjykata procedon në mungesë të të ekstraduarit.

3. Nuk ka vend për gjykim në qoftë se i ekstraduari, me deklaratat e parashikuara në paragrafin 1, ka pranuar zgjerimin e ekstradimit

4. Dispozitat e sipërme zbatohen edhe në rastin kur shteti, të cilit i është dorëzuar personi, kërkon pëlqimin për riekstradimin e po këtij personi në një shtet tjetër.

Neni 502

Kalimi tranzit

1. Kalimi tranzit përmes territorit të shtetit shqiptar i një personi

të ekstraduar nga një shtet në tjetrin, autorizohet, me kërkesën e këtij të fundit, nga Ministria e Drejtësisë, në qoftë se kalimi tranzit nuk prek sovranitetin, sigurimin ose interesa të tjera shtetërore.

2. Kalimi tranzit nuk autorizohet:

a) kur ekstradimi është dhënë për fakte që nuk parashikohen si vepra penale nga ligji shqiptar;

b) kur janë rastet e parashikuara nga neni 491, paragrafi 1;

c) kur është fjala për një shtetas shqiptar, për të cilin ekstradimi në shtetin që ka kërkuar kalimin tranzit nuk do të jepej.

3. Autorizimi nuk kërkohet kur kalimi tranzit bëhet në rrugë ajrore dhe nuk parashikohet zbritje në territorin shqiptar. Por, kur ndodh zbritja, zbatohen për aq sa pajtohen, dispozitat për masat e sigurimit.

Neni 503

Shpenzimet e ekstradimit

1. Shpenzimet e bëra në territorin shqiptar mbulohen nga pala shqiptare, kur nuk ka marrëveshje tjetër.

SEKSIONI II

EKSTRADIMI NGA JASHTË SHTETIT

Neni 504

Kërkesa për ekstradim

(Ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Ministria e Drejtësisë është kompetente që t'i kërkojë një shteti të huaj ekstradimin e një personi të proceduar ose të dënuar penalisht, ndaj të cilit duhet të ekzekutohet një masë që kufizon lirinë personale. Për këtë, prokurori pranë gjykatës në territorin e së cilës procedohet ose është dhënë vendim dënimi, i bën kërkesë Ministrisë së Drejtësisë, duke i dërguar aktet dhe dokumentet e nevojshme. Kur nuk e pranon kërkesën, Ministria njofton autoritetin që e ka bërë atë.

2. Ministria e Drejtësisë është kompetente të vendosë në lidhje

me kushtet e vëna eventualisht nga shteti i huaj për të dhënë ekstradimin, kur ato nuk vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar. Autoriteti procedues detyrohet të respektojë kushtet e pranuar.

3. Ministria e Drejtësisë mund të vendosë, për qëllimet e ekstradimit, kërkimin jashtë shtetit të personit të proceduar ose të dënuar dhe arrestimin e tij të përkohshëm.

4. Paraburgimi jashtë shtetit, si rrjedhojë e një kërkesë ekstradimi të paraqitur nga shteti shqiptar, llogaritet në masën e dënimit, sipas rregullave që normon neni 57 i Kodit Penal.

KREU II LETËRPOROSITË NDËRKOMBËTARE

SEKSIONI I LETËRPOROSITË NGA JASHTË SHTETIT

Neni 505

Kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë

1. Ministria e Drejtësisë vendos që t'i jepet rrugë letërporosisë së një autoriteti të huaj për komunikimet, njoftimet dhe për marrjen e provave, përveçse kur çmon se veprimet e kërkuara rrezikojnë sovranitetin, sigurimin ose interesa të rëndësishme të shtetit.

2. Ministria nuk i jep rrugë letërporosisë kur del e qartë se veprimet e kërkuara janë të ndaluara shprehimisht nga ligji ose kur vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar. Ministria nuk i jep rrugë letërporosisë edhe kur ka arsye të bazuara për të menduar se konsideratat lidhur me racën, fenë, seksin, kombësinë, gjuhën, bindjet politike apo gjendjen shoqërore mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e procesit, si dhe kur nuk del që i pandehuri të ketë shprehur lirisht pëlqimin e tij për letërporosinë.

3. Në rastet kur letërporosia ka si objekt thirrjen e një dëshmitari, të një eksperti a të një të pandehuri para autoritetit gjyqësor të huaj,

Ministria e Drejtësisë nuk i jep rrugë letërporosisë kur shteti kërkues nuk jep garancinë e duhur për paprekshmërinë e personit të thirrur.

4. Ministria ka të drejtë të mos i japë rrugë letërporosisë kur shteti kërkues nuk jep garancinë e duhur të reciprocitetit.

Neni 506

Procedimi gjyqësor

(Shtuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 99, datë 31.7.2014)

1. Letërporosia e huaj nuk mund të vihet në ekzekutim pa u marrë më parë vendimi në favor i gjykatës së vendit ku duhet të procedohet.

2. Prokurori i rrethit, pasi merr aktet nga Ministria e Drejtësisë, paraqet kërkesën në gjykatë brenda 5 ditëve nga paraqitja e akteve nga Ministria e Drejtësisë.

3. Gjykata disponon ekzekutimin e letërporosisë me vendim brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

4. Ekzekutimi i letërporosisë nuk pranohet:

a) kur janë rastet që Ministria e Drejtësisë nuk i jep rrugë letërporosisë, në përputhje edhe me parashikimet e akteve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe rezervat e deklaratimet ligjore;

b) kur fakti për të cilin procedon autoriteti i huaj nuk parashikohet nga ligji shqiptar si vepër penale.

Neni 507

Ekzekutimi i letërporosive

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjykata që pranon kërkesën për ekzekutimin e letërporosisë, kryen dhe veprimin e kërkuar ose autorizon për këtë qëllim prokurorin, në rastet kur ligji e lejon.

2. Për kryerjen e veprimeve të kërkuara zbatohen normat e këtij Kodi, përveç rasteve kur duhet të respektohen rregulla të veçanta të kërkuara nga autoriteti gjyqësor i huaj, të cilat nuk vijnë në kundërshtim

me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar.

Neni 508

Thirrja e dëshmitarëve që kërkohen nga autoriteti i huaj

1. Thirrja e dëshmitarëve që kanë vendqëndrimin ose vendbanimin në territorin e shtetit shqiptar për t'u paraqitur në autoritetin gjyqësor të huaj, i dërgohet prokurorit të rrethit përkatës, i cili merr masa për njoftimin duke vepruar si në rastin e njoftimit të pandehurit në gjendje të lirë.

SEKSIONI II

LETËRPOROSITË PËR JASHTË SHTETIT

Neni 509

Dërgimi i letërporosive autoriteteve të huaja

1. Letërporositë e gjykatave dhe prokurorive, të drejtuara autoriteteve të huaja për njoftimet dhe marrjen e provave, i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë, e cila merr masa për t'i nisur ato.

2. Kur çmon se mund të rrezikohet sigurimi ose interesat e tjera të rëndësishme të shtetit, Ministria urdhëron, brenda tridhjetë ditëve nga marrja e letërporosisë, që kësaj të mos i jepet rrugë.

3. Ministria i komunikon autoritetit procedues që ka bërë kërkesën datën e marrjes së saj dhe nisjen e letërporosisë ose urdhrin për të mos i dhënë rrugë letërporosisë.

4. Në rastet e ngutshme, autoriteti procedues mund të vendosë nisjen direkt, duke informuar Ministrin e Drejtësisë.

Neni 510

Paprekshmëria e personit të thirrur

1. Personi i thirrur në bazë të letërporosisë, kur paraqitet, nuk mund t'i nënshtrohet kufizimit të lirisë personale për fakte që kanë ndodhur para njoftimit për t'u paraqitur.

2. Paprekshmëria e parashikuar në paragrafin 1 pushon kur dëshmitari, eksperti a i pandehuri, duke patur mundësinë nuk është larguar nga territori i shtetit shqiptar, me kalimin e pesëmbëdhjetë ditëve nga momenti kur prania e tij nuk kërkohet më nga autoriteti gjyqësor ose kur, pasi është larguar, është kthyer vullnetarisht.

Neni 511

Vlera e akteve të marra me letërporosi

1. Kur shteti i huaj ka vënë kushte për përdorshmërinë e akteve të kërkuara, autoriteti procedues shqiptar është i detyruar t'i respektojë, në qoftë se ato nuk vijnë në kundërshtim me ndalimet e caktuara nga ligji.

KREU III

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE

SEKSIONI I

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE TË HUAJA

Neni 512

Njohja e vendimeve penale të huaja

1. Ministria e Drejtësisë, kur i vjen një vendim penal i dhënë jashtë shtetit ndaj shtetasve shqiptarë ose të huaj ose pa shtetësi, por me banim në shtetin shqiptar, ose ndaj personave të proceduar penalisht në shtetin shqiptar, i dërgon prokurorit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor të vendbanimit ose vendqëndrimit të personit, një kopje të vendimit dhe dokumentacionin përkatës, bashkë me përkthimin në gjuhën shqipe.

2. Ministria e Drejtësisë kërkon njohjen e një vendimi penal të huaj edhe kur çmon se në bazë të një marrëveshje ndërkombëtare ky vendim duhet të ekzekutohet ose t'i njihen efekte të tjera në shtetin shqiptar.

3. Prokurori i bën kërkesë gjykatës së rrethit gjyqësor për njohjen e vendimit të huaj. Nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë ai mund t'u

kërkojë autoriteteve të huaja informacionet që i çmon të nevojshme.

Neni 513

Njohja e vendimeve penale të gjykatave të huaja për efektet civile

1. Me kërkesën e të interesuarit, në të njëjtin procedim dhe me të njëjtin vendim, mund të deklarohen të vlefshme disponimet civile të vendimit penal të huaj lidhur me detyrimin për kthimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit.

2. Në rastet e tjera kërkesa bëhet, nga ai që ka interes, në gjykatën ku disponimet civile të vendimit penal të huaj do të ekzekutoheshin.

Neni 514

Kushtet e njohjes

(Shfuqizuar shkronja "e" me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

1. Vendimi i gjykatës së huaj nuk mund të njihet kur:

a) vendimi nuk ka marrë formë të prerë sipas ligjeve të shtetit ku është dhënë;

b) vendimi përmban disponime në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar;

c) vendimi nuk është dhënë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme ose i pandehuri nuk është thirrur të paraqitet në gjykim ose nuk i është njohur e drejta që të pyetet në një gjuhë që e kupton dhe të ndihmohet nga një mbrojtës;

ç) ka arsye të bazuara për të menduar se kanë ndikuar në përfundimin e procesit konsiderata lidhur me racën, fenë, seksin, gjuhën apo bindjet politike;

d) fakti për të cilin është dhënë vendimi nuk parashikohet si vepër penale nga ligji shqiptar;

dh) për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në shtetin shqiptar është dhënë një vendim i formë së prerë ose zhvillohet një procedim penal.

Neni 515

Masat shtrënguese

(Shtuar fjali në pikën 1 dhe 3 e ndryshuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente për njohjen e një vendimi të huaj mund të vendosë një masë shtrënguese ndaj të dënuarit që ndodhet në territorin shqiptar. Në caktimin e masave shtrënguese respektohen dispozitat e titullit V, të këtij Kodi, për atë që mund të zbatohen.

2. Gjykata, brenda tre ditëve nga ekzekutimi i masës shtrënguese, merr masa për identifikimin e personit dhe i njofton menjëherë atij të drejtën për të patur mbrojtës.

3. Masa shtrënguese e vendosur në bazë të këtij neni revokohet kur nga fillimi i ekzekutimit të saj kanë kaluar tre muaj pa u dhënë vendimi i njohjes nga gjykata e rrethit gjyqësor ose gjashtë muaj pa marrë vendimi formën e prerë. Nëse bëhet ankim në gjykatën e apelit apo Gjykatën e Lartë, masa shtrënguese revokohet nëse gjykimi nuk ka përfunduar brenda 3 muajve nga marrja e akteve respektivisht për secilën gjykatë.

4. Revokimi dhe zëvendësimi i masës shtrënguese vendosen nga gjykata e rrethit gjyqësor.

5. Kopja e vendimit të dhënë nga gjykata u njoftohet, pas ekzekutimit, prokurorit, të dënuarit nga gjykata e huaj dhe mbrojtësit të tij, të cilët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit.

Neni 516

Caktimi i dënimit

(Shtuar një fjali në pikën 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur bën njohjen e një vendimi të huaj, gjykata cakton dënimin që duhet të vuhet në shtetin shqiptar. Ajo konverton dënimin e caktuar në vendimin e huaj në një nga dënimet e parashikuara për të njëjtin

fakt nga ligji shqiptar. Ky dënim duhet t'i përgjigjet nga natyra atij që është dhënë në vendimin e huaj. Masa e dënimit nuk mund të kalojë kufirin maksimal të parashikuar për të njëjtin fakt nga ligji shqiptar.

2. Kur në vendimin e huaj nuk është caktuar masa e dënimit, gjykata e cakton atë mbi bazën e kritereve të treguara në Kodin Penal. Në asnjë rast dënimi i dhënë nuk mund të jetë më i lartë se ai i caktuar nga vendimi penal i njohur.

3. Kur ekzekutimi i dënimit të dhënë në shtetin e huaj është pezulluar me kusht, gjykata disponon në vendimin e njohjes, veç të tjerave, edhe pezullimin me kushte të dënimit. Të njëjtën gjë gjykata bën edhe kur i pandehuri është liruar me kusht në shtetin e huaj.

4. Për të caktuar dënimin me gjobë shuma e vënë në vendimin e huaj konvertohet në vlerë të barabartë me lekë shqiptare, duke zbatuar kursin e këmbimit të ditës në të cilën është vendosur njohja.

5. Në vendimin e njohjes për ekzekutimin e një konfiskimi, urdhërohet edhe zbatimi i konfiskimit.

Neni 517

Sekuestrua

1. Me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente mund të vendosë sekuestrimin e sendeve të konfiskueshme.

2. Kundër vendimit mund të bëhet ankim.

3. Respektohen, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat që rregullojnë sekuestron preventive.

Neni 518

Ekzekutimi i vendimit të huaj

1. Pasi janë njohur, vendimet penale të gjykatave të huaja ekzekutohen sipas ligjit shqiptar.

2. Prokurori pranë gjykatës që ka bërë njohjen e vendimit merr masa për ekzekutimin e tij.

3. Dënimi me burgim i vuajtur në shtetin e huaj llogaritet për

efektet e ekzekutimit.

4. Shuma e nxjerrë nga ekzekutimi i vendimit me gjobë derdhet në Bankën e Shqipërisë. Ajo mund të derdhet në shtetin ku është dhënë dënimi me kërkesën e tij kur ai shtet, në të njëjtat rrethana, do të vendoste derdhjen në favor të shtetit shqiptar.

5. Sendet e konfiskuara i dorëzohen shtetit shqiptar. Ato i dorëzohen, me kërkesën e tij, shtetit ku është dhënë vendimi i njohur kur ky, në të njëjtat rrethana, do të vendoste dorëzimin në shtetin shqiptar.

SEKSIONI II EKZEKUTIMI JASHTË SHTETIT I VENDIMEVE PENALE SHQIPTARE

Neni 519

Kushtet e ekzekutimit jashtë shtetit

1. Në rastet e parashikuara nga marrëveshjet ndërkombëtare ose nga neni 501, paragrafi 2, Ministria e Drejtësisë kërkon ekzekutimin jashtë shtetit të vendimeve penale ose jep pëlqimin kur ai kërkohet nga shteti i huaj.

2. Ekzekutimi jashtë shtetit i një vendimi penal dënimi me kufizim të lirisë personale mund të kërkohet ose të lejohet vetëm në qoftë se i dënuari që ka marrë dijëni për pasojat, ka deklaruar lirisht se jep pëlqimin dhe kur ekzekutimi në shtetin e huaj është i përshtatshëm për riintegrimin e tij shoqëror.

3. Ekzekutimi jashtë shtetit lejohet edhe kur nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara nga paragrafi 2, në qoftë se i dënuari ndodhet në territorin e shtetit, të cilit i është drejtuar kërkesa dhe ekstradimi është mohuar ose sidoqoftë nuk është i mundur.

Neni 520

Vendimi i gjykatës

1. Para se të kërkojë ekzekutimin jashtë shtetit të një vendimi, Ministria e Drejtësisë i dërgon aktet prokurorit, i cili bën kërkesë në

gjykatë.

2. Pëlqimi i të dënuarit duhet të jepet para gjykatës shqiptare. Në qoftë se ai ndodhet jashtë shtetit, pëlqimi mund të jepet para autoritetit konsullor shqiptar ose para gjykatës së shtetit të huaj.

Neni 521

Rastet e moslejimit të ekzekutimit të dënimit jashtë shtetit

1. Ministria e Drejtësisë nuk mund të kërkojë ekzekutimin jashtë shtetit të një vendimi penal dënimi me kufizim të lirisë personale kur ka arsye të çmohet se i dënuari do t'u nënshtrohet akteve persekutuese ose diskriminuese për shkak të racës, fesë, seksit, kombësisë, gjuhës apo bindjeve ose dënimeve e trajtimeve të egra, çnjerëzore ose poshtëruese.

Neni 522

Kërkesa për paraburgim jashtë shtetit

1. Kur kërkohet ekzekutimi i një dënimi me kufizim të lirisë personale dhe i dënuari ndodhet jashtë shtetit, Ministria e Drejtësisë kërkon paraburgimin e tij

2. Në kërkesën për ekzekutimin e një konfiskimi, Ministria e Drejtësisë ka të drejtë të kërkojë sekuestrimin e sendeve të konfiskueshme.

Neni 523

Pezullimi i ekzekutimit në shtetin shqiptar

1. Ekzekutimi i dënimit në shtetin shqiptar pezullohet nga çasti kur ka filluar ekzekutimi në shtetin e huaj.

2. Dënimi nuk mund të ekzekutohet më në shtetin shqiptar, kur sipas ligjeve të shtetit të huaj ai është shlyer tërësisht.

Neni 524
Dispozita të fundit

Kodi i Procedurës Penale i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr.6069, datë 25.12.1979, me gjithë shtesat e ndryshimet e mëvonshme, si dhe çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë Kod, shfuqizohen.

Neni 525
(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr.7977, datë 26.7.1995 dhe ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr.8027, datë 15.11.1995)

Ky Kod hyn në fuqi më 1 gusht 1995.

Për çështjet penale që ditën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi ndodhen në fazën e hetimit ose të gjyqimit në shkallë të parë dhe në apel, do të zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të mëparshëm, por jo më pas se data 1 mars 1996.

(Dispozitë kalimtare e ligjin nr. 8570, datë 20.1.2000)

Afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit, sipas këtij ligji, do të zbatohen ndaj personave që paraburgosen pas hyrjes në fuqi të tij.

(Dispozitë e shtuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002)

Dispozitat procedurale për gjykatat për krimet e rënda do të zbatohen pas hyrjes në fuqi të ligjit për caktimin e ditës së fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

(Dispozitë e ligjit nr. 145/2013, datë 2.5.2013)

Pavarësisht ndryshimeve, sipas nenit 1 të këtij ligji, procedimet penale të filluara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji do të gjyqohen nga gjykata që ka kompetencën lëndore, sipas legjislacionit në fuqi

në momentin e kryerjes së veprës penale.

(Dispozitë e parashikuar me ligjin nr. 21, datë 10.3.2014)

Çështjet penale, për të cilat ka filluar ose është kërkuar gjykimi i tyre, përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vijojnë të gjykohen në gjykatën e rrethit gjyqësor apo gjykatën e apelit.

(Dispozitë kalimtare e shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Deri në krijimin e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet penale në kompetencën lëndore të saj, sipas nenit 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të gjykohen, përkatësisht, nga Gjykata për Krimet e Rënda dhe gjykatat e rretheve gjyqësore.

2. Pas krijimit të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çështjet në gjykim para gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe çështjet për të cilat mund të vendoset rigjykimi, do të përfundohen nga këto të fundit.

3. Aktet dhe provat e marra deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji janë të vlefshme dhe të përdorshme edhe në rastet kur ky ligj parashikon rregullime të ndryshme.

4. Deri në krijimin e Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim për veprat penale apo subjektet e parashikuara në nenin 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, do të hetohen përkatësisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, sipas kompetencës të përcaktuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5. Pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, çështjet në hetim në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda i transferohen sipas kompetencës Prokurorisë së Posaçme, sipas nenit 75/a, të Kodit të ndryshuar me këtë ligj, dhe prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. I njëjti rregull zbatohet edhe për çështjet në hetim në prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, të cilat kalojnë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme.

6. Pikat 6, 7 dhe 8, të nenit 57, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, shfuqizohen.

7. Përbërja e trupave gjykues rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.

Shpallur me dekretin nr.1059, datë 5.4.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

TREGUESI ALFABETIK I KODIT TË PROCEDURËS PENALE

- A -

AFATET

- e format e kërimit të përjashtimit të gjyqtarit, 19
- për njohjen e mbrojtësit me provat, 57
- e infiltrimit të punonjësit të policisë, 294/b/3
- e legjitimitit të paditësit civil, 62
- data, 100
- i paraqitjes së memorieve dhe kërkesave, 110
- për përkthimin me shkrim të akteve dhe zëvendësimi i përkthyesit, 127
- pavlefshmëria relative e akteve, 129
- caktimi, llogaritja, 144
- që nuk mund të zgjaten, 145
- shkurtimi nga palë në favor të së cilës është caktuar, 145/2
- zgjatja për paraqitje, 146
- rivendosja, 147
- kërkesa për rivendosje, 147/3
- efektet e rivendosjes, 148
- e ekspertimit, 185
- e fillimit të kontrollit të banesës dhe cenimi i afatit, 206
- sekuestrimi i dokumentit brenda afatit, 211
- depozitimi i letrave me vlerë, ose parave të sekuestruara, 219
- përcaktimi i mënyrës dhe afatit të përgjimit, 222
- ankimi kundër vendimit që pranon përgjimin, 222/a
- i arrestit në shtëpi, 237

- i marrjes në pyetje të të pandehurit, 248
- e drejta e të pandehurit për t'u ankuar në Gjykatën e Lartë dhe afati, 249
- mënyra e llogaritjes së masës së sigurimit, 250
- i kërkesës së prokurorit për vlerësimin e masës në gjykatë, 258
- i shqyrtimit të revokimit të masave të sigurimit, 260
- e shuarjes së masave të sigurimit, 261
- e paraburgimit pa u dorëzuar aktet në gjykatë, 263
- organi që kërkon zgjatjen e kohës së paraburgimit, 265
- masat për lirimin nga burgu për shkak të mbarimit të afatit, 266
- maksimale të masave të tjera të sigurimit, 267
- e kërkesës për kompensim, 269
- i ankimit, 276
- i kallzimit nga personeli mjekësor, 282
- i tëheqjes së ankimit, 286
- për të mos publikuar regjistrimin e njoftimit të veprës penale, 287
- i paraqitjes së kërkesës së prokurorit për procedim, 288
- i mbajtjes së personit deri në identifikimin e tij të plotë, 295
- i dërgimit të procesverbalit të kontrollit, 298
- i sekuestros së plikove dhe korrespondencës, 299
- e drejta e ankimit brenda afatit , 301
- afati i formulimit të kërkesave të prokurorit, 305
- paraqitja brenda afateve për përfundimin e hetimeve, 317
- e paraqitjes së kërkesave për sigurimin e provës, 319
- marrja, afati dhe përmbajtja e vendimit, 320
- e përfundimit të hetimeve paraprake, 323
- kur bëhet zgjatja e afatit të hetimeve, 324
- e drejta për t'u ankuar kundër vendimit të zgjatjes së afatit të hetimeve, 325
- i caktimit të seancës gjyqësore, 333
- i njoftimit për sigurimin e provës, 336
- e paraqitjes së kërkesës për dëshmitarë dhe ekspertë, 337
- shpalljes së ndërprerjes së shqyrtimit gjyqësor, 342
- i caktimit të ekspertimit gjatë gjykimit, 366

- të drejtat e palëve për të kërkuar afat për mbrojtjen, 376
- paraqitja për gjykim të drejtpërdrejtë brenda afatit, 401
- i përgatitjes së mbrojtjes, 402
- për të paraqitur kërkesën për gjykim të shkurtuar, 403
- i riparaqitjes së kërkesës, 404
- përcaktimi i afateve të ankimit dhe pamundësia e zgjatjes së afatit, 415
- e dërgimit të akteve të procedimit, 419
- i paraqitjes së apelit kundërshtues, 423
- i veprimeve paraprake të gjykimit nga kryetari i kolegjit të gjykatës, 426
- i shtyrjes së shqyrtimit, 427
- i paraqitjes së rekursit dhe caktimi i mbrojtësit, 435
- i rishikimit të vendimeve të formës së prerë, 499
- i kërkesës për kompensim të dënimit të padrejtë, 459
- i njoftimit të vendimit të prokurorit dhe mbrojtësit, 463
- i shtyrjes së konvertimit, 467
- e njoftimit nga gjykata, 471
- i përsëritjes së kërkesës së rrëzuar, 477
- i paraqitjes së kërkesës për shqyrtim, 492
- i revokimit të masave shtrënguese, 493, 494
- detyrimi i gjykatës brenda një afati për të dëgjuar personin, 496
- i njoftimit të prokurorit për ekstradimin, 497
- e dorëzimit të personit të ekstraduar, 499
- e pezullimit të ekzekutimit të ekstradimit, 500
- i paprekshmërisë së personit të thirrur nga jashtë shtetit, 510
- dhe revokimi i masave shtrënguese, 515

AGJENTI I POLICISË GJYQËSORE

- arrestimi në flagrancë, 251
- disponimet në rastet e lirimimit nga burgu, 266
- kryerja e funksioneve të policisë gjyqësore, 30
- subjektet që kryejnë shërbimet, 31
- përdorimi i akteve të policisë gjyqësore kur pyetet si dëshmitar, 369

- personat që kanë cilësinë e agjentit, 32
- ruajtja e sekretit shtetëror, 160
- verifikimet e ngutshme në vend, 300
- zbatimi i detyrave që caktohen nga prokurori, 33
- zbatimi i masave të sigurimit, 246, 247

AKT

- dërgimi gjykatës kompetente, 85
- dërgimi organit kompetent për mungesë juridiksioni, 72, 73
- dërgimi prokurorit pranë gjykatës kompetente, 84
- marrja dijani nga personat që nuk dinë shqip, 8
- heqja dorë nga gjykimi i padisë civile, 64
- gjuha, nënshkrimi, data, kopja, publikimi, prokura, 98, 111
- forma e disponimit të gjykatës dhe mënyra, 112
- forma e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit, 19
- depozitimi i akteve origjinale të gjykatës, 113
- i njoftimit të akuzës, 34
- kërkimi nga një prokurori tjetër, 29
- me të cilat duhet të njihet mbrojtësi i ri, 55, 57
- mënyra e ndreqjes së gabimeve materiale nga gjykata që ka nxjerrë, 114
- ekspertimi, 185
- përpilimi kur kërkohet pjesëmarrja e të miturve, 35
- që i dërgohet këshillit drejtues të dhomës së avokatëve për këqyrjen, kontrollin ose sekuestrimin e zyrës së një mbrojtësi, 52
- që i kalohen një prokurorie tjetër, 28
- që i jepet mbrojtësit nga i pandehuri, 48
- që përfshihen në fashikullin e gjykimit, 332
- që pranon deklarimin e heqjes dorë ose kërkesën e përjashtimit, 23
- e drejta e gjykatës për të lejuar lexime të akteve, 369

AKUZA

- ankimi kundër vendimit të pushimit, 329

- caktohet përkthyes për të pandehurin që nuk e kupton, 123
- çmuarja si provë në raport me sjelljen e viktimës, 153
- dyshimi çmohet në favor të të pandehurit (prezumimi i pafajësisë), 4
- element i vendimit gjyqësor, 383
- e drejta për ta vërtetuar nga viktimia akuzuese, 59
- faktet që kanë lidhje me të si objekt prove, 150
- komunikimi i një akuze të re kur lidhet me afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit, 263
- kur i pandehuri nuk i përmbahet objektit gjatë deklarimeve, 358
- mjaftueshmëria e provave për vërtetimin në rastin e autorizimit të përgjimit, 222
- ndahen çështjen kur për të është vendosur pezullimi, 93
- ndryshimi, 372
- ndryshimi për një vepër tjetër, 373
- ndryshimi për një fakt të ri, 374
- ndryshimi i cilësimit juridik të veprës, 375
- ngritja në gjykatë nga prokurori, 24
- njoftimi të pandehurit që është i paraburgosur ose që vuan dënimin me burgim, 139
- marrja e cilësisë së të pandehurit nëpërmjet njoftimit, 34
- parashtrimi hyres i fakteve si objekt nga prokurori ose viktimia akuzuese, 356
- pushimi nga prokurori, 328
- shkëlja e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja si shkak për prishjen e vendimit nga Gjykata e Apelit, 428
- shqyrtimi në të njëjtën kohë nga disa gjykata, 89
- tërheqja nga prokurori, 377
- të drejtat e palëve për akuzat e reja, 376
- tregimi në hapjen e shqyrtimit gjyqësor, 355

ANËTAR I TRUPIT GJYKUES

- marrja e vendimeve, pavlefshmëria dhe shpallja e vendimeve nga, 382-384

ANKIMI KUNDËR VENDIMEVE

- e drejta për t'u ankuar e të pandehurit ose atij që sekuestrohet, 212
- e drejta për t'u ankuar në Gjykatën e Lartë, 249, 259
- e drejta e ankimit kundër vendimit të zgjatjes së paraburgimit, 264
- e drejta e ankimit, procedura, afati dhe gjykata që vendos mbi kërkesën, 276
- kur mund të fillojë ndjekje penale me ankimin e viktimës, procedura, 284
- heqja dorë nga e drejta e ankimit dhe kur nuk është e vlefshme, 285, 286
- e drejta e ankimit për mosfillimin e procedimit penal, 291
- procedura e sekuestros dhe ankimi, 301
- e drejta për t'u ankuar kundër vendimit të pushimit të çështjes, 329
- detyrimi për shpenzimet dhe dëmet kur pushohet çështja penale, 330
- e drejta e ankimit kundër vendimit të pezullimit, 343
- e drejta e ankimit kundër deklarimit të falsitetit të vendimit përfundimtar, 391
- viktima akuzuese, 409
- tërheqja, 286

ANKIMI PËR PROCEDIM

- kundër vendimit që lejon ose refuzon kërkesën për rivendosje në afat, 147
- kundër vendimit të masës së sigurimit, 249
- kundër vendimit për zgjatjen e hetimeve, 325
- kundër vendimit të pushimit të çështjes, 329
- papranueshëm, 398, 421
- mjetet, 497
- e drejta, 407/4
- në gjykatën jokompetente, 407/5
- i prokurorit, 408
- e viktimës akuzuese, 409
- i të pandehurit, 410

- kundër vendimit të dhënë në mungesë, 410/2
- i paditësit civil, 411
- i të paditurit civil, 411/2
- forma, 412
- paraqitja, 413
- njoftimi, 414
- afatet, 415
- shtrirja te të pandehurit e tjerë, 416
- për liritë personale, 417/2
- heqja dorë, 418
- dërgimi i akteve gjykatës që do ta shqyrtojë, 419
- rastet e mospranimit, 420
- kundër vendimit të gjykatës që rigjykon çështjen, 448
- kundër vendimit të rishikimit, 458

ANONIM

- dokument, 194
- kallëzimet, 283/3

APEL

- afati i paraqitjes së apelit kundërshtues, 423
- e drejta e apelit të vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, 422
- gjykata e apelit si gjykatë penale, 12
- gjykata kompetente që vendos mbi apelin, 424
- kompetenca e gjykatës së apelit, 434
- kundër vendimit mbi vleftësimin e masës së sigurimit, 259
- kundër vendimit mbi zgjatjen e paraburgimit, 264
- kur vendimi mund të ankimohet, 448
- përbërja e gjykatës së apelit, 14
- si mjet ankimi, 407
- si ankim kundër vendimit të gjykatës së rigjykimit, 448
- ushtrimi i funksioneve nga prokurorët pranë gjykatave të apelit, 25
- vendosja për dorëheqjen e prokurorit pranë gjykatës së apelit, 26

ARREST NË BURG

- kriteret e veçanta për caktimin, 230
- vendimi, 238
- njoftimi çdo dy muaj i gjykatës nga prokuroria për të arrestuarin, 246/6
- revokimi ose zëvendësimi, 246/6, 248/2
- marrja në pyetje, 248, 256
- pyetja e të arrestuarit nga gjykata e një rrethi tjetër, 284/4
- në flagrancë, 251
- nga çdo person në rast flagrancë, 251/4
- moslejimi në rrethana të caktuara, 254
- lirimi i menjëhershëm, 257
- kërkesa e vleftësimit, 258
- seanca e vleftësimit, 259
- humbet fuqinë, 259/5
- nga policia gjyqësore për ekstradim, 495

ARREST NË FLAGRANCË

- kur kryhet nga organi që bën arrestimin, 251
- kur prokurori bën kërkesën për procedim, 288

ARREST NË SHITËPI

- koha e qëndrimit llogaritet në caktimin e dënimit, 237/5
- kohëzgjatja, 237/4

- marrja në pyetje, 248
- vendimi, 232, 237

- B -

BALLAFAQIMET

- kushtet, 169
- mbahet procesverbal nga prokurori kur kryhet si veprim me të pandehurin, 315

- ndalimi për ta kryer si veprim ndaj personit për të cilin kërkohet autorizimi, 289
- njoftimi i mbrojtësit njëzetekatër orë përpara kur kryhet si veprim ku duhet të marrë pjesë i pandehuri, 309
- procedimi me format e zakonshme kur gjykata e çmon për kryerjen e veprimeve me autoritetet e larta të shtetit, 162
- procedohet me sigurimin e provës kur ndërmjet personave që pyeten nga prokurori ka kundërthënie, 316
- rregullat, 170
- si veprim i deleguar posaçërisht nga prokurorit për t'u kryer nga policia gjyqësore, 304

BANESA

- element i referimit të veprës penale të prokurorit nga policia gjyqësore, 293
- deklarimi i caktimit të banesës në organin e policisë kur gjykata vendos detyrimin e qëndrimit, 235
- koha për kryerjen e kontrollit, 206
- kompetenca e gjykatës për të vendosur masën shtrënguese në rastin e ekstradimit, 494
- kontrolli, 202
- mbajtja në ruajtje e të ndaluarit të sëmure ose të mitur, 255
- moslargimi nga banesa kur urdhërohet arresti në shtëpi, 237
- njoftimi i të pandehurit në banesën e deklaruar ose të zgjedhur, 137, 139/4, 140, 142
- rastet kur kontrolli bëhet jashtë kohës së parashikuar në nenin 206, 298
- rezultimi i vendbanimit për zgjatjen e afatit të paraqitjes, 146

BANKA

- depozitimi i një shume të hollash si garanci pasurore, 236
- derdhja e shumës së nxjerrë nga ekzekutimi i një vendimi të huaj, 518
- disponimet në rast moskthimi, 219

- kontrolli i dokumenteve dhe i korrespondencës, 203/2
- sekuestrimi i sendeve dhe letrave me vlerë, 210

BASHKIMI I ÇËSHTJEVE

- rastet, 79, 92
- rastet kur gjykimi bëhet i drejtpërdrejtë dhe bashkimi i çështjeve, 400

BASHKIMI I DËNIMEVE

- e drejta e prokurorit ose të të dënuarit për të kërkuar, 475

BASHKËPUNIMI

- me drejtësinë, 37/a
- pyetja e bashkëpunëtorëve, 361/a

BISEDË E MBROJTËSIT ME

- të arrestuarin, 53

BURGIMI

- ekzekutimi i vendimit me burgim në kuptimin e ekstradimit, 488
- ekzekutimi i vendimit, 464
- kompensimi kur është i padrejtë, 268
- komunikimi i dispozitivit kur duhet të pushojë vazhdimi, 446
- kopja e vendimit që i bashkëngjitet kërkesës për ekstradim, 489
- kusht që një shtet i huaj duhet të deklarojë për vendosjen e masave shtrënguese në rastin e ekstradimit, 494
- lirimi i të burgosurit kur i rrezikohet jeta, 478
- llogaritja e dënimit të vuajtur në shtetin e huaj për efektet e ekzekutimit të vendimit, 518
- llogaritja e periudhës së paraburgimit, 465
- lloj dënimi si mundësi për kryerjen e kontrollit, 298
- lloj dënimi për përcaktimin e kompetencës në procedimet e lidhura, 82

- kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit, 230
- i përjetshëm, ulja e dënimit, 406
- masë dënimi për afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit, 263
- masë dënimi për ndalimin e të dyshuarit, 253
- masë dënimi në veprat penale që gjykohen nga një gjyqtar, 13
- masë dënimi në veprat penale që gjykohen nga gjykata e krimeve të rënda, 75/a
- masë dënimi për lejimin e përgjimeve telefonike, 221
- masë dënimi si kusht për detyrimin ose të drejtën e kryerjes së arrestimit në flagrance, 251
- masë dënimi si kusht për zbatimin e masave ndaluese, 241
- trajtimi dhe rehabilitimi i të dënuarve, 5
- ulja e dënimit me një të tretën në gjykimin e shkurtuar dhe zëvendësimi i burgimit të përjetshëm me njëzetepesë vjet, 406
- vendi për njoftimin e të pandehurit të burgosur, 139
- zgjedhja e mbrojtësit kur i dënuari nuk e ka bërë vetë, 48

BURIM PROVASH

- detyra e policisë për të siguruar, 294

- C -

CAKTIMI

- eksperti, 314, 366
- i kohës së burgimit, 465
- i dënimit, 516

- Ç -

ÇËSHTJA PENALE

- ankimi kundër vendimit të pushimit, 329
- dërgimi në gjykatë, 331
- kufijtë e shqyrtimit nga gjykata e apelit, 425
- pushimi nga prokurori, 328

- transferimi, 94, 97

- D-

DEKLARIMET

- ndalimi i përdorimit si dëshmi, 36
- që tregojnë vetëpërgjegjësi, 37
- e personave të izoluar, 111
- gojore të palëve, 121
- nga i bashkëpandehuri ose i pandehuri i një procedimi që lidhet me të, 152
- paraqitja vetë për të bërë, 307
- i mungesës së të pandehurit, 351
- i hapjes së shqyrtimit, 355
- të të pandehurit, 358
- leximi i deklarimeve të të pandehurit e të personave të tjerë, 369, 370
- për falsitetin e dokumenteve, 391

DETYRIMI

- për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, 232, 234
- i qëndrimit në një vend të caktuar, 232, 235
- oferta për garantimin e detyrimit, 272
- i ankuesit për të paguar shpenzimet dhe dëmet, 330
- për pagimin e gjobës, 392
- i të dënuarit dhe të paditurit solidarisht për shpenzimet, 393, 394
- ekzekutimi i përkohshëm i detyrimit civil, 396
- i palëve private me shpenzimet procedurale, 397
- i ankuesit dhe shpenzimet dhe me dëmet, 398, 399
- i palëve private, 421
- disponimet e gjykatës për ekzekutimin e detyrimit civil, 430
- saktësimi, 395
- për paraqitjen e të dhënave kompjuterike, 191/a

DËNIMI

- mënyra e marrjes, 191
- për personalitetin e të pandehurit dhe besnikërisë e dëshmitarit, 192
- rastet e marrjes nga procedimet e tjera, 193
- përkthimi, 196/1
- transkriptimi, 196/2
- lëshimi i kopjeve, 197
- bashkimi, 475

DËSHMI

- detyrimet e dëshmitarit, 157
- e drejta e gjykatës për të urdhëruar shoqërimin e dëshmitarit, 164
- e punonjësit të infiltruar, 294/b/4
- ku merret dëshmia e Presidentit, nëpunësve të lartë e diplomatëve, 162, 163
- kundërshtimi, 362
- kur përdoret dëshmia indirekte, 154
- ndalimi i përdorimit të deklarimeve të të pandehurit, 36
- në rastin e sigurimit të provës, 316
- objekti dhe kufijtë e, 153
- personat që përjashtohen , 108, 156, 158, 159, 160, 180
- përgjegjësia për dëshmi të rreme ose refuzim dëshmie, 165
- pyetja si dëshmitar e të pandehurit, 167
- pyetja në distancë e një personi të personi të marrë si i pandehur, 167/a
- procedura e thirrjes së dëshmitarëve dhe ekspertëve, 337
- paralajmërimi për dëshmi të rreme në marrjen e provës, 368
- paraqitja dhe betimi i dëshmitarit, 360
- rregullat që përdoren për marrjen e të dhënave nga prokurori, 312
- zotësia për të dëshmuar, 155

DËSHMITARI

- detyrimet, 157

- dëshmia e rreme ose refuzimi për të dëshmuar, 165
- dëshmia indirekte, 154
- drejtimi i pyetjeve nga ana e mbrojtësit, 50
- kundërshtimi i dëshmisë, 362
- ndalimi i publikimit të gjeneraliteteve dhe fotografive për të miturit, 103
- në aktet procedurale, 108
- në rastin e ruajtjes së sekretit shtetëror, 160
- objekti dhe kufijtë e dëshmisë (për çfarë pyetet), 153
- papajtueshmëria me detyrën e gjyqtarit në të njëjtin procedim, 15
- papajtueshmëria me detyrën e përkthyesit në të njëjtin procedim, 124
- papajtueshmëria, 156
- paprekshmëria dhe pushimi i saj, 510
- paraqitja dhe betimi, 360
- përjashtimi i paditësit civil nga kërkesa dhe pëlqimi për t'u pyetur, 166
- pjesëmarrja e të pandehurit dhe e viktimës në pyetje, 321
- përdorimi i akteve nga oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore kur pyetet sedëshmitar, 369
- pyetja, 361
- pyetja e të mbrojturve, 361/a
- pyetja në shtëpi, 364
- rasti kur kërkohet vërtetimi i gjendjes gjyqësore, 484
- referimi i papajtueshmërisë me detyrën e ekspertit, 180
- respektimi i dispozitave edhe në pyetjen e ekspertëve, 363
- siguria në rastet e gjykimeve me dyer të mbyllura, 340
- shoqërimi i detyrueshëm, 164
- thirrja, 337
- thirrja si objekt i një letërporosie, 505
- thirrja kur kërkohet nga autoriteti i huaj, 508
- urdhërimi për të deponuar në rastin e sekretit profesional, 159
- vlerësimi i besueshmërisë, nëpërmjet dokumenteve, 192

- zbatimi i dispozitave kur pyeten të pandehurit, në një procedim të lidhur, 167

- E -

EKSPERIMENTI

- kushtet, 176
- rregullat e kryerjes, 177
- procesverbali që i bashkohet kërkesës së prokurorit në fashikullin e gjyimit, 332
- shpenzimet procedurale, 485

EKSPERTI

- procedura e caktimit, 179
- detyrimi për të kryer detyrën, 179/4
- papajtueshmëria me detyrën, 180
- afati për të kërkuar përjashtimin, 181/3
- përjashtimi, 181
- detyrimi i tij për të deklaruar shkakun e përjashtimit, 181/2
- deklarata për detyrimet dhe përgjegjësinë, 183/1
- shpërblimi, 183/2
- veprimet, 184
- zëvendësimi, 186
- caktimi nga policia gjyqësore, 294/3
- caktimi nga prokurori, 314
- nuk mund të refuzojë detyrën pa shkaqe të arsyeshme, 314
- kërkesa e palëve për thirrjen në gjykim, 337
- pyetja në gjykim, 363
- pyetja në distancë, 363/3
- pyetja në shtëpi, 364

EKSPERTIMI

- afati, 185/3
- akti, 185

- kryerja nga disa ekspertë, 179/3
- masat për paraqitjen e personave që i nënshtrohen ekspertimit, 182/2
- nuk lejohet për të përcaktuar prirjet kriminale, karakterin e të pandehurit, 178/2
- objekti, 178
- rastet e moslejimit, 182/1

EKSTRADIMI

- arrestimi nga policia gjyqësore, 495
- dëgjimi i personit ndaj të cilit është marrë masë shtrëngimi, 496
- disponimi i Ministrisë së Drejtësisë, 499
- kalimi tranzit i të ekstraduarit, 502
- kërkesa për, 489
- kërkesa për ekstradim nga jashtë, 504
- kuptimi, 488
- kushtet, 490
- masat shtrënguese dhe sekuestrimet , 493
- mospranimi i kërkesës, 491
- pezullimi i dorëzimit, 500
- shpenzimet, 503
- shqyrtimi i kërkesës në gjykatë, 497
- vendimi i gjykatës, 498
- veprimet e prokurorit, 492
- zbatimi i përkohshëm i masave shtrënguese, 494
- zgjerimi i ekstradimit dhe riekstradimit, 501

EKZEKUTIMI

- bashkimi i dënimeve, 475
- dyshimi për identitetin fizik të të arrestuarit, 472
- gabimi në emrin e të dënuarit, 473
- gjykata kompetente, 470
- i dënimeve më gjobë, 467
- i dënimeve plotësuese, 468

- i disa dënimeve, 469
- i disa dënimeve për të njëjtin fakt, 474
- i masave të sigurimit, 466
- i vendimeve me burg, 464
- i vendimeve penale jashtë shtetit, 519
- i vendimit të huaj, 518
- kompetenca të tjera të gjykatës, 480
- kushtet e njohjes së vendimeve të huaja, 514
- lirimi i të burgosurit, 478
- lirimi me kusht, 477
- llogaritja e paraburgimit, 465
- mënyra e procedimit për shqyrtimin e kërkesave që lidhen me ekzekutimin, 471
- masat shtrënguese për ekzekutimin e një vendimi të huaj, 515
- njohja e vendimeve penale të huaja që kërkohet të ekzekutohen, 512, 513
- njoftimi i gjykatës që ka dhënë vendimin nga prokurori për ekzekutimin e vendimit, 463/4
- pezullimi me paraqitjen e kërkesës, 476/2
- pezullimi në shtetin shqiptar kur ka filluar ekzekutimi në shtetin e huaj, 523
- rastet e moslejimit të ekzekutimit jashtë shtetit, 521
- sekuestrua për ekzekutimin e një vendimi penal të huaj, 517
- shtyrja, 476
- vendimet e ekzekutueshme, 462
- veprimet e prokurorit për ekzekutimin e vendimit, 463

- F -

FASHIKULLI I GJYKIMIT

- aktet e hetimit paraprak që futen në, 332
- e drejta e palëve për ta shqyrtuar, 335
- futen transkriptimet, 223/5
- futja e akteve të gjykimit, 371

- provat materiale i bashkohen, 186

FASHIKULLI I PROKURORIT

- aktet e hetimit paraprak, 315/3
- kopje e akteve dhe provave të dërguara gjykatës, 332/2

FLAGRANCA

- detyrimi dhe e drejta e oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore të kryejnë arrestimin, 251
- e drejta e personit të arrestuar për të folur me mbrojtësin, 53
- gjendja, 252
- kërkohet menjëherë autorizimi për të proceduar, 288
- rast i gjykimit të drejtpërdrejtë, 400
- rast kur kryhet kontrolli i personit ose i vendit pa një vendim kontrolli, 202
- rast kur kryhet kontrolli si veprimtari me iniciativë e policisë gjyqësore, 298
- rast kur merren të dhëna të nevojshme për vazhdimin e hetimeve, 296

- G -

GABIM

- në emër dhe korigjimi, 114

GARANCIA PASURORE

- deklarata, 236
- si masë shtrënguese, 232

- GJ -

GJENDJA GJYQËSORE

- heqja e shënimeve, 483
- shënimet në regjistrin e, 482

- vërtetimet, 484
- zyra, 481

GJOBA

- detyrimi për pagimin, 392
- ekzekutimi i dënimeve, 467
- për ata që pengojnë zhvillimin e seancës, 341
- për mosplotësimin e detyrës nga përkthyesi, 127/2

GJUHA SHQIPE

- e akteve, 98
- përdorimi në procedim, 8

GJYKATAT

- pavarësia, 3
- funksionit, 11
- drejtësia penale jepet nga, 12
- Gjykata e Lartë, 12
- penale të shkallës së parë, 12, 13
- përbërja, 13
- e apelit, 14
- e rrethit gjyqësor, 13, 74
- kompetencat për hetimet paraprake, 279
- kompetente për ekzekutim, 470

GJYKATA PËR KRIMET E RËNDA

- përbërja, 13
- kompetencat, 75/a

GJYKATA E LARTË

- gjykon në shkallë të parë, 75/b/2
- shqyrton ankimet kundër masave të sigurimit, 149
- shqyrton rekursin kundër vlerësimit të vendimit të arrestit dhe ndalimit, 159/3, 4

- rivendos në afat, 148
- si pjesë e sistemit gjyqësor, 12
- vendos për kompetencën, 86, 90, 91
- vendos për transferimin e çështjes, 94-97
- zgjidh mosmarrëveshjet për juridiksionin, 73

GJYKATA E APELIT

- ankimi kundër vendimit që pranon përgjimin, 222/a
- ankimi kundër vendimit të saj si gjykatë rigjykimi, 448
- dërgimi për rigjykim nga Gjykata e Lartë, 453
- humbja e fuqisë së paraburgimit në rast mosdhënie vendim dënimi nga kjo gjykatë, 263
- kompetenca, 424
- kompetenca për të vendosur për ekstradimin, 498
- kompetenca për të vendosur për masat shtrënguese dhe sekuestrimet në rastet e ekstradimeve, 493, 495
- kufijtë e shqyrtimit të çështjes, 425
- kompetenca për të vendosur për masat shtrënguese dhe sekuestrimet në rastet e ekzekutimit të vendimeve penale të huaja, 515
- mund të bëhet ankim kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat, 147
- mund të bëhet ankim kundër vendimit të gjykatës që shqyrton ankimin kundër pushimit të çështjes ose të akuzës, 329
- mund të bëjë ankim prokurori i rrethit ose i apelit, 408
- pezullohet ekzekutimi i vendimit të ankimuar deri në përfundim të gjykimit, 417
- përbërja, 14
- prishja e vendimit nga Gjykata e Lartë, 441
- rekurs kundër vendimit për masën e sigurimit, 249
- rekursi kundër vendimeve, 432
- seksionet e Gjykatës së Apelit Tiranë, 14
- shqyrtimi i ankimit mbi vendimin për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për sigurimin e provës, 320

- si gjykatë penale, pjesë e sistemit gjyqësor, 12
- ushtrimi i funksioneve të prokurorëve pranë gjykatave të apelit, 25
- vendimi, 428-430
- vendimi mbi kompetencën e gjykatës së shkallës së parë, 86
- vendosja mbi dorëheqjen e prokurorit pranë gjykatës së apelit, 26
- vënia e sekuestros para se aktet t'i dërgohen kësaj gjykate, 271
- vendos mbi ankimin për vënien ose mosvënien e sekuestros, 276

GJYKATA E APELIT RËR KRIMET E RËNDA

- përbërja, 14
- kompetencat, 75/a, 424

GJYKIM I SHPEJTË

- kur prokurori kërkon, 334

GJYKIMI ME DYER TË MBYLLURA

- rastet, 340

GJYQTARI

- afatet dhe format e kërimit të përjashtimit, 19
- disponimet kur pranohet heqja dorë dhe përjashtimi, 23
- heqja dorë, 17, 23
- kompetenca për përjashtim, 21
- konkurrimi i heqjes dorë dhe përjashtimit, 20
- përjashtimi, 18,19,20, 23
- rastet e papajtueshmërisë, 15, 16
- vendimi për përjashtimin, 22

- H -

HETIMET PARAPRAKE

- afati, 323
- ankim për zgjatjen , 325
- detyrimi për ruajtjen e sekretit, 279

- hetimet e lidhura të dy prokurorive, 306/2
- kohëzgjatja, 324/2
- kompetencat e gjykatës, 278
- organet e ngarkuara, 277
- pezullimi, 326
- pezullimi i afatit kur është i nevojshëm autorizimi i procedimit 323/2
- përfundimi i hetimeve, 327, 331
- zgjatja e afatit, 324
- zgjatja për qëllimet e sigurimit të provës, 317/4

- I -

IDENTIFIKIMI

- dokumentimi i akteve nga policia gjyqësore gjatë kryerjes së veprimeve, 303
- dokumentet e tjera të vlefshme për të dalë jashtë shtetit, kur zbatohet vendimi i ndalimit të daljes jashtë shtetit, 233
- kur dyshohet identiteti i të burgosurit, 472
- i burimit për vërtetësinë e të dhënave në ruajtjen e sekretit profesional, 159,
- i të pandehurit, 40
- i personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, 295
- i personit të cilit i atribuohet fakti në kallëzim, 281, 282
- marrja e masave për identifikimin e personit në rastin e ekzekutimit të vendimit penal të huaj, 515
- njoftim i policisë gjyqësore të prokurori, 293
- pavlefshmëria e urdhërit të paraqitjes së të pandehurit në gjykatën e apelit, 426
- pamundësia për personat e dëmtuar, 138
- paraqitja e elementeve të mjaftueshëm nga shteti i huaj në rastin e masave shtrëguesë para ekstradimit, 494
- përmban vendimi i gjykatës, 245
- të dhëna që vlejné për personin ndaj të cilit zhvillohen

- hetime kur ftohet për t'u paraqitur, 308
- të dhëna që vlejné për të pandehurin për t'u treguar në procesverbalin e seancës, 345
- të dhëna që vlejné për të pandehurin për t'u treguar në vendimin e gjykatës, 383
- urdhërimi i paraqitjes së të interesuarit te prokurori në rastin e ekstradimit, 492

IMITURI

- detyrimi për njoftimin e prindit ose kujdestarit, 255
- gjykimi nga gjykata për krimet e rënda, 75/a
- kufijtë e bashkimit të procedimeve, 81
- mbajtja në ruajtje jo në burg, 255
- merret parasysh në caktimin e masës së sigurimit, 229/3
- mosdorëzimi i kopjes së njoftimit, 140
- mosndërprerja e proceseve edukative në masat e sigurimit, 229
- mosarrestimi për kundërvajtje, 230
- mosprania në seancë, 339
- ndalimi i publikimit të akteve, 103
- ndihma që i jepet të pandehurit, 35
- nuk mund të arrestohet për kundërvajtje penale, 230/4
- nuk mund të jenë dëshmitarë për të vërtetuar përmbajtjen e aktit procedural, 108
- nuk pranohet në seancë, 339
- papajtueshmëria me detyrën e ekspertit, 180
- papajtueshmëria me detyrën e përkthyesit, 124
- përjashtimi nga betimi si dëshmitar, 360
- pyetja si dëshmitar, 361/5
- rasti i gjykimit me dyer të mbyllura, 340
- seksionet për gjykimin, 13
- verifikimi i moshës së të pandehurit, 41
- verifikimi për personalitetin e të pandehurit, 42

I PADITURI CIVIL

- ankimi kundër vendimit, 411
- detyrimi, 394
- ndërhyrja me vullnetin e tij, 66
- thirrja, 65

I PANDEHURI

- ankimi për pushimin e çështjes, 329
- ankimi për zgjatjen e hetimeve, 325
- biseda me mbrojtësin, 53
- deklarimet në gjykim, 358
- deklarimi i mungesës, 351
- dënimi, 390
- i njoftohet vendimi i ekspertimit, 179
- kërkesa për pyetjen, 166
- largimi nga gjykimi, 352
- leximi i deklarimeve në gjykim, 370
- marrja e cilësisë, 34
- marrja në pyetje në një proces të lidhur nga prokurori, 311
- masat mjekësore, 46
- mbrojtja, 6
- mbrojtësi i zgjedhur dhe i caktuar, 48, 49
- mungesa në gjykim, 352
- ndalimi i përdorimit si dëshmi i deklarimeve, 36
- ndihma e të pandehurit të mitur, 35
- ndihma falas me përkthyes, 123
- në lidhje me kompetencën, 76, 77, 81, 90, 91
- njoftimet për atë që është i lirë, 140
- njoftimet për atë që është i burgosur, 139
- njoftimi nga prokurori për të marrë pjesë në kontrollime, sekuestrime, 310
- njoftimi për atë që nuk gjendet, 141
- njoftimi për vendimin për përjashtimin e gjyqtarit, 22
- paralajmërimi për deklarimet, 37

- pezullimi i procedimit për shkak të gjendjes mendore dhe revokimi i pezullimit, 44, 45
- prezumimi i pafajësisë, 4
- pyetja, 39
- rregullat e marrjes në pyetje, 38
- shoqërimi i detyrueshëm, 353
- shtrirja e të drejtave të mbrojtësi, 50
- të drejtat për ekspertimin dhe ekspertin, 179/2
- vdekja, 47
- verifikimi i identitetit, 40
- verifikimi i moshës, 41
- verifikimi i personalitetit për atë të mitur, 42
- verifikimi për përgjegjshmërinë, 43

- J -

JURIDIKSIONI

- kërkesa për gjykim, 60, 331, 334
- mosmarrëveshjet, 73
- mungesa, 72
- penal, 69

- K -

KALLËZIMI

- akt që i bashkëngjitet kërkesës së prokurorit për gjykimin e çështjes në fashikullin e gjykimit, 332
- mbajtja e procesverbalit nga policia gjyqësore si dokumentim veprimi, 303
- mbajtja e procesverbalit nga prokurori si dokumentim veprimi, 315
- nga nëpunësit publikë, 281
- nga personeli mjekësor, 282
- nga shtetasit, 283
- njoftimi për vendimin e mosfillimit të procedimit atyre që

- e kanë bërë, 291
- përjashtimi nga mosdetyrimi për të dëshmuar, 158
- rast i papajtueshmërisë, 15
- rregullat që zbatohen nga personat e izoluar, 111

KËQYRJET

- akt që i bashkëngjitet kërkesës së prokurorit për gjykimin e çështjes në fashikullin e gjykimit, 332
- e kufomës, 200
- e personave, 199
- e vendeve dhe e sendeve, 201
- mbajtja e procesverbalit nga policia gjyqësore si dokumentim veprimi, 303
- mbajtja e procesverbalit nga prokurori si dokumentim veprimi, 315
- moslejimi deri në dhënien e autorizimit për të proceduar, 289
- njoftimi i mbrojtësit për kryerjen, 309
- përfshirja në shpenzimet procedurale të bëra nga shteti, 485
- rastet dhe format, 198
- rrethanat kur lejohet të këqyret zyra e mbrojtësit, 52

KOMPENSIMI

- kërkesa, 269
- në rast vdekje, 460
- për dënim të padrejtë, 459
- për burgim të padrejtë, 268

KOMPETENCAT

- e gjykatës në hetimet paraprake, 278
- e gjykatës së rrethit gjyqësor, 74
- kërkesa në gjykim, 354
- parashtrimi i mosmarrëveshjes, 90
- për procedimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, 78
- për shkak të bashkimit të procedimeve, 79, 80, 81

- për shkak të lidhjes së procedimeve, 82
- për veprat penale të kryera jashtë shtetit, 77
- rastet e mosmarrëveshjeve, 84
- tokësore, 76
- vendimi i gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë, 86
- zgjidhja e mosmarrëveshjes, 91

KONFISKIM

- moskthimi i sendeve të sekustruara, 217
- rrethanat e humbjes së fuqisë, 275
- kërkesa për ekzekutim nga Ministria e Drejtësisë, 522
- kompetencat e gjykatës për të vendosur shuarjen, 480
- vendimi i njohjes për ekzekutimin, 516

KONTROLLET

- garancitë për mbrojtësin, 52
- i personit, 204
- i vendeve, 205
- i banesës, 206
- i gjyqtarit për asgjësimin e dokumentacionit të përgjimit, 224
- i respektimit të urdhrave që i janë dhënë të pandehurit, 237
- kërkesa e dorëzimit të sendit pas kontrollit, 203
- kushtet për kryerjen, 202
- në rastet e flagrancës, 202/3
- sekuestrimi i sendeve gjatë kontrollit, 207
- mbajtja e procesverbalit nga policia gjyqësore si dokumentim veprimi, 303
- mbajtja e procesverbalit nga prokurori si dokumentim veprimi, 315
- moslejimi deri në dhënien e autorizimit për të proceduar, 289
- ndihma e mbrojtësit, 302
- nga policia gjyqësore në rast flagrante ose kur duhet të kryhet një ndalim ose arrestim, 298
- njoftimi i të pandehurit për të marrë pjesë, 310

KOPJE

- autentike e verifikuar, 101
- dorëzimi të interesuarit nga sekretaria, 132/3
- e dokumenteve të sekuestruara, 213
- kërkesa e Ministrit të Rendit Publik dhe e Kryetarit të Shërbimit Informativ Shtetëror për të marrë kopje nga gjykata, 106
- lëshimi, 197
- marrja, 105
- për deklaratimet e palëve, 121

KORRESPONDENCA

- kontrolli në bankë, 203/2
- marrja nga policia gjyqësore, 299
- mbajtja e procesverbalit nga policia gjyqësore si dokumentim veprimi për marrjen, 303
- ndalimi i kontrollit si garanci për mbrojtësin kur ky komunikon me të pandehurin, 52
- sekuestrimi, 209

KUJDESTARI

- bën ankimin që i takon të pandehurit, 410
- caktimi në rastin e papërgjegjshmërisë së të pandehurit, 44
- heqja dorë e gjyqtarit, 17
- kërkon rishikimin, 451
- njoftimi i detyrueshëm nga policia gjyqësore kur i arrestuari ose i ndaluar është i mitur, 255
- ushtron të drejtat e të pandehurit pas vdekjes së tij në procesin e rishikimit, 452

- L -

LEGJISLACIONI PROCEDURAL PENAL

- detyrat, 1

LETËRPOROSIA

- ekzekutimi I 507
- dërgimi autoriteteve të huaja, 509
- kompetenca e Ministrisë së Drejtësisë, 505
- paprekshmëria e personit të thirrur me letërporosi, 506
- thirrja e dëshmitarëve që kërkohen nga autoriteti i huaj, 508
- vlera e akteve të marra, 511

LIRIM

- disponimet në rastet e lirit nga burgu, 266
- kur nuk merren parasysh kushtet e ekstradimit, 490
- kur vazhdimi i burgimit rrezikon jetën, 478
- indentifikimi i të pandehurit, 472
- i menjëhershëm, 257 - 262
- me kusht, 477
- shënohet deklarimi ose zgjedhja e banesës në aktin e lirit për shkak të ndryshimit të masës së sigurimit, 139
- urdhërimi kur vendoset pafajësia ose pushimi, 389
- urdhërimi kur është gabuar identiteti, 472
- vendosja nga gjykata me rastin e arrestimit të përkohshëm, 495
- vënia në dijeni e prokurorit kur lirohet, 265

- M -

MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

- respektimi për marrjen e deponimeve nga nëpunësit diplomatikë të huaj, 163/2
- zbatimi, 10

MASAT NDALUESE

- llojet, 240
- afatet, 267

MASAT E SIGURIMIT

- afatet e kohëzgjatjes maksimale, 267
- ankimi kundër, 249
- bashkimi, 231
- ekzekutimi, 466
- kërkesa për caktimin, 244
- kërkimi i personit që nuk gjendet, 247
- kriteret për caktimin, 229
- kushtet për caktimin, 228
- llogaritja e afateve të kohëzgjatjes, 250
- ndarja, 227
- njoftimi, 246
- paraqitja vetë nuk pengon zbatimin, 307/3
- pasojat e shuarjes, 262
- pasoja e vendimit të Gjykatës së Lartë kur duhet të pushojë vazhdimi i një mase sigurimi, 446
- revokimi, 260/1
- shuarja, 261
- të vendosura nga gjykata jokompetente, 88
- vendimi i gjykatës që cakton masën e sigurimit, 245
- zbatimi, 246
- zëvendësimi, 260/2, 3, 231

MASAT E SIGURIMIT PASUROR

- sekuestroja konservative, 270 273
- sekuestroja preventive, 274 deri 276

MASAT SHTRËNGUESE

- llojet, 232 - 239
- detyrimi i gjykatës për të dëgjuar personin, 496
- afatet dhe revokimi i, 515

MASAT MJEKËSORE

- të detyrueshme, 46

- ekzekutimi, 464/4
- shtrimi i përkohshëm në spital, 239

MBROJTËSI I TË PANDEHURIT

- asiston në kontrollimet dhe verifikimet e ngutshme të policisë gjyqësore, 302
- biseda me të pandehurin, 53
- garancitë, 52
- i caktuar kryesisht nga prokurori, 309/1
- i caktuar nga organi që procedon, 49
- i zgjedhur nga i pandehuri, 48
- lajmërohet nga prokurori për të marrë pjesë në veprimet hetimore, 309/2
- i disa të pandehurve, 54
- merr pjesë në pyetjen e personit të arrestuar, 248, 256
- mospranimi, dorëheqja ose revokimi, 55
- njoftimi nga prokurori për të marrë pjesë në kontrollime sekuestrime, 310
- prania e detyrueshme kur merren të dhëna nga personi, ndaj të cilit zhvillohen hetime 296
- përgjegjësia për lënien ose refuzimin e mbrojtjes, 56
- sigurimi i mbrojtjes, 6
- shtrirja e të drejtave të të pandehurit të mbrojtjes, 50
- zëvendësimi, 49
- zëvendësues, 51, 57

MEMECI

- pjesëmarrja në bërjen e akteve, 107

MEMORIET

- duhet të nënshkruhen nga mbrojtësi, 435/2
- e palëve, 110
- i bashkohen procesverbalit, 347
- paraqitja në rastin e ekstradimit, 492

MINISTRIA E DREJTËSISË

- autorizimi për kalimin tranzit të personit të ekstraduar, 502
- disponon për ekstradimin, 499
- bën kërkesë për ekstradim nga jashtë, 504
- i dërgon kërkesën përkatëse prokurorit, 492
- i dërgon letërporosi autoriteteve të huaja, 509
- bën kërkesat për masat shtrënguese dhe sekuestrimet, 493, 494
- kërkesa për ekstradim i drejtohet, 489
- kompetencat për letërporositë ndërkombëtare, 509
- mund të caktojë edhe kushte të tjera për ekstradimin, 490/3
- pezullimi i dorëzimit, 500
- transmeton kërkesën për marrjen në pyetje të nëpunësve diplomatikë, 163
- zyra e gjendjes gjyqësore pranë, 481

MOSKOMPETENCA

- caktimi i masave të sigurimit kur deklarohet, 244/2
- e shpallur gjatë hetimeve paraprake, 84
- e shpallur në gjykimin e shkallës së parë, 85
- lëndore dhe tokësore, 83
- vendimi i gjykatës së apelit dhe i Gjykatës së Lartë, 86

- N -

NDALIMI

- detyrat e policisë gjyqësore, 255
- e drejta e personit që ndalohej për të biseduar me mbrojtësin, 53
- humbet fuqinë, 295/5
- fillimi i ecjes së efekteve të paraburgimit, 250
- i daljes jashtë shtetit dhe për të qëndruar në një vend të caktuar (si masë shtrënguese), 232, 233, 235
- i përkohshëm i ushtrimit të një veprimtarie (si masë ndaluese), 240, 243
- i të dyshuarit për një krim, 253

- kërkesa e vleftësimit, 258
- lirimi i menjëhershëm, 257
- marrja në pyetje, 256
- moslejimi në rrethana të caktuara, 254
- moslejimi deri në dhënien e autorizimit për të proceduar, 289
- rasti kur lejohet të bëhet kontroll, 298
- seanca e vleftësimit, 259
- zbatimi i dispozitave mbi ndalimin në rastin e shkeljes së urdhërave të lirimit nga burgu, 266

NDARJA E ÇËSHTJEVE

- rastet, 93

NDALIMI I DALJES JASHTË SHITETIT

- si masë shtrënguese, 232
- vendimi, 233

NDALIMI I USHTRIMIT TË NJË VEPRIMTARIE TË CAKTUAR

- si masë ndaluese, 240
- vendimi, 243

NDALIMI I QËNDRIMIT NË NJË VEND TË CAKTUAR

- si masë shtrënguese, 232
- vendimi, 235

NDJEKJA PENALE

- ushtrimi nga prokurori, 24
- kur mund të fillojë, 284
- rifillimi, 292

NORMAT PROCEDURALE

- respektimi i detyrueshëm, 2

- NJ -

NJOFTIMET

- i akteve të prokurorit, 134
- me telefon, telegraf dhe faks, 133
- nga palët private, 135
- organet që i bëjnë, 132
- pavlefshmëria, 143,130/2
- për palët private, 137
- për prokurorin, 136
- për personat e dëmtuar, 138
- për të pandehurin e burgosur, 139
- për të pandehurin e lirë, 140
- për të pandehurin jashtë shtetit, 142
- për të pandehurin që nuk gjendet, 141

NJOHJET

- e personave, 171, 172
- e personave dhe sendeve nga prokurori, 313
- e sendeve, 173
- e zërave, tingujve, 174
- nga disa persona ose e disa personave, 175

NJOHJE E VENDIMVE PENALE

- procedura, njohja dhe kur vendimi i gjykatës së huaj nuk njihet, 512-514

NJOHJE PERSONASH E SENDESH

- procedura, 313

- O -

OFICERËT (DHE AGJENTËT) E POLICISË GJYQËSORE

- fiksojnë gjurmët dhe sendet që i përkasin veprave penale, 300
- funksionet, 30/3

- janë oficerë dhe agjentë të policisë gjyqësore, 32
- kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë, 251/2
- kontrollojnë dokumentet dhe korrespondencën e bankës, 203/2
- kryejnë detyrimisht arrestimin në flagrancë, 251/1
- kryejnë kontrollin e personit ose vendit në rast flagrante, 22/3
- kur pyetet si dëshmitar mund të përdorë aktet e policisë gjyqësore, 369/4
- mban procesverbal për heqjen dorë nga ankimi, 285/1
- merr plikot dhe korrespondencën, 299
- merr të dhënat nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, 296/2
- në rast flagrante bëjnë kontrollin e personit ose të lokalit, 298
- pezullon dërgimin e letrave, pakove, vlerave monetare, 299/2
- përgjigjen para prokurorit dhe zbatojnë detyrat që u cakton ai, 33
- pjesëtarët e seksionit nuk mund të hiqen pa pëlqimin e Prokurorit të Përgjithshëm, 33/3

- P -

PADIA CIVILE NË PROCESIN PENAL

- disponimet për padinë civile, 68
- heqja dorë nga gjykimi, 64
- heqja dorë nga ankimi, 285
- ndërhyrja e të paditurit në gjykim, 66
- ngritja e padisë, 61
- sigurimi, 63
- thirrja e të paditurit në gjykim, 65

PADITËSI CIVIL

- afati i legjitimit, 62
- ankimi kundër vendimit, 411
- heqja dorë nga gjykimi, 64
- heqja dorë nga padia, 185
- kërkesa në gjykatën e apelit për ekzekutimin e vendimit civil, 430

PAFAJËSIA

- ekzekutimi menjëherë i vendimit, 426/3
- kompensimi për paraburgimin, 268
- prezumimi, 4
- vendimi, 388
- rishikimi i vendimit, 449/2

PAJTIMI

- përpjekjet, 338

PALËT

- detyrimi me shpenzimet, 397
- heqja dorë nga ankimi, 418
- kërkesat për provë, 356
- gjyqumbësi detyrohet me shpenzimet, 421
- njoftimet, 135, 137
- njoftimi i ankimit, 414
- paraqitja e ankimit, 413
- paraqitja në seancë, 348
- përfaqësuesi, 67
- pyetja, 168
- pyetja në gjykim, 365
- të drejtat në gjykim, 365

- të drejtat në rastet e akuzave të reja, 376
- verifikimi i paraqitjes, 348

PARABURGIMI

- afatet e kohëzgjatjes, 263
- dërgimi menjëherë në një institut në rastin e arrestit në burg, 238
- e drejta e kompensimit, 268
- humbja e fuqisë për masat e ndryshme nga paraburgimi, 267
- kërkohet nga Ministria e Drejtësisë në rastin e ekzekutimit jashtë shtetit të vendimeve penale shqiptare, 522

- kohëzgjatja nuk mund të kalojë gjysmën maksimale të dënimit për veprën, 264/3
- moscenimi i afateve kur zgjaten nga Prokurori i Përgjithshëm, 324
- lirimi për shkak të mbarimit të afatit, 266/1
- llogaritja e afateve, 250
- llogaritja e paraburgimit jashtë shtetit në rastin e ekstradimit, 504
- llogaritja në caktimin e kohës së dënimit, 465
- llogaritja në caktimin e kohës së dënimit me burgim, 465
- pezullimi i afateve, 265
- rekursi në Gjykatën e Lartë për kohëzgjatjen, 249/9
- rivënia në fuqi, 266/2, 3
- shuhet masa kur kohëzgjatja është më e madhe se masa e dënimit, 261
- vendosja nga gjykata në rastin e ekstradimit, 498
- vënia në dispozicion të prokurorit në dhomat e paraburgimit, 255
- vlefshmëria e rregullave për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi, 237
- zëvendësimi nga gjykata kur i arrestuari është i sëmurë mendërisht, 239
- zgjatja, 264

PAVLEFSHMËRIA

- çmuarja, 130
- e aktit për shkak të shkeljes së rregullave për gjuhën, 98
- e aktit për shkak të mostregimit të datës, 100
- e aktit të thirrjes së të pandehurit në ndarjen e çështjeve, 93
- e akteve, 128
- e betimit, 360
- e njoftimeve, 143
- e njohjes, 171, 172, 173
- e lajmërimeve, komunikimeve dhe njoftimeve, 130/1
- e procesverbalit, 122
- e provave të marra nga gjykata jokompetente, 87
- e vendimit e parashikuar si rast i kthimit të akteve nga gjykata e apelit, 429

- e vendimit e parashikuar si shkak i rekursit, 432
- mosngritja në rigjykim, 447
- pasojat e deklarimit, 131
- relative, 129

PEZULLIMI I EKZEKUTIMIT

- rrethanat, 472, 473, 523
- të vendimit, detyrimit, 417, 430
- të ekstradimit, 500

PEZULLIMI I HETIMEVE

- rastet, 326

PEZULLIMI I MASËS SË SIGURIMIT

- e drejta e gjykatës, 454

PEZULLIMI I PROCEDIMIT

- për shkak të papërgjegjshmërisë së të pandehurit, 44
- revokimi i vendimit, 45

PEZULLIMI I SHQYRTIMIT GJYQËSOR

- rastet, 343
- vendimi i gjykatës për, 350

PEZULLIMI I USHTRIMIT TË NJË DETYRE A SHËRBIMI PUBLIK

- si masë ndaluese, 240
- nuk zbatohet ndaj të zgjedhurve, 242/2
- vendimi, 242

PËRFAQËSUESI

- i palëve private, 67

PËRGJIMI I BISEDIMEVE DHE I KOMUNIKIMEVE

- ankimi kundër, 222/a
- pushimi i përgjimit, 223/1/1
- ndalimi i përgjimit, 226/2
- ndalimi i përdorimit të rezultateve, 226/1
- përdorimi i rezultateve në procedimet e tjera, 225
- për të lehtësuar kërkimin e personit të ikur, 247
- rastet dhe kufijt e lejimit, 221
- veprimet e përgjimit, 222
- ruajtja e dokumentacionit, 224
- vendimi për lejimin, 223

PËRKTHYESI

- afati për përkthimet me shkrim, 127
- caktimi, 123
- e drejta për të pasur, 8
- kërkesa për përjashtim dhe për heqjen dorë, 125
- paralajmërimi për detyrimin që të bëjë përkthim të saktë dhe për të mbajtur sekretin, 126
- pazotësia dhe papajtueshmëria, 124
- zëvendësimi, 127

PËRMBARUESI GJYQËSOR

- ekzekutimi i detyrimit për shpenzimet procedurale, 486
- ekzekutimi i vendimit me gjobë, 467
- zbatimi i vendimit për sekuestron konservative, 271/3

POLICIA GJYQËSORE

- bën kontrollet në rast flagrance, ndalimi ose arrestimi, 298
- bën njoftimin e akteve, 132/2
- bën verifikim të ngutshëm, 300
- cakton ekspert, 294/3
- dokumentimi i veprimeve, 303
- funksionet, 30

- identifikon personat, 295
- infiltrimi i punonjësit, 294/b
- kryen veprimet e deleguara nga prokurori, 30, 304/2
- marrja dijeni për veprën penale, 280
- merr të dhënat për persona të tjerë, 297
- merr të dhëna nga personi nën hetim, 296
- merr plikot dhe korrespondencën, 299
- njofton aktet e prokurorit, 134
- pranon ankimin e viktimës, 284
- pranon kallëzimin nga nëpunësit publikë, 281
- pranon kallëzimin nga personeli mjekësor, 282
- pranon kallëzimin nga shtetasit, 283
- referon veprën penale të prokurorit, 293
- sekuestron provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën, 300/2
- siguron burimet e provave, 204
- shërbimet dhe seksionet, 31
- varësia, 33
- veprime simuluese, 294/a
- veprimet në përfundim të hetimeve, 327
- zhvillon hetime, 30, 277

POSTA

- dërgimi i ankimit, 413
- kontrolli i zyrave, 209
- marrja e plikove, letrave nga policia gjyqësore, 299
- njoftimet e akteve, 132, 134

PROCEDIMI

- autorizimi, 288
- ndalimi i veprimeve kur mungon autorizimi, 289
- në kundërshtim me ligjin, 9
- rifillimi, 292
- rrethanat që nuk lejojnë fillimin, 290
- vendimi për mosfillimin, 291

PROCESVERBALI

- kërkesat e palëve, 347
- i marrjes së provës, 368
- i seancës gjyqësore, 345
- i veprimeve të përgjimit, 223
- marrja e tyre nga procedime të tjera, 193
- në formë të përmbledhur, 120
- nënshkrimi, 117
- pavlefshmëria, 122
- për deklaratimet dhe kërkesat e palëve, 121
- përmbajtja si akt, 116
- përmbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore, 346
- përpilimi, 115
- riprodhimi fonografik dhe audioviziv, 119
- transkriptimi, 118

PROKURË

- kur kërkohet përjashtimi i gjyqtarit, 19
- i bashkohet procesverbalit në deklaratimet gojore të palëve, 121
- pajisja e përfaqësuesit të palëve private, 67
- procedura e dhënies, 109
- shoqëron kërkesën e viktimës akuzuese, 60

PROKURORI

- ankimi kundër vendimit që pranon përgjimin, 222/a
- caktimi i ekspertit, 314
- çmon pavlefshmërinë e aktit gjatë hetimeve paraprake, 130/4
- dokumentimi i veprimeve, 315
- fashikulli i dokumenteve, 315/3
- ftesa për paraqitjen e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, 308
- funksionet, 24
- heqja dorë, 26
- ka të drejtë të mos fillojë ose të pushojë procedimin penal, 24/2
- kalimi i akteve në një prokurori tjetër, 28

- kalimi i akteve prokurorit nga gjykata, 377
- kërkimi i akteve nga një prokuror tjetër, 29
- kontrolli në hetimet paraprake, 24
- lajmërimi i mbrojtësit, 309
- marrëdhëniet ndërmjet prokurorive, 306
- merr pjesë në çështjet që gjykohen me kërkesën e viktimës, 59/2
- merr të dhëna nga ata që tregojnë rrethana për qëllimet e hetimit, 312
- njoftimi i akteve të prokurorit, 132, 136
- njoftimi i të pandehurit për të marrë pjesë në kontrollime e sekuestrime, 310
- procedon për njohjen e personave dhe të sendeve, 313
- thërret me urdhër përkthyesit dhe ekspertët, 312
- urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë, 24/4
- ushtrimi i funksioneve, 25
- ushtron ndjekjen penale, 24
- veprimet në përfundim të hetimeve, 327
- veprimet për ekzekutimin e vendimeve, 463
- veprimet për ekstradimin, 24, 492
- veprimtaria hetimore, 304
- zëvendësimi, 27

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

- cakton se cila prokurori duhet të procedojë, 28, 29
- pëlqimi për heqjen e pjesëtarëve e seksioneve të policisë gjyqësore, 33/2
- urdhëron marrjen përsipër të hetimeve, 305
- urdhëron zëvendësimin e prokurorit, 27

PROVAT

- bazë për kërkesë të re për rishikim, 461
- çmuarja, 152
- dërgimi në gjykatë, 331

- disponimet e gjykatës, 357
- dhënia rrugë letërporosisë, 505, 509
- elementet e vendimit, 383
- gjendja që vërteton pafajësinë e të pandehurit kur prokurori tërheq akuzën, 377
- kapja në gjendjen e flagrancës, 252
- kërkesa e palëve për marrjen e provave të reja, 376
- kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit përmban, 19
- kërkesat për provë, 356
- kërkesa për rimarrje ose marrje provash të reja në rastin e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, 427
- kërkesa për rishikim duhet t'i përmbajë, 452
- kërkitimi i marrjes nga viktimi akuzuese, 58
- konsiderimi i provave të marra në seancën e vleftësimit të arrestimit ose të ndalimit, 259
- kuptimi, 149
- kusht për caktimin e masave të sigurimit personal, 228
- llojet, kreu II i titullit IV, nenet 153 - 197
- marrja, 151
- marrja dijeni e personave që nuk dinë shqip, 8
- marrja e procesverbaleve si dokumente, 193
- marrja e provave të reja, 367
- marrja gjatë kohës që vazhdon verifikimi i përgjegjshmërisë, 43, 44
- marrja në rastin e sekretit, 211
- marrja nga ekspertit kur autorizohet, 184
- mjaftueshmëria për vërtetimin e akuzës në rastin e lejimit të përgjimit, 222
- mosdëmtimi në rastet e marrjes së masave ndaluese, 267
- në rastin e sekretit shtetëror, 160
- njohja e të pandehurit, 39
- njohja prej mbrojtësit zëvendësues, 55, 57
- objekti, 150
- pavarësia dhe bazueshmëria e gjykatës, 3
- paraqitja e provave të tjera në gjykimin e drejtpërdrejtë, 402

- përfundimi i hetimeve, 327
- përpilimi i vendimit, 382
- procesverbali i marrjes, 368
- provat e marra nga gjykata jokompetente, 87
- që mund të përdoren për marrjen e vendimit, 380
- rast kur lidhen hetimet e dy prokurorive, 306
- rastet e bashkimit të çështjeve, 92
- rastet e dëshmisë së rreme, 165
- rradha e marrjes, 359
- saktësimi i dëmit, 395
- sigurimi, 316-322
- sigurimi i burimeve, 294
- vendimi i rishikimit nuk mund të jepet duke vlerësuar provat e marra në gjykimin e mëparshëm, 456
- veprimet e ngutshme në gjykatë, 336
- vlerësimi i deklarimeve në kundërshtimin e dëshmisë, 362
- vlerësimi i leximeve të lejueshme, 369
- zbulimi i provave të reja në rastin e rishikimit, 450
- zhvillimi i diskutimit, 378

PROVAT MATERIALE

- disponimet në përfundim të procedimit, 190
- dokumentacioni që i vihet në dispozicion prokurorit nga policia gjyqësore, 303
- dokumentet që përbëjnë, 191
- fshehja si kusht për të kryer kontrollin, 202
- i bashkëngjiten kërkesës së prokurorit në fashikullin e gjykimit, 332
- kuptimi, 187
- marrja a masave shtrënguese në rast ekstradimi, 493
- njohja, 173
- përshkrimi, fotografimi dhe marrja, 188
- rast kur lejohet këqyrja dhe kontrollimi i zyrës së mbrojtësit, 52
- ruajtja, 189
- sekuestrimi, 208

- sekuestrimi me vendim gjykate në rastin e ekstradimit, 498
- sekuestrim në rastin e arrestimit në rastin e ekstradimit, 495
- sekuestrimi në verifikimet e ngutshme në vend, 300
- sekuestrimi nga gjykata si zbatim i përkohshëm i masave shtrënguese, 494

PUSHIMI I ÇËSHTJES

- kur i pandehuri vdes, 47
- ankimi kundër vendimit, 329
- kompetencat për paraburgimin e vuajtur, 268/3
- nga prokurori, 328
- për shkak pajtimi, 338
- vendimi, 387

PYETJE

- në themel, 39
- e dëshmitarit, 361, 363
- e dëshmitarit në distancë, 361/7
- e dëshmitarëve të mbrojtur dhe e bashkëpunëtorëve të drejtësisë, 361/a
- ekspertit në distancë, 363/3
- e palëve private, 365
- në shtëpi e ekspertit, 364
- në shtëpi e dëshmitarit, 364
- rrethanat kur pyetet i pandehuri dhe i padituri, 166-168

- R -

REGJISTRIMI

- i njoftimit të veprave penale, 287

REKURSI I GJYKATËS SË LARTË

- i drejtpërdrejtë, 431
- i drejtpërdrejtë kundër masave të sigurimit, 249/1

- janë objekt, 431
- kundër vendimeve të formës së prerë, 432
- kundër vendimit të pezullimit për shkak të gjendjes mendore të të pandehurit, 144/2
- kundër vendimit të vlefhtësimit të arrestit e të ndalimit, 259/3, 4
- kundër vendimit për zgjatjen e paraburgimit, 264/1
- mospranimi, 433
- nënshkrimi i aktit nga mbrojtësi, 435/2
- për kohëzgjatjen e paraburgimit, 249/9, 10
- paraqitja, 435

REPLIKA

- e drejta, 378/3
- nuk lejohet, 437/5

REVOKIMI

- i vendimit për pezullimin e procedimit, 45
- e drejta e gjykatës, 246
- i arrestit, 248
- i masës së sigurimit, 260
- i sekuestros, 272
- i vendimit të pezullimit, 343
- i vendimit të deklarimit, 351
- i vendimit për marrjen e provave, 357
- i vendimit të dënimit, 474
- i vendimit të lirimit, 477
- i vendimit të dënimit për shkak të shfuqizimit të veprës penale, 479
- afati i revokimit të masave shtrënguese, 493, 494, 515

RIGJYKIMI

- ndalimi i gjykitimit dy herë, 7
- ankimi kundër vendimit, 44
- pas prishjes, 417

RISHIKIMI

- ankimi kundër vendimit, 458
- forma e kërkesës, 452
- gjykimi, 455
- kërkesa, 451
- kompensimi në rast vdekjeje, 460
- kompensimi për dënim të padrejtë, 459
- mospranimi i kërkesës, 453
- pasojat e mospranimit ose rrëzimit të kërkesës, 461
- pezullimi i vendimit, 454
- rastet, 450
- vendimet që mund të, 499
- vendimi, 456, 457

RUAJTJA

- e përsheptuar dhe mirëmbajtja e të dhënave kompjuterike, 299/a
- e përsheptuar dhe zbulimi i pjesshëm i dhënave kompjuterike, 299/b

- S -

SEANCA GJYQËSORE

- caktimi, 333
- drejtimi, 341
- e gjyqimit të shkurtuar, 405
- largimi i të pandehurit, 344/2, 352
- mungesa e të pandehurit, 351
- ndalohet prania e të miturve, të dehurve, të armatosurve, 339
- ndërprerja, 342/2
- prania e të pandehurit, 344
- procesverbali, 345-347
- publiciteti, 339
- rastet e gjyqimit me dyer të mbyllura, 340

- shtyrja, 342/1

SEKRETARIA E GJYKATËS

- depozitimi i aktit, 136, 137
- depozitimi i akteve të përgjimit, 223/4
- depozitimi i njoftimeve publike, 138
- depozitimi i vendimeve për masat e sigurimit, 246/4
- i dorëzon të intresuarit kopjen e aktit të njoftimit, 132/3
- lëshon kopje të akteve, 197
- njoftimi me telefon, 133

SEKRETE

- detyrimi për dorëzimin e dokumenteve, 211
- ndalimi i publikimit të akteve, 103
- përjashtimi, 161
- ruajtja e sekretit profesional, 159
- ruajtja e sekretit shtetëror, 160
- veprimet hetimore, 279

SEKSIONI

- për gjykimin e të miturve, 13
- për krimet e rënda në Gjykatën e Apelit Tiranë, 14
- të policisë gjyqësore, 31, 33

SEKUESTRIMET

- disponimet në rast moskthimi të sendeve të sekuestruara, 219
- e sendeve të zbuluara gjatë kontrollit, 207
- i dokumenteve sekrete, 211
- kopje e dokumenteve të sekuestruara, 213
- korrespondencës, 209
- kthimi i sendeve të sekuestruara, 217,218
- kundërshtimi i vendimit, 212
- objekti, 208
- organi që disponon, 209

- pranë bankave, 210
- ruajtja e sendeve të sekuestruara, 214
- shpenzimet për sendet e sekuestruara, 220
- vulosja e sendeve të sekuestrura, 215,216
- i të dhënave kompjuterike, 208/a

SEKUESTROJA KONSERVATIVE

- efektet pushojnë, 271/4
- ekzekutimi i masës, 273
- kushtet dhe efektet, 270
- revokimi ose mosvënia, 272
- vendimi i gjykatës, 271
- vënia nga policia gjyqësore, 300
- vleftësimi nga prokurori, 301

SEKUESTROJA PREVENTIVE

- ankimi kundër vendimit, 276
- heqja, 274/3
- humbja e fuqisë, 275
- objekti, 274
- vendosja, 274/2
- vendimi për, 274

SIGURIMI I PROVËS

- disponimi mbi kërkesën, 320
- kërkesa, 317
- kërkesa e viktimës, 318
- gjatë gjykimit, 336
- marrja e provës, 321
- paraqitja e kërkesës, 319
- përdorimi i provave të marra, 322
- rastet, 316

- SH -

SHPENZIMET PROCEDURALE

- caktimi, 485/3
- çfarë përfshihen, 485/2
- detyrimi i të dënuarit, 393
- detyrimi i ankuesit, 398
- detyrimi i palëve private, 397
- e bëra nga shteti, 485
- ekzekutohen nga zyra e përmbarimit, 486
- kur rrëzohet ose deklarohet i papranueshëm ankimi, 421
- kur tërhiqet ankimi, 286/3
- pagimi, 486
- për përsëritjen e aktit, 131/2
- të ekstradimit, 503
- zgjidhja e ankesave për, 48

SHUARJE

- e masave të sigurimit, 261
- e veprës penale, 479
- e dënimit, 480

- T -

TELEGRAF-TELEFON

- njoftimet urgjente, 133

TRANSFERIMI I ÇËSHTJES

- kërkesa, 95
- shkaqet, 94
- pasojat e kërkesës, 96
- vendimi mbi kërkesën, 97

- TH -

THIRRJA

- e dëshmitarëve që kërkohen nga autoriteti i huaj, 508
- e dëshmitarëve dhe ekspertëve nga gjykata, 337
- e ekspertit nga organi procedues, 182/2
- e palëve nga gjykata e caktuar për rigjykimin e çështjes, 455
- e përkthyesit dhe ekspertit nga prokurori, 312/3
- e viktimës, 376
- e të paditurit civil, 65
- ndarja e çështjes për shkak të pavlefshmërisë ose padijenisë së aktit të thirrjes, 93
- nga gjykata e apelit, 426
- nga prokurori e personit që hetohet, 308
- nga prokurori e personave që kanë dijeni për veprën, 312
- pavlefshmëria e aktit kur thirja e të pandehurit është e detyrueshme, 128
- përsëritja, 349, 350
- si objekt i letërporosisë, 505
- zbatimi i dispozitave për thirrjen e të pandehurve në një procedim të lidhur, 167

- U -

URDHRI

- arsyetohet, ndryshe i pavlefshëm, 112/3
- disponimi nga gjykata me, 112
- i gjykatës për marrjen e provave, 151
- i përsëritjes së veprimeve në të cilat pala kishte të drejtë të merrte pjesë, pas rivendosjes në afat, 148
- i policisë gjyqësore për pezullimin e dërgimit të korrespondencës, 299
- i prokurorit për policinë gjyqësore, 30
- jepet me gojë, 112/6
- kthimi i sendeve të sekuestruara, 218
- mospritja e urdhrit të prokurorit për ndalimin, 253

- në gjykimin e drejtpërdrejtë, 401
- në veprimet paraprake të gjykimit në apel, 426
- njoftimi i personave, përveç të pandehurit, 133, 138
- njoftimi dhe kërkimi i të pandehurit kur nuk gjendet dhe jashtë shtetit, 141, 142
- për drejtimin e seancës, 341
- për ekzekutimin e vendimeve me burgim, 464
- për kryerjen e ekspertimit për përgjegjshmërinë e të pandehurit, 43
- për kryerjen e ekspertimit për verifikimin e moshës së të pandehurit, 41
- për llogaritjen e paraburgimit dhe të dënimeve të shlyera, 465
- për pyetjen e dëshmitarit të mitur, 361
- për ruajtjen e të pandehurit në një institucion psikiatrik, 46
- për shpërblimin e ekspertit, 183/2
- për të mos i dhënë rrugë letërporosisë së autoritetit të huaj, 509
- zëvendësimi i prokurorit, 27

- V -

VENDIMI

- arsyetohet, ndryshe i pavlefshëm, 112/3
- askush nuk mund të deklarohet fajtor pa vendim, 11
- ekzekutimi, 462-480
- efektet e vendimit penal për gjykimin civil dhe administrativ, 70
- elementet, 383
- depozitimi, 386
- dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Lartë, 441-446
- i dënimit, 390
- i gjykatës së apelit, 428
- i pafajsisë, 388
- i pushimit të çështjes, 387
- i rishikimit, 456, 457
- jepet në bazë të provave e të ligjit, 13
- kur vendimi penal varet nga zgjidhja e një mosmarrëveshjeje civile, 71/2

- marrja kolegjalisht, 381
- menjëhershmeria e marrjes, 379
- merret në dhomën e këshillimit, 112/4
- mbi kërkesën e transferimit, 97
- mbi kompetencën, 86
- ndreqja, 385
- njohja e vendimeve të huaja, 512, 513
- pasojat e vendimit civil në gjykimin penal, 71
- përfundimtar në emër të popullit, 112/2
- për caktimin e masave të sigurimit, 245
- për mosfillimin e procedimit, 291
- për sekuestron konservative, 271
- për sigurimin e provës, 320
- përpilimi, 382
- pezullimi i ekzekutimit për shkak ankimi, 417
- provat që mund të përdoren, 379
- publikimi për të riparuar dëmin jopasuror, 399
- revokimi për shkak të shfuqizimit të veprës penale, 479
- shpallja, 384
- për kërkesën e ekstradimit, 498
- zbatimi i detyrueshëm i vendimit të Gjykatës së Lartë, 440

VEPRA PENALE

- marrja në dijeni, 280
- kallëzimi nga nëpunësit publikë, 281
- kallëzimi nga personeli mjekësor, 282
- kallëzimi nga shtetasit, 283
- kur kryhet në sallën e gjyqit, 341/2
- referimi nga policia gjyqësore tek prokurori, 293
- regjistrimi i njoftimit, 287

VERIFIKIM

- e ngutshme në vend, 300
- i aftësive për të dëshmuar, 155

- identiteti, 40
- i legjitimitetit të palëve ne Gjykatën e Lartë, 437
- i legjitimitetit të palëve në rastin e gjykimit të shkurtuar, 405
- i paraqitjes së palëve para shqyrtimit gjyqësor, 348
- mbajtja e procesverbalit nga prokurori si dokumentim i veprimeve, 315
- moshë, 41
- ne rastin e ruajtjes së sekretit, 211
- në rastin e shqyrtimit të kërkesës për ekstradim, 497
- në rastin e zgjatjes së paraburgimit, 264
- personalitet, 42
- përgjegjshmërie, 43
- pjesëmarrja e mbrojtësit, 302
- teknike në rastin e ekspertimit, 314
- urdhërohet nga gjykata kur dyshohet se personat duan t'i shmangen dëshmisë, 159
- zgjatja e afatit të ekspertimit kur ka nevojë për verifikime, 185
- zgjatja e afatit të masave shtrënguese në rastin e ekstradimit kur ka nevojë për verifikime, 493

VLEFTËSIMI

- gjykata që ka bërë vleftësimin e përgjimit vendos për asgjësimin e dokumentacionit, 224
- i arrestit dhe ndalimit, 257-259
- i përgjimit, 222
- i sekuestros, 301
- kërkimi i autorizimit për të proceduar përpara seancës, 288

VULË

- vulosje e sendeve të sekuestruara, 215
- procedura e heqjes dhe vënies së vulave, 216

- Z -

ZBATIMI

- i detyrueshëm i vendimit, 440
- i marrëveshjes, 10

ZËVENDËSIM PROKURORI

- rastet kur, 27

ZGJATJE AFATI

- rrethanat kur, 324
- e drejta e ankimit kundër vendimit të, 325
- pamundësia e, 415

ZOTËSIA JURIDIKE

- të drejtat e personit të dëmtuar, 58
- e drejta e të pandehurit për t'u ankuar, 410

ZYRA E GJENDJES GJYQËSORE

- depozitimi i vendimeve të shkurtuara, 481

ZYRA E PËRMBARIMIT

- ekzekutimi i dënimeve me gjobë, 467
- ekzekutimi i detyrimeve për shpenzimet procedurale, 486

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

RSH. Kuvendi

Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë /
RSH. Kuvendi. - Tiranë : Qendra e Botimeve Zyrtare,
2018.

... f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-01-081-0

1.E drejta penale 2.Procedura penale 3.Ligje

343.1(496.5) (094)



Çmimi: 2792 lekë